



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

**T R A N S K R I P T**

**I MBLEDHJES SË JASHTËZAKONSHME TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS  
SË KOSOVËS, E MBAJTUR MË 20 PRILL, 31 MAJ, 1 DHE 4 QERSHOR 2018**

**SA VANREDNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,  
ODRŽANE 20. APRILA, 31. MAJA, 1 I 4. JUNA 2018. GODINE**

**PRILL/MAJ/QERSHOR - APRIL/MAJ/JUN  
2018**

## **Rendi i ditës**

1. Debat parlamentar lidhur me Raportin e Progresit për Republikën e Kosovës

## **Dnevni red**

1. Parlamentarna rasprava o Izveštaju progressa za Republiku Kosova

## **Mbledhjen e drejtoi nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.**

KRYESUESI: Të nderuar deputetë,

Zoti ministër,

Të tjerët e kanë lexuar dhe e kanë studiuar, me siguri Qeveria nuk ka nevojë të merret me raportin.

I hap punimet e seancës së jashtëzakonshme të Kuvendit të Republikës së Kosovës, me kërkesë të 40 deputetëve të Kuvendit.

Konstatoj se në sallë janë të pranishëm 40 deputetë.

### **1. Debat parlamentar lidhur me Raportin e Progresit për Republikën e Kosovës**

Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje, mbështetur nga 40 deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, ka parashtruar kërkesë për debat parlamentar lidhur me Raportin e Progresit për Republikën e Kosovës.

Ftoj zonjën Fitore Pacolli që në emër të propozuesit ta paraqesë çështjen për të cilën është kërkuar debati parlamentar.

FITORE PACOLLI: Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Të nderuar deputetë,

15 vjet më parë u konfirmua perspektiva evropiane për të gjitha shtetet e Ballkanit Perëndimor, përfshirë Kosovën.

Mirëpo 15 vjet më vonë kjo perspektivë u rikonfirmua prapë për të gjitha shtetet e Ballkanit, mirëpo për Kosovën rruga drejt integritimit evropian praktikisht ende mbetet e mbyllur.

Raporti për vendin, i cili u publikua para katër ditëve, nuk duhet të trajtohet vetëm si një dokument, i cili skanon dhe paraqet gjendjen e rëndë në të cilën gjendet shteti ynë, por si një dokument përmes të cilit ne fillojmë seriozisht të shqyrtojmë rrugën dhe marrëdhënien kontraktuale shtetërore të Kosovës me Bashkimin Evropian.

Pra, që tani është më se e domosdoshme të fokusohemi në saktësimin e hapave të ardhshëm që do të ndërmarrë Kosova. A do të aplikojmë për status të shtetit kandidat? Nëse po, kur? Si do t'i evitojmë pengesat që kemi, e sidomos çfarë qasje do të ketë Kosova ndaj 5 shteteve të BE-së që nuk e kanë njohur Kosovën?

Këto çështje nuk janë vetëm temë e përgjithshme politike, por agjenda kryesore dhe prioritare e Ministrisë së Integritimit, Ministrisë së Jashtme dhe Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Kjo sepse, siç është konfirmuar e rikonfirmuar përmes qëndrimeve të BE-së, Kosova është vendosur te dy mekanizma: tek ai përmbushjes dhe zbatimit të MSA-së, me zbatimin e së cilës kemi mbetur shumë prapa dhe tek mekanizmi që mat përparimin ose jo të Serbisë drejt integritimit në BE përmes dialogut, me fillimin e të cilit Kosova humbi rastin e saj të jashtëzakonshëm për të kushtëzuar rrugën evropiane të Serbisë me njohjen e Kosovës.

Në vend se përqendrimi ynë të ishte tek rruga jonë drejt BE-së, personat që edhe sot mbajnë pozitat kyçe në vend bartën tërë fokusin në organizimin e dialogut me Serbinë dhe kështu zbehën edhe vendimin pozitiv për pavarësinë e Kosovës të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë. Dhe është pikërisht kjo qasje, e cila po vazhdon të mbizotërojë edhe sot, që ka ndikuar që Kosova të jetë këtu ku është.

Sot as shtetet të cilat ishin përkrahëset më të mëdha të pavarësisë së Kosovës nuk bëjnë më as thirrje te 5 shtetet e BE-së që të njohin Kosovën, edhe pse mosnjohja nga 5 shtetet anëtare mbetet pengesë serioze dhe e pakapërcyeshme për Kosovën në realizimin e aspiratës së saj drejt integritimit evropian.

E për më keq, mosnjohjen e Kosovës nga 5 shtetet e BE-së kanë filluar ta shohin si përparësi, pasi që BE si neutrale ndaj statusit të Kosovës po e ka më lehtë të luajë rolin e saj si 'lehtësuese' e dialogut. Ndërsa Kosova nuk ka ndërmarrë asnjë hap për të përmirësuar marrëdhëniet bilaterale me këto 5 shtete.

Strategjia e BE-së për zgjerim të Ballkanit Perëndimor definoi rrugët e strukturuar që duhet të ndjekin shtetet veç e veç për të avancuar drejt integritimit evropian, por Kosova u trajtua vetëm si mjet përmes së cilës i hapet rruga Serbisë. Për derisa Serbisë iu bë e qartë se normalizimi i marrëdhënieve me Kosovën do t'i sigurojë anëtarësimin në BE, Kosovës iu tha se duhet të vazhdojë të jetë e përkushtuar në dialog, sepse edhe Kosova përfiton nga normalizimi, por nuk u tha se çka. Pra, Kosova në këtë strategjinë e Bashkimit Evropian mbetet pjesë e dokumentit, por nuk është pjesë e strategjisë së zgjerimit.

Prandaj, ne sot kemi mundësinë ideale të përmirësojmë gabimet e bëra. Të mos ngutemi me platformë të re të dialogut me Serbinë pa analizuar se çfarë ka humbur dhe fituar Kosova nga dialogu dhe pa e pasur të qartë rrugën të cilën duhet ta ndjekim.

Ne nuk duhet të humbim edhe disa vjet duke e fokusuar tërë potencialin tonë në dialog me Serbinë, nga i cili më shumë humbëm sesa fituam, por duhet të fokusohemi urgjentisht në

çështjet e brendshme e të jashtme, të cilat prekin direkt të ardhmen e këtij vendi dhe jetën e qytetarëve tonë.

E për këtë, ky raport i vendit, i cili më parë është quajtur ‘Raport i Progresit’, e të cilit emri që i përshtatet më së shumti sot është ‘Raport i regresit’, paraqet shumë çështje në të cilat, të gjitha qeveritë që nga shpallja e pavarësisë kanë dështuar të sjellin rezultate pozitive.

Unë do të jap një përmbledhje të të gjeturave, duke krahasuar ato me të gjeturat e raporteve nga vitet 2014, 2015 dhe 2016, nga të cilat shohim se pas sa vjetëve gjendja e rëndë në vendin tonë është bërë edhe më e rëndë.

1. Reforma elektorale përmendet në pothuajse të gjitha raportet, kjo kërkesë përsëritet edhe në raportin e vitit 2018, i cili thekson nevojën për vullnet politik për të bërë reformat e nevojshme. Pra, është kaq e thjeshtë, nevojitet vetëm vullnet politik, i cili mungon ngase partive në pushtet nuk u konvenon reforma.

2. Administrata publike, ndonëse është bërë pak progres ndër vite, administrata mbetet tejte e politizuar dhe kjo është paraqitur si shqetësim serioz në të gjitha raportet, përfshirë edhe këtë të fundit, ku konsiderohet shqetësuese vazhdimi i thellimit të politizimit të administratës nga kjo qeveri, ku përmenden emërimet e fundit partiake në ndërmarrjet dhe agjencitë publike.

3. Sistemi i drejtësisë në të gjitha raportet theksohet se është bërë pak progres dhe pavarësisht kësaj, ky sistem vazhdon të cenohet nga ndërhyrjet politike.

4. Lufta kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar ka mbetur vetëm në strategjitë e shumta të qeverive, të cilat kanë udhëhequr me vendin. Korrupsioni mbetet i përhapur në shumë sfera dhe vazhdon të mbetet problem serioz. Efikasiteti i hetimeve vazhdon të pengohet nga ndërhyrjet politike për t’i mbrojtur kokat e krimit nga ndjekja penale. Raporti tërheq vërejtjen se numri i dënimeve përfundimtare, hetimeve financiare dhe konfiskimit të aseteve mbetet i vogël.

5. Zhvillimi ekonomik, edhe gjatë raportimit dje të ministres së Integritetit Evropian u pa shumë se ka tendencë që ky raport të paraqitet si pozitiv.

Pra, konstatoi se në këtë raport thuhet se Kosova ka bërë shumë progres sa i përket zhvillimi ekonomik. Unë veçse e kisha lexuar raportin fjalë për fjalë dhe e kisha krahasuar atë me të gjitha raportet e tjera dhe nuk mund ta kuptoj si ministria ka gjetur fjalën ‘shumë progres’ në raport, sepse në secilën faqe nuk bëhet fjalë për shumë progres.

Pra, raporti konstaton se Kosova mbetet në fazë të hershme të zhvillimit të ekonomisë funksionale dhe për dallim nga viti i kaluar, ka pasur rritje të mëtutjeshme të papunësisë, e cila

ka prekur veçanërisht gratë, të rinjtë dhe punëtorët joprofesionalë. Kosova vazhdon të mbetet vendi më i varfër në rajon. Për çfarë progresi atëherë po flasim?

6. Sistemi i arsimit pas sa e sa strategjive e reformave që kanë ndodhur, në secilin raport e gjeni se Kosova nuk ka bërë asnjë përparim në përmirësimin e arsimit dhe në përgatitjen e të rinjve për tregun e punës. Numri i fëmijëve që ndjekin mësimin parashkollor mbetet shqetësues. Vetëm 18% e fëmijëve janë të sistemuar nëpër çerdhe. Ndërsa investimi në shkencë dhe hulumtime shkencore është praktikisht joekzistent. Edukimi mbetet sektor me rrezik të lartë për korrupsionin dhe ndikimet politike, të cilat pasqyrohen edhe në vendimin skandaloz të kësaj qeverie që rezultojë me përjashtimin e Kosovës nga EQAR.

7. Shqetësuese mbetet edhe gjendja e rëndë në shëndetësi. Raporti thekson se mbetet shqetësuese vlera e ulët e investimeve në këtë sektor. Tepër shqetësuese është se rreth 30% të popullsisë nuk arrijnë të marrin shërbimet e nevojshme shëndetësore për shkak të varfërisë ekstreme në vend.

8. Liria e shprehjes vetëm është përkeqësuar. Për dallim prej viteve të tjera, numri i kërcënimeve dhe sulmeve ndaj gazetarëve është rritur. Vetëm gjatë vitin 2017 kanë ndodhur 24 incidente, pra dyfishi i numrit krahasuar me periudhën e mëparshme të raportimit.

9. Ndonëse Kosova përballet me ndotje të lartë të ambientit, nuk ka asnjë përparim në zgjidhjen e problemeve mjedisore që ndikojnë direkt në shëndetin e qytetarëve.

Pasi që i paraqita të gjitha këto probleme, unë në fund të kësaj seance i ftoj të gjithë deputetët që të definojnë rekomandime, qoftë përmes grupeve të tyre parlamentare, qoftë së bashku dhe pastaj t'i përmbledhim këto rekomandime në një grup të caktuar, ku ia dërgojmë Qeverisë, e cila duhet t'i ndërmarrë pa humbur kohë.

Pra, rekomandimet tona duhet të kenë qëllim primar përmirësimin e kushteve të jetës për qytetarët e Republikës së Kosovës dhe ndryshimin e agjendës shtetërore për të përcaktuar rrugën që duhet të ndjekim si shtet...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYESUESI: Regjia, le ta përfundojë raportin.

FITORE PACOLLI: Unë i kam disa rekomandime, presim që deputetët e tjerë t'i sjellin rekomandimet e tyre, prandaj do t'i lexoj në fund të seancës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, zoti Hoti e ka fjalën.

AVDULLAH HOTI: Faleminderit, kryesues i seancës!

Ne sot jemi duke shqyrtuar një raport shumë të rëndësishëm. Unë shpresoj që deputetët kanë arritur ta lexojnë, e kam parasysh për arsye teknike nuk është përkthyer materiali në gjuhën shqipe, në gjuhën serbe, që të jetë në dispozicion për të gjithë deputetët këtu në Kuvend. Besoj që tash për shkak të kësaj pengese jo të gjithë deputetët do të jetë plotësisht të involvuar në debatin që bëhet këtu në Kuvendin e Kosovës dhe për këtë kërkoj mirëkuptim.

Raporti e qartëson se Qeveria e Kosovës nga shtatori 2017 nuk ka dërguar asnjë sinjal bindës në Bruksel se është serioze të kryejë obligimet që i ka shteti i Kosovës, si rezultat i kësaj dalja e kosovarëve nga izolimi nuk ka ndodhur ende.

Te kriteret politike të këtij raporti, derisa ai i vitit 2016 e përmend polarizimin mes Qeverisë dhe opozitës, që është normale, në fakt, raporti i fundit vë në dukje polarizimin brenda vetë koalicionit qeverisës dhe brishtësinë e koalicionit, i cili tani e ka humbur dhe shumicën e thjeshtë. Kjo brishtësi në fakt i ka pamundësuar këtij koalicioni që të ndërtojë një konsensus të përgjithshëm për tema të rëndësishme nacionale në përputhje me agjendën evropiane.

Raporti thekson tendencën e institucioneve për t'u ikur obligimeve ndërkombëtare. I vetmi sukses që përmendet në këtë raport është ratifikimi i marrëveshjes së demarkacionit me Malin e Zi, i cili u përmbush falë angazhimit të Lidhjes Demokratike të Kosovës.

Raporti thekson se Qeveria ka dështuar ta adresojë rekomandimet e dhëna të vitit 2016, që tregon një mungesë serioziteti përballë këtyre obligimeve ndërkombëtare.

Te funksionimi i institucioneve, në mënyrë të vazhdueshme ne si grup parlamentar kemi vënë në dukje funksionimin jo të rregullt të Kuvendit të Kosovës, edhe mungesën e Qeverisë në seancat e Kuvendit të Kosovës. Tani kjo po vërtetohet në këtë raport, është theksuar qartë që në punën e Kuvendit shpesh ka munguar kuorumi edhe për shkak të mungesës së vetë lidershit të Kuvendit dhe të Qeverisë dhe se ka munguar një debat konstruktiv në mes të Qeverisë dhe Kuvendit si rezultat i neglizhencës që Qeveria ka treguar ndaj Kuvendit.

Kritika jepen edhe për Qeverinë, për numrin shumë të madh të zëvendësministrave dhe për mungesën e krejt Kabinetit qeveritar në seancat plenare.

Te sundimi i ligjit dhe lufta kundër korrupsionit, përveç integritit të gjyqtarëve dhe prokurorëve serbë në sistemin e drejtësisë kosovare, gjë e cila ka ndodhur në fillim të vitit 2017, nuk përmendet ndonjë përparim i dukshëm sa i përket përmbushjes së këtyre kriterëve që lidhen me reforma në drejtësi. Vihet në dukje vonesa në miratimin e pakos së ligjeve të fushës së drejtësisë dhe brishtësia e sistemit gjyqësor në Kosovë përballë ndikimeve politike.

Fatkeqësisht në raport përmendet edhe vendimi i fundit për dëbimin e shtetasve turq pa e përfillur asnjë procedurë ligjore.

Lufta kundër korrupsionit mbetet sfida kryesore e institucioneve të Kosovës dhe e theksova se korrupsioni mbetet akoma i përhapur në shumë fusha dhe se efikasiteti i hetimeve vazhdon të pengohet nga politika.

Te reforma në administratën publike akoma nuk është miratuar pakoja e ligjeve të administratës publike, shërbimi civil dhe të pagave dhe raporti gjithashtu ngrë shqetësim lidhur me disa emërimet dhe në disa raste shkarkime në shërbimin civil të lartë, institucione dhe agjenci të pavarura, të cilat nuk janë bazuar në merita dhe duke u nënshtuar ndaj ndikimit politik.

Te fusha e ekonomisë, vërehet se Kosova ka bërë përparim në vendosjen e rregullave për zhvillimin e një ekonomie të tregut që është funksionale.

Gjithashtu potencohet edhe ruajtja e rregullës fiskale për deficitin buxhetor, por shprehet shqetësimi te rreziku që vjen në stabilitetin buxhetor nga disa shpenzime të paplanifikuara dhe skema të ndryshme pensionale.

Te liria e shprehjes vërehet se nuk është bërë asnjë progres, kërcënime dhe sulme ndaj gazetarëve vazhdojnë. Krahasuar me vitin 2016, është dyfishuar numri i sulmeve dhe kërcënimeve ndaj gazetarëve, nuk është treguar përkushtim në zgjidhjen e financimit të transmetuesit publik, duke lënë atë plotësisht të hapur ndaj ndikimeve politike.

Sa u përket të drejtave të njeriut, është bërë përparimi në miratimin e legjislacionit në përputhje me standardet e BE-së, por që në asnjë nga këto raste ky legjislacion nuk respektohet.

Në fushën e arsimit raporti vlerëson si gjendje shqetësuese, pa asnjë progres, në veçanti në përmirësimin e cilësisë në arsim. Rekomandohet si nevojë urgjente adresimi i ndryshimeve që duhet të ndodhin në Ligjin për arsimin e lartë, në reformimin e kurrikulave, në funksionimin e pavarur të institucioneve të arsimit të lartë dhe mekanizmave të tjerë që sigurojnë cilësinë e arsimit të lartë.

Kërkesa të tilla, në fakt, janë diskutuar edhe në këtë Kuvend, siç është rasti me përjashtimin e përkohshëm të Kosovës nga Regjistri Evropian i Cilësisë.

Te dialogu me Serbinë dhe normalizimin e marrëdhënieve Kosovë-Serbi, raporti thekson se Kosova ka qenë e angazhuar në dialog, në zbatimin e marrëveshjeve, por kërkohet angazhim shumë i madh në këtë drejtim.



Më lejoni në fund të theksoj disa çështje se është tepër e nevojshme që të gjitha forcat politike në Kosovë të arrijnë një konsensusit nacional për reformat që duhet të ndërmerren për të adresuar sfidat e këtij raporti dhe tema të mëdha që na presin përpara.

Më lejoni të them prapë para jush këtu që është më se e qartë që koalicioni qeverisës, tanimë i pakicës, nuk mund ta bëjë këtë, nuk e ka as vullnetin politik edhe as mbështetjen e nevojshme qytetare dhe politike për të ndërtuar këtë lloj konsensusi për tema të mëdha.

Tryeza apo takimi i partive politike është më se i nevojshëm, i cili tanimë është caktuar për të mërkurën.

Më lejoni që edhe këtu në foltore për para jush t'ju njoftoj që ftesat do t'i pranoni gjatë ditës së sotme për takimin e të mërkurës të partive politike për të filluar ndërtimin e këtij konsensusi për ta nxjerrë Kosovën nga kjo krizë politike dhe institucionale.

Unë shpresoj shumë që të gjithë do t'i kalojmë agjenda ditore politike dhe të bashkohemi për ndërtimin e këtij konsensusi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, zonja Blerta Deliu e ka fjalën.

BLERTA DELIU-KODRA: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar ministra,

Po e them që në fillim të fjalës time që për një raport të tillë për vendin unë kam pritur që të jetë e pranishme edhe Qeveria me numër më të madh, sepse është një raport tejet i rëndësishëm. Pajtohem që Kryesia e Kuvendit dje ka vendosur për thirrjen e kësaj seance për të trajtuar raportin për vendin të Komisionit Evropian pas nënshkrimit që është bërë nga 40 deputetë, ndonëse po e them në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, mendoj se kjo seancë po mbahet pa u shqyrtuar mirë raporti në fjalë, pasi që ne ende nuk e kemi përkthimin zyrtar të këtij raporti tejet të rëndësishëm dhe besoj se deputetët në këtë fazë nuk kanë arritur që ta shqyrtojnë mirë këtë raport për vendin.

Prandaj, unë kam pritur që të mos ketë nguti për një raport të tillë, ta trajtojmë si duhet dhe t'i prekim fushat specifike, pastaj të ftohet seanca e sotme në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Megjithatë unë e respektoj vendimin e nënshkrimeve të 40 deputetëve që kjo seancë të thirret dhe do ta vazhdoj fjalën time sot.

Komisioni për Integritet gjatë ditës së djeshme ka diskutuar këtë raport bashkë me anëtarët e komisionit dhe ministren e Integritetit, zonjën Dhurata Hoxha dhe ka rekomanduar po ashtu që i njëjti raport të diskutohet në seancë plenare, pasi të shteren mundësitë e shqyrtimit të deputetëve veç e veç të këtij raporti të rëndësishëm.

Si kryetare e Komisionit për Integritet konsideroj se Raporti për vendin është raport i arsyeshëm, mjaft objektiv që paraqet pasqyrën reale të progresit të vendit gjatë dy vjetëve të fundit, periudhë kjo që e mbulon ky raport.

Komisioni Evropian edhe një herë konfirmon përkushtimin e vazhdueshëm për të ardhmen evropiane të vendit, po ashtu sikurse edhe strategjia e zgjerimit të Bashkimit Evropian flet saktësisht për perspektivën e Kosovës në BE, duke saktësuar se tashmë vendet anëtare të Bashkimit Evropian e pranojnë dhe e trajtojnë Kosovën si shtet të pavarur dhe sovran, përfshirë këtu edhe ato shtete të cilat ende nuk e kanë njohur Republikën e Kosovës.

Zgjedhjet lokale dhe parlamentare janë vlerësuar si mirë të administruara në shumicën e vendeve në Kosovë.

Ratifikimi i marrëveshjes së kufirit me Malin e Zi është vlerësuar si përparim i rëndësishëm, duke u cilësuar si veprim tejte i rëndësishëm i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Po ashtu veprim i papranueshëm dhe jodemokratik është cilësuar përdorimi i gazit lotsjellës, i cili ka penguar procedurat parlamentare në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Reforma e administratës publike dhe përparimi që është bërë në shqyrtimin e agjencive ka marrë notë pozitive, megjithëse politizimi i administratës vazhdon të jetë ende shqetësim që adreson edhe raporti i vendit.

Në takimet që i kemi pasur bashkë me kolegët deputetë, me ministrin e Administratës Publike, na është konfirmuar se Ministria e Administratës Publike do të sjellë në Kuvend në muajin qershor pakon e re të ligjeve, të cilat do të ndikojnë në reformën e administratës publike, e ku përfshihen Projektligji për organizimin e administratës, Projektligji për pagat e zyrtarëve të lartë dhe Projektligji për shërbyesit civilë, projektligje të cilat besoj shumë që do të shënojnë rezultate konkrete në atë që është sfida, e që thuhet që është politizimi i vazhdueshëm i administratës.

Sa i përket komponentit të sundimit të ligjit, raporti i fundit vlerëson pakon e ligjeve të vitit 2015 si dhe integritetin e gjyqtarëve dhe prokurorëve serbë të Kosovës në sistemin gjyqësor të Republikës së Kosovës.

Të nderuar kolegë deputetë,

Raporti për vendin ka njohur progresin e institucioneve të Republikës së Kosovës sa i përket luftimit të krimit të organizuar dhe të korrupsionit dhe ka pasur evoluim pozitiv në të ashtuquajturën ‘trac records’, posaçërisht në rastet e ashtuquajtura të profilit të lartë të korrupsionit dhe të krimit të organizuar.

Ka një strategji shumë më të qartë dhe shumë më konkrete sa i përket këtij komponenti.

Legjislacioni dhe nismat e reja, të cilat vijnë nga Ministria e Drejtësisë, harmonizohen vazhdimisht me direktivat e Bashkimit Evropian, por prapëseprapë sfida mbetet implementimi dhe fuqizimi i mekanizmave mbikëqyrës që këto projektligje të kenë masat edhe sanksionet e tyre.

Po ashtu ka progres në konfiskimin e pasurisë së fituar në mënyrë të paligjshme, edhe pse jo progres shumë të thellë, ndonëse ka pak raste, ne duhet të vazhdojmë mekanizmat për ta fuqizuar këtë komponent dhe duhet të miratohet po ashtu Ligji për konfiskimin e pasurisë së paluajshme të fituar me vepër penale.

Procesi i liberalizimit të vizave është reflektuar pozitivisht në raport, ndonëse është pothuajse i ndarë si proces, madje të katër kriteret teknike tashmë pothuajse janë përmbyllur dhe ne po presim vlerësimin e delegacionit të lartë të Bashkimit Evropian, i cili javën e ardhshme do të vizitojë Kosovën dhe besoj që do të ofrojë rekomandim të qartë lidhur me informatat që do t'i mbledhë sa i përket progresit që kanë shënuar institucionet në këtë komponent.

Kosova ka plotësuar kornizën ligjore në trajtimin të migrimin ilegal dhe migrimin të parregullt, si dhe është plotësuar po ashtu korniza ligjore sa i përket azilit. U përmend liria e shprehjes dhe raporti për vendin vlerëson se ka progres në lirinë e shprehjes, duke u vlerësuar që Kosova vazhdon të ketë një mjedis pluralist dhe një mjedis të gjallë. Është e vërtetë që sulmet ndaj gazetarëve kanë vazhduar, ndonëse po punohet shumë që institucionet të jenë të përgjegjshme dhe t'i adresojnë këto shqetësime, të cilat nuk duhet të rriten.

Transmetuesi publik është kërkuar të ketë një trajtim të Kuvendit të Republikës së Kosovës për të gjetur financimin e qëndrueshëm dhe për të zgjidhur një herë e përgjithmonë këtë çështje. Progresi në ekonomi ka marrë notë pozitive, posaçërisht përmirësimi i ambientit të të bërit biznes që reflektohet në raportin e vendit, por edhe këtu mbetet sfida papunësia, e cila në masë të madhe ka prekur gratë dhe të rinjtë. Dhe, kur përmendim gratë, raporti i vendit po ashtu adreson edhe mungesën e implementimit të saktë të Ligjit për barazi gjinore, ndonëse ne si Kuvend kemi miratuar një ligj të mirë dhe mjaft afirmativ, institucionet e Republikës së Kosovës ende nuk kanë arritur që ta adresojnë dhe ta implementojnë këtë ligj me saktësi. Nëse kthehemi vetëm te zgjedhjet lokale, të cilat i kemi mbajtur, është parë që ka pasur një numër të vogël të grave, të

cilat janë kandiduar nga partitë politike si kandidate për kryetare të komunave dhe në këtë shqetësim duhet ta adresojmë.

Po ashtu, përmendet edhe sfidë përfshirja e vogël e grave në Qeveri dhe në institucione të tjera vendimmarrëse. Si adresime të tjera që do t'i përmend, shumë shqetësuese është edhe, madje quhen pa asnjë përparim, cilësia e arsimit, e cila thuhet në raport është tejte e dobët, e këtu konsideroj se shqetësimi rritet edhe më shumë kur e kemi parasysh vendimin e fundit për përjashtim të Kosovës nga Regjistri Evropian për Cilësi të Arsimit të Lartë. Konsideroj që ky vendim e ka rënduar rritjen e cilësisë së arsimit në Republikën e Kosovës dhe po ashtu, raporti paraqet si shqetësuese çështjet mjedisore, të cilat kërkohet nga institucionet e Republikës së Kosovës që t'i adresojnë me seriozitet të shtuar.

Si adresime të fundit në raport janë thirrjet për angazhim në dialog konstruktiv me Kuvendin, si forumi kryesor për debate politike, është zbatimi i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit që Kuvendi duhet ta luajë rolin e tij në këtë proces dhe po ashtu dialogu që po zhvillohet ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Serbisë.

Kolegë deputetë,

Të gjeturat e këtij raporti konsideroj që institucionet e Republikës së Kosovës duhet t'i trajtojnë me shumë seriozitet dhe sfidat që ne do t'i evidentojmë do t'u qasemi si komision me shumë përpikëri. Po ashtu, unë dua edhe një herë të vlerësoj punën konstruktive të anëtarëve të Komisionit për Integritet Evropian dhe të Qeverisë, të cilët kanë qenë përherë në takime për të raportuar lidhur me të gjeturat dhe zhvillimet që kanë ndodhur jo vetëm në përafrimin e Kosovës me agjendën evropiane, por edhe me procesin e liberalizimit të vizave, si procese të ndara.

Si kryetare e Komisionit për Integritet, po e them që komisioni do të vazhdojë të luajë rol konstruktiv dhe koordinues që ne të bashkohemi dhe të bëhemi pjesë e Bashkimit Evropian. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Glauk Konjufca e ka fjalën.

GLAUK KONJUFCA: Të nderuar deputetët të Kuvendit të Kosovës,

Erdhi edhe ky raport i radhës, i progresit, i Komisionit Evropian dhe duke lexuar këtë raport u mundova t'i shquaj fjalët më të përdorura, terminologjinë më të shprehur në këtë raport dhe i vërejtja dy terme, të cilat përdoren në mënyrë konstante në Raportin e sivjetshëm të Progresit.

Dy termat anglisht, të cilët janë më të përdorur në këtë Raport të Progresit, është termi "early stage", në anglisht, përmes të cilit kualifikohen shumë procese në Kosovë. Kjo do të thotë, janë hapa të tyre të parë. I bie që pothuajse nuk ekzistojnë si procese, si zhvillime, edhe termi i dytë që e kam vërejtur që përdoret shpesh në këtë Raport të Progresit është termi anglisht "weak", "i

dobët”, dhe përdoret për shumë fusha në jetën tonë, duke filluar prej arsimit deri te mbikëqyrja që e ka Parlamenti mbi Qeverinë. Këto dy terme janë më të përdorurat në Raportin e Progresit dhe kjo duhet të na shqetësojë shumë. Unë kam arritur t’i nxjerr 22 përfundime shumë të rëndësishme nga Raporti i Progresit, të cilat desha t’i ndaj bashkë me ju.

E para, sistemi gjyqësor është në fazë të hershme, pra “early stage”. Vetë sistemi i drejtësisë kategorizohet në hapat e tij të parë. Institucionet e gjyqësorit ende mbeten të cënueshme nga ndikimi politik. Termi anglisht që përdoret është “political influence” dhe kapacitetet e gjyqësorit nuk qëndrojnë mirë. Çka do të thotë kjo? Kjo është me të vërtetë e tmerrshme, sepse ne kemi sistem të drejtësisë që 17 vjet. Pas 17 vjetëve që ke filluar të ndërtosh sistem të drejtësisë, të vijë një raport i vlerësimit prej Bashkimit Evropian që thotë se je duke i hedhur hapat e parë, kjo do të kishte qenë deri diku e pranueshme në vitin 2004, por në vitin 2018 kjo është me të vërtetë e papranueshme dhe duhet të jetë njëfarë lloj alarmi, i cili duhet të na vërë në lëvizje të gjithëve.

Përfundimi i dytë, ka pasur një strategji thuhet dhe këtu me siguri nënkuptohet përgjegjësia që i përket Beogradit për shënjestrimin e përfaqësuesve politikë në pjesën e veriut të Kosovës që nuk vijnë nga Lista serbe. Domethënë të gjithë ata eksponentë politikë, të cilët kanë garuar në zgjedhje dhe të cilët nuk kanë ardhur nga formacioni politik Lista serbe, pra që nuk kanë qenë në kontroll të drejtpërdrejtë të Beogradit, janë ndier të kërcënuar dhe janë ndier të frikësuar gjatë zgjedhjeve të fundit në Kosovë. Kjo tregon edhe një herë se çfarë ndikimi ka Serbia dhe Beogradi, çfarë ndikimi negativ të zhvillimit të politikës, sidomos në komunat, të cilat janë të banuara me popullatën serbe.

Konkludimi i tretë, thuhet “vazhdon politizimi i Administratës Publike”.

Përfundimi i katërt, “dënohet përpjekja shumë e rrezikshme e disa eksponentëve politikë, më të rëndësishëm të Kosovës, për anulimin, për zhbërjen e Gjykatës Speciale”.

Përfundimi i pestë, “konfiskimi i pasurisë të paligjshme mbetet në nivel shumë të ulët në Kosovë”.

Përfundimi i gjashtë dhe këtë dua ta lexoj në gjuhën angleze, thotë: “corruption is widespread”, që i bie “korrupsioni është shumë i përhapur”, me fjalë të tjera, gjerësisht i përhapur.

Konkludimi i shtatë, lufta kundër krimit të organizuar po ashtu kualifikohet në anglisht si “early stage”. Faktikisht, nuk ka fare luftë kundër krimit të organizuar në Kosovë.

Përfundimi i tetë, vendimet përfundimtare të gjykatave për ndëshkimin e krimit të organizuar janë të pakta.

Përfundimi i nëntë, ka kërcënime dhe frikësim të gazetarëve. Pra, liria e shprehjes dhe liria e medias përballen me sfida serioze.

Përfundimi i dhjetë, për shkak të moszgjidhjes së mënyrës së financimit, RTK-ja ka mbetur e cenueshme ndaj ndikimit politik. Me siguri që kjo bëhet me qëllim, ashtu që televizioni publik të mund të shndërrohet në një shërbëtor të pushtetit dhe të Qeverisë.

Përfundimi i 11-të, merreni me mend, thuhet “ekonomia e tregut është në ‘early stage’”. Si fazë, si kategori në të cilët vendoset. Domethënë, në faktikisht as nuk kemi liri të tregut në Kosovës, ky është niveli i ekonomisë tonë.

Përfundimi i 12-të, në cilësinë e arsimit nuk ka fare progres. Anglisht thuhet “no progres”.

Përfundimi i 14-të, benefitet e veteranëve të luftës e ngarkojnë së tepërmi buxhetin e pushtetit dhe kjo ndodh edhe për shkak të manipulimit dhe të fryrjes së listave të veteranëve.

Përfundimi i 15-të, infrastruktura energjetike dhe ajo hekurudhore është shumë e dobët.

Përfundimi i 16-të, zbatimi i MSA-së është shumë i ngadalshëm.

Përfundimi i 17-të, kurrfarë progresi nuk ka në çështjet e ambientit, në çështjet e mjedisit nuk ka fare progres.

Përfundimi i 18-të, në Kuvend shumë ligje kalohen me procedura të përshpejtuara dhe pa debat, duke përfshirë bile edhe buxhetin e shtetit, njërin prej ligjeve më të rëndësishme. Në anën tjetër, mbikëqyrja e Qeverisë nga ana e Kuvendit është e dobët, termi që përdoret anglisht është “weak”. Pra, Parlamenti nuk e mbikëqyr, nuk arrin ta mbikëqyrë Qeverinë, nuk arrin ta performojë rolin e vet kushtetues, i bie kjo.

Përfundimi i 19-të, thuhet “financimi i partive politike është jotransparent”.

Përfundimi i 20-të, “zyrtarët politikë në pjesën e Veriut të Kosovës nuk e deklarojnë pasurinë e tyre”, zyrtarët serbë të pjesës veriore të Kosovës.

Përfundimi i 21-të, “kurrfarë progresi nuk ekziston sa i përket mbrojtjes së të dhënave në Kosovë”.

Dhe, përfundimi i fundit i rëndësishëm që unë e kam nxjerrë nga Raporti i Progresit, është përfundimi i 22-të, që thotë se Kuvendi dështon vazhdimisht të zgjedhë personat meritore nëpër bordet e agjencive të pavarura.

Për mendimin tim, kjo mund të përkthehet kështu, meqë mazhoranca i ka numrat në Kuvend dhe meqë logjikisht, politikisht Qeveria e përkthyer në mazhorancë parlamentare gjithmonë i ka numrat, kjo do të thotë që Kuvendi arrin vazhdimisht të zgjedhë njerëz joprofesionalë nëpër bordet e agjencive, sepse më me rëndësi për mazhorancën është punësimi i njerëzve, të cilëve u ka premtuar, punësimi i njerëzve me ndikim në parti apo në struktura të degëve, e kështu me radhë, se sa punësimi i njerëzve profesionalë, të cilët do të bënin punë të mirë për shtetin e Kosovës.

Këto janë 22 përfundimet, për mendimin tim, më të rëndësishme të Raportit të Progresit, por çka është më fatkeqja për Kosovën ka të bëjë me faktin që nëse kemi një qeverisje të tillë, si kjo e tanishmja, e cila do të vazhdojë me këta parametra të qeverisjes edhe në vitin e ardhshëm, po ju garantoj që do ta kemi edhe në vitin e ardhshëm një Raport të njëjtë të Progresit me të gjitha këto mangësi, të cilat i adreson Raporti i sivjetshëm i Progresit i Komisionit Evropian.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Dardan Sejdiu e keni fjalën.

DARDAN SEJDIU: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë,

Në fakt, diskutimi sot, e adresova mbrëmë edhe në mbledhje të Kryesisë, ka një mungesë të theksuar të, si të them, informacionit për të gjithë. Pra, po më duket që sot po e zbatojmë atë që në ekonomi njihet si 'asimetri e informatave'. Pra, ka deputetë që kanë pas mundësi ta lexojnë raportin për vendin, meqë e dinë gjuhën angleze dhe ka të tjerë që duhet të presin datën 26, meqë Qeverisë i duhen 10 ditë apo më shumë për të përkthyer një raport 90 faqesh.

Në këso lloj situatë, mendoj që nuk i bëjmë nder diskutimit mbi të gjeturat e Raportit për vendin, sepse në fakt, ka shumë prej nesh që janë ekspertë të fushës, por në mungesë të dijes të gjuhës angleze nuk mund të shpërfaqin qoftë kritikën, qoftë rekomandimet sa i përket rrugës përpara. Dhe, rrjedhimisht këtu sot kemi deputetë që do të qëndrojnë në sallë, do të dëgjojnë për raportimin telegrafik të dikujt që e ka lexuar Raportin, qoftë për kritikë, e qoftë për lëvdatë dhe në fund fare një numër krejt i vogël yni do të thotë që ka diskutuar për Raportin e Progresit. Në fakt, Raportin për vendin, sepse nuk është më Raport i Progresit, është "country report". Për neve si grup parlamentar, t'ju them të drejtën, ka edhe deputetë që nuk e kanë lexuar, sepse nuk e dinë gjuhën angleze dhe po besoj që në secilin grup parlamentar ka deputetë të tillë. Pra, nuk e dinë gjuhën angleze dhe rrjedhimisht nuk kanë mundur ta lexojnë raportin.

Mendoj që në këto rrethana, në këtë 'asimetri të informatave' po e zhvlerësojmë diskutimin për raportin, nuk po ia japim rëndësinë që duhet ta ketë. Për konsum të shpejtë po e zhvlerësojmë rëndësinë e një raporti që vjen nga një institucion kaq me rëndësi për Republikën e Kosovës. Sido që të jetë, meqë na keni vendosur në këtë situatë, meqë jemi në këtë situatë, atëherë disa prej nesh që e kemi lexuar një herë, sepse leximi i këtij raporti nuk është veç lexim si i një

romani për argëtim, por edhe nxjerrje e rekomandimeve që i jep ky raport, e prej këtyre rekomandimeve po shpresoj shumë, edhe politikave që duhet t'i adresojmë dhe kështu të ecim përpara me rregullimin e temave, të cilat këtu shpërfaqen si problematike.

Unë dua të fokusohem te pjesa e cila e trajton ekonominë dhe në fakt nuk e di a e ka kritikuar ndonjëherë dikush Raportin për vendin. Pra, Raporti për vendin i kritikon në masë të madhe politikën që i merr Qeveria për trajtimin e temave ekonomike, por nuk e di dikush a u mundua të shpërfaqë edhe paradokset që gjenden brenda raportit. Për shembull, një pjesë e raportit thotë kështu dhe po e lexoj: “Kapacitetet prodhuese në përgjithësi në Kosovë janë të pazhvilluara dhe ekonomia varet kryesisht prej konsumit, investimeve në infrastrukturë dhe remitencave”. Ndërsa në anën tjetër, i njëjti raport kërkon që Qeveria të vazhdojë me politikëbërje që është komplet e bazuar në model ekonomik që është tek oferta. Pra, te taksat, te konsumi, te një lloj ekonomie, e cila është e hapur për të gjithë, pa e konsideruar se cilat do të ishin përparësitë krahasuese që duhet të zhvillohen me intervenime në politikë, e rrjedhimisht me ndërtimin e kapaciteteve prodhuese.

Pra, elementi kyç në këtë raport, në fakt, duhet thënë që ky raport është ‘de javu’, nëse e lexoni raportin e vitit të kaluar, në shumë pjesë të këtij raporti thuhet që nuk ka progres fare nga viti i kaluar, pra rekomandimet janë të njëjta. Pra, kemi një raport i cili na shpërfaq neve saktë llojin e politikave ekonomike që ne duhet t'i ndërmarrim. Na thotë prodhimi është problem, pra nuk prodhohet në këtë ekonomi, na thotë që ndonëse eksportet janë rritur, na tregojnë prej kah janë rritur. Janë rritur për shkak të “Ferronikelit” dhe jo për shkak se ne kemi ndërtuar ndonjë kapacitet të ri prodhues dhe krejt këtë na e shpjegon me idenë e remitencave dhe me idenë e investimeve në infrastrukturë publike.

Në fakt, mua më duhet të potencoj që këtu qëndron edhe një prej sfidave kryesore, të cilësdo qeverisje, edhe kësaj, pra. Po e shoh këtu një ministër, i cili merret me temat e ekonomisë, në fakt me Tregti dhe Industri, faleminderit, ministër, që je sot këtu me neve, një prej sfidave kryesore është ngritja e kapaciteteve prodhuese në këtë Republikë dhe përgjatë këtij mandati asgjë nuk është bërë që të ngrihen kapacitetet përpunuese dhe prodhuese në këtë ekonomi, këtë e shpërfaq edhe raporti. Dhe, rrjedhimisht edhe eksportet që mund të jenë pjesë, si të thuhet, e krijimit të vendeve të punës, e që këtu përsëri e potencon që “unemployment remains high” pra, papunësia është e madhe, mund të adresohet në ndërtimin e kapaciteteve industriale apo përpunuese e prodhuese në këtë ekonomi.

Gjithashtu, këtu një element, i cili është interesant thotë që për dallim prej viteve të kaluara, raportet tregojnë që konsumi është zvogëluar për 2,5%, ndonëse është rritur niveli i kredive konsumuese. Pra, kjo gjithsesi na shpërfaq, të themi kështu, nevojën që e kemi për ta mirëmbajtur këtë ekonomi nga remitencat. Por, edhe një element të rëndësishëm na tregojnë që raportimet statistikore janë jokonsistente. Pra, na tregojnë dy gjëra fundamentalisht problematike



për mënyrën e politikëbërjes në ekonomi. E para, thotë “nuk ka ngritje të kapaciteteve prodhuese, pra tregtia apo net eksportet gjithmonë do të jenë problem”, dhe e dyta thotë “politikat që i bëni ju si Qeveri bazohen kryekëput në statistika jokonsistente”. Dhe, kjo është shumë interesant për një qeveri, e cila mendon të zhvillojë ekonominë dhe të trajtojë tema këtu. Pra, keni informacion të gabuar nga Agjencia e Statistikave ose, më mirë të them, më së lehti thënë, inkonsistente, e në anën tjetër, të gjitha politikat i keni të bazuara në modelin ekonomik të ofertës, e që ka të bëjë me hapjen e tregut për gjithkënd, në çdo kohë, në çdo mënyrë dhe asnjëherë për ndërtimin e kapaciteteve të reja përpunuese.

Gjithashtu, më duhet të potencoj edhe nivelin e ndihmës shtetërore që e tregon si problematik ky raport. Thotë “ndihma shtetërore dhe subvencionet janë të administruara pa ndonjë strategji gjithëpërfshirëse dhe pa ndonjë analizë të kostos apo benefitit që vjen nga këto ndihma shtetërore, e në fakt, edhe nga subvencionet”. Në fakt në njërin prej interpelancave që do e kemi për ‘Contour Global’, shihet gjithashtu që po vazhdoni me këtë idenë e ndihmave shtetërore për përfitime, të themi, private, me kontrata, të cilat cenojnë rentabilitetin ekonomik e financiar të kësaj Republike dhe, si duket, në Raportin e vitit 2018 përsëri do të lexojmë për tema të njëjta.

E përmendën edhe parafolësit që ndërmarrjet publike i trajtojmë sikurse një hapësirë për rehatimin e militantëve partiakë, aparatçikëve partiakë, raporti për vendin e shpërfaq këtë edhe një herë. Pra, thotë që ndërmarrjet publike janë thjesht vend për punësim, e jo vend për krijimin e vlerës së shtuar për ekonominë. Në fakt, prej 16 ndërmarrjeve publike, vetëm 1 ndërmarrje serioze ka fitim, përkundër mbipopullimit me punëtorë partiakë, e ky është KEK-u. Dhe, KEK-u gjithashtu me marrëveshjen që e keni bërë për ‘Contour Global’ ia keni hequr mundësinë e rritjes, e pra e keni shndërruar në Raportin e ardhshëm të Progresit si ndërmarrje e cila po shkon drejt falimentimit.

Përmendet Ligji për investime strategjike dhe thotë që ndonëse është miratuar, ende nuk ka pasur asnjë impakt në thithjen e investimeve të huaja. Ndonëse që 18 vjet na flisni vetëm për investime direkte të huaja, keni miratuar ligj e impakti është minimal. Tregon gjithashtu për moslidhjen e arsimit, pra nuk ka kurrfarë lidhje të arsimit dhe shkathtësitë që u japim rinisë sonë me ekonominë, të cilën po e ndërtojmë. Pra, është komplet në shpërputhje kërkesa e ekonomisë me llojin e cilësisë të shkathtësive që i japim rinisë tonë në arsim. Pra, e shpërfaq edhe një herë një qasje komplet të paplanifikuar, komplet, të themi kështu, që i nënshtrohet mendimit ad hoc mbi ekonominë. Arsimi nuk është i lidhur me ekonomi, prodhim nuk ka, ndihma shtetërore bëhet pa planifikim dhe në fund fare, ndërmarrjet publike janë në funksion të rehatimit të militantëve partiakë.

Si përfundim, debati për këtë raport do të kishte cilësi nëse 120 deputetë do të kishin mundësi të lexonin dhe secili prej tyre të japë mendimin...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYESUESI: Edhe një minutë, ta përfundojë!

DARDAN SEJDIU: Faleminderit!

E dyta, Raporti për vendin shpërfaq, në fakt, mungesën totale të kuptimit të politikave zhvillimore për vendin, vazhdon duke e sinjalizuar të njëjtën kohë një paradoks, pra politika që bazohen në njëfarë modeli neoliberal, neoklasik dhe kërkon prodhim. Njëra me tjetrën nuk rrinë pa intervenimin e shtetit, e intervenimi i shtetit duket që është komplet partiak dhe i paplanifikuar, siç parashihet këtu, siç shpërfaqet këtu.

Rrjedhimisht, po besoj shumë që rekomandimet janë të qarta, ndonëse në disa momente edhe në kundërtënie me kërkesat që i ka Raporti, por pres nga Qeveria, nga Kuvendi, që të marrë me seriozitet nevojën për ndërtimin e një ekonomie, e cila prodhon e krijon vlerë, e jo një ekonomie që subvencionon e mirëmban. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka, replikë, zonja...

O, burrë tash e merr fjalën, mos u nervozo, mos gjuani me dorë! Rrini të qetë, tash e merr fjalën. Albulena Haxhiu e ka fjalën.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit!

Arsyeja se pse po e marr fjalën është për ta dhënë një sqarim në raport me thirrjen e këtij debati për të diskutuar për raportin për vendin. Ne e kemi thirrur këtë debat të jashtëzakonshëm me kërkesë të Vetëvendosjes me mbështetjen e LDK-së për ditën e enjte, pra për dje, mirëpo pastaj në konsultim edhe me Grupin Parlamentar të LDK-së, nga sekretari i Kuvendit na është thënë që ky raport mund të përkthehet të enjten deri pak para orës 12:00. Prandaj, e kemi shtyrë për të premtën, pastaj dje në mbledhjen e Kryesisë na është thënë që jo, kompanisë që e ka marrë përsipër i duhen dhjetë ditë për ta përkthyer një dokument të tillë. Si ka mundësi? Po, një person mund ta përkthejë ndoshta për dy-tri ditë këtë raport dhe, në anën tjetër, një kompanie iu dashkan dhjetë ditë për ta përkthyer një raport të tillë.

Pra është komplet joserioze, prandaj kritikata ndaj kësaj duhet t'i bëhen Ministrisë së Integritimit që s'e ka sjellë një raport në gjuhën shqipe për deputetët e Kuvendit. Po, është e rëndësishme për ta diskutuar raportin, por edhe për ta lexuar të gjithë deputetët, edhe ata që s'e zotërojnë gjuhën angleze, por kemi qenë në rrethana të tilla. Na është thënë që më datën 27 ka seancë të jashtëzakonshme, pra s'mund të mbahet edhe debati për këtë, sepse për të pagjeturit s'flitet për Raportin e Progresit, sepse nuk shkojnë të dyja bashkë. Ajo ditë është komplet e rezervuar me aktivitete për të pagjeturit, pastaj na është thënë që të hënën s'bën, sepse lidhet me Një Majin dhe deputetët mund të shkojnë nëpër pushime. Pra, është komplet një qasje joserioze, prandaj duhet

të adresohet sot ky debat. Ndonëse ne përnjëmend e marrim seriozisht që disa prej deputetëve apo shumë deputetë nuk kanë mundur ta lexojnë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! E vërteta është se është shkelje e së të drejtës së deputetëve për ta pasur materialin dhe për ta lexuar. Zoti Kuçi e ka fjalën.

BLERIM KUÇI: Faleminderit, kryesues!

E para, unë do të shfaq dy çështje që kanë të bëjnë me procedurën e thirrjes së kësaj seance të jashtëzakonshme. Është shkelur Rregullorja e Kuvendit me këtë thirrje të seancës së jashtëzakonshme. Nën një, zoti Sejdiu e ceku çështjen e mospërkthimit në gjuhën shqipe, dhe nën dy ka të bëjë me Rregulloren e Kuvendit, neni 38. Neni 38 nën 3a, thotë: “Kërkesa për mbledhje të jashtëzakonshme duhet ta përmbajë çështjen që do të shqyrtohet dhe arsyetimin pse konsiderohet çështje e ngutshme dhe e jashtëzakonshme. Çka ka të bëjë këtu me çështje të jashtëzakonshme? Kush e ka thirrur këtë seancë ka bërë shkeljen e kësaj rregulloreje, sepse në materialin e thirrjes nuk ka arsyetim, nuk kemi asnjë arsyetim pse kjo seancë është e jashtëzakonshme.

E para, pra ka të bëjë me mospërkthimin e materialit në gjuhën shqipe dhe propozoj që kjo seancë të jetë e anglishtfolësve, të gjithë ata që dinë anglisht, ose konsiderojnë se dinë anglisht, le të rrinë në këtë seancë. Kurse, e dyta, për çështjen e jashtëzakonshme, qenka shumë e jashtëzakonshme, emergjente, e pyeta njërin prej kolegëve që e ka nënshkruar këtë ftesë për seancë të jashtëzakonshme, i thashë a mund të më ndihmosh diçka, i thashë pse e keni thirrur këtë seancë të jashtëzakonshme? Në anglishten tënde pse është thirrur? Tha, ka regres, progres,... o i thashë kallëzomë për çka e ke thirrur seancën e jashtëzakonshme? A po do nesër të na bijë Rusia, a turku do të na hyjë nesër në Kosovë, apo ufotë donë ta sulmojnë nesër Kosovën...? Çka ka të bëjë me seancë të jashtëzakonshme?

Më vonë e mora vesh se edhe ai i shkreti që ka nënshkruar as ai s’po dinte anglisht sikur unë. Ai i shkreti na ka thirrur në këtë seancë, e ne të mjerët kemi ardhur në këtë seancë. Po, unë nuk jam i mjerë dhe nuk rri në këtë seancë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Bilall Sherifi e ka kërkuar fjalën, në emër të Grupit Parlamentar Nisma.

BILALL SHERIFI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë desha, para se të hyj në fushat për të cilat flet raporti për gjendjen e vendit, të theksoj tash për ata që nuk e kanë lexuar, për çfarëdo arsye, që ky raport e mbulon periudhën nga tetori 2016 deri në shkurt 2018. Pra, nuk është një raport që e përshkruan gjendjen në vend për një periudhë njëvjeçare, por për një periudhë një vit e gjysmë apo 18 muaj dhe bazohet në burime të

ndryshme, duke përfshirë edhe burimet nga Qeveria e Kosovës, nga shtetet anëtare të Bashkimit Evropian, nga raportet e Parlamentit Evropian, si dhe nga burime të ndryshme ndërkombëtare dhe të organizatave joqeveritare.

Pra, ky raport është 18-mujor dhe përfshin punën e dy qeverive, apo më saktë përfshin punën më të madhe të qeverisë së kaluar dhe shumë pak të kësaj qeverie. 12 muaj janë të qeverisë së kaluar dhe gjashtë muaj janë të kësaj qeverie. Dhe, nëse i marrim këta gjashtë muaj të kësaj qeverie, atëherë duke marrë parasysh faktin që janë marrë kryesisht pas muajit tetor, shumë gjëra nuk kanë arritur ende as të raportohen, në mënyrë që të përfshihen pastaj në Raportin e Progresit, apo në raportin që në fakt e përshkruan gjendjen në vend, ku në disa fusha ka progres, në disa ka regres, në disa ka stagnim. Dhe, as nuk mund të quhet raport i regresit, as raport i stagnimit, as raport i progresit, por është raport nëpërmjet të cilit kuptojmë se çka është bërë në Republikën e Kosovës për këta 18 muaj, si është gjendja në fushën e arsimit, në fushën e të drejtave të njeriut, në fushën e shëndetësisë, në fushën e të drejtave të gazetarëve, të fjalës së lirë..., në të gjitha fushat.

Pra, këtu e kemi një përshkrim të gjendjes, në të cilën gjendet shteti i Kosovës në të gjitha këto fusha. Nëse kemi stagnim në fushën e arsimit, atëherë përgjegjës është më shumë Qeveria e kaluar sesa kjo Qeveri, për faktin se kemi 12 muaj nga qeveria e kaluar të përfshira në raport dhe kemi gjashtë muaj, madje as gjashtë muaj të plotë, nga kjo Qeveri, nën një. Nëse kemi stagnim apo pak progres në fushën e drejtësisë, e njëjta vlen edhe për këtë fushë. Pra, le t'i lëmë këto analiza nga këndvështrime partiake, kush ishte, kur, ku ishte, dhe kush është fajtor dhe përgjegjës për gjendjen, por le ta bëjmë një analizë të mirëfilltë se çka duhet të bëjmë, çfarë mësimesh duhet të nxjerrim nga ky raport për ta përmirësuar gjendjen, në mënyrë që raporti i ardhshëm, pas 12 muajsh apo pas 18 muajsh, kurdo që ai të vijë, të na tregojë se ne kemi bërë përparime në të gjitha këto fusha, të cilat zakonisht raporti i analizon, i përshkruan dhe na i sjell më shumë si një indeks i gjërave, të cilat i kemi bërë dhe si një indeks mbi të cilat dhe për të cilat ne duhet të vazhdojmë të punojmë, në mënyrë që rruga jonë drejt integritit në Bashkimin Evropian të jetë më e shpejtë.

Nuk është se këtu gjithçka është zi. Ka gjëra që kanë shkuar përpara, është ecur përpara, por natyrisht nuk ka vend për vetëkënaqësi. Ka hapësirë, madje edhe kushtet janë shumë më të mira dhe mundësitë më të mëdha, që tani e tutje ky raport apo fushat në të cilat raporti i analizon të bëhen përmirësime dhe këtu angazhim, jo vetëm i pozitës, por edhe i opozitës. Ka fusha, siç janë marrëdhëniet me fqinjë, siç është dialogu me Serbinë, siç janë shumë fusha në të cilat është i nevojshëm edhe roli i opozitës, duhet ta ndërtojmë një pajtueshmëri, konsensus të plotë, që së bashku ta ndërtojmë një strategji, nëpërmjet së cilës do të hynim në këtë proces në fazën e re të procesit dhe vendi do të përfitonte nga kjo.

Ne duhet të dimë dhe besoj se të gjithë jemi të vetëdijsëm që kjo është një nga çështjet nëpërmjet të cilave Bashkimi Evropian do të na masë se në çfarë shpejtësie do të jetë rruga jonë drejt integritimeve evropiane. Unë në cilësinë e kryetarit të Grupit Parlamentar të Nismës mund të them që ky debat sot, pa marrë parasysh që hendikepon, apo ua pamundëson deputetëve të cilët ende nuk kanë arritur ta kenë në gjuhën shqipe për ta lexuar, megjithatë nuk është një raport që sot e kemi marrë, që sot duhet të flasim dhe gjithçka përfundon. Mësimet do të nxirren në ditët, javët dhe muajt, detyrat do të nxirren në ditët, javët dhe muajt në vijim, se ku duhet të ndryshojmë, çka duhet të ndryshojmë, ku duhet të ndërhyjmë dhe çka duhet të ndërhyjmë për ta përmirësuar gjendjen në të gjitha fushat, por sot është mirë që është ftuar, ka mundur të ftohet edhe një ditë tjetër. Nuk patëm mundësi që dje të arrijmë një pajtueshmëri në mbledhjen e Kryesisë që kjo të shtyhet edhe për në maj, nuk ka pasur asgjë të keqe që ky debat të mbahej edhe në mes të majit, më 5, 6, 7 apo 8 maj, sepse nuk është një çështje që ka afat kadence. 18 muaj do të na nevojitet të punojmë, 12-18 muaj, në të gjeturat e këtij raporti, për të përmirësuar aty ku kemi vërejtje, aty ku të gjitha këto burime kanë vërejtur ngecje në zhvillimin e vendit.

Unë i inkurajoj të gjithë deputetët, pa marrë parasysh nëse e kanë pasur rastin apo jo ta lexojnë, që sapo të vijë i përkthyer në gjuhën shqipe ta lexojmë dhe të shohim sesi na shohin të tjerët, sepse ka mundësi që ne e shohim ndryshe, por ne nuk do të matemi me atë se si e shohim ne veten, por do të matemi me atë si na shohin të tjerët. Ne mund të kemi vërejtur ndryshime e dallime më të mëdha në ndonjë fushë, por pak ka rëndësi sesi e shohim ne. Rëndësi ka që të tjerët nuk na i kanë regjistruar a shënuar këto përparime. Pra, me pak fjalë do të thosha që Qeveria, deputetët, qoftë pozitiv, qoftë opozitiv, duhet t'i nxjerrin detyrat në mënyrë urgjente, që në të ardhmen punët t'i kryejmë punët ashtu siç ata kërkojnë nga ne, kështu që raporti i ardhshëm të jetë më pozitiv, sepse, në fund të fundit, nuk do të jetë as raporti i parë as i fundit para se Kosova të bëjë hapa përpara në drejtim të integritimeve evropiane. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nga "6+" nuk është kurrkush. Fjalën e ka zëvendëskryeministri, zoti Enver Hoxhaj.

ZËVENDËSKRYESMINISTRI ENVER HOXHAI: I nderuar zoti nënkryetar, kryesues i Kuvendit, zoti Haliti,  
Shumë të respektuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,  
Të nderuar kolegë ministra,  
Zonja dhe zotërinj,  
Meqë kryeministri Haradinaj ishte në një angazhim, më luti të vij edhe në emër të Qeverisë me urgjencë, të marr qëndrim për këtë raport... A po doni ta shtyjmë, apo jo? Nëse hyj shpejt në temë është kjo, unë e kam pranuar zyrtarisht në emër të Qeverisë këtë raport të mërkurën, i cili i ka diku nja 85 faqe tekst, e që nëse shtypet si libër i ka gati nja 200 faqe tekst dhe e di që prej njerëzve më të lexueshëm, Hegeli dhe Gëte, kanë lexuar nga 50 faqe në ditë, nëse deputetët e Kuvendit të Kosovës dhe ne që jemi në Qeveri kemi kapacitet edhe më të gjerë që të lexojmë

edhe më shpejt dhe të reflektojmë më shpejt, mund ta kemi një debat të tillë, por nuk është vetëm problemi gjuhësor, problemi është se raporti nuk duhet të lexohet me një paragraf dhe të dalim e të ndërtojmë qëndrime politike pse dikush prej nesh e ka lexuar një paragraf.

Përtej kësaj, unë kam arritur që ta marr kopjen e raportit një ditë më herët, jozyrtarisht, dhe shpeshherë edhe mediet që kanë raportuar nuk ka qenë të sakta. Prandaj, nëse flasim për një gjendje të saktë duhet të flasim për një gjendje të saktë. Tash, meqë kryesuesi ma dha fjalën dhe ka iniciativë këtu në Kuvend, unë nuk e di nëse dëshironi ta dëgjoni fjalën time në emër të Qeverisë, në emër të kryeministrit deri në fund, apo dëshironi që ta ndalni debatin. Nuk jam i vullnetit që të ju... A të vazhdoj?

Të nderuar deputetë,

Të nderuar zonja dhe zotërinj,

Raporti i Komisionit Evropian, i cili është prezantuar më 17 prill 2018 është një vlerësim edhe objektiv, edhe real, edhe i saktë, i gjendjes në të cilën është Kosova, e në analizë ky raport përmend edhe progresin që ka pasur vendi, po edhe ngecjet e sfidat në fusha të caktuara. Ky është një vlerësim në fakt i punës së të dy qeverive dhe të të dy mandateve të Kuvendit të Kosovës, dhe i cili në veten e tij përfshin edhe një cikël që e kemi pasur vitin e kaluar të ndërprerjes së një funksionimi normal të shtetit dhe institucioneve për shkak të zgjedhjeve të parakohshme dhe për shkak të zgjedhjeve të rregullta lokale, zgjedhjet e parakohshme qendrore.

Ne si qeveri kemi arritur ta lexojmë raportin në tërësi, por nuk dua të them këtu para jush që kemi mbërri që ta analizojmë çdo paragraf dhe fjalë për fjalë, meqë tek të hënën do ta kemi një mbledhje të Qeverisë dhe aty secili koleg i Qeverisë do të reflektojë për gjetjet e raportit dhe për sfidat dhe për atë nëse raporti e përshkruan vërtet gjendjen e saktë në çdo sektor, apo shpeshherë ka edhe përsëritje.

Unë dëgjova vlerësime të ndryshme prej anës suaj dhe nuk dua t'i përsëris këto vlerësime, por dua t'i them disa gjëra kryesore. Së pari, bërja publike e këtij raporti për Kosovën, por bërja publike edhe e raporteve të veçanta prej vendeve tjera të rajonit në Ballkanin Perëndimor nga Komisioni Evropian është një ngjarje e veçantë dhe janë dy momente që janë të rëndësishme. Së pari, propozimi i Komisionit Evropian për Shqipërinë dhe për Maqedoninë që këtij vendi t'i hapen negociatat, që është një moment i veçantë për Ballkanin. Arritja e Shqipërisë është një arritje edhe e shqiptarëve në rajon dhe ne duam t'i përgëzojmë edhe Qeverinë e Shqipërisë, edhe Qeverinë e Maqedonisë për këtë moment të rëndësishëm të tyre, për këtë arritje të madhe.

Së dyti dhe momenti i dytë që ka të bëjë direkt me Kosovën dhe kështu duhet të lexohet edhe raporti, është që ky raport e konfirmon atë lajmin e shumëpritur prej qytetarëve të Kosovës sa i takon vlerësimin për procesin e liberalizimit të vizave, edhe pse liberalizimi i vizave nuk është punë kryesore e këtij raporti. Liberalizimi i vizave dhe raporti për integrim të Kosovës në

Bashkim Evropian janë dy binarë të ndryshëm, por këtu ka një paragraf, i cili është i saktë, e ku thuhet që falë demarkimit dhe ratifikimit të marrëveshjes për demarkacion, për çka dua ta falënderoj çdo deputet të Kuvendit të Kosovës, dhe përmirësimit në luftën kundër krimit dhe korrupsionit, Kosova e ka një vlerësim pozitiv sa i takon liberalizimit të vizave. Pas 10-12 ditësh do të ketë një ekip na ana e Komisionit Evropian, i cili do të duhej të vijë në Kosovë, e të cilët do ta shkruajnë një raport shtesë dhe i cili raport pastaj do të ofrojë një pamje të plotë për atë se ku jemi me përmbushjen e këtyre kritereve.

Por, çfarë mund të ju them në bazë të komunikimit zyrtar që kam pasur edhe me komisionarin Johannes Han është se në institucionet e BE-së në Bruksel, nuk dua të them për shtetet anëtare, po për institucionet e BE-së, ka një unanimitet të plotë, ka një vendosmëri të plotë, që ta mbështetin Kosovën në marrjen e të së drejtës për liberalizim të vizave në vendet e zonës Shengen. Raporti përmend edhe fusha ku është shënuar progres, por edhe ngecje, prej progresit më të madh, më konkret, ka të bëjë me progresin që kemi arritur në fushën e kritereve ekonomike, por edhe në raportet tona me rajonin, po ashtu edhe në normalizimin e raporteve me Serbinë, si dhe sa i takon harmonizimit të legjislacionit me standardet e BE-së.

Kur jemi te fusha e ekonomisë, përmirësimi i mjedisit të të bërit biznes është diçka që veçohet, që ka dalë edhe në parametra e indikatorë të tjerë ndërkombëtarë, sikur edhe përparimet në përmirësimin e infrastrukturës rrugore.

Sa u takon standardeve evropiane, progres kyç është shënuar edhe te liria e lëvizjes së mallrave, të shërbimeve, tatimeve, doganave, prokurimit publik, konkurrencës, si dhe menaxhimit dhe të migrimit të rregullt dhe atij ilegal në Republikën e Kosovës, por po ashtu ka progres në fushën e sigurisë, sidomos sa i takon luftës kundër terrorizmit, konkretisht në rastin e Kosovës sa i takon zbatimit të masave për ta parandaluar dhe luftuar ekstremizmin e dhunshëm, radikalizmin dhe për t'i parandaluar qytetarët e Kosovës që të marrin pjesë në konfliktet e huaja jashtë vendit.

Ka tone po ashtu pozitive për ambientin e favorshëm të shoqërisë civile në Kosovë. Ka edhe një listë të gjatë të ngecjeve, të sfidave, të problemeve me të cilat ballafaqohet vendi. I përmendën shumë kolegë deputetë në emër të grupeve të tyre parlamentare, unë nuk dua t'i përsëris dhe nuk dua të flas, meqë kemi edhe kolegë nga sektorët tjerë, por te sektori i sundimit të ligjit, të drejtësisë, pakoja ligjore që e ka prezantuar ministri Tahiri, që është miratuar në Kuvendin e Kosovës, do të jetë diçka që Kosovën vitin e ardhshëm do ta nxjerrë me vlerësime më pozitive.

Një sfidë e cila i takon edhe Kuvendit ka të bëjë edhe me fragmentarizmin e jetës politike në Kosovë dhe me polarizime të thella, por mbi të gjitha edhe me mungesën e konsensusit sa i takon zbatimit të reformave evropiane, por po ashtu ka një vlerësim negativ sa i takon numrit të ministrave dhe të ministrive. Unë mendoj se një qeveri, e cila vërtet është e madhe, ku edhe unë jam pjesë e kësaj Qeverie, ku nuk duhet t'ia përshkruajmë një njeriu dhe një adrese numrin e

ministrave në këtë Qeveri, duhet ta kemi një debat njëherë e përgjithmonë të qartë që të zvogëlohet numri i dikastereve në Qeveri të Kosovës dhe që të mos e kemi një Qeveri vazhdimisht të madhe, po me ligj ta rregullojmë dhe ne si Qeveri jemi të gatshëm që në një të ardhme të afërt ta afrojmë një ligj për përbërje të Qeverisë dhe Qeveria të jetë shumë më e vogël.

Te politizimi i administratës që vërehet në rajon, te shërbimet joefikase vërehen edhe në Kosovë, deficitin tregtar është ai i cili neve na nxjerr si vend jo mirë në raport edhe me interesat tona të brendshme ekonomike, po edhe në raport me Bashkimin Evropian dhe me vendet e rajonit, sikurse edhe stagnimi që përmendet në fushën e mjedisit, edhe pse këtu duhet të ketë një debat më të plotë, vërtet raporti a e përshkruan gjendjen reale apo jo?

Te sfidat e sektorit të energjetikës, po ashtu ministrat e resorëve të caktuar duhet të dalin me sugjerime dhe rekomandime konkrete, jo vetëm që ta kuptojnë se çka analizon dhe rekomandon raporti, po cili do të jetë interesi ynë më strategjik?

Marrë në tërësi, raporti është një vlerësim real i gjendjes, edhe pse ka kundërthënie të mëdha, nëse unë do të dilja këtu jo si anëtar i Qeverisë, po si deputet, kisha gjetur paragrafë dhe paragrafë ku diku ka një koncept tjetër, në paragrafin tjetër ka një koncept tjetër, të cilat bien goxha shumë në kundërthënie me një politikë publike koherente të një vendi të caktuar, po ne e marrim si vlerësim serioz edhe për gjendjen e institucioneve politike, edhe për ekonominë, edhe për shoqërinë.

Po arsyeja pse dola të flas ka të bëjë me diçka tjetër. Dhe, kjo më shqetëson për organizimin e kësaj seance dhe kësaj mënyre të organizimit të kësaj seancës dhe për numrin e deputetëve.

Ma merr mendja që nuk duhet ta lexojmë këtë raport vetëm si vlerësim teknik, po duhet ta lexojmë edhe si një mënyrë se sa ne si Kosovë po vërejmë që ta artikulojmë vullnetin tonë politik në raport me Bashkimin Evropian. Nuk është me rëndësi se kush është në Qeveri dhe kush në opozitë, po neve na duhet një konsensus nacional, jo si deklaram në Kuvend të Kosovës, jo si deklaram në opinion publik, po na duhet një konsensus nacional i mirëfilltë për agjendën evropiane, na duhet një plan i veprimit jo vetëm çka parasheh ERA dhe MSA-ja, po çka ne jemi të gatshëm që ta lexojmë drejt shpejtësinë tonë në raport me Bashkimin Evropian.

Na duhet një konsensus nacional, meqë marrëdhënia me BE-në është e rëndësishme, po në të njëjtën kohë pjesërisht është edhe marrëdhënie ambiguitive, është e dykuptimtë, janë dy institucione të BE-së, të cilat kanë qëndrimin që e kanë në raport me shtetin e Kosovës dhe janë pesë shtete anëtare të cilat nuk e kanë njohur Kosovën dhe të cilat shpeshherë janë një sfidë serioze në trajtimin e Kosovës në raport me Bashkimin Evropian.



Natyrisht që ky dokument është referenca kryesore, korniza kryesore se si BE-ja, Bashkimi Evropian, shtetet anëtare, e kuptojnë Kosovën, po përtej kësaj është referenca më e rëndësishme se si edhe bota e lexon Kosovën, se si BE-ja e kupton Kosovën, në fakt është se si e kuptojnë edhe krejt shtetet e tjera të ndryshme në botë Kosovën, edhe pse ka nganjëherë njëfarë raporti të UNMIK-ut, i cili është propagandë tipike në raport me shtetin e Kosovës dhe i cili na dëmton në gjeografi të ndryshme.

Çfarë kisha apeluar për fund është kjo, nëse ju do të miratoni ndonjë rezolutë, do të duhej pas kësaj rezolute apo pas rekomandimeve që dalin, ndoshta disa nga ne, nga ana e Qeverisë, shefat e grupeve parlamentare, kryetarët e komisioneve, anëtarët e komisioneve, qoftë për Integritet Evropian, qoftë për Politikë të Jashtme, qoftë edhe për Ekonomi apo për Tregti, të ulemi dhe ta mendojmë cila do të jetë qasja jonë afatgjatë në raport me raportin e Komisionit Evropian...

*(Ndërprerje nga regjia)*

*(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetarja e Kuvendit, znj. Myfera Shinik.)*

KRYESUESJA: Regjia, të lutem fjalën zëvendëskryeministrit!

ZËVENDËSKRYEMINISTRI ENVER HOXHAI: Ma merr mendja që mund ta kemi një adresim të saktë në një plan më afatgjatë nëse mendojmë se si do t'i qasemi këtij fenomeni.

Ajo se çfarë kam parë për vende të tjera është që shpeshherë në Shqipëri ka qenë problem kryesor opozita, se si është kuptuar Shqipëria në Evropë. Nuk dua ta them këtu as si nëntekst, as si mbitekst në raport me opozitës, se kam respektin më të duhur, por ka pasur vende ku opozita pikërisht e ka udhëhequr agjendën evropiane, sikurse është Kroacia dhe Qeveria ka qenë mbështetje.

Jam i mendimit që pas këtij debati, kurdo që dëshironi, çfarëdo formati, është mirë ta mendojmë se si t'i qasemi si Qeveri, si opozitë, si grupe parlamentare këtij dokumenti dhe ta kemi një qasje afatgjate se çka duam të bëjmë Raportin e Progresit. Nëse kjo ndodh, jam i sigurt që brenda një kohe të shkurtër Raporti i Progresit do të jetë jo më pozitiv, për shkak edhe të ndryshimit të gjendjes, po do të jetë më pozitiv për shkak të unifikimit të vullnetit tonë politik për agjendën evropiane.

Prandaj, pakës e kam parë këtë farë debati të parakohshëm, po ju keni vendosur dhe ne jemi këtu, çka do që mund të bëjmë, do të bëjmë përpjekje që ta shtyjmë.

KRYESUESJA: Faleminderit, zëvendëskryeministër! Fjalën e ka deputeti Ilir Deda.

ILIR DEDA: Faleminderit!

Më falni, po ne ishim duke diskutuar, a jemi duke e shtyrë këtë seancë apo? Nuk kemi kuorum. Ok-ej. Faleminderit!

Atëherë, Raporti i Progresit faktikisht e godet këtë realitet të sotshëm njëjtë, kur ne nuk e kemi kryeministrin dhe shumicën e Kabinetit qeveritar këtu, kjo është kritika e Raportit të Progresit, ndër të tjera, po është, se ku janë? Po de, në shtëpi janë, e nuk vijnë të japin llogari para Kuvendit, e mandej ku është Kuvendi, Kuvendi nuk e mbikëqyr Qeverinë. Pse s'e mbikëqyr Qeverinë? Për shkak të kulturës politike, edhe ajo goditja është në kulturën politike, e cila është ndërtuar në vendin tonë. E tash kur e sheh ti, i lexon mangësitë, natyrisht që ka mangësi në një vend i cili karakterizohet si shtet, i cili ka elemente të kapjes së shtetit dhe çka po na çudit neve këtu?

Nuk të duhet, Enver, konsensus për një vit politik, qysh do ta 'çkapni' shtetin ju. Ju e dini më së miri kush e ka 'kapë' shtetin! Hajde, ndërmerrni masa për shkapje, po nuk do ta ndërmerrni asnjë masë për atë punë.

E çka thotë tjetër: thotë që duhet të ketë debat konstruktiv parlamentar në Kuvend, kjo nënkupton që edhe Qeveria t'i qaset në mënyrë konstruktive Kuvendit. Platformën, të cilën e keni lansuar dje në media apo atë çka po e quani platformë për dialog me Serbinë është totalisht në kundërshtim me atë çka na thotë Komisioni Evropian. Po. As nuk është platformë, as nuk është produkt i konsensusit, e ju thoni ne duam konsensus! Jo, ju po bëni lojë, po në këtë legjislaturë s'do t'ju kalojë loja të cilën e keni planifikuar. As ajo kuaziplatformë që është një lloj mashtrimi për opinionin publik për ta mandatuar Hashim Thaçin. Kuvendi, për ta udhëhequr dialogun me Serbinë nuk do të ndodhë në këtë legjislaturë, atë tash ta dini.

Nuk do t'i merrni kurrë votat e 61 deputetëve që do të qëndrojnë këtu, më mashtrim me deputetë nuk ka!

Nuk do ta mbërrini atë punë, konsensusin e keni fjalë boshe, e keni zbuluar tash ju, po gjithçka bëni kundër konsensusit politik, doni të na vendosni para aktit të kryer, doni një proces ta përfundoni me rezultat jo të mirë për Kosovës, po duke dashur që opozita tash juve t'ju përkrahë në atë rrugë, e Hashim Thaçi s'ka përkrahje prej këtij Kuvendi, as s'do ta udhëheqë dialogun me Serbinë, as nuk do të keni delegacion të Kosovës, i cili do të thotë po në përfundim të një procesi, që po i bën në mënyrë jotransparente kryetari i shtetit tonë.

Shkapjen e shtetit nuk do ta bëjë Qeveria, e cila i ka 52 deputetë, të cilët po e përkrahin, do ta bëjë një Qeveri e ardhshme, pas zgjedhjeve të ardhshme. E sa për konsensus, urdhëroni, të lutem, javën e ardhshme e kemi thirrur bashkë me LDK-në tryezën e partive politike, po fillojmë në mënyrë konsensuale të gjejmë datën e zgjedhjeve për pjesën e dytë të këtij viti, edhe po shkojmë

bashkë në zgjedhje, edhe Qeveria e ardhshme, me legjitimitet të fortë demokratik i përfundon proceset të cilat janë nisur, e janë nisur keq.

KRYESUESJA: Faleminderit! Urdhëro, zëvendëskryeministri e ka fjalën.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI ENVER HOXHAI: Zoti Deda, unë nuk e mendova vërtet si retorikë këtë çështje, nuk e mendova si retorikë, kemi pasur debate në këto 2-3 ditët e fundit sa i takon Raportit të Progresit.

Ne e pranojmë raportin në tërësi si të saktë dhe shumë seriozisht e trajtojmë.

Po disa prej pjesëve, sidomos ato që i tha zoti Konjufca, nuk janë vetëm vlerësime statike, të sakta, të mirëfillta politike. Nëse dikujt i thua 'early stage', fazë e hershme, është më shumë se sa vlerësim politik dhe për mua është e papranueshme dhe çfarë tha zoti Konjufca tregon që ne si shtet, si shoqëri, si Qeveri, krejt partitë politike duhet ta shtrojnë pyetjen pse përdoret një frazë e tillë dhe kush e përdor, se faza të hershme ke te shtetet, te popujt, po faza të tilla reflektojnë edhe një nënvetëdije, e cila është nganjëherë në Bruksel në raport me ne që nuk dua ta ngarkoj për shkak të pozitës që e kam në Qeveri, por për mua më së pakti një vlerësim i tillë është i saktë, është i duhur, është totalisht i gabuar dhe çfarë tha zoti Konjufca do të duhej të mendohej mirë, se i bie se si Evropa po e lexon Kosovën dhe për mua është e papranueshme, nëse i thua dikujt "early stage". E di, e di, e di, pikërisht për këtë. Për atë po ju lus, pa dashur t'i ik temës së dialogut, do t'i them 2-3 fjali për dialogun.

Për atë, po kërkoj prej jush si deputetë të Kuvendit të Kosovës, të të gjitha partive politike, këtu po flas edhe në emër të PDK-së.

Ne jemi të gatshëm që ju ta mendoni një mekanizëm, nuk është me rëndësi a e udhëheq opozita, a Qeveria, se si ta adresojmë temën e Raportit të Progresit në një plan më afatgjatë. Model i mirë është Kroacia, Vesna Pesiç ka qenë ministre e Jashtme, ka qenë udhëheqësjë kryesore e Kroacisë në procesin e anëtarësimit para se të bëhet ministre e Jashtme dhe para se të jetë në BE. Hajde, të ulemi dhe ta bisedojmë këtë temë, meqë po e shoh që jeni një grup i deputetëve që mund ta formësojmë këtë temë dhe ne kemi vullnet politik.

Ky është raport i dy qeverive, edhe i ish-koalicionit, edhe..., jo, jo, për Raportin e Progresit jam duke folur, veç për Raportin e Progresit.

Kështu që përgjegjës jemi krejt, me përjashtim të kolegëve që janë në krahun e djathtë. Te teza e shkapjes dhe kapjes së shtetit, kjo ka lindur paralelisht me njëfarë koalicioni VLAN dhe ju të VLAN-it, në atë kohë që keni qenë kundër PDK-së, disa keni qeverisur në mandatin e kaluar, disa po qeverisni tash. Në politikë është me rëndësi ai i cili në fund të fundit e menaxhon

situatën, ne kemi mbërritur si PDK ta menaxhojmë situatën, kështu që mos shitni përralla të tilla të kapjes a shkapjes së shtetit, le, se e di.

Te dialogu, ne kemi hartuar një dokument, i cili është një kornizë e platformës, nuk është platforma. Ne mendojmë që e kemi vetëm një temë të hapur në Serbinë dhe kjo temë e hapur është e karakterit bilateral, e cila ka të bëjë me njohje të ndërsjellë.

Neve nuk na merr mendja që ne duhet të shkojmë në dialog dhe të hapim tema, të cilat çdo ditë Vuçiqi, në dialogun e tij të brendshëm në shoqërinë serbe ngre, qoftë për pozitën e serbëve në Kosovë, qoftë për kishat, qoftë të pronat, qoftë për tregun e përbashkët rajonal që ne e kemi kundërshtuar dhe do ta kundërshtojmë. Prandaj, edhe ajo platformë i ka dy faqe tekst, ne mendojmë që kjo është pritja jonë, po kur të vijë në Kuvend të Kosovës, ju vendosni për përmbajtjen e platformës.

Ne e kemi çuar vetëm një propozim në formë institucionale, në bazë të sistemit tonë politik. Qeveria ka dalë me një dokument, e sjellim në Kuvend, debatojmë dhe e shohim se çka duhet të ndryshohet, e jepni pëlqimin, por faza në të cilën po hyn Kosova, të dialogut, dhe ka edhe një plan kohor, kur them ka një plan kohor, nuk dua të them që më 1 maj mund të fillojë diçka, po ka një plan kohor dhe ka një vullnet kohor prej neve si bartës të institucioneve, për juve në Kuvend dhe për neve në Qeveri të kërkohet një mendim strategjik, çka mund të arrihet dhe çka nuk mund të arrihet?

Në vitin 2018 e kemi kontestin më të pafavorshëm në Evropë në raport me ne, se sa që e kemi pasur më 2008.

Në 2018-ën e kemi kontestin më të pafavorshëm ndërkombëtar për Kosovën se sa e kemi pasur më 2008.

Prandaj, duhet të ulemi dhe të bisedojmë.

*(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.)*

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Deda ka replikë.

ILIR DEDA: Janë tri çështje, të cilat dua t'i adresoj.

E para, ka të bëjë, nëse flasim për kualifikime të cilat i jep Raporti i Progresit, për shembull, mua çka më ka penguar edhe e kam adresuar edhe jashtë ku isha, është konkludimi që korrupsioni në Kosovë është gjithkund i shpërfaqur.

Problem i korrupsionit në Kosovë është Ligji për prokurim publik, hajde, bëjeni ligjin e ri.

E dyta është “impunity”, kultura e pandëshkueshmërisë. Raporti i Progresit njëjtë, ne të gjithë e dimë, ata kërkojnë që çdo ministër ndaj të cilit ka edhe aktakuzë për korrupsion të shkarkohet menjëherë. Shkarkoni, tre i keni në Qeveri, hajde tregoni, qe kjo është ajo.

Edhe për fund, sa i përket dialogut. Çdo parti politike në këtë Kuvend është e gatshme të jetë pjesë e një tryeze, e cila do ta prodhojë konsensusin nacional për dialogun e ardhshëm. Po ju nuk e keni marrë asnjë hap që t’i ftoni partitë politike në një tryezë që të shohim ku ka mundësi të ndërtohet ky konsensus. Nuk janë konsensus veprimet e njëanshme të Qeverisë, të cilat pastaj duhet t’i pranojmë ne të tjerët, apo të diskutojmë mbi dokumentet, të cilat ju i keni prodhuar në mënyrë të njëanshme, e në anën tjetër, thoni jo, ne duam konsensus. Platforma, e çka do tjetër çka vendoset në letër, duhet të jetë rezultat i tryezës të bisedimeve të partive politike.

A e dini çka është çështja më pozitive? Që ju nuk jeni, po më duket, as të vetëdijshëm ende, që sot i ke të gjitha partitë e gatshme të ulen në atë tryezë, po shfrytëzoni këtë moment, pra. E ajo tryezë dhe ai konsensus nuk ka të bëjë as me jetëgjatësi të Qeverisë, e as me asgjë tjetër...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Glauk Konjufca, replikë.

GLAUK KONJUFCA: Disa probleme që i ngriti zoti Hoxhaj, dua t’ia jap edhe një dimension paksa teorik-politik, për arsye se ma merr mendja që ky i di çka po dua të them.

Këtu në Kosovë problemi themelor që e kemi me shtetin tonë është që pushteti prej vitit 1999 që është krijuar në Kosovë nga vendorët nuk ka arritur të krijojë një sistem shtetëror përtej pushtetit. Ky nuk është njëfarë lloj naiviteti, as nuk është njëfarë lloj pafajësie, prej të cilës mund të justifikohen elitat politike që kanë qeverisur vazhdimisht në Kosovë.

Ky ka qenë projekt i qëllimshëm, për arsye që ata që janë në Qeveri dhe ata që janë në pushtet të ndihen të plotfuqishëm. Sidomos dy rrafshe të jetës institucionale i kanë pasur instrumente, e që nuk do të duhej të ishte kështu. Parlamentin e Kosovës, ku e kanë veç një mazhorancë instrumentale që e çojnë duart për t’i shtyrë Qeveria proceset qysh mendon, dhe kapjen e gjyqësorit që të ndihen të plotfuqishëm dhe të mos ndihen të kërcënuar nga ndëshkimi për gabimet e tyre.

Unë mendoj që kjo ka qenë karakteristikë në Kosovë këtu, për çdo pushtet, për çdo qeveri.

E tash vijmë pse po na thotë Raporti i Progresit “early stage”. Po na thotë për shkak të kësaj, nuk keni arritur të ndërtoni një sistem stabil shtetëror, i cili funksionon përtej pushtetit dhe interesave e tekeve të tij.

Unë e kam kuptuar në këtë raportin e korrupsionit që ka ardhur prej këtyre tre ekspertëve shumë më mirë pse jemi në “early stage” në gjyqësor. Aty, për shembull, njëri prej konkludimeve është që kur i kanë intervistuar, për shembull, prokurorët e Kosovës, ata thonë nuk kishin haber për konfiskimin e pasurisë, as nuk e dinë qysh bëhet ajo punë, as nuk kanë vullnet. Edhe përmes milionave që krimi i fiton, pastaj i arrin qëllimet e veta.

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Beqa.

HAJDAR BEQA: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

I nderuar zëvendëskryeministër, zoti Hoxhaj,

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Realisht ne sot po vazhdojmë këtë debat. Unë konsideroj që nuk ka qenë e jashtëzakonshme që të bëjmë këtë seancë të jashtëzakonshme sot, derisa ende ne si deputetë nuk e kemi pasur materialin zyrtarisht të dorëzuar as në gjuhën angleze, as në gjuhën shqipe, në asnjë gjuhë.

Megjithatë, jemi munduar ta sigurojmë raportin përmes mediave apo formave të tjera.

Mendoj që më e jashtëzakonshme ka qenë që institucionet dhe të gjithë ne, pozitë dhe opozitë, gjatë këtyre dy vjetëve që raportohet, periudha raportuese, ta kryejmë punën tonë me përgjegjësi dhe përkushtim që të kemi raport më të mirë, se sa të ngutemi sot kush po e merr flamurin i pari ta bëjë këtë debat. Nëse i shikojmë, as Qeveria nuk është këtu, s’e ka marrë serioze këtë debat, as Lëvizja Vetëvendosje, të cilët e kanë nënshkruar, do të thotë nuk janë as 50% të deputetëve, të cilët e kanë thirrur këtë seancë, po as deputetët e subjekteve të tjera.

Megjithatë, do të mundohem t’i them disa fjalë që jam munduar t’i nxjerr nga raporti, kryesisht në fushëveprimtarinë që bien në komisionin, të cilit i takoj, në Komisionin për Legjislacion, që të mos ngarkohem në pjesë të tjera, që u takon edhe kolegëve.

Raporti i Progresit për Kosovën, i publikuar dje zyrtarisht nga ana e Bashkimit Evropian, pasqyron përgjegjësitë, të arriturat dhe sfidat e Republikës së Kosovës përgjatë dy vjetëve të fundit, në fushat kryesore që ndërlidhen me aspektin politik, ekonomik e social, përfshirë edhe komponentin e qeverisjes dhe ato të sundimit të ligjit.

Në adresimin e gjetjes mbi sistemin e drejtësisë, aspektet kryesore të këtij raporti janë si në vijim: Ka progres të konsiderueshëm në avancimin e pakos së ligjeve për gjyqësorin.

Integrimi i gjyqtarëve dhe i prokurorëve serbë dhe stafit të tyre mbështetës në sistemin gjyqësor të Kosovës ka qenë një ndër të arriturat më të mëdha në këtë fushë në vitin 2017.

Me këtë e kemi shtrirë sovranitetin e shtetit në fushën e drejtësisë dhe në pjesën veriore të Republikës së Kosovës, ku me këtë veprim janë shuar edhe strukturat paralele atje.

Ka përgatitje të konsiderueshme në luftimin e korrupsionit, ka përparim në zgjedhjen e rasteve që janë evidentuar në mekanizmin përcjellës, që ndërlidhen me rastet e profilit të lartë të korrupsionit dhe krimit të organizuar, në kuptim të ngritjes së aktakuzave, por edhe vendimeve të formës së prerë të gjykatave.

Unë e thashë, ka përgatitje të konsiderueshme, do të thotë nuk ka ndoshta ende veprim të mjaftueshëm në këtë fushë.

Ka progres po ashtu edhe në sekuestrimin e konfiskimit të pasurisë në fazë të hershëm, megjithatë ende ka ngecje në konfiskimin e formës së prerë, me vendim të gjykatës.

Nuk është e kënaqshme nëse e marrim te Raporti i Progresit, por edhe gjendjen reale edhe në vitin për të cilin tash jemi duke diskutuar, përveç çka është në raport.

Pasqyra e përgjithshme e legjislacionit është vijë me standardet e Bashkimit Evropian, që siguron edhe mbrojtje e të drejtave themelore të njeriut.

Një e arritur shumë e lartë është edhe lansimi i aplikacionit për njohjen dhe verifikimin e statutit të viktimave të dhunës seksuale gjatë luftës në Republikë të Kosovës.

Ka progres edhe në drejtim të rritjes së numrit të rasteve të zgjedhura përmes sistemit të ndërmjetësimit.

Është adoptuar nga ana e Qeverisë një plan i veprimit për zbatimin e Agjendës së Reformave Evropiane, një e arritur konsiderohet edhe rritja e buxhetit për Këshillin Prokurorial dhe Këshillin Gjyqësor, që konsideroj se është meritë edhe e Ministrisë së Drejtësisë, por edhe Kuvendit, edhe Qeverisë që e ka orientuar atë fushë që është me rëndësi të veçantë.

Normat ligjore që kanë për qëllim luftimin e korrupsionit janë në linjë me standardet evropiane, por normalisht që këto duhet të zbatohen dhe të jetë një efikasitet më i madh në zbatimin e këtyre normave. Ligji për parandalimin e konfliktit të interesit është rishikuar dhe ka shënuar progres të madh të përshtatshmërisë me standardet e Bashkimit Evropian. Amendamenti i ligjeve për Agjencinë Kundër Korrupsionit dhe deklarimin e pasurisë duhet të përfundohet, megjithëse njihet si proces i nisur, por duhet të përfundohet, është edhe në duart e ne deputetëve. Strategjia e

re kundër korrupsionit 2018-2022 është hartuar dhe miratuar nga Qeveria, por nuk mjafton hartimi dhe miratimi nga Qeveria, prandaj konsideroj që duhet të ketë hapa konkretë të zbatimit të kësaj strategjie. Duhet ta kemi një agjendë dhe mendoj që njëra prej rekomandimeve të dalë nga ky debat duhet të jetë edhe agjenda konkrete e zbatimit të strategjisë për luftimin e korrupsionit dhe krimit të organizuar.

Situata është përgjithësisht e qëndrueshme dhe e kënaqshme sa i përket parandalimit të torturës dhe keqtrajtimit në sistemin korrektues. Do të thotë, sa i përket sistemit të burgjeve është duke iu përmbajtur standardeve minimale të Kombeve të Bashkuara për trajtimin e të burgosurve dhe standardeve evropiane për burgjet. Te burgjet realisht kemi pasur një avancim, burgjet e Kosovës kanë hapësirë të mjaftueshme dhe nuk vuajnë nga mbipopullimi. Është bërë progres në adresimin e aspektit shëndetësor të të burgosurve nëpërmjet kalimit të përkujdesjes dhe kompetencës nga Ministria e Drejtësisë në Ministrinë e Shëndetësisë. Kur e kemi pasur këtë kalim të kompetencës, mendoj që ka qenë një hap i duhur dhe u pa që është një progres në këtë fushë.

Objekti i ri në Lipjan për edukim në Qendrën Korrektuese gjithashtu ka ndërmarrë një hap pozitiv. Ndryshimet e parapara në Kodin Penal janë vlerësuar, por janë vetëm ndryshime të parapara dhe ne si deputetë duhet dhe si komisione përkatëse ta japim kontributin tonë, por në veçanti ku trajtohen krimet kibernetike. Ka bashkëpunim të mirë ndërmjet mekanizmave, ku përfshihet edhe Ministria e Drejtësisë në çështjet që ndërlidhen me parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm, por ne duhet t'i shohim edhe disa çështje tjera, të cilat me të vërtetë ndikojnë negativisht në këtë Raport të Progresit. Mendoj që kriteret teknike për liberalizimin e vizave janë përmbushur, vlerësohet se ka progres edhe në lirinë e shprehjes, por është sfida sulmi ndaj gazetarëve, që është i papranueshëm për një shoqëri demokratike. Përmirësimi i ambientit për të bërë biznes në Kosovë, në bazë të raportit ka progres, por është sfida e madhe niveli i ulët i punësimit apo papunësia në Republikën e vendit. Nëse e marrim si hap më të rëndësishëm, në bazë të Raportit të Progresit, është ratifikimi i marrëveshjes përmes shënimit të vijës kufitare ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi, por konsideroj që duhet t'i cekim edhe disa shkaqe që kanë ndikuar në këtë raport jo të kënaqshëm, që ndoshta nuk varen krejt edhe prej Ekzekutivit, por edhe ne të tjerët duhet ta japim kontributin tonë.

Për shembull, bojkotimi i punëve në Kuvend është përgjegjësi e të gjithëve, jo vetëm e Qeverisë, por edhe e deputetëve të pozitës dhe opozitës, të cilët e bojkotojnë punën. Por, edhe sot, siç thanë parafolësit, nëse e shohim se në çfarë rrethanash po shqyrtohet ky raport, nuk jep asnjë lloj karakteri serioz. Hedhja e gazit lotsjellës në seanca plenare, kur u pengua puna nëpër seanca, edhe kjo ka ndikuar negativisht në raport, që është mirë ta cekim edhe këtë. Te edukimi e shohim që nuk e kemi një vlerësim të mirë në arsim, është tejte i dobët, nuk ka një ecje të qëndrueshme.

Te çështja e mjedisit, që është shumë e rëndësishme, edhe këtu nuk ka ndonjë progres që vlen të theksohet, është për të mos thënë. Te politizimi i Administratës që kemi përgjegjësi të gjitha



subjektet politike, edhe në nivelin lokal, edhe në nivelin qendror, është një sfidë që duhet ta theksojmë edhe në këtë raport për dy vjetët e fundit, do të thotë është cekur që duhet të ndikojmë që të kemi një administratë më efikase, por jo të politizuar. Është sfidë ndoshta edhe kjo që thashë edhe më herët, Qeveria duhet të jetë e pranishme në seanca, ministrat duhet t'u përgjigjen deputetëve me kohë në pyetje, sepse dikur përgjigja nuk ka kuptim nëse është një çështje urgjente dhe deputeti e shtron sipas Rregullores së Kuvendit dhe ai përgjigjet pas tre muajve, kjo nuk ka asnjë kuptim për atë përgjigje. Dhe, kemi edhe shumë çështje tjera në të cilat nuk dua të ndalem se edhe më shkuan minutat, por kërkoj që ne si deputetë pas këtij debati të dalim me rekomandime konkrete të harmonizuara nga të gjitha subjektet politike në interes të zhvillimit të vendit dhe të...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Hajdar! Fjalën e ka zoti Rexhaj.

ARBËR REXHAJ: Qysh në fillim të diskutimit tim dua të shpreh indinjatën time të thellë si përfaqësues i popullit me regresin që kanë bërë institucionet e Republikës së Kosovës në të gjitha fushat e jetës sonë ekonomike dhe shoqërore.

Po ashtu, nga të gjeturat dhe konstatimet në këtë raport dallohet qartë se këtu në këtë Kuvend Qeveria ka gënjyer duke thënë se posa ta kalojmë demarkacionin me Malin e Zi, Kosovën e pret liberalizimi i vizave. E gënjyen qytetarin dhe sot ky raport po e shënjon fytyrën ogurzezë dhe natyrën e mbrapshtë të faljes së tokës Malit të Zi në emër të liberalizimit dhe zhblllokimit të Kosovës. Në vitin 2016, sa i përket sistemit të drejtësisë, raporti vlerëson se përkundër hapave pozitivë, siç janë: miratimi i amendamenteve kushtetuese dhe legjislacionit të nevojshëm për implementimin e pakos ligjore për drejtësi 2015, administrata gjyqësore mbetet e ngadalshme dhe e paaftë, si dhe llogaridhënia e pamjaftueshme e zyrtarëve.

Kosova është në një fazë të hershme të zhvillimit të një procesi gjyqësor funksional, për më tepër Gjyqësori mbetet i cenueshëm nga ndikimet politike dhe institucionet e sundimit të ligjit, vuan nga mungesa e fondeve dhe burimeve njerëzore.

Në vitin 2018, në mënyrë të njëjtë sikur në raportin e vitit 2016, me fjalë të njëjta përshkruhet sistemi i drejtësisë në Kosovë. Kosova është në fazë të hershme të zhvillimit të një sistemi gjyqësor funksional. Sa progres është arritur në implementimin e pakos ligjore 2015? Gjyqësori mbetet i cenueshëm nga ndërhyrjet politike, administrata e Gjyqësorit mbetet e ngadalshme dhe joefikase. Në vitin 2016, sa i përket luftimit të korrupsionit, Kosova është në fazë të hershme. Raporti vlerëson se Kosova i ka fuqizuar kapacitetet institucionale për ta luftuar krimin e organizuar dhe korrupsionin me themelimin e ekipit hetues shumëdisiplinor, ngritjen e mekanizmit

të gjurmimit për nivelin e lartë të korrupsionit dhe krimit të organizuar, si dhe fuqizimin e departamenteve për krime të rënda në gjykatat themelore.

Prapëseprapë, korrupsioni mbetet i përhapur në shumë fusha dhe mbetet një ndër problemet serioze. Rastet e konfiskimit dhe sekuestrimit të aseteve janë rritur, por numri mbetet ende i vogël. Numri i rasteve të hetuara dhe të dënuara mbetet shumë i ulët, zbrazëtitat në legjislacion dhe zbatimi i legjislacionit duhet të përmirësohet sidomos në pastrimin e parave, konfiskimi dhe sekuestrimi i aseteve dhe hetimi i financave. Ndërhyrjet në hetime, si dhe mungesa e angazhimit strategjik politik e pengojnë luftimin e krimit të organizuar. Kosova ka vazhduar të bëjë përpjekje në luftimin e terrorizmit, por ende ballafaqohet me sfida në këtë fushë.

Edhe për vitin 2018, raporti thekson se Kosova është në fazë të hershme sa i përket luftimit të korrupsionit dhe se korrupsioni është i përhapur dhe mbetet shqetësim serioz. Sa progres është bërë në regjistrimin e dëshmive për luftimin e korrupsionit dhe krimit të organizuar në nivelin e lartë, përfshirë edhe dënimet finale? Progres është shënuar edhe në konfiskimin paraprak të aseteve, por numri i konfiskimeve finale mbetet i vogël.

Raporti tërheq vërejtjen se numri i dënimeve përfundimtare, i hetimeve financiare dhe i konfiskimit të aseteve mbetet i vogël. Agjencitë për zbatimin e ligjit kanë vështirësi ta luftojnë krimin e organizuar në veri të Kosovës. Autoritetet kosovare duhet të jenë më efektive në përpjekjet e tyre që ta luftojnë shpëlarjen e parave dhe ligji adekuat duhet të përshtatet me standardet evropiane dhe ndërkombëtare. Ndërsa sa u përket kriterëve ekonomike në vitin 2016, Kosova mbetet në fazë të hershme të zhvillimit të ekonomisë funksionale. Papunësia shënoi rënie, por Kosova mbetet vendi më i varfër në rajon. Ekonomia joformale mbetet e përhapur, raporti vlerëson se Kosova ka bërë ca progres sidomos në përkrahjen e bizneseve të orientuara në eksport, përmirësimin në zbatimin e kontratave, posaçërisht në sektorin financiar dhe qasjen në financa. Raporti thekson se nuk është bërë fare progres në përmirësimin e cilësisë së edukimit, e cila është shtylla kryesore për të përmirësuar rritjen afatgjatë dhe konkurrencën.

Në vitin 2018, Kosova mbetet në fazën e hershme të zhvillimit të ekonomisë funksionale. Papunësia shënoi rritje dhe Kosova prapë mbetet vendi më i varfër në rajon. Papunësia i ka prekur veçanërisht gratë dhe të rinjtë, mjedisi i biznesit është përmirësuar dhe Qeveria e ka respektuar rregullën fiskale për deficitin buxhetor, megjithatë përfitimet e veteranëve të luftës vazhdojnë ta përbëjnë një sfidë për financat publike. Ekonomia joformale mbetet e përhapur. Kosova ka bërë disa përparime edhe në fazën e hershme sa i përket kapacitetit për ta përballur presionin konkurrues dhe forcat e tregut brenda BE-së. Asnjë përparim nuk është bërë në përmirësimin e cilësisë së arsimit dhe trajnimit e boshllëqeve në tregun e punës.

Kosova ka bërë disa përparime në përmirësimin e infrastrukturës rrugore, por boshllëqet e mëdha të infrastrukturës në sektorët e hekurudhave dhe energjisë mbeten. Ndryshimet strukturore në

ekonomi janë të ngadalta, pasi mbeten të varura nga sektori i tregtisë me pakicë. Integrimi me BE-në pengohet nga zbatimi i ngadalshëm i MSA-së.

Të dashur qytetarë,

Në këto tri vështrime të sistemit të drejtësisë, luftimit të korrupsionit dhe kritereve ekonomike të viteve 2016 - 2018, Kosova nuk ka shënuar progres, por e kundërta, ose ka mbetur në vitin 2016, ose ka shënuar regres. Kjo qeveri dhe qeveria mbrapa saj nuk e kanë zhvilluar Kosovën ekonomikisht, përkundrazi qytetari është varfëruar, siç e thotë edhe Raporti i Progresit - nuk e ka luftuar krimin e organizuar dhe nuk e ka zhvilluar sistemin e drejtësisë. Secili prej qytetarëve të Kosovës e ndien në lëkurën e vet këtë katastrofë qeverisëse, me numra të tmerrshëm të shpenzimeve qeveritare, me zëvendësministra të asgjësë, me kabinet e ministra plot e me këshilltarë të asgjësë politikëbërëse, por të shumëçkaje zhatëse. Agresiviteti në punësime alla-zëvendësministrash e stafesh shoqëruese të tyre të instaluar nga qeverisja Mustafa-Thaçi-Veseli, i shkoi në skaj qeverisja Haradinaj-Veseli-Limaj-Pacolli. Zgjerimi i koalicioneve të pakicës qytetare po reflekton çdoherë e më shumë në zgjerim të shpenzimeve qeveritare e posteve për ta mbuluar këtë pakësim të mbështetjes popullore.

Duket qartë edhe nga të gjeturat e Raportit të Progresit sesa ulët është mbështetja popullore për këta që e kanë uzurpuar Ekzekutivin në Kosovë, e aq më shumë shtohen përpjekjet klienteliste për ta mbajtur atë pushtet nëpërmjet keqpërdorimit të shpërndarjes së buxhetit. Standardi që i referohet Komisioni Evropian për jetën dhe veprimtarinë institucionale është plotësisht i munguar në institucionet tona. Nuk ka justifikim që një qeveri e stërmadhe ta marrë guximin dhe t'ia rrisë vetes pagën teksa nuk e bën asnjë përpjekje qoftë formale për ta funksionalizuar zbatimin e Kontratës Kolektive për punëtorët e Kosovës. Nga të gjitha veprimet e deritanishme të Qeverisë Haradinaj-Veseli-Limaj-Pacolli, nuk mund të thuhet diçka tjetër, përpos se kjo Qeveri, si dhe të tjerat pasardhëse, në fakt janë antievropiane, janë anti-BE.

Orientimi i Kosovës drejt BE-së ka tjetër kah, nga siç qeveriset në Kosovë. Këtë na e dëshmon çdo bashkëvendës që jeton e punon në vendet e BE-së, madje edhe në ato vende ku niveli ekonomik nuk është aq i lartë sa i vendeve lidere, si Gjermania apo Franca. Prandaj, na nevojitet një mendësi e re në qeverisje, një rimëkëmbje e vërtetë dhe demokratike për ta filluar etapën e re të zgjimit kombëtar e shtetëror, emancipimit dhe luftimit të korrupsionit dhe shtrimit të rrugës për zhvillim ekonomik. Një emancipim e orientim drejt shtetit zhvillimor e shtetit social do ta kthente Kosovën drejt kuptimit dhe jetësimit të saj, gjë që qytetarët kuptojnë e aspirojnë me Bashkimin Evropian. Pra, punë, dinjitet e solidaritet dhe drejtësi shoqërore. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Rexhaj! Radhën e ka Grupi i Pavarur i Deputetëve. Fjalën e ka zonja Baftiu.

BESA BAFTIU: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë,

Unë pajtohem me atë se është shumë e rëndësishme të diskutojmë, mirëpo pajtohem edhe me një pjesë të kolegëve të mi parafolës se nuk ka qenë urgjente që ne sot të debatojmë, duke pasur parasysh Raporti i Progresit është publikuar para tri ditësh, dhe duke pasur parasysh se ende ne si deputetë nuk e kemi marrë, jo vetëm që nuk e kemi marrë në gjuhën shqipe përkthimin, mirëpo nuk e kemi as kopjen fizike, qoftë atë edhe në gjuhën angleze, dhe duke pasur parasysh se është dita e katërt kur ne si deputetë jemi në seanca.

Megjithatë, unë e kam lexuar raportin dhe jam fokusuar në dy fusha, siç janë fusha e shëndetit publik dhe fusha e barazisë gjinore. Kur e krahasojmë Raportin e Progresit 2016 me këtë të vitit 2017, nuk ka dallime sa i përket shëndetit publik. Të gjeturat në këtë raport për shëndetin publik nuk kanë ndryshuar. Ende janë shqetësim serioz shpenzimet shumë të ulëta publike në shëndetësi, ku kërkohet një rritje e buxhetit financiare për të lejuar zbatimin e reformave në sektorin shëndetësor, si dhe implementimin e Sistemit Informativ Shëndetësor. Po ashtu, në raport ceket se rreth 30% e popullatës nuk është e përfshirë në shërbime shëndetësore për shkak të varfërisë ekstreme. Përmendet se llogaridhënia institucionale është e ulët dhe nuk ka iniciativa të qarta për ta përmirësuar produktivitetin, efikasitetin dhe cilësinë në sektorin e shëndetësisë. Shpenzimet private mbeten të larta dhe janë vlerësuar në 40% të kostos totale mjekësore.

Shqetësim tjetër mbetet moszbatimi i Ligjit të duhanit, moszbatimi i Ligjit për transplantin e indeve dhe qelizave, si dhe Ligji për transfuzionin e gjakut, e sa i përket këtij ligji ky është duke u trajtuar në komision dhe pritet shumë shpejt të silltet edhe në Kuvend në lexim të dytë. Mbulimi i imunizimit me vaksina në vitin 2017 është më i ulët se në vitin 2016. Shqetësim tjetër mbetet imunizimi i komunitetit rom e ashkali, ku vetëm 3 në 10 fëmijë janë plotësisht të vaksinuar. Ka vërejtje për përshkrimin e antibiotikëve, ku në raport thuhet se duhet të jenë më shumë të kontrolluara për ta parandaluar rezistencën kundër mikrobeve. Ka vërejtje se legjislacioni i Kosovës në lidhje me barnat për përdorim njerëzor dhe veterinar nuk është në linjë me “asqui”.

Promovimi i shëndetit në lidhje me sëmundjet jo të transmetueshme mbetet i dobët. Kosova nuk e ka një strategji ose plan për këtë. Kosova nuk ka strategji për kontrollin e kancerit në vend, nuk ka ligje për ushqimin dhe aktivitetin fizik. Përmenden edhe sigurimet shëndetësore, kur dihet se jemi i vetmi vend në rajon që nuk kemi sigurime shëndetësore. Është vlerësuar se 1/3 e popullsisë nuk ka akses të lehtë në shërbime shëndetësore. 18% e popullsisë për arsye ekonomike nuk kërkojnë shërbime mjekësore në rast të ndonjë sëmundjeje. Sa i përket barazisë gjinore, në Raportin e Progresit nuk ekziston asnjë fushë, ku mund të numërohet përparim sa i përket domosdoshmërisë për barazi ndërmjet grave dhe burrave. Mburra që dëgjojmë nga secila qeveri merr shkak tek ligjet të cilat na qenkan në linjë me standardet ndërkombëtare. Kjo është shumë e mirë, por kjo na doli të jetë e pamjaftueshme. Përkundër kësaj, Raporti i Progresit mat

ngecje në të gjitha nivelet ku kjo kornizë ligjore supozohet që do të duhej të kishte ndikuar sado pak në gjendjen në terren.

Raporti vë në pah problemet duke filluar nga dhuna në familje, diskriminimi me bazë gjinore në tregun e punës, në gjyqësi dhe polici. Thuhet që ekziston një koordinim i dobët ndërmjet policisë, prokurorëve dhe aktorëve tjerë lidhur me dhunën në familje. Dhe tutje, se ekziston një mbikëqyrje e papërshtatshme, jo adekuate e policisë, ndaj urdhrave të gjykatave lidhur me këtë lloj dhune. Ky është qarku i parë i problemeve që në vazhdimësi e pasojnë njëra-tjetrën. Dhuna nis në familje, përcillet në polici, vazhdon në gjyqësi.

Por, për ta kuptuar thelbin e problemit, duhet ta ndërrojmë këtë radhitje, sepse dhuna në familje nuk mund të shpjegohet jashtë hapësirës shoqërore, ekonomike, kulturore e juridike të vendit. Kjo dhunë manifestohet në familje, por përgjegjësinë për mbikëqyrje, ndërhyrje dhe ndërrim të raporteve shtypëse e bartin institucionet. Prandaj, le të provojmë ta kthejmë rendin e gjërave ndryshe. Dhuna e ka zanafillën në sistemin politik, ekonomik dhe kulturor, përcillet nëpërmjet mekanizmave, siç është policia, e cila e bën gjyqin rrugës për gjykatë dhe përfundon te gjyqtarët që në diskrecionin e tyre kanë mundësinë e përvjedhjes së mendësisë patriarkale, që ndikon në vendimin përfundimtar.

Qarku i dytë i problemeve, edhe sipas raportit, është te mungesa e strehimit për viktimat e dhunës në familje dhe mungesa e politikave efikase për riintegrimin e tyre. Strehimoret ekzistuese nuk mbështeten mjaftueshëm financiarisht. Viktimat detyrohen që pas dhunës të kthehen në familje. Ky fakt ndikon që dhuna në të shumtën e rasteve as të mos raportohet. Mungesa e investimit në vendet dhe kushtet e strehimit dhe mungesa e politikave që përfshijnë viktimat përsëri në jetën shoqërore është dekurajuese.

Duke mos gjetur zgjidhje të vërteta nëpërmjet mekanizmave institucionalë, gratë mbeten të heshtura, të nënshtruara dhe të vetmuara. Sfidë tjetër mbetet prona dhe trashëgimia. Kjo çështje ende zgjidhet me zakonet e vjetra, në ndërkohë që përdoren ligjet e reja dhe në këtë mënyrë, sado i mirë të jetë, ligji po del të jetë i parealizueshëm në synimet e tij, nëse nuk vihet në funksion i tërë sistemi politik, ekonomik e juridik.

Papunësia te gratë është qarku i tretë dhe më substancial që duhet adresuar. Të hedhura në situatë, të varura ekonomikisht, ato do të jenë vazhdimisht peng të një sistemi, i cili i keqpërdor ato para syve të botës, nëpërmjet “ligjeve prej letre”, por që nuk kanë ndërmarrë asnjë hap konkret në avancimin e tyre në fushat që ndikojnë drejtpërdrejt në jetën e tyre. Çështjet që lidhen me gjendjen e gruas, kushtet e jetesës dhe mundësitë për të ardhmen, asnjëherë nuk janë trajtuar seriozisht nga institucionet përkatëse. Shumica e hapave konkretë që janë bërë kanë ardhur si rezultat i punës së organizatave të grave të shoqërisë civile dhe iniciativave jashtë institucioneve.

Ajo çfarë e kemi të njëjtë me vendet e përparuara, në të vërtetë janë vetëm disa ligje të cilat në vendin tonë nuk lexohen njëjtë, sepse realiteti është i ndryshëm. Për t'i arritur standardet ndërkombëtare, jo domosdoshmërisht duhet t'i kopjojmë ligjet. Ajo çfarë duhet përvetësuar janë vlerat dhe synimet për liri, drejtësi e barazi, por jo, të gjitha qeveritë e Kosovës kanë kopjuar ligje, e në këtë mënyrë paradoksalisht kanë shkelur mbi këto vlera, duke i anuluar synimet. Edhe kjo Qeveri dhe këto institucione mbeten të mbyllura ndaj kauzës për barazi gjinore. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Ahmet Isufi e ka fjalën.

AHMET ISUFI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë konsideroj se kjo seancë kështu si po mbahet, s'e ka asnjë kuptim për shumë arsye. Një, se është thirrur duke shkelur të drejtën e deputetit në gjuhën amtare zyrtare, që është e drejtë themelore. Është shkelur Rregullorja. Njëkohësisht, ne kemi pas raporte edhe viteve të kaluara, por kurrë s'ka pasur kaq nguti për ta analizuar dhe për ta debatuar një raport të tillë, sepse 85 faqe me 90 tabela përshkruese, është absurd që të themi se e ka lexuar dikush prej deputetëve me vëmendje dhe ka mundur ta analizojë, e së paku ta pasqyrojë në këtë Kuvend. Madje, do të ishte shumë mirë sikur kolegët e mi anglishtfolës ta mbanin këtë seancë në gjuhën angleze, meqë edhe materialin e siguruar e kanë pasur privatisht, jo në mënyrë zyrtare nga Kuvendi në gjuhën angleze dhe kjo tregon për seriozitetin e thirrësve të kësaj seance, e cila vërtet po shihet se nuk ka të bëjë me analizën dhe debatin e një raporti serioz, po ka të bëjë me përgatitje të agjendave politike vetëm sa për t'i thënë ato që i kanë përsëritur shpeshherë në Parlamentin e Kosovës.

Tendencat për të pasur sa më shumë debate, sa më shumë interpelanca, sa më shumë agjenda të cilat do të jenë vetëm për të pasur në Parlament diskutime të pafund, unë konsideroj se nuk i shërbejnë këtij Parlamenti dhe më së paku u shërbejnë qytetarëve të Kosovës. Prandaj, para se të thirremi në rregulla, në ligje, në Kushtetutë, t'i zbatojmë ato, të mos kërkojmë çështje që dalin jashtë këtyre procedurave, në mënyrë që pastaj vërtet të dalim edhe qesharakë para qytetarëve të Kosovës.

Unë jam i bindur se kjo seancë, ashtu siç ka filluar, me tendencë për t'u devaluuar, ashtu edhe do të përfundojë. Edhe dje në Kryesi kemi kërkuar që shtyhet për një kohë, derisa të pajisen deputetët me material, derisa t'i bëjnë analizat, derisa të konsultohen, qoftë edhe me profesionistët, për ta pasur një debat përmbajtjesor, ashtu siç e meriton ky Parlament. Në fund të fundit, po shihet se është nisur keq, do të përfundojë keq. Asgjë tjetër!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Hoxha, ministria për Integritet.

MINISTRJA DHURATA HOXHA: I nderuar zëvendëskryetar i Kuvendit,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Fillimisht më lejoni të përshëndes thirrjen e kësaj seance, ku do të diskutojmë për raportin e vendit si dokumenti më i rëndësishëm i Komisionit Evropian për vendin.

Megjithatë, edhe unë i bashkohem shqetësimit të shumë deputetëve me të cilin pajtohem edhe unë, që është koha shumë e shkurtër për ta analizuar në detaje raportin, sidomos për faktin se ende nuk e kemi raportin në gjuhën shqipe dhe serbe, sepse është në proces të përkthimit.

Dhe, ata që kanë pasur mundësi për ta analizuar këtë raport, përmbajtjen, kemi parë progresin, por edhe sfidat që janë përmendur në raport. Në përgjithësi, këtë raport e konsiderojmë real dhe objektiv. Kemi dëgjuar opinione e interpretime të ndryshme lidhur me raportin dhe fillimisht besoj fuqishëm se raportin për vendin duhet ta shohim si dokument orientues për punën e institucioneve tona gjatë vitit të ardhshëm. Raportin për vendin duhet ta vlerësojmë objektivisht, qoftë sa u përket të arriturave që specifikon ky raport, por edhe sa u përket sfidave që u përmendën. Po ashtu, duhet dhe është mirë që raportin për vendin ta shohim edhe nga perspektivat krahasuese me vendet tjera të Ballkanit Perëndimor. Edhe në Strategjinë për Zgjerim të Komisionit Evropian është theksuar se të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor duhet të punojnë më shumë dhe t'i ndërmarrin reformat përkatëse, nëse e duan integrimin në familjen evropiane.

Të nderuar deputetë,

Edhe pse të gjithë kemi pasur qasje në gjuhën angleze në raport, më lejoni shkurtimisht të përmend të arriturat dhe progresin që nënvijëzon raporti për vendin. Konsiderohet se zgjedhjet e vitit 2017 janë mbajtur në mënyrë të rregullt dhe në mjedis të shëndoshë konkurrues ndërmjet partive politike. Votimi në Kuvend i Ligjit për ratifikimin e Marrëveshjes ndërkombëtare për demarkacionin e kufirit me Republikën e Malit të Zi vlerësohet gjithashtu arritje e madhe.

Ka progres në kuadër të reformës së Administratës Publike dhe rishikimit të agjencive dhe trupave të pavarura. Ka progres në zbatimin e pakos ligjore të vitit 2015 në kuadër të sistemit gjyqësor. Integrimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve serbë në sistemin e drejtësisë së Kosovës vlerësohet gjithashtu si arritje shumë e madhe e vitit 2017. Në kuadër të luftës së korrupsionit është shënuar progres në trajtimin e rasteve të shënjestruara, duke përfshirë vendimet e shkallës së fundit. Po ashtu, progres është shënuar edhe në konfiskimet preliminare. Progres është shënuar edhe në luftën kundër terrorizmit, përfshirë zbatimin e masave për ta luftuar ekstremizmin e dhunshëm, radikalizmin dhe parandalimin e qytetarëve për t'iu bashkuar konflikteve në vendet e treta.

Në Kosovë, gjithashtu thuhet në raport, ka mjedis pluralist dhe dinamik të medieeve. Kemi rezultate shumë të mira në fushën e zhvillimit ekonomik. Është përmirësuar mjedisi i të bërit biznes dhe Qeveria e ka respektuar rregullin fiskal për deficitin buxhetor. Eksporti ka shënuar rritje të ndjeshme. Është bërë progres i mëtutjeshëm në përmirësimin e infrastrukturës rrugore. Raporti, gjithashtu, nënvizon se Kosova ka vazhduar masat për marrëdhënie të mira dhe konstruktive bilaterale me vendet e rajonit dhe njëkohësisht vlerësohet angazhimi i Kosovës në kuadër të dialogut për normalizimin e marrëdhënieve. Është shënuar progres në lirinë e lëvizjes së mallrave dhe shërbimeve, tatimit dhe doganave, prokurimit publik, të të bërit biznes dhe konkurrencës. Dhe, po ashtu, kemi progres në menaxhimin e migrimit të rregullt dhe atij ilegal.

Të nderuar deputetë,

E theksove edhe më herët se konsideroj që raportin duhet ta shohim dhe ta trajtojmë me objektivitet, ashtu siç është. Askujt nuk i bën nder dhe nuk na duhet që të mohohen të arriturat dhe progresi, të cilin e përmend Komisioni Evropian në raport, por gjithashtu askujt nuk i duhet dhe nuk na ndihmon që të mos flasim edhe për sfidat, të cilat janë specifikuar në raport. Dhe, më lejoni gjithashtu shkurtimisht të përmend disa nga sfidat ku kërkohet më shumë punë nga institucionet e vendit.

Raporti thekson se fragmentimi dhe polarizimi i vazhdueshëm politik ka ndikuar negativisht në rolin e Kuvendit dhe ka ndikuar në efektivitetin e Qeverisë, veprimet e papranueshme nga një numër i deputetëve gjatë periudhës raportuese, si përdorimi i gazit lotsjellës, e kanë penguar punën e Kuvendit. Ka shqetësime sa i përket politizimit të Administratës Publike. Konsiderohet se ende duhet të punohet në rritjen e kapaciteteve të Gjyqësorit dhe eliminimin e ndikimit politik. Nga institucionet e Kosovës kërkohet që të jenë më efektive në përpjekjet e tyre për ta luftuar pastrimin e parave. Konsiderohet se korniza ligjore në përgjithësi garanton mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore në përputhje me standardet evropiane, por megjithatë nevojiten përpjekje shtesë lidhur me zbatimin.

Ekonomia joformale ende mbetet shqetësim. Po ashtu, edhe rritja e normës së papunësisë, posaçërisht papunësia që e ka prekur një përqindje të madhe, ku preken gratë, të rinjtë dhe punëtorët e pakualifikuar. Mbetet sfidues përmirësimi i cilësisë së arsimit dhe adresimi i boshllëqeve të aftësive në tregun e punës. Sa i përket harmonizimit me standardet evropiane kërkohet më shumë punë rreth zbatimit, si dhe më shumë punë në adresimin e çështjeve mjedisore.

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Konsideroj se raporti për vendin është një mundësi e mirë që të gjitha institucionet t'i shohin prioritetet dhe të kuptojnë se ku duhet të fokusohet puna e tyre gjatë këtij viti. Me theks të veçantë duhet të fokusohemi në fuqizimin e zbatimit të ligjeve, implementimin e reformës së



Administratës Publike, avancimin e politikave të punësimit dhe arsimit, vazhdimin e luftës kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit.

Puna e institucioneve në këto fusha duhet të jetë konkrete dhe t'i përfshijë të gjitha hallkat e zinxhirit institucional. Raporti për vendin është edhe një arsye më shumë që të gjitha institucionet, duke përfshirë edhe opozitën, ta kuptojnë seriozitetin e procesit të integritetit dhe punën e madhe që na pret. Siç e dini, tashmë disa herë kam insistuar në krijimin e një konsensusi nacional për reforma dhe procese që janë pjesë e rrugës sonë drejt integritetit. Asnjë projektligj, reformë apo proces tjetër nuk guxon të ngecë për shkak të mospajtimit politikë e partiakë. Është koha e fundit që të gjithë ta kuptojmë rolin tonë në procesin e integritetit evropian, pavarësisht çfarë funksioni mbajnë.

E kemi raportin për vendin dhe sfidat e identifikuar, po ashtu e kemi edhe Agjendën Evropiane të Reformave dhe MSA-në, si dokumente udhërrëfyese. Le ta krijojmë një konsensus nacional për të gjitha çështjet dhe reformat që janë pjesë e këtyre dokumenteve dhe të ecim përpara. Pas publikimit të këtij raporti është shumë e rëndësishme për qytetarët e vendit, hapat të cilët do t'i ndërmarrim për t'i adresuar sfidat e përmendura në raport.

Dhe, si ministre e Integritetit Evropian do të angazhohem maksimalisht që të gjitha institucionet ta intensifikojnë punën për t'i adresuar sfidat e evidentuara në raportin për vendin.

Pra, raporti përmbledh aktivitetet tona, duke tejkaluar koncepte pozitë-opozitë dhe ashtu duhet ta gjejmë çelësin e vlerësimit për të arriturat dhe sfidat e raportit për vendin.

Nuk është ky raport vetëm për Qeverinë, apo vetëm për Kuvendin, pra është raport për Republikën e Kosovës. Prandaj, për fund, më lejoni të them se ky raport nuk duhet dhe nuk do të mbetet vetëm një dokument, por do të jetë udhërrëfyes i institucioneve tona në përpjekjet e përbashkëta për avancimin drejt integritetit evropian. Kjo është ajo çka duhet të bëjmë për qytetarët tanë, që presin nga ne që të punojmë më shumë për avancimin dhe mirëqenien e tyre. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja Hoxha! Fjalën e ka zoti Milaim Zeka.

MILAIM ZEKA: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar qytetarë të Kosovës,

Në qoftë se e dëgjojmë një debat të tillë sot krejtësisht të panevojshëm, në radhë të parë, dhe të ngutshëm, e jo për atë pse na ka ardhur materiali vetëm në gjuhën angleze, po kjo është bërë kryekëput për inate politike, "ta bëj unë, mos ta bëjë ai tjetri", domethënë kush po e bën i pari, e mos ta bëjë tjetri.

Sidoqoftë, kjo është një dëshmi ose një ilustrim se edhe udhëheqësit tanë politikë, 90% pas lufte, na kanë udhëhequr duke folur me ndërkombëtarët, ata fol anglisht, këta thuaj “yes, yes,...”, pa e ditur hiç çka po thonë ata. Po, tani meqenëse erdh kryeministri, unë do flas pak pozitivisht për Qeverinë, jo për raportin. E më së pari, krejt ky raport, për mua, prej a-së e deri në zh e pasqyron gjendjen e mjerë të misioneve ndërkombëtare në Kosovë, të misionit të UNMIK-ut, të misionit të Bashkimit Evropian në Kosovë. Në qoftë se Bashkimi Evropian për 18 vjet ka deklaruar para qeverive të veta në të gjitha vendet anëtare të Bashkimit Evropianë se në Kosovë kanë mbjellë dredhëza e u kanë dalë ferra, ky nuk është faji i qytetarëve të Kosovës, por është faji i njerëzve të instaluar në organizatat ndërkombëtare këtu në Kosovë.

Do të thotë, përgjegjësinë për ecjen e projektit të shtetit të përbashkët, qoftë në aspekt pozitiv, ose për të gjitha ngecjet dhe dështimet, e kemi të barabartë dhe të përbashkët me Bashkimin Evropian dhe me institucionet tjera ndërkombëtare. Unë po habitem nga një pjesë e medieve dhe nga një pjesë e kolegëve tanë deputetë. Qysh bre, nuk po lodheni? Shaj Brukseli Kosovën, shaj ne, shaj ata, shaj ne... e kemi mbjellë njëfarë tuneli të pashpresë për qytetarët e Kosovës. Po të na dëgjojnë ata na çka po themi sot, shyqyr që s’ka det se duhet të dalin njerëzit e të mbyten në det, të bëjnë vetëvrasje.

Nuk është aq tabelë e zezë ajo që thuhet në këtë raport të përpiluar, në fund të fundit, nga burokratë të Brukselit. Dhe, po ta shikojmë me syrin kritik, që është detyrë jona si deputetë ta shohim me syrin kritik, është detyrë e medieve ta shohin me sy kritik raportin. E jo, fol ata, e ne sot veç po e ripërsëritim raportin. Po ta shikoni raportin në shumë faqe, është një cirk i vërtetë. Ka ripërsëritje të pasuseve, veç copy-paste janë marrë pasuesit dhe, në anën tjetër, kritikohen fushat ku vendimmarrës kryesorë ose ndikues kryesorë në ato fusha kanë qenë pikërisht zyrtarët e Bashkimit Evropian në Kosovë, siç është EULEX-i, por edhe zyrtarë tjerë, ta marrim UNDP-në, për shembull. Po ndalemi në fushën e medieve. Në fushën e medieve, për shembull, UNDP-ja, shkon merrini raportet e UNDP-së, do ta shihni se si përshkruhen keqpërdorimet drastike të shoqatave të ndryshme të gazetarëve në Kosovë. Ose, merrini raportet e organizatave të ndryshme ndërkombëtare, siç është për shembull DFID-i anglez, ose SIDA suedeze, dhe do ta shihni atje që pjesa dërrmuese e atyre bosëve të medieve që i kanë marrë paratë nga këto institucione dhe që kanë qenë të dedikuara për zhvillimin e medieve, ato para janë keqpërdorur në mënyrë drastike.

Në qoftë se tash kalojmë te opozita, këtu për shembull një deputet i opozitës, i Vetëvendosjes, tha se në Kosovë nuk është shënuar asnjë progres në arsim. Është dashur të paktën të flasë pak për kryeqytetin e Prishtinës, ku Vetëvendosja ka udhëhequr, të thotë “nuk ka pasur progres, po qe bile në Prishtinë ka pasur”. Këtu flitet krejt në bllok, vetëm negativisht. Ky nihilizëm, ose ky mohim i së kaluarës nuk i bën mirë Kosovës. E tha një parafolës, një deputet i Lidhjes Demokratike të Kosovës, me shumë të drejtë, që problemi kryesor është Ligji i prokurimit. Po këtë ligj të prokurimit e kanë bërë ndërkombëtarët, ne duhet ta ndryshojmë.

Procesin e privatizimit në Kosovë e kanë udhëhequr ndërkombëtarët, nuk e kemi bërë ne. Prandaj, edhe këtu duhet të marrim e të ndryshojmë diçka.

Profesori Enver Hoxhaj, që tani mban postin e zëvendëskryeministrit të Qeverisë, e tha në fjalimin e tij që “unë tha nuk pajtohem me Brukselin, mënyrën se si na trajton”. Po, por pikërisht ministrat dhe kryeministri duhet të jenë më të ashpër në komunikimin e tyre me Brukselin, më të drejtpërdrejtë dhe t’u thonë atyre që ata nuk mund të vijnë e të bëjnë këtu raporte të zeza për Kosovën duke u bazuar në një shoqëri civile, që kam thënë 100 herë është shumë më e korruptuar edhe më e zhytur në krim se qeveritë e kaluara. Po them se qeveritë e kaluara, sepse kjo qeveri i ka 6 muaj dhe ky raport, me sa unë e di, ministrja Hoxha ndoshta mund të më përmirësojë, është i bërë për 18 muaj. Apo jo? Eh, tash, 18 muaj, 12 muaj të fajit i takojnë Qeverisë së kaluar, në të cilën, më vjen gjynah, por ka qenë pjesë kryesore Lidhja Demokratike e Kosovës. Tash, kur flasim... po aty keni qenë, bashkë e keni gatuar këtë kulaç, LDK-ja dhe PDK-ja, shyqyr ne Nisma s’kemi qenë, tash e merr përgjegjësinë Nisma çka të bëhet në këtë Qeveri ne s’mund të mbrohemi. Por, edhe në këtë qeveri ka hapa pozitivë. Për shembull, unë nuk mund të mos i përmend këtu hapat pozitivë që janë bërë edhe nga kryeministri, edhe nga ministri ynë i Tregtisë e Industrisë, kur ka ndërmarrë hapa për bllokimin e disa mallrave nga Serbia. Tash, ministri Hasani ka marrë hap edhe për bllokimin e qumështit, që po na vjen nga Bosnjë-Hercegovina, që ata s’na i pranojnë as vizat, por ky e ka ndërmarrë një hap të atillë, me çka unë pres që edhe ne si deputetë ta mbështetim, por edhe vetë kryeministri t’i mbështesë hapat e tillë.

Dhe, fare në fund, kisha pasur dëshirë që ne si deputetë të Parlamentit të Kosovës, për hir të interesit të përgjithshëm, për hir të interesit kombëtar, t’i japim udhëzime dhe mbështetje Qeverisë së Kosovës sesi të kalojmë nga kjo situatë dhe si të vijmë deri te liberalizimi i vizave, sepse liberalizimi i vizave është interes jetik i shtetit të Kosovës dhe i qytetarëve të Kosovës. Ne nuk u ndihmojmë proceseve veç duke sharë e duke folur terr për Qeverinë, sepse, në fund të fundit, pjesën kryesore të fajit e kemi ne si deputetë me mosaprovimin e ligjeve, me mosvotimin e ligjeve, me moskalimin e marrëveshjeve ndërkombëtare, me mospjesëmarrjen tonë nëpër seanca të Parlamentit të Kosovës. Në qoftë se jemi autokritikë, atëherë mund ta kritikojmë edhe Qeverinë.

Sa i përket procesit të dialogut Beograd-Prishtinë, unë mendoj se do të thirret një seancë e veçantë lidhur me këtë dhe mendoj që ky dialog duhet të zhvillohet në Prishtinë dhe në Beograd, për arsye se edhe ky është njëri prej kushteve jo për liberalizimin e vizave, por për hyrjen e Kosovës në Bashkimin Evropian.

Ta përfundoj fjalimin tim me një fjali shumë optimiste, që është shumë reale, nga ajo që unë kam dëgjuar nga presidenti francez në fjalimin e tij, të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës, unë jam 99% i sigurt se qytetarët e Kosovës me rastin e Krishtlindjeve, me rastin e Vitit të Ri, domethënë në dhjetor të këtij viti kanë për të udhëtuar në Evropë pa viza dhe do të bëhet

liberalizimi i vizave, jo pse ne i kemi plotësuar ndoshta të gjitha detyrat, por sepse ky është një vendim politik i Brukselit, që nuk dëshiron ta injorojë popullin e Kosovës dhe nuk dëshiron të vazhdohet që ne si qytetarë të jemi të izoluar.

Prandaj, unë shpresoj që Vitin e Ri kemi për ta festuar së bashku me këtë Qeveri me viza. Edhe Ilir Deda në fjalimin e tij, më duket e tha, ose një deputet tjetër, kërkoj falje, jo Glauku tha, që Qeveria do të vazhdojë kështu edhe vitin e ardhshëm, domethënë na dha shpresë që Qeveria nuk do rrëzohet deri vitin e ardhshëm nga opozita. Kështu që ne do ta japim mbështetjen tonë edhe për Qeverinë, edhe për ministren Hoxha.

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka kryeministri i Kosovës, zoti Ramush Haradinaj.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: I nderuar kryesues, zoti Xhavit Haliti,

Të nderuar deputetë,

Anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Ministre e Integritimeve, zonja Hoxha,

Shikoni, komunikimin me ju do ta bëj çdoherë të sinqertë. Ftesa për një seancë të shpejtë për Raportin e Progresit mendoj se është gabim prej anës suaj, për shkak se një raport i këtillë e kërkon një analizë më serioze dhe duhet t'ia lini një proces edhe Qeverisë, edhe vetes, për këtë raport, ndryshe edhe sot e javën tjetër nuk e kuptoj çka është dallimi, sikur t'i kishim bërë përgatitjet e duhura...

Unë sot nuk po vij të flas për të arriturat e progresin që e kemi pasur rast ta dëgjojmë, por po ju flas për sfidat që i kemi nxjerrë ne, me të cilat do të përballemi me to nga ky raport, se ai është i Kosovës, i dedikohet Kosovës, përfshihemi të gjithë, të gjitha qeveritë që kanë punuar në këto dy vjet, pozitivë apo opozitivë, komuna e të gjithë.

Si sfida janë incidentet në komunat ku jetojnë serbët, pra sfidë e nxjerrë. Pastaj janë dobësitë që ka Kosova për ta adresuar financimin e partive politike, pra është sfidë. Është folur për këtë. Po ashtu është sfidë edhe mospërputhja ndërmjet kornizës ligjore zgjedhore dhe ofrimit të të drejtave të barabarta të Ligjit për barazi gjinore, pra është sfidë e Kosovës, duhet ta trajtojmë me kujdes.

Është sfidë më vete reforma zgjedhore. Parlamenti thotë se duhet ta mbikëqyrë më shumë Qeverinë, pra që Qeveria duhet t'i raportojë Parlamentit. Qeveria dhe Kuvendi duhet t'i zbatojnë rekomandimet që kanë dalë nga shqyrtimi i agjencive të pavarura. Mbikëqyrja parlamentare e Forcave të Sigurisë së Kosovës, të Agjencisë Kosovare të Inteligjencës, duhet të jetë më e vërtetë, ashtu po thotë këtu, e kështu me radhë... Pra, janë plot sfida.

Çka do të bëjë Qeveria për sfidat, jo për të arriturat, se ato do t'i dëgjojmë duke u lavdëruar dhe kemi për t'u lavdëruar non-stop. Në mbledhjen e parë të Qeverisë propozojmë plan veprues, plan aksionar, se çka Qeveria mund ta ndihmojë Kosovën dhe ta ndihmojë Parlamentin e çdo institucione tjetër të përfshirë, që t'i adresojmë këto sfida, ta adresojmë një plan veprues. Të hënën e kemi këtë mbledhje, s'kemi mundur më përpara. Do të ishte joserioze sikur të kishim insistuar në një...

Ja tash i kemi nxjerrë dy dokumente, njëri është përmbledhja për raportin, Qeveria e ka nxjerrë, njëri është kjo analiza ku i kemi nxjerrë sfidat, është edhe progresi. Në disa raste ka progres më shumë, në disa raste ka sfida më shumë. Nuk i ikim Parlamentit, nuk jemi në shtëpi, sikur është thënë. Kjo seancë është kërkuar dhe për sot. Qeveria ka megjithatë obligimet që i merr. Për shembull, unë tash vij prej një takimi me NART-in, që është delegacion këshillëdhënës i NATO-s për ushtrinë tonë. Janë tema të dakorduara me muaj përpara. Edh ministrat tjerë kanë qenë.

Të nderuar deputetë,

Liberalizimi i vizave, e kam thënë në publik në raste të caktuara, është vendosur ajo temë, nuk është përfshirë në raport, se vetë karakteri i raportit ka dedikim të caktuar. Është një e arritur e madhe fakti se dy fqinjëve tanë u është rekomanduar hapja e negociatave, sidomos e kemi fjalën për Republikën e Shqipërisë, por edhe të Maqedonisë. Jam i bindur se ajo që na intereson neve shumë, e që është liberalizimi i vizave, pra do të ndodhë. Unë mendoj se para pushimit të verës do të na konfirmohet. Mendoj, e thashë, nuk po thirrrem në asgjë tjetër, po nuk e them krejt për koincidence, njëkohësisht atë që tha edhe zoti Zeka, Milaimi, po mendoj se jam në atë drejtim.

Sfidat që i ka vendi ynë, ju i shihni, disa janë rajonale, disa janë marrëdhënie me Serbinë, disa janë të tjera. Në disa raste lëvdohem se është progres, po nuk na pëlqen as progresi që kemi arritur se i ka ndjeshmëritë e veta, mirëpo Kosova nuk ka dilema në përcaktimin e vet evropian dhe euro-atlantik dhe do ta vazhdojmë këtë rrugë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka Haxhi Avdyli.

HAXHI AVDYLI: I nderuar kryeministër,

I nderuar kryesues,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Raporti i Progresit shpërfaq edhe një herë që rruga e Kosovës drejt BE-së është një rrugë e largët dhe në shumicën e sektorëve flitet për përmbushje parciale dhe shpeshherë për regres.

Përgjegjësia politike e progresit të Kosovës duhet adresuar drejt dhe në çdo sektor, duke përfshirë përgjegjësit e sektorëve të veçantë, por edhe hierarkinë politike në tërësi.

Për shkak të kohës së shkurtër të analizës së këtij raporti, unë jam koncentruar më shumë në ata sektorë që i njoh dhe jam pjesë e komisionit parlamentar, sektorit të politikave sociale dhe të shëndetësisë.

Kosova mbetet ende në fazën e hershme të përgatitjes së politikave sociale dhe punësimit. Akoma theksohet se Agjencia për Punësim nuk është funksionale, theksohet shumë qartë dhe zëshëm që siguria në punë dhe mbrojtja shëndetësore e punëtorëve është nën çdo nivel. Rekomandimet e vitit 2016 kanë ngecur edhe këtë vit në këtë sektor.

Përmendet që kërkohet amendamenti i Ligjit të punës dhe kërkohet që të punohet më shumë në mosdiskriminimin e gruas në punë dhe përmendet shpeshherë edhe ajo që ky Kuvend e ka përmendur këtu disa herë, për kushtet e rënda të sektorit privat, në të cilën ka një diskriminim të madh të punëtorëve.

Çështja e fëmijëve në punë adresohet dhe veçanërisht përmendet komuniteti RAE.

Shkalla e lartë e papunësisë mbetet njëri ndër problemet më të mëdha të Kosovës dhe praktikat sociale, jodiskriminuese, të kërkohet që të punohet më shumë, sepse aty ka një ngecje të madhe.

Po ashtu Kosova është në fazën e hershme të mbrojtjes së të drejtave të konsumatorit dhe respektimit të tregut të drejtë.

Në këtë raport tregohet që shëndeti publik ka adaptuar shumë rregullore dhe strategji dhe implementimi i tyre mbetet i mangët.

Mbetet shqetësuese që 30% e popullatës kosovare, si pasojë e varfërisë, s'mund t'i marrë shërbimet shëndetësore adekuate.

Edhe ajo që është përmendur këto ditë në Kosovë që mbetet vendi në nivelin më të ulët të financimit shëndetësor dhe shpenzimet nga xhepi i qytetarëve për shëndetin e tij arrijnë deri në 40%.

Përkundër që Ligji për duhanin në fillim ka pasur një sukses të mirë dhe ka dhënë efektet e para, ka një regres të madh në respektimin e Ligjit për duhanin në tërë territorin e Kosovës.

Legjislacioni për parandalimin e përhapjes së sëmundjeve ngjitëse mungon dhe çka është më shqetësuese, në sistemin tonë shëndetësor ka një regres në mbulueshmërinë e vaksinimit, domethënë nga viti 2016 në vitin 2017 ka një regres në vaksinim, e veçanërisht te fëmijët dhe më shumë shprehet te komuniteti RAE dhe si pasojë e saj, Kosova hyn në një rrezik të shpërthimit të epidemive, e veçanërisht kemi pasur rastin edhe të shpërthimit të epidemisë së fruthit.

Mbrojtja e të drejtave të pacientëve nuk është në harmoni me legjislaturën evropiane. Po ashtu theksohet me të drejtë që jemi vend me ngecje të mëdha në instalimin e sistemit të informimit shëndetësor, për të cilën para disa ditëve patëm edhe një interpelancë.

Promovimi shëndetësor dhe parandalimi i sëmundjeve mbetet shumë i dobët, siç mbetet edhe parandalimi i hershëm i kancerit.

Legjislacioni i shëndetit mendor është joadaptibil me ‘acquis communautaire’ dhe si pasojë e kësaj, ne mbetemi si një vend që nuk ofron barazi dhe gjithëpërfshirje në sektorin shëndetësor me shpenzime të mëdha familjare për shërim dhe i vetmi vend në Evropë me mungesë të sigurimeve shëndetësore.

Prandaj, rruga e progresit tonë drejt BE-së në këta dy sektorë ka ngecje dhe është një rrugë e gjatë e papërfunduar me tendenca të regresit.

Më vjen mirë që kryeministri në fjalimin e tij të mëhershëm tha se kërkohet nga Qeveria që ta respektojë më shumë Kuvendin dhe shpresoj që ky rekomandim do të vazhdohet edhe më tutje, të respektohen rregullat e Republikës sonë parlamentare.

Edhe nga rekomandimet që ky raport ka dhënë dhe unë dua ta bëj edhe si apel nga ky vend që Kosova ka nevojë për një reformë zgjedhore dhe ky apel u bëhet të gjithëve, jo vetëm atyre që janë në pozitë, por edhe neve si opozitë, edhe partive tona që të fillohet me një seriozitet shumë më të madh për një reformë zgjedhore, sepse e kemi parë që në zgjedhjet e kaluar ka pasur probleme dhe këto problem dhe këto anashkalime të cilat kanë ndodhur mund të përsëriten dhe ne të vazhdojmë të njëjtin avaz, si pasojë edhe të vjedhjeve të votave, por edhe anomalive të tjera që i kemi pasur në proces. Tani më Kosova e ka përvojën e duhur për t’i adresuar këto çështje dhe në zgjedhjet e ardhshme, kurdo që mbahen, të hyjmë të përgatitur dhe duke i pastruar listat, por edhe duke i ndryshuar disa nga anomalitë të cilat i kemi pasur në procesin zgjedhor. Pse jo, ndoshta edhe të fillohet jo vetëm me reformën zgjedhore, por edhe me ndryshime kushtetuese, të cilat duhen të përcillen me këtë reformë zgjedhore. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Një përjashtim, fjalën e ka zonja Kalludra.

**MIRJETA KALLUDRA:** Faleminderit, kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Ne sot po diskutojmë për raportin e Kosovës për vitin 2018, siç njihet te ne, Raporti i Progresit.

Mirëpo është mirë që është ndërruar emri i Raportit të Progresit, pasi që është vlerësuar se nuk po ka progres dhe tashmë quhet Raporti i vendit.

Për mua nuk është befasuese nga ajo që është prezantuar në raport, pasi që të gjithë e dimë se përveç të arriturës së ratifikimit të demarkacionit me Malin e Zi, në asnjë fushë tjetër nuk kemi pasur përmirësim të situatës, pra kjo është vërtetuar edhe me publikimin e raportit.

Me rastin e publikimit të raportit, Përfaqësuesja e Lartë e BE-së për Politikë të Jashtme dhe Siguri ka thënë se çdo shtet është vlerësuar në bazë të meritave të veta.

Në këtë rast, vendet fqinje, sipas Raportit të Progresit, Shqipërisë dhe Maqedonisë u është hapur rruga për t'i nisur negociatat për pranimin në Bashkimin Evropian, ndërsa Kosova ende duhet të luftojë krimin dhe korrupsionin, kjo tregon më së mirë për gjendjen e vendit tonë.

Në këtë raport Bashkimi Evropian ka shprehur shqetësimet rreth përpjekjes së disa deputetëve të Kuvendit të Kosovës në dhjetor 2017 për të shfuqizuar Ligjin mbi dhomat e specializuara dhe Prokurorinë Speciale dhe për këtë gjë do të ketë pasoja, njëherësh ka kërkuar nga institucionet që me përkushtim të përmbushin obligimet që dalin nga Ligji për dhomat e specializuara.

Kurse te reforma në administratën publike, si një kriter që është kërkuar në vazhdimësi, nëse dëshirojmë të ecim drejt rrugës së integritetit të Bashkimit Evropian.

Përveç që nuk është punuar asgjë në këtë aspekt, përkundrazi është konfirmuar se ka politizim të vazhdueshëm të administratës publike.

Sa i përket sistemit gjyqësor të Kosovës, është theksuar se është realitet, pra se sistemi është i brishtë dhe ka ndërhyrje të vazhdueshme politike, po ashtu është cilësuar si ngadalshëm dhe joefikas në trajtimin e lëndëve.

Është theksuar se Kosova është në fazën fillestare sa i përket luftimit të korrupsionit dhe krimit të organizuar.

Është theksuar se Kosova ka bërë vetëm disa përparime në lidhje me rezultatet e ndjekjes penale dhe pozita të nivelit të lartë që kanë të bëjnë me korrupsion dhe raste të krimit të organizuar, duke përfshirë edhe dënimet përfundimtare.

Është kërkuar se autoritetet e Kosovës duhet të jenë më efektive në përpjekje të tyre për të luftuar pastrimin e parave.

Po ashtu është shumë shqetësuese se është konfirmuar se kërcënimet dhe sulmet kundër gazetarëve kanë vazhduar, edhe pse liria e shprehjes është e garantuar me Kushtetutë, theksohet se Kosova nuk ka pasur progres gjatë periudhës raportuese sa i përket respektimit të lirisë së shprehjes.



Nga Kosova po ashtu është kërkuar të marrë masa konkrete edhe në pavarësinë, llogaridhënien, profesionalizmin dhe efikasitetin e sistemit gjyqësor.

Të luftohet me ngulm korrupsioni dhe konfiskimi i pasurisë së fituar në mënyrë të kundërligjshme.

Është kërkuar luftimi i korrupsionit të nivelit të lartë dhe rastet e krimit të organizuar, ku përveç 42 rasteve, është kërkuar të zgjerohet edhe me raste të tjera, të përfshihen të gjitha rastet e korrupsionit të lartë, te rastet e krimit të organizuar.

Korrupsioni është i përhapur dhe mbetet një çështje shqetësuese. Duhet të punohet me seriozitet për të trajtuar këtë problem, në një mënyrë gjithëpërfshirëse dhe strategjike.

Po ashtu është kërkuar mbrojtja e të drejtave themelore të njeriut, me prioritet të lartë është kërkuar për të siguruar kapacitete adekuate dhe burime financiare për zbatimin dhe promovimin e tyre, duke përfshirë ndihmën për grupet e cënueshme.

Është theksuar se gjykatat vazhdojnë të përballen me një numër të madh të rasteve penale, shumica të cilat janë lëndë të kundërvajtjes. Kjo rrezikon që gjykatat të mos jenë në gjendje t'u kushtojnë vëmendjen e duhur raste të profilit të lartë dhe serioz.

Në këtë rast është kërkuar se sistemi i ndërmjetësimit, si zgjidhje alternative e mosmarrëveshjeve të mbështetet financiarisht dhe të promovohet me qëllim që të ndikojë në uljen e numrit të lëndëve në sistemin gjyqësor.

Do të theksoj dështimet edhe te sektori i politikave sociale dhe punësimit, pra është vlerësuar se ka pasur vetëm progres te funksionalizimi i Agjencisë së Punësimit, pasi që asnjë nga rekomandimet e vitit 2016 nuk janë zbatuar.

Qeveria duhet të zbatojë planin për trajtimin e papunësisë së të rinjve, të zbatojë strategjinë 2018-2022 për punësim dhe mirëqenie sociale, të ndryshojë dhe të zbatojë Ligjin për punë dhe legjislacionin për shëndetin dhe sigurinë në punë dhe t'i miratojë dhe të zbatojë legjislacionin për inspektime, për të zvogëluar numrin e aksidenteve në punë.

Duhet të ndryshojë po ashtu Ligji për Këshillin Ekonomik dhe Social.

Në këtë sektor është theksuar se incidentet fatale në punë po rriten dhe Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive nuk po zbatohet.

Po ashtu është shprehur edhe shqetësimi serioz sa i përket punësimit të fëmijëve. Rreth 11% të fëmijëve janë të përfshirë në punë.

Nga Inspektorati i Punës është kërkuar të jetë më efikas në zbatimin e legjislacionit si dhe është kërkuar që të rritet numri i inspektorëve, të paktën nga 49 në 65 të planifikuar.

Është theksuar se punësimi i ulët po ashtu mbetet një sfidë kryesore në këtë sektor.

Norma e papunësisë është shumë e lartë, enden rreth 31% për vitin 2017.

Po ashtu është shumë shqetësuese se vetëm 29% e të punësuarve kanë kontratë të përhershme të punës, kurse 71% punojnë me kontratat afatshkurtra.

Kurse për mbrojtjen sociale apo shërbime sociale familjare është kërkuar që të parashihet grandit special për shërbime sociale në kuadër të buxhetit të komunave, pra të rregullohet me Ligjin për financimin e pushtetit lokal.

Po ashtu një çështje tjetër është edhe mbrojtja e konsumatorit dhe shëndetit. Është vlerësuar sikur në gjitha fushat se nuk ka pasur përparim.

Është kërkuar të rritet përfshirja e shoqërisë civile në mbrojtjen e konsumatorit dhe të drejtat e konsumatorit dhe të sigurohet numër adekuat i inspektorëve dhe mbikëqyrje e tregut.

Po ashtu është kërkuar rritja e burimeve financiare për të lejuar zbatimin e reformave të sektorit shëndetësor, respektivisht zhvillimin e sistemit elektronik të informimit shëndetësor.

Kurse sa i përket Ligjit për sigurime shëndetësore, është theksuar se zbatimi i tij mbetet i ngadalshëm dhe është vonuar. Pra, në vazhdimësi kemi shprehur shqetësimet tona dhe ne si deputetë dhe se Qeveria është duke u vonuar në fillimin e zbatimit të fillimit të sigurimeve shëndetësore.

Buxheti i vogël për shëndetësinë vazhdon të mbetet shqetësim serioz, është vlerësuar se vetëm 40% e totalit të nevojave vjetore për kujdesin shëndetësor janë të mbuluara.

Llogaridhënia është e ulët dhe nuk ka përmirësim të efikasitetit dhe cilësi në sektorin e shëndetësisë.

Po ashtu është vlerësuar se shpenzimet private nga xhepi mbeten të larta dhe vlerësohen në 40% të kostos totale mjekësore. Pra, kjo vazhdon të rëndojë jetën e qytetarëve.

Siç është prezantuar, edhe në këtë sektor ka dështuar Qeveria në përmirësimin e situatës dhe është konstatuar se nuk ka pasur përmirësim të situatës.

Vlerësohet se 1/3 e popullatës nuk kanë qasje të lehtë në shërbimet e kujdesit shëndetësor, ose kanë qasje të kufizuar për shkak të mungesës së fondeve.

Po ashtu është shprehur edhe shqetësim serioz sa i përket zbatimit të Ligjit mbi kontrollin e duhanit, është theksuar se niveli i zbatimit të tij ka vazhduar të bjerë për shkak të mungesës së vullnetit politik dhe performansës së dobët të autoriteteve zbatuese.

Pra, siç keni vërejtur, raporti ka shprehur shqetësimet apo dështimet e Qeverisë pothuajse në të gjithë sektorët.

Të nderuar kolegë,

Të nderuar qytetarë,

Kjo është edhe më shqetësuese, sepse me këtë Qeveri të papërgjegjshme jemi larg adresimit të sfidave dhe përmirësimin të jetës së qytetarëve si dhe luftimit të korrupsionit dhe krimit të organizuar që e kanë ngufatur shoqërinë tonë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Albulena Haxhiu e ka fjalën.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit!

Së pari vërejtjet e deputetëve lidhur me tekstin e papërkthyer janë të drejta. Prandaj, le ta trajtojmë këtë debat vetëm si hapje e shqyrtimit mbi Raportin për vendin, në mënyrë që ta trajtojmë pastaj edhe në komisionet parlamentare, Komisioni për Integritet tashmë e ka pasur ministren e Integritetit, por po ashtu edhe të gjitha komisionet e tjera për fushat e veta.

Menjëherë pas publikimit të Raportit për vendin, Qeveria u ngut, duke thënë se ky raport është raporti më pozitiv që ka pasur ndonjëherë Kosova.

Secila qeveri normale kritikën në këtë raport do t'i merrte seriozisht. Një qeveri e përgjegjshme do të duhej që t'i thërriste mendjes për problemet që po kalon vendi, sepse ky raport në fakt është pasqyra se si në Kosovë nuk funksionon asgjë.

Qasja e tillë sikur ajo që ky raport është raporti më pozitiv nuk i ndihmon aspak as Qeverisë, përkundrazi nëse s'jemi kritik dhe nëse s'i marrim seriozisht ngecjet, vendi do të vazhdojë të përballet me probleme të shumta që po na përsëriten për çdo vit.

Si ka mundësi që kjo Qeveri nuk e merr seriozisht as opozitën, as shoqërinë civile, as mediat, as qytetarët e Republikës, as raportet vendore apo ndërkombëtare që po bëhen për vendin?

Unë do të ndalem sot në tri çështje.

E para ka të bëjë me sistemin e drejtësisë. Shumë prej problemeve që sot sistemi i drejtësisë i ka, janë të paraqitura edhe në këtë raport.

Thuhet se mungon një strategji gjithëpërfshirëse për reformat e sektorit të drejtësisë dhe kjo është e vërtetë.

Vetëm tani së fundi, në njërën anë jemi vërshuar me projektligje për sistemin e drejtësisë, në anën tjetër, na është thënë që është duke u bërë rishikimi funksional dhe projektligjet po vijnë me një renditje të gabuar për faktin se së pari është dashur që të bëhet rishikimi funksional, për t'i ditur se cilat janë problemet me sistemin e drejtësisë, e pastaj që kjo të përcillet me projektligje.

Edhe në këtë raport thuhet se rishikimi funksional nuk ka pasur zhvillime të rëndësishme, ndonëse në vazhdimësi në shumicën e mandateve PDK-ja ka drejtuar apo ka udhëhequr me Ministrinë e Drejtësisë.

Ne nuk kemi parë që ministrat e PDK-së, qoftë Hajredin Kuçi, qoftë Dhurata Hoxha, apo edhe tani Abelard Tahiri ta kenë ndjekur një program që ka për qëllim instalimin e shtetit të së drejtës. Pra më shumë kemi parë veprime ad hoc dhe propozime për ndryshime që vijnë nga grupe apo individ të caktuar për interesa personale.

Për sistemin e drejtësisë thuhet se është në një fazë të hershme të zhvillimit, pra po flas vetëm pas shpalljes së pavarësisë, 10 vjet e më shumë, kështu është thënë edhe në vitin 2014, kështu është thënë edhe më 2015, kështu është thënë edhe më 2016, kështu po thuhet edhe tani në 2018-ën. Po ashtu sikur edhe në çdo raport tjetër flitet për cenimin dhe ndikimet politike në sistemin e drejtësisë.

Gjithçka e thënë për shtetin e së drejtës nga Qeveria rezultojnë retorikë boshe, pasi që ne vazhdojmë të kemi jashtëzakonisht shumë probleme në këtë drejtim.

Unë konsideroj se ka pasur një tendencë të vazhdueshme prej pushteteve të ndryshme që sistemi i drejtësisë të mos jetë funksional. Ka pasur një kontribut të fshehtë për mosfunksionalizim të sistemit të drejtësisë, tamam ashtu siç u përshtatet interesave të keqbërësve të shtetit.

Së dyti përmendet mungesa e buxhetit për sistemin e drejtësisë që është ndarë ndoshta pak më shumë se 2% e totalit buxhetor, resurse të munguara, staf të munguar, pra përveç ndërhyrjeve direkte e indirekte në sistemin e drejtësisë, edhe vetë mosmbështetja e sistemit të drejtësisë është në fakt cenim i saj.

Së treti, ky raport evidenton edhe një herë problemet me administratën e gjyqësorit, para dy jave u miratua Projektligji për prokurorin e shtetit dhe sipas ligjit në fuqi paraprak, Ministria e Drejtësisë ka qenë e obliguar të nxjerrë një ligj për administratën gjyqësore dhe në vend të tij, ajo e hoqi obligimin me ndryshimet e fundit dhe e dobësoi edhe më shumë administratën gjyqësore që, në fakt, është shtylla e sistemit të drejtësisë.

Te kapitulli i sistemit të drejtësisë flitet për mungesën e kapaciteteve të gjyqtarëve e prokurorëve, stafit mbështetës, kërkohen masa konkrete për pavarësim, llogaridhënie, profesionalizëm dhe efikasitet.

Janë ende më shumë se 300 mijë lëndë të pazgjidhura dhe me gjithë kërkesat e vazhdueshme për adresim dhe ndërmarrje të masave në zvogëlimin e lëndëve, kjo nuk po adresohet dhe është kritikë edhe në këtë raport, sidomos sa u përket çështjeve civile.

Me aq sa di, lëndët civile që po shqyrtohen tani janë ato të vitit 2012. Kjo krijon mosbesim, dëshpërim dhe dekurajim për qytetarët e Republikës së Kosovës, madje edhe cenim të të drejtave të tyre për zgjidhje të rasteve në një kohë të arsyeshme.

Kritikat në këtë raport adresohen me theks të veçantë edhe ndaj Këshillit Gjyqësor të Kosovës, evidentohet fakti se nuk ka ndonjë kontroll mbi rastet që konsiderohen politike.

Tash e sa kohë ne kemi parë sistemin e drejtësisë duke përndjekur në vazhdimësi aktivistët e Lëvizjes Vetëvendosje dhe, në anën tjetër, nuk kemi parë asnjëherë që Këshilli Gjyqësor i Kosovës ka trajtuar me kujdes rastet kur janë konsideruar politike ose të ketë ndërmarrë masa disiplinore ndaj gjyqtarëve, sikur Kalludra, por po ashtu nuk kemi parë veprim të Këshilli Gjyqësorë apo Prokurorial që do të na inkurajonte në raport me shkeljet e tmerrshme që ndodhin në procese gjyqësore kundër nesh.

Shqetësim mbetet niveli i profesionalizmit, sidomos i prokurorëve, madje flitet edhe për trajnime joadekuate për faktin që nuk aplikohen trajnimet e vazhdueshme për gjyqtarët dhe prokurorët. Jo rrallëherë kam përmendur shembuj të shumtë kur prokurorët dhe gjyqtarët nuk kanë mundësi hetimi dhe as gjykimi të rasteve që kanë të bëjnë me krimin e organizuar dhe korrupsionin dhe ky raport shton nevojën e trajnimit të vazhdueshëm, madje edhe të domosdoshëm, për krimet ekonomike, konfiskim, prokurim publik, raste të ngacmimeve seksuale si dhe dhunën me bazë gjinore.

Sipas këtij raporti, Kosova vazhdon të ketë probleme serioze lidhur me krimin e organizuar dhe korrupsionin.

Kërkohet rritja e numrit të prokurorëve në prokurori speciale, me theks të veçantë ndjekja e rasteve të korrupsionit të nivelit të lartë si dhe nevojat e trajnimeve për shtimin e kapaciteteve për hetime financiare.

Ne kemi paraqitur, për shembull, dhe kemi bërë thirrje për hetimin e fondeve, vjedhjes së tyre për sistemin informativ shëndetësor, të cilin e kishim në trajtim në interpelancën e thirrur nga zonja Fatmire Kollçaku.

Unë jam e bindur se Prokuroria e Shtetit, përveç që nuk ka vullnet, nuk ka dhe staf profesional për ta hetuar këtë vjedhje milionëshe të fondeve nga “Luxe Development” dhe buxheti i shtetit.

Pastaj flitet për Ligjin për sinjalizuesit që tek ne është komplet i pazbatueshëm, që nga viti 2011 është në fuqi dhe s’ka pasur asnjëherë tendencë për adresim të tij.

Madje, kemi pasur raste të shumta ku pikërisht ata që i kanë raportuar veprimet e kundërligjshme brenda institucioneve janë ndëshkuar, kjo është e vërtetë alarmante dhe dekurajim ekstrem i luftës kundër korrupsionit.

Në fund, sa i përket Ligjit për konfiskimin e pasurisë së pajustificueshme, Ministria e Drejtësisë tashmë e ka për mendim projektligjin të propozuar nga Lëvizja Vetëvendosje për vërtetimin dhe shqyrtimin e pasurisë së pajustificueshme, pra Ligjin antimafia. Pra, e ka proceduar Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje. Ne kërkojmë që mendimi i ministrisë të jetë pozitiv sa i përket këtij projektligji dhe i njëjti sa më parë duhet të hyjë në fuqi, pasi që pa e kaluar barrën e provës të personi i dyshuar, nuk do të ketë asnjëherë konfiskim, hetim dhe gjykim të zyrtarëve të korrumpuar. Ajo që dua të ndaj me ju këtu sot është se përgjatë gjithë këtyre viteve, pra që nga viti 2011 deri më tash në Komisionin për Legjislacion kam parë dhjetëra e dhjetëra zyrtarë që raportojnë para deputetëve, zyrtarisht me një gjuhë të ngurtë, nganjëherë siç e do dhe protokollin i mbledhjeve, por po aq shpesh kam dëgjuar rrëfimet e tyre pafund jashtë mbledhjes për afera, për parregullsi, ndikim të drejtpërdrejtë të pushtetit, probleme tepër të mëdha me funksionimin institucional.

Po ashtu, përgjatë gjithë këtyre viteve kemi lexuar me vëmendje jo vetëm raportet e progresit, por edhe raportet e organizatave tona dhe të tjera ndërkombëtare. Mund të them me përgjegjësi të plotë se qeveritë tona janë në thelb qeveri antievropiane. Asgjë në jetën e përditshme të tyre nuk ngjan me normën, frymën edhe të shtetit më të dobët përbrenda Bashkimit Evropian. Shumë shpesh jemi përpjekur të shtyjmë përpara nisma edhe të qeverive që janë dukur si të duhurat, nuk ka kaluar pak kohë dhe jemi sinjalizuar që pas asaj nisme ka qenë i mbuluar një interes okult, i paligjshëm e i padrejtë.

Ne mund të formalizojmë shumë instrumente antikorrupsion dhe do të punojmë drejt asaj, por qytetarët duhet ta dinë që me qeveri të tipit Thaçi, Mustafa, Veseli, Haradinaj nuk ecin dot përpara rrugës së integritit evropian, e as të zhvillimit të brendshëm. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Evgjëni Thaçi e ka fjalën.

EVGJËNI THAÇI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Të dashur qytetarë të Kosovës,

Edhe unë insistoј në atë se është e pashpjegueshme ngutia për të debatuar dhe trajtuar Raportin e Progresit, kur akoma ky raport nuk është përkthyer në gjuhët zyrtare që përdoren në Republikën e Kosovës.

Ky është raport, të cilën shumica dërrmuese e deputetëve apo zyrtarëve të tjerë në Kosovë nuk e kanë lexuar dhe si i tillë nuk është analizuar mirë. Ky raport meriton më shumë respekt, prani më të madhe të deputetëve në këtë debat dhe diskutim më kualitativ. Kemi parasysh se qëndrimet që vijnë nga deputetët lidhur me këtë raport rrjedhin nga informacionet që kanë ardhur nga mediat, e jo nga raporti zyrtar. Prandaj, debati mund të jetë edhe çorientues për qytetarët, por meqenëse jemi në këtë fazë të debatit, atëherë duhet të vazhdojmë.

Raporti nuk është befasues, të gjithë e dimë gjendjen e zhvillimit në Kosovë në të gjitha fushat, i dimë të arriturat dhe ngecjet. Prandaj, duhet t'i themi gjërat ashtu siç janë në të vërtetë dhe secili nga ne të marrë përgjegjësinë që i takon. Thuhet se jemi në hapat e parë në zhvillimin e reformave, u tha që kjo shprehje do të kishte kuptim më shumë në vitin 2004, se sa në vitin 2018. Mos harroni se MSA-ja daton që nga viti 2016 dhe kjo është krejt normale. Reformat janë të vazhdueshme dhe vazhdojnë edhe në shtetet që janë tashmë të anëtarësuara në BE, bile angazhimi më i madh dhe më i vështirë është në fazat e mëvonshme. Prandaj, konsideroj që shprehja “fazë e hershme” në këtë aspekt nuk është shqetësuese, por ky raport shpreh edhe angazhimin e Qeverisë në implementimin e reformave që kanë të bëjnë në disa fusha. Pra, të mos e neglizhojmë faktin që Raporti i Progresit pasqyron progres solid në disa fusha dhe ne duhet t'i njohim mirë ato.

Reforma solide janë bërë në agjendën e reformave evropiane, po ashtu në reformat ekonomike, është bërë progres në zhvillimin e ekonomisë së tregut, është përmirësuar ambienti i të bërit biznes. Ka përparim në përmbushjen e standardeve evropiane sa i përket aspektit legjislativ dhe përafrimit me ‘acquis communautaire’, përparim në lirinë e lëvizjes së qytetarëve, mallrave dhe shërbimeve në prokurorim publik, përparime në luftën kundër terrorizmit, përfshirë marrjen e masave për trajtimin e ekstremizmit dhe radikalizmit dhe në shumë fusha të tjera. Në mënyrë të veçantë theksohet se ratifikimi i marrëveshjes për shënjimin e kufirit mes Kosovës dhe Malit të Zi është një e arritur e rëndësishme në përmbushjen e kritereve kyçe për liberalizimin e vizave.

Ndërsa, është arritur përparim në përmbushjen e kriterit të fundit që është lufta kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar, pra kriterit 94.

Mendoj se duhet të jemi krenarë që i kemi përmbushur të gjitha këto kritere, të cilat shpeshherë kemi thënë që nuk janë të drejta, mirëpo ne nuk mund të vendosim se cilat kritere t'i përmbushim e cilat jo. Ne thjesht duhet të punojmë në plotësimin e tyre, pra liberalizimi i vizave mund të jetë vendim politik, por jo krejt politik, sepse do të vijë dhe si rezultat i përmbushjes së kritereve nga ana e institucioneve të Kosovës. Të mos harrojmë se raporti në mënyrë të veçantë trajton punën e Kuvendit, ku përgjegjësi të njëjtë për të arriturat dhe ngecjet kanë të gjitha grupet parlamentare dhe deputetët individualisht. Sjellja bllokuese e disa deputetëve, duke përfshirë edhe përdorimin e gazit lotsjellës, e kanë penguar pa masë punën e Kuvendit dhe kanë shfaqur një pamje të keqe para opinionit ndërkombëtar. Mungesa e deputetëve në seanca dhe mbledhje të komisioneve, ku trajtohen ligje shumë të rëndësishme për jetën e qytetarëve të Kosovës, të ardhmen e tyre dhe të ardhmen e vendit.

Bojkoti i vazhdueshëm i seancave nga opozita kur kemi të bëjmë me çështjet kyçe për vazhdimin e punës, është mjaft shqetësues dhe ndikon direkt në mosfunksionimin normal të Kuvendit. Kemi pasur rastin kur është bojkotuar votimi IPA 2016, që në seancën e parë të kësaj legjislature. Po ashtu, është bojkotuar diskutimi dhe votimi i buxhetit. Kuvendi duke thirrur, pra deputetët duke thirrur debate dhe interpelanca për çështje që nuk i përkasin organit legjislativ, Kuvendi po kthehet në një organ të drejtësisë, duke shkëlur kështu parimin bazë të funksionimit të institucioneve që është ndarja e pushteteve dhe mospërzierja në punët e njëra-tjetrës. Në këtë mënyrë, ka ardhur edhe deri te procedimi i shpejtë dhe pa debate, e konsultim me propozuesit e ligjeve të ndryshme.

Kjo praktikë duhet të ndalet dhe Kuvendi duhet të kryejë punën e vet në pajtim me kompetencat e veta. Pra, në përgjithësi, përgjegjësi shumë të madhe ka dhe opozita në këtë aspekt, e jo vetëm pozita. Unë pajtohem se të gjitha partitë politike duhet të gjejnë vullnet dhe të intensifikojnë përkushtimin e tyre për arritjen e një konsensusi kur kemi të bëjmë me çështje të rëndësishme nacionale. Unë mendoj se raporti është korrekt dhe shpresëdhënës, Kosova po vazhdon mirë në reformat për të cilat është zotuar t'i zhvillojë dhe nuk mungon vullneti. Bazuar në këtë, Kosova dhe qytetarët e saj meritojnë të trajtohen njëjtë sikurse edhe qytetarët e tjerë të rajonit, ne meritojmë të trajtohem ashtu siç jemi, pra evropianë dhe në këtë drejtim liria e lëvizjes është fundamentale. Shpresoj që ky vullnet është i ndërsjellë dhe ne së shpejti do të kemi liberalizim të vizave nga BE-ja, në mënyrë që të vazhdojmë zhvillimin dhe integrimin individual dhe shtetëror. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka kërkuar ministri i Drejtësisë, zoti Tahiri.



MINISTRI ABELARD TAHIRI: I nderuar kryesues!

Të nderuar deputetë,

Zonja Haxhiu lëvizi nga salla, mirëpo unë i them që të paktën Raporti i Progresit ka evidentuar zakonisht përpjekjet e të gjithë atyre kryeministrave që i përmendi për të paktën për shpejtimin e reformave, mirëpo në anën tjetër, sa u përket juve, e ka theksuar degradimin që i keni bërë jetës parlamentare në Republikën e Kosovës, sidomos këto tre vjetët e fundit.

Sot kjo temë është shtruar për debat në Kuvendin e Kosovës dhe konsideroj se pritjet tona, ashtu siç presin edhe qytetarët tanë, duhet të jenë unifikuese, reale dhe motivuese, por edhe më shumë se çdo gjë që del nga ky raport t'i përgjigjemi me hapa konkretë, në këtë drejtim përgjegjësia është e gjithë neve, por më shumë e pozitës.

Të nderuar deputetë,

Ky raport pa dyshim që është Raport i Progresit dhe kjo gjë është e qartë, ani pse mund të flasim për shkallën se sa ka pasur progres apo nëse në sektorë të caktuar nuk është shënuar ndonjë progres i theksuar. Ky Raport i Progresit të vendit që mat zhvillimin në rrafshin politik, ekonomik-social, si dhe segmente të caktuara të qeverisjes, por edhe nga metodologjia e hartimit të tij është real, ndonëse në një situatë konkrete do të duhej të pasqyronte çdo përpjekje të Qeverisë, të cilat edhe sot e kësaj dite janë duke bërë diferencën e madhe në raport me të kaluarën, ani pse ende s'kanë marrë formën finale. Ne si Qeveri nuk jemi të ngazëllyer me raportin, ani pse ajo që paraqet progresi lidhet kryesisht me masat që kemi ndërmarrë për shtatë muaj pasi jemi në këtë Qeveri, por është e padrejtë të ndihen të ngazëllyer, siç po e shoh në këtë debat, ata që kanë qeverisur për një kohë, për të cilën flet ky raport.

Nuk dua të thellohem më tutje në diskutim gjeneral, por do të flas për të gjeturat e raportit që ndërlidhen me fushën e drejtësisë, për të cilat sot unë jam përgjegjës. Madje, do të filloj nga ato pjesë ku është evidentuar se nuk ka pasur progres të mjaftueshëm. Raporti thekson, mes të tjerash, se zbatimi i ligjeve dhe strategjisë ka qenë joadekuat për shkak të mungesës së resurseve dhe në këtë rast më vjen keq që zoti Hoti nuk është në këtë sallë, sepse ka qenë një njeri që vërtet kishte bllokuar në atë periudhë sa ka qenë ministër i Financave Këshillin Gjyqësor dhe Këshillin Prokurorial. Nuk ka pasur prioritet të qartë të koordinimit adekuat në fushën e drejtësisë, fatkeqësisht edhe kjo një mosvullnet i Zyrës së Kryeministrit për ato tre vjet. Institucionet e sundimit të ligjit nuk kanë pasur përkrahje të mjaftueshme financiare, pra si rezultat i mosbashkëpunimit dhe mosmarrjes parasysh fare të kërkesave të këtyre dy këshillave nga ministri i Financave dhe kryeministri i asaj kohe. Nuk ka pasur administrim të mirëfilltë të sistemit gjyqësor, nuk ka pasur buxhet të mjaftueshëm për sistemin e drejtësisë, e për pasojë nuk ka pasur ndonjë alternativë për uljen e numri të lëndëve.

Të nderuar deputetë,

Sa i përket numrit të lëndëve, veç një gjë dua t'ju them, pavarësisht kërkesave prej Gjykatës Supreme, Dhomës së Posaçme, e cila funksionon me 20 gjyqtarë, 7 prej tyre ndërkombëtarë dhe 13 vendorë, kanë 22 mijë lëndë. Këto 22 mijë lëndë, 20 gjyqtarë, ju mund të merrni me mend se sa mund të jetë efikase puna e tyre, domethënë për katër vjet rresht nuk janë plotësuar kërkesat e tyre, që është e padrejtë dhe kjo Qeveri për herë të parë ka adresuar kërkesat e kësaj Dhome ashtu siç ka adresuar kërkesat e Këshillit Gjyqësor dhe Këshillit Prokurorial. Nuk ka pasur koordinim të mirëfilltë të donatorëve në fushën e sistemit të drejtësisë si rezultat i mosvullnetit të kryeministrit dhe ministrit të Financave.

Të nderuar të pranishëm,

Pra, rekomandimet e njëjta të vjeshtës së vitit 2016 janë bartur sërish sa i përket legjislacionit, siç është ai për mbrojtjen e informatorëve, Agjencia Kundër Korrupsion, deklarimit të pasurisë si dhe kompetencat e zgjeruara për konfiskim të pasurisë. Nuk ka pasur integrim të mirëfilltë të institucioneve në luftimin e korrupsionit dhe krimin të organizuar, nuk ka pasur përmirësim të legjislacionit në fushën penale. Pra, besoj jemi të qartë që tashmë kam proceduar në Kuvend Kodin Penal, një çështje që ka qenë e adresuar në vjeshtën e vitit 2016, nga Raporti për vendin në atë periudhë dhe shumë shpejt do ta kemi në Kuvend edhe Kodin e Procedurës Penale.

Të nderuar deputetë,

E nderuara zonja Vjosa,

Ti s'ke nevojë të prekesh, se s'e ke votuar atë Qeveri në atë kohë, kështu që kush ka qenë kryeministër dhe ministër i Financave? LDK-ja, po e kritikoj kryeministrin tënd që e ka bllokuar një sistem, Dhurata ka qenë ministre e Drejtësisë, jo agjenci ligjzbatuese. Po, nuk ke nevojë të shqetësohesh, ke të drejtë se s'e ke votuar atë qeveri. LDK-ja e ka veç një meritë në këtë aspekt, ish-kryeministri i kësaj partie është përmendur në raport si një kryeministër i shkarkuar me votë të mosbesimit për shkak se nuk ka arritur të sigurojë hapa të nevojshëm që i hapin perspektivën evropiane qytetarëve të Republikës së Kosovës. Ndërsa, sot ju kërkoni një unifikim të spektrit politik. Keni pasur një dështim dhe tani është e pandershme të kërkoni. Unë po ju kërkoj, po ju kritikoj juve, po e kritikoj ministrin e Financave, gjë që kishte bllokuar për tre vjet rresht Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe Këshillin Prokurorial të Kosovës.

Këto të gjetura janë atribut ekskluziv i paaftësisë së qeverisë së udhëhequr nga LDK-ja, për të prioritetizuar dhe shtyrë përpara çështjet e rëndësishme që fuqizojnë sundimin e ligjit, luftën kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar, si dhe qasjen në drejtësi efikase për të gjithë qytetarët e vendit.

Të nderuar të pranishëm,

Tash duke mos devijuar për asnjë moment nga përgjegjësia ime si ministër i Drejtësisë, të nderuar deputetë, më lejoni t'ju njoftoj se çfarë kam bërë unë për këta shtatë muaj në adresim të

problemeve, për të cilat ky raport flet. Në fakt, dëshiroj të falënderoj edhe kryetarin e Kuvendit, kryeministrin edhe kolegët ministra dhe veçmas deputetë të nderuar që keni mbështetur dhe vazhdoni të mbështetni nismat ligjore të sundimit të ligjit në Republikën e Kosovës, e që sjellin një dimension tërësisht të ri, për të cilin besoj që do të flas Raporti i ardhshëm i Progresit, e kur ai raport të dalë, sërish do të jemi këtu për të bërë vlerësimin e performansës. Në radhë të parë, raporti shënon si ndër të arriturat më të mëdha integrimin e gjykatësve dhe prokurorëve të komunitetit joshumicë në sistemin unik të drejtësisë së Republikës së Kosovës.

Për korrektësi, po e ndaj me ju këtë informatë që nga marrja e detyrës si ministër i Drejtësisë nga 9 shtatori, çdo të premtë kam pasur takime me krerët e institucioneve të Drejtësisë, Bashkimit Evropian, Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, për të trajtuar çdo detaj të fundit për të dinamizuar procesin e integritit të këtyre gjykatësve dhe prokurorëve, gjë që është kurorëzuar përfundimisht me fillimin e punës dhe integrimin e tyre më 24 tetor të vitit që lëmë pas.

E dyta, që në fillim të mandatit tim kam shtruar para vetes një agjendë legislative prej 18 projektligjesh, në mesin e të cilave Kodin Penal, Kodin e Procedurës Penale, pakon e ligjeve të gjyqësorit, pakon e ligjeve kundër korrupsionit, pakon e ligjeve të drejtave pronësore, si dhe i kam paraprirë një dinamikë të përshpejtuar secilit prej rekomandimeve që sot thotë ky raport dhe në dy muajt në vijim, përveç atyre që tashmë janë miratuar, të gjitha projektligjet e rekomanduara nga Raporti do të jenë të miratuara në Qeveri dhe do të vijin për miratim në Kuvend, ku besoj do ta kenë përkrahjen tuaj.

E treta, kam ndërmarrë dhe zgjeruar në kuptim të gjithëpërfshirjes reformën më të madhe të ndërmarrë ndonjëherë në Kosovë, veçmas në fushën e drejtësisë, pra rishikimin funksional të sektorit të sundimit të ligjit. Pra, reformë e ndarë në shtatë shtylla, ku secili prej tyre reflekton rekomandimet e këtij raporti.

E katërta, kam rekomanduar dhe mbështetur fuqishëm rritjen e buxhetit të Këshillit Prokurorial dhe atij Gjyqësor, për miratim të të cilit ju kam falënderuar dhe ju falënderoj edhe sot e kësaj dite, sepse kjo rritje e buxhetit për këto dy Këshilla, do të mundësojë shtimin e kapaciteteve të sistemit gjyqësor dhe atë prokurorial, për të mundësuar kështu administrim efikas të drejtësisë, uljen e numrit të lëndëve të pazgjidhura dhe forcimin e besimit të qytetarëve në drejtësi, pra në Republikën e Kosovës.

E gjashta, kam nxitur fushën për promovim të profesioneve të lira ligjore, në mënyrë që përmbauesit privatë, noterët, ndërmjetësuesit e tjerë, të jenë pikë reference për qasje më efektive në drejtësi, duke plotësuar kështu paraprakisht edhe një nga rekomandimet edhe në këtë raport. Më tutje, kam ofruar mbështetjen time të plotë për Këshillin Gjyqësor dhe atë Prokurorial, gjithashtu duke respektuar në mënyrë strikte ndarjen dhe pavarësinë e plotë të pushteteve.

Të nderuar deputetë,

Ju falënderoj për vëmendjen dhe besoj që të gjitha këto të gjetura, të gjitha këto që dalin nga ky Raport i Progresit, shumica nga to do të adresohen nga agjenda legislative e Ministrisë së Drejtësisë të këtij viti. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Replikë, zonja Haxhiu, sepse ia ka përmendur emrin.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit!

Së pari, ministri aktual i Drejtësisë nuk ka të drejtë të paktën në aspektin moral të flasë për forcimin e sistemit të drejtësisë, reformën në sistemin e drejtësisë, për shkak se partia e Abelard Tahirit është përgjegjëse për degradimin e sistemit të drejtësisë. Është e tepërt çfarëdo fjale kur tashmë e kemi të qartë se si janë zgjedhur prokurorët, gjyqtarët, afëra “Pronto” në fakt e dëshmon këtë. Dhe, pse sistemi i drejtësisë është i kapur, e dëshmon që u ngritën aktakuza për disa persona, përfshirë një ministër dhe një deputet të PDK-së, por jo edhe për Kadri Veselin e Hashim Thaçin, që janë në fakt protagonistët e aferës “Pronto”.

Tutje, para pak ditëve, ministri i Drejtësisë ishte në një mbledhje të Këshillit Gjyqësor dhe Këshillit Prokurorial dhe ishte prania e tij e paligjshme. Çfarë kërkon ministri i Drejtësisë në një mbledhje me dyer të mbyllura kur diskutohen rastet e korrupsionit? A është kjo ndërhyrje direkte në sistemin e drejtësisë? Gjatë kohës sa ka qenë ministër Hajredin Kuçi, ka qenë edhe e drejta e tij me ligj që të marrë pjesë në Këshillin Prokurorial të Kosovës, vetëm prania e tij aty bënte presion mbi vendimet që i merrte Këshilli Prokurorial i Kosovës.

Andaj, zoti ministër, përgjegjësinë për këtë e ka PDK-ja dhe mos u mundo që me fjalë dhe retorikë boshe ta arsyetosh kapjen e sistemit të drejtësisë. Pra, të paktën në aspektin moral, të lutem, ke pak konsideratë edhe për shkak të qytetarëve të Republikës së Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Kundër-replikë, ministri!

MINISTRI ABELARD TAHIRI: Zonja Haxhiu, juve veç sundimi i ligjit nuk ju konvenon në këtë Republikë. Pjesëmarrja ime në mbledhje të përbashkëta me Këshillin Gjyqësor dhe Këshillin Prokurorial lidhet me agjendën legislative, të cilat ato projektligje që unë i kam sjellë në Kuvendin e Republikës së Kosovës nuk janë produkt i vetëm Ministrisë së Drejtësisë, por janë produkt i punës së përbashkët i Ministrisë së Drejtësisë, Këshillin Gjyqësor, Këshillit Prokurorial, Akademisë së Drejtësisë, Gjykatës Supreme, zyrës së Prokurorit të Shtetit, pra të gjithë mekanizmave të drejtësisë dhe unë po të siguroj, jo atëherë, por sot e shtatë muaj kam takime të rregullta me to sa i përket koordinimit të politikave që vijnë për miratim dhe ligjet që vijnë për miratim në këtë Kuvend.

Është Partia Demokratike e Kosovës dhe unë si ministër i saj që sot e kam sjellë në Kuvendin e Kosovës një Projekt kod penal, të cilën ju ftoj ta miratojmë, që i ashpërsojmë jashtëzakonisht masat kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit. Më mirë të them, ua pamundësojmë të merren me politikë dhe të shërbejnë në institucione...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYESUESI: Fjalën e ka zoti Çausi.

DRITON ÇAUSHI: Faleminderit!

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,  
Kolegë deputetë,

Dua që fillimisht të shpreh një shqetësim timin në lidhje me mënyrën se si po zhvillohet ky debat, edhe shumë debate të tjera, konsideroj. Për disa arsye që më bëjnë të dyshoj shumë në funksionalitetin edhe produktivitetin e këtyre seancave.

E para, është një dokument shumë i rëndësishëm, i cili mendoj se meriton trajtim shumë serioz përtej leximit dhe interpretimit dhe në këtë drejtim mendoj se për të plotësuar këtë parakusht, për të pasur një debat të mirëfilltë, do të duhej që edhe kolegët e tjerë të kishin kohën e mjaftueshme për të marrë një formë të përkthyer të këtij dokumenti. Mbi të gjitha mendoj që nuk ka kuptim të quhet “debat” kjo që po bëjmë sot, përderisa pjesa më e madhe e përfaqësuesve të Qeverisë nuk janë në këtë sallë. Sidoqoftë, janë dy fusha të cilat mendoja t’i trajtoja në fjalën time, por do të kufizohem për shkak se edhe do të përsëris nga ajo që është lexuar dhe interpretuar edhe do të lexohen, rilexohen dhe interpretohen më tutje.

Në fushën e arsimit nuk është se dallon shumë për nga vlerësimi negativ që u është bërë edhe fushave të tjera. Mirëpo, do të ndalem te dy çështje, të cilat lidhen me disa të gjetura nga ky raport që kanë të bëjnë me arsimin e lartë, ku thuhet se, edhe pse numri i studentëve është dyfish në raport me mesataren e Bashkimit Evropian, kemi një shkallë shumë të lartë të diplomimit. Kjo është besoj e njohur për të gjithë studentët dhe ata që janë të angazhuar në universitet që shkalla e diplomimit është skandaloze, është tepër e ulët dhe, përveç kësaj, thuhet që papunësia te të diplomuarit është rreth 25%, që është tepër e ulët. Mendoj që kjo gjetje mund të lidhet shumë mirë me atë që ka ndodhur me Universitetin publik, me shkollimin e lartë në përgjithësi, e kam fjalën sidomos për të gjitha ato universitete që u hapën në vitet e fundit, e të cilat jo që nuk sollën cilësi, por rrezikojnë të mbyllën dhe mbi të gjitha ulën edhe në mënyrë të dukshme cilësinë që ofrohet në Universitetin “Hasan Prishtina”.

Besoj që indikator i më i mirë për të treguar qëllimin e këtyre universiteteve është koha e themelimit të tyre. Nëse i shihni shumica prej tyre gjashtë universiteteve të tjera janë themeluar në prag ose gjatë fushatave elektorale. Kjo besoj që bashkë me shumë universitete private, e ka

dëmtuar në mënyrë shumë të vështirë cilësinë e arsimit të lartë. Nuk do ta zgjas më shumë në këtë fushë, një temë tjetër të cilën do të përpiqem shumë sipërfaqësisht, duke u ndalur prapë në dy çështje me të cilat vetë raporti nuk merret, por besoj se janë të ndërlidhura me gjetjet, e që ka të bëjë me mjedisin. Natyrisht që edhe këtu thuhet se nuk ka asnjë rezultat pozitiv në zgjidhjen e problemeve serioze mjedisore, e që vazhdojnë të ndikojnë në jetën e njerëzve dhe në shëndetin e tyre. Gjetjet janë të rënda kur i lexojmë, për shkak se thuhet se edhe nuk ka një strategji për ta ndryshuar gjendjen e mjedisit, mirëpo nuk ka asnjë identifikim të ndotësve më seriozë në pjesë të ndryshme të mjedisit. Tani mendoj se rasti që e kishim me krizën e ajrit të ndotur e tregon më së miri mënyrën se si ne e trajtojmë mjedisin ose seriozitetin me të cilin ne e trajtojmë mjedisin, pra ngjashëm sikurse me skandalin e sigurisë së ushqimit. Janë çështje të rëndësishme për një periudhë shumë akute dhe nuk ka asnjë ndjekje të problemit dhe asnjë trajtim serioz.

Treguesi më i mirë për këtë është raporti i Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit, të cilin e kemi pasur para disa muajsh në këtë Kuvend, dhe nëse ju kujtohet, ai raport as në mënyrë sipërfaqësore nuk i tregon parametrat kryesorë të ndotjes së mjedisit në Kosovë. Pra, besoj që ju kujtohet që nuk ka asnjë identifikim të gjendjes së tokës, mënyra sesi janë matur treguesit e ndotjes së ajrit është tepër joserioze. Nuk ka asnjë informacion për ndotjen ose për gjendjen e ujërave nëntokësore dhe kështu edhe me disa parametra tjerë.

Kujtoj që ai raport ishte i vitit 2016. Pra, ne nuk e kemi ende një raport për gjendjen e mjedisit për vitin që shkoi. Besoj që natyrisht se duhet të fillojë një trajtim serioz i kësaj çështjeje, mirëpo duhet t'i trajtojmë në radhë të parë institucionet që merren me këtë çështje dhe këtu në radhë të parë është Ministria e Mjedisit, por edhe efektivitetin e paqenë dhe punën e pamjaftueshme të Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Ministri Hasani e ka fjalën.

MINISTRI BAJRAM HASANI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë,

U tha këtu për Raportin e Progresit, e mund të themi që një pjesë e mirë e këtij progresi, nëse po themi pavarësisht edhe rekomandimeve, edhe një pjese, po flasim veç për anën e progresit, i takon shumë edhe Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë me rezultatet e këtij progresi që janë shënuar.

U tha për një periudhë më të gjatë, këtu domethënë vlen që këto rezultate i takojnë edhe ish-ministres së Tregtisë dhe Industrisë.

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë ka pasur të arritura në lëvizjen e lirë të mallrave, në lëvizjen e lirë të shërbimeve, në lehtësirat e të bërit biznes, si dhe në qasjen në kredi. Aspekt pozitiv në këtë raport është edhe rangimi në top-dhjetë vendet më të suksesshme që kanë bërë reforma të thella

dhe të raportuara nga Banka Botërore në fushën e të bërit biznes. Po ashtu, në raport theksohet se janë bërë lehtësira për bizneset duke krijuar platformë elektronike të regjistrimit të biznesit dhe qasja në kredi është bërë më e lehtë si rezultat i definimit të procedurave të falimentimit.

Ligji për shoqëri tregtare do t'i thjeshtësojë edhe më tej procedurat e regjistrimit dhe çështja e likuidimit është thjeshtësuar pasi është vendosur korniza rregullative.

Meqenëse jemi te Ligji për shoqëri tregtare, kisha kërkuar prej deputetëve, për shkak se Presidenti e ka rikthyer Ligjin për shoqëritë tregtare, për të cilin keni vendosur këtu pa dashjen dhe pa propozimin tim për kuotën gjinore, unë kisha kërkuar që ky ligj sa më parë të procedohet dhe të votohet në Kuvendin e Kosovës, me qëllim që në rast se deri më 15 maj votohet Ligji për shoqëritë tregtare, ju garantoj se Kosova do të shënojë prapë progres në ambientin e të bërit biznes dhe gjatë këtij viti, në tetor, do të kemi raportin prapë nga Banka Botërore që do të shënojë progres të vazhdueshëm në këtë drejtim.

Në tregun e brendshëm dhe lëvizjes së lirë të mallrave i kemi plotësuar standardet e BE-së, po ashtu e kemi hartuar legjislacionin primar dhe sekondar për tregtinë dhe shërbimet, duke e përafuar me BE-në. Është rishikuar një numër i konsiderueshëm i ligjeve me qëllim përafritimit me BE-në. Vlerësim pozitiv është se Kosova është në fazë të hershme të përgatitjes për lëvizjen e lirë të mallrave, në përgjithësi kornizën për prodhim, distribuim dhe reklamimin e produkteve që është përafuar, ligjet për standardizim, akreditim dhe kërkesa teknike dhe vlerësimi të konformitetit janë aprovuar në vitin 2018, si dhe në planin e zbatimit të MSA-së janë specifikuar hapat e përafritimit të mëtejshëm dhe zbatimit të legjislacionit të BE-së.

Aspekt pozitiv është edhe standardizimi. Ligji i ri i standardizimit e ka përafuar edhe më shumë legjislacionin kosovar me atë të BE-së. Rreth 647 standarde janë të adaptuara për kohën e raportimit. Edhe pse Kosova nuk është anëtare e Komitetit Evropian për Standardizim dhe Komitetit Evropian për Standardizim Elektronik (CEN dhe CENELEK), kjo organizatë në vitin 2017 ia ka lejuar Kosovës qasjen direkte në standarde.

Dua të theksoj se Ministria e Tregtisë dhe Industrisë është pothuajse i vetmi institucion që në Raportin e Progresit ka dalë suksesshëm, duke theksuar se ka pasur përparim në të gjitha fushat që i mbulon ministria jonë.

Aspekt tjetër pozitiv janë 39 trupa të vlerësimit të konformitetit të akredituar në Kosovë dhe katër janë në proces të krijimit. Mbikëqyrja e tregut, domethënë Ligji për sigurinë e produkteve është përafuar me legjislacionin e BE-së. Koordinimi ndërinstitutional është përmirësuar që nga themelimi i këshillit. Kosova e ka përafuar legjislacionin me BE-në sa u përket lodrave, pajisjeve elektromagnetike dhe sigurisë së liftave. Një tjetër aspekt pozitiv, që përmendet në raport është edhe kryesimi në marrëveshjen e CEFTA-s, ku theksohet pjesëmarrja aktive e

Kosovës dhe kryesimi aktiv nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë. Po ashtu, theksohet se ka trend pozitiv të rritjes së eksporteve, si në mallra, ashtu edhe në shërbime dhe Ministria e Tregtisë dhe Industrisë do të vazhdojë t'i promovojë dhe përmbushë obligimet që dalin nga MSA-ja.

Dokumenti për anëtarësimin në Organizatën Botërore të Tregtisë ka përfunduar dhe kjo përmendet si një arritje tjetër pozitive dhe Ministria e Tregtisë dhe Industrisë tani do të vazhdojë me hapa tjerë drejt anëtarësimit. Kosova gjithashtu e ka vazhduar koordinimin me bashkimin evropian sa i përket pozicionimit në lidhje me çështjet tregtare.

Kjo ishte sa i përket raportit, kurse dua të ndërlidhem me fjalimin që e pati deputeti Dardan Sejdiu, i cili thotë se nuk është bërë asgjë sa i përket prodhimit, prodhuesve.

Unë ju them me përgjegjësi të plotë, hapat që i ka ndërmarrë kjo Qeveri për këta muaj sa jemi në qeverisje, ndoshta mund të themi që janë reformat më të thella që po i bën në legjislacion sa i përket mbështetjes së prodhimit vendor. Ne kemi arritur që sot prodhuesve, edhe sa i përket importit, domethënë hyrjet, e gjithë linja, pjesët rezervë, te makineria për përdorimin e prodhimit është hequr dogana dhe akciza, është një arritje e madhe, një lehtësim i madh. Kurse sa i përket, ju e keni parë që ne kemi pasur edhe hapa konkretë sa u përket prodhuesve, ndërmarrësve, siç u përmend mielli, bllokat, tash qumështi, dhe kemi shumë produkte, ato të cilat natyrisht na i lejon ligji, e kemi ligjin anti-damping që mund ta mbrojmë prodhuesin, është ligji për masa mbrojtëse. Aty ku na lejon ligji, ne kemi kërkuar vazhdimisht nga prodhuesit, ne na kanë mbështetje të plotë dhe duhet menduar se Kosova ka qenë e orientuar si shoqëri tregtare, për shkak se ndoshta ka shumë aspekte pse edhe ligjet kur bëhen duhet të bëhen natyrisht gjithnjë duke i pasur rrethanat edhe nga komuniteti përkatës.

Ne kemi bërë shumë përparime në drejtim të legjislacionit sa u përket mbështetjeve të prodhuesve dhe i siguroj gjithë prodhuesit që kjo Qeveri, po e themi edhe një herë, që është ndër qeveritë më të mira, që po e bën punën në mbështetje të prodhimit vendor dhe prodhuesit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër! Fjalën e ka zoti Nitaj.

MUHARREM NITAJ: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Qytetarë të Kosovës,

Është për të të ardhur keq që një raport për vendin po e prodhon një debat kaq të 'lodhtë' në sallën e Kuvendit të Kosovës.



Nuk ka njeriu sesi të mos pajtohet me zotin Çausi më herët, me zotin Sejdiu, me kolegun tim Blerim Kuçi, i cili në mënyrë demonstrative e lëshoi sallën e Kuvendit, dhe me shumë të tjerë, që kjo seancë është thirrur sa për të përfunduar, sa për t'u kryer, dhe Kryesia e Kuvendit do të duhej ta kishte refuzuar kërkesën e iniciuesit, ose thirrësit të kësaj seance me justifikimin se pa plotësimin e kushteve elementare nuk mund të ketë debat për një çështje të caktuar, siç është debati i sotëm.

Mua më vjen shumë keq prej iniciuesit të kësaj seance që ky debat do të bëhet sa për sy e faqe dhe nuk do të prodhojë atë që do të duhej. Raporti e ka merituar një debat shumë më serioz, shumë më cilësor. Fakti që aktualisht kanë ngelur në sallë diku rreth 20 deputetë dhe po largohen njëri pas tjetrit edhe deputetët, edhe ministrat, flet se kjo seancë faktikisht është njëra prej seancave të dështuara dhe Kryesia e Kuvendit me ose pa vetëdije i ka shkelur edhe të drejtat elementare të deputetëve.

Unë besoj që ndoshta ky do të jetë një mësim i mirë që të hiqet dorë nga një strategji e grupeve të caktuara parlamentare, që në këtë debat të flitet për gjithçka pa ndërprerë dhe pa produkt, pa efekt. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Osmani e ka fjalën.

VJOSA OSMANI: Faleminderit, zoti kryesues!

Meqenëse raporti për vendin është raport gjithëpërfshirës i shumë fushave, unë shpresoj shumë që debati për këtë raport nuk do të përfundojë me sot, por do të vazhdojë deri kur të publikohet raporti i ardhshëm, sepse sfidat që përfshihen në atë raport kanë të bëjnë me problemet tona të përditshme dhe jo vetëm me problemet e funksionimit të institucioneve, por të gjitha problemet dhe sfidat me të cilat ballafaqohen qytetarët tanë.

Unë do të fokusohem në radhë të parë në thirrjen për unifikim, të cilën e bëri zëvendëskryeministri Hoxhaj dhe ministrja Hoxha, por po ashtu edhe për thirrjen për mosunifikim që në fund e bëri zoti Tahiri, ministri i Drejtësisë.

Të nderuar deputetë,

Asnjë dokument i Bashkimit Evropian nuk mund të lexohet i vetmuar. Bashkimi Evropian ka prodhuar një sërë dokumentesh lidhur me Republikën e Kosovës, të cilat krijojnë një numër të madh detyrash të shtëpisë që duhet të kryhen për një periudhë të shkurtër, në mënyrë që të tregohet përkushtimi ynë dhe orientimi i qartë strategjik properëndimor. Prandaj, raporti për vendin duhet të lexohet së bashku me Strategjinë e Zgjerimit, e cila është dokument shumë më afatgjatë. Dhe, arsyeja pse po e përmend këtë strategji është për shkak të akuzës së zëvendëskryeministrit Hoxhaj se kur deputetët flasin për shtet të kapur, këto janë përralla.

Në fakt, zoti zëvendëskryeministër, që nuk jeni këtu, ashtu sikur edhe pritej, shteti i kapur si kualifikim është kualifikim i Bashkimit Evropian. Strategjia e Zgjerimit qysh në fillim e akuzon Kosovën së bashku me shtetet e tjera të Ballkanit Perëndimor, pra e cilëson se ka elemente të shtetit të kapur dhe po ashtu thotë se krimi dhe korrupsioni janë të lidhura me nivelet më të larta të qeverisjes. Është citim nga po ky dokument. Pra, nuk është përrallë, është kualifikim i Bashkimit Evropian, i cili do të mund të ndryshohet vetëm me punë, e jo me akuza ndaj deputetëve të Kuvendit të Kosovës, të cilët dinë të lexojnë. Pra, ne dimë të lexojmë dhe aty shkruan qartë se ky është cilësimi për Republikën e Kosovës.

Por, në qoftë se është një mesazh, se në fakt kemi dëgjuar nga liderët politikë të Kosovës këto ditë edhe akuza në raport me Bashkimin Evropian, se s'po na trajton të barabartë, se ka standarde të dyfishta..., por në qoftë se është një mesazh që do të duhej t'i shkonte sot Bashkimit Evropian, ai është se ata nuk mund në një anë ta akuzojnë Qeverinë si shtet të kapur, të korruptuar dhe të lidhur me korrupsion dhe, në anën tjetër, pas dy javësh të takohen me liderët e po asaj qeverie dhe të kërkojnë reforma nga ta. Dhe, të thonë se janë të inkurajuar me përkushtimin për reforma nga po të njëjtit njerëz, të cilët vetë Bashkimi Evropian po i akuzon për shtet të kapur, krim dhe korrupsion.

Pra, ky është mesazhi që sot duhet t'i shkojë Bashkimit Evropian dhe ky është i vetmi standard i dyfishtë në fakt. U tha, siç e përmenda, se në mënyrë që të ecim përpara në procesin e integritimit evropian duhet unifikim i skenës politike për çështje të interesit nacional dhe pajtohem. Një prej temave më të rëndësishme që trajtohet në këtë raport është dialogu ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, apo si po quhet ndryshe “proces i normalizimit”.

Komisionari Han këto ditë është cituar nga mediet e Kosovës të ketë thënë se e ardhmja e Kosovës varet nga dialogu Kosovë - Serbi. Mua më erdhi vërtet keq të dëgjoj një deklaratë të tillë, sepse do të duhej që e ardhmja e Kosovës të varej nga zhvillimi ekonomik, nga mënyra sesa i përkushtohemi shëndetësisë, arsimit dhe nevojave të tjera të qytetarëve tanë. Por, nëse është ashtu, në qoftë se vërtet dialogu ndërmjet Kosovës dhe Serbisë qenka e ardhmja, apo e tërë e ardhmja jonë po u varka nga ai proces, atëherë ne sot e pamë një kryeministër që ia dorëzoi një presidenti dokumentin apo platformën për dialogun, siç po e quajnë, pra këtë të ardhme të Kosovës e dorëzon në duart e një personi, në duart e Hashim Thaçit, pa u miratuar në Kuvendin e Kosovës, edhe pse vetë dokumenti thotë që do të duhej të miratohej.

Pra, një kryeministër i cili akuzonte më parë që nuk duhet marrëveshje ndërkombëtare e dokumente të tilla të dorëzohen pa u konsultuar në Kuvend, pa pasur dialog, pa pasur unifikim të skenës politike, pa u miratuar në Kuvend, sot e bëri pikërisht të njëjtën. Pra, për një proces kaq jetik, e dorëzon tërësisht në duart e Hashim Thaçit. Dhe, pse e bën këtë? E bën për shkak se arma e fundit e imunitetit që i ka mbetur Hashim Thaçit është pikërisht ky dialog. Nuk ka tjetër, vetëm kjo i ka mbetur. Mënyra e vetme e tij për t'u faktorizuar para komunitetit ndërkombëtar, kur

është defaktorizuar tërësisht edhe në partinë e tij. Po e them në partinë e tij, sepse ai sot është gjithçka tjetër, pos faktor i unitetit qytetar dhe unitetit politik në vend. Mjafton të dëgjohen intervistat e tij dhe akuzat për një parti e për tjetrën, akuzat për deputetët, akuzat për secilën çështje për të cilën ai nuk pajtohet dhe e di se do t'i kushtojë. Për secilën shkelje që ai e di, do t'i kushtojë.

Prandaj, është detyrë e këtij Kuvendi që t'ia heqë këtij imunitet të fundit që i ka mbetur Hashim Thaçit dhe t'i thotë jo asaj platforme, e cila, siç e kam thënë edhe më herët, nuk është platformë që do t'i mbrojë interesat e Kosovës, por do t'i mbrojë vetëm interesat e një individi. Aty në atë platformë nuk përcaktohen çka janë prioritetet e Kosovës, përderisa Raporti i Progresit flet për fatin e personave të zhdukur dhe mungesën e progresit në këtë aspekt, platforma nuk e trajton këtë temë fare, nuk kërkon nga delegacioni i Kosovës që të insistojë nga Serbia t'ia japë të dhënat lidhur me personat e zhdukur.

Ministri i Drejtësisë i bëri një sërë akuzash në këtë Kuvend. Më vjen mirë që ka përparuar në një aspekt, sepse po kritikon njerëz për mospunë, edhe kur ata janë të partisë së tij. Dy ministrat paraprakë të Drejtësisë kanë qenë pikërisht nga partia e tij. E akuzoi ish-ministrin e Financave për bllokim të fondeve, por po harron që edhe para tij ka qenë një ministër i Financave, dy e tre, të partisë së tij. Por, jemi gjallë dhe do ta shohim se çka po tenton të bëjë ky ministër i Drejtësisë është pushtim i Gjyqësorit nga militantë partiakë. Do ta shohim dhe do të dëshmohet kjo punë me kohë. Dhe, kush po na flet këtu për drejtësinë? Njerëzit që më 22 dhjetor ia bënë sulmin më të madh Republikës së Kosovës dhe citoj, edhe “thikën pas shpine Shteteve të Bashkuara”, me tendencën për ta shfuqizuar një ligj për Gjykatën Speciale, që vetë ky Kuvend e kishte miratuar, vetë po ata deputetë e kishin përkrahur.

Pra, këta na flasin këtu për drejtësi dhe për sundim të ligjit, e janë aq të dëshpëruar për të treguar suksese, sa që dalin e flasin për raportin e të bërit biznes, për top-dhjetëshen, të cilat a e dini se deri cilën periudhë e përfshijnë? Deri në maj të vitit 2017. Pra, cila Qeveri i paska sjellë ato suksese deri në maj të vitit 2017? Pra, po, e përmendi dikush nga deputetët e pushtetit më herët, që një pjesë e qeverisjes së LDK-së trajtohet këtu. Është pikërisht ajo pjesa ku flitet për sukses, zhvillim ekonomik dhe sukses në ambientin e biznesit.

Performansa e Kuvendit është çështja e fundit që kritikohet me të drejtë. Po, duhet të rritet mbikëqyrja ndaj Qeverisë, por ne kemi të bëjmë me një Qeveri që vazhdimisht është në mungesë, me një kryeministër që ka vetëm seanca pesëminutëshe në Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe ikën nga përgjegjësia, ashtu siç iku sot, duke ia dorëzuar simbolikisht gjithë përgjegjësinë që t'i mbrojë interesat e Kosovës para Serbisë. Kujt? Hashim Thaçit! Ky është sukcesi i vetëm i kësaj Qeverie, ikja nga përgjegjësia. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zonja Mexhide Mjaku.

MEXHIDE MJAKU-TOPALLI: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Fillimisht mund të them se pajtohem me fjalën e zotit Nitaj, po ashtu edhe me një pjesë së fjalës së koleges apo parafolëses, kur thotë se Raporti i Progresit nuk duhet që sot të diskutohet dhe asnjëherë më të mos diskutohet në Kuvend.

Unë mendoj se duhet të ndahet në baza katërmujore apo gjashtëmujore, që të diskutohet në këtë sallë brenda nesh. Po kthehem te fala ime.

Fillimisht mund të them se raporti ka shumë vlerësime pozitive. Ndërmjet tjerash, zgjedhjet nacionale dhe lokale të vitit të kaluar, ratifikimi i Marrëveshjes për demarkacionin e Kufirit me Malin e Zi, si dhe ekzistimi i një mjedisi pluralist dhe dinamik të medieve. Progres ka pasur edhe në fushën e reformës së Administratës Publike dhe rishikimin e agjencive dhe trupave të pavarura në sistemin e drejtësisë. Në sistemin e drejtësisë ka përparime në zbatimin e pakos ligjore të vitit 2015 dhe në veçanti në integrimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve të komunitetit serb në sistemin e drejtësisë së Kosovës.

Ngjashëm në luftimin e korrupsionit dhe krimin të organizuar njihen përparimet e bëra në trajtimin e rasteve të shënuara. Progres është shënuar edhe në luftën kundër terrorizmit, përfshirë zbatimin e masave për ta luftuar ekstremizmin e dhunshëm, radikalizmin dhe parandalimin e qytetarëve për të ju bashkuar konflikteve në vendet e treta.

Raporti nënvijëzon se Kosova i ka vazhduar masat për marrëdhënie të mira dhe konstruktive e bilaterale në vendet e rajonit dhe njëkohësisht vlerësohet angazhimi ynë në kuadër të dialogut për normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë.

Ndërsa sa u përket kritereve ekonomike konstatohet se janë arritur rezultatet shumë të mira në zhvillimin ekonomik, konkretisht është përmirësuar mjedisi afarist.

Qeveria e ka respektuar rregullin fiskal për deficitin buxhetor dhe eksporti ka shënuar rritje të ndjeshme. Gjithashtu vlerësohet se kemi shënuar përparime në përmirësimin e infrastrukturës rrugore. Sa u përket standardeve evropiane, ministrja Hoxha në fjalën e saj theksoi se ka shënuar progres liria e lëvizjes së mallrave dhe shërbimeve, tatimit dhe doganat, prokurimi publik, konkurrenca, si dhe në menaxhimin e migrimit të rregullt dhe atij ilegal.

Po ashtu, në këtë raport janë evidentuar edhe sfidat dhe unë do të ndalem te fusha e të drejtave të njeriut, konkretisht te barazia gjinore. Në veçanti, statusi i grave në Kosovë mbetet i pabarabartë, me sfida që vazhdojnë në shumë fusha të ndryshme, si në sferën publike, jeta politike, përfaqësimi, punësimi, shëndetësia dhe arsimit, ashtu edhe në sferën private, dhuna në familje, çështja e pronës, e tjerë.

Duke e ditur që Ligji për barazi gjinore paraqet fusha më të rrepta për shqyrtimin e perspektivës gjinore në politikat komunale dhe kombëtare, në faza të ndryshme, duke filluar nga analiza, planifikimi, zbatimi, monitorimi dhe vlerësimi i politikave.

Për më tepër, ligji parasheh masa të posaçme, të përkohshme dhe afirmative, për të garantuar më tej të drejtat e barabarta dhe për të promovuar barazinë gjinore në fusha të caktuara. Këto masa nuk konsiderohen diskriminuese përderisa ato synojnë të përshpejtojnë barazinë aktuale mes burrave dhe grave, në të vërtetë ato pritet të pushojnë pasi të arrihet qëllimi.

Në vazhdim ky ligj ofron edhe mundësi të barabarta për persona, identiteti i cilëve nuk është binar në grua apo burrë, duke përshtatur kështu Kosovën me standarde të Evropës Perëndimore, të paktën në këtë çështje specifike.

Edhe pse ligji në përgjithësi është i qëndrueshëm dhe pa dyshim një hap në një drejtim të duhur, ai paraqet disa çështje që kanë nevojë për rishikim, sidomos trajtimi i kuotave gjinore në ligj.

Këto janë zakonisht kundërtënëse, po si masa janë gjerësisht të pranueshme, të cilat kanë për qëllim të sigurojnë barazi gjinore në aspektin afatgjatë.

Aktualisht ekzistojnë dispozita kundërtënëse mes Ligjit për barazi ligjore, i cili kërkon ndarjen e gjysmës së listave zgjedhore, ndërsa Ligji për zgjedhjet dhe Ligji për zgjedhjet komunale kërkon një ndarje prej së paku 30%. Në një traditë më të zhvilluar ligjore, Ligji për barazi gjinore do të kishte eliminuar në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë këto dispozita kundërtënëse.

Meqenëse këtu rasti nuk është i tillë, një opinion ligjor për këtë çështje është i nevojshëm, në mënyrë që të shmanget çdo paqartësi e mundshme ligjore dhe me qëllim që të sigurohet zbatimi i plotë i dispozitave të Ligjit për barazinë gjinore.

Në fund mund të kërkohet edhe ndryshimi i Ligjit për zgjedhje dhe i zgjedhjeve lokale.

Si përfundim mund të thuhet se Qeveria, sapo e dëgjuam fjalën e kryeministrit për sfidat në këtë drejtim, në përkushtimin e tij në përmbushjen e përgjegjësive sa i përket ligjit në fjalë që të gjejë zbatim në të ardhmen. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Zoti Sejdiu ka replikë.

**DARDAN SEJDIU:** Faleminderit, kryesues!

Në fakt, edhe pse nuk është ministri i Tregtisë këtu, kuptova dhe e pashë që kishte përmendur disa gjëra që janë bërë në mbrojtjen e prodhimit vendor dhe unë po mundohem t'i shpërfaq dy momente që besoj janë tepër të rëndësishme.

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Tregti, Industri ka kërkuar nga ministria të cilin e udhëheq ministri që të na e sjellë pakon e ligjeve që ndërlidhen me mbrojtjen e prodhimit vendor. Kjo pako e ligjeve në vete i përfshin tri ligje dhe i njëjti ka refuzuar të bëjë një gjë të tillë, duke thënë që këto do të vijnë një pas një.

Mirëpo, gjithashtu i njëjti ministër ka sjellë ligje, të cilat në fakt nuk janë për mbrojtjen e prodhimit vendor, edhe këtë e shohin më së miri, për shembull, nëse bëjmë krahasimin e dy prodhuesve identikë.

Themi një prodhues i keksëve në Kosovë dhe një prodhues i keksëve në Serbi, prodhuesi i biskotave, i keksëve në Serbi, merr pagesën prej 50% në ditën e porosisë së mallit dhe 50%-shi tjetër i paguhet në ditën kur fillon transporti i mallit.

Prodhuesi vendor nuk i merr paratë deri në 60 ditë pasi që të vendoset malli në raftin e një tregtari. Pra, prodhuesi vendor pret plot 60 ditë pasi e ka dërguar mallin, derisa një prodhues nga Serbia i merr paratë ende para se të niset, para se të mbërrijë malli në Kosovë. Kështu nuk mbrohet prodhimi vendor.

Përveç kësaj që krijohet një avantazh për importues të jashtëzakonshëm, përveç kësaj mënyra se si trajtohen ligjet për mbrojtjen e prodhimit vendor në mënyrë të fragmentuar nuk bëjnë asnjë lloj avantazhi apo asnjë lloj përparësie për prodhuesin vendor.

Rrjedhimisht, jam shumë optimist, meqë qenka kaq i interesuar, që me ligjet që na vijnë të dakordohet me...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Sami Kurteshi, je i regjistruar sipas listës.

SAMI KURTESHI: Faleminderit, zoti kryesues!

Ne i dëgjuam sot shumë kolegë këtu, meqenëse shumica nuk janë këtu, kishte arsyetime të ndryshme, nuk është raporti i përkthyer, është marrë nga mediat, nuk është analizuar, është në gjuhë të huaj, krejt ato janë megjithatë gjëra që duhet të merren parasysh, t'i kemi edhe ne parasysh.

Por unë mendoj se një tekst i tillë vërtet pritët gjatë kohë nga krejt institucionet e Republikës së Kosovës, sepse është teksti bazë, pa i përjashtuar tekstet e tjera që përcakton raportin mes Kosovës edhe Bashkimit Evropian për periudhën që e mbulon dhe për periudhën që pritët.

Për periudhën që e mbulon ka karakter përshkrues, edhe ne këtu e kemi.

Nëse vërtet raporti qenka real, i saktë dhe i drejtë, të gjeturat janë këtu që po i shohim. Natyrisht nuk janë në gjuhën shqipe, janë në gjuhën angleze.

Nëse raporti qenka krejt pozitiv, përsëri të gjeturat i kemi këtu, nëse raporti është vetëm negativ, krejt i kemi këtu.

Unë dëgjova disa fjalë, dëgjova edhe zëvendëskryeministrin Hoxhaj, edhe ministrin Tahiri që nuk janë këtu, edhe nga ata vetë kishte ftesa kundërthënëse në raport me opozitën.

Njëri kërkonte që të bëhemi disi bashkë e të diskutojmë për çështje, platforma nacionale, në raport me Serbinë e me të tjerët, tjetri e përjashtonte atë. Nejse, kjo nuk është diçka e çuditshme, po ishte e çuditshme, për shembull, nëse del ndonjë deputet nga opozita ose edhe vetë ministri dhe prej një teksti 96-faqesh që është i shkruar në gjuhën angleze, konstaton, ndër konstatimet e rëndësishme është se thotë opozita, duke mendua në Vetëvendosjen, e ka degraduar jetën parlamentare. Kjo është e frikshme, kjo është e tmerrshme, sepse nëse e kemi për Vetëvendosjen, përmendet krejt tri herë në këtë raport dhe nuk mund të gjenden krejt këto elemente në një raport 96-faqesh.

Përpiqen t'i hedhin të gjitha fajet te të tjerët, thuajse e kemi raportin e parë. Po t'u hidhet një sy këtyre raporteve të progresit, vërtet prej vitit 2014 përdoret gjuhë e njëjtë, "fazë e hershme e zhvillimit". Në gjuhën politike, në shumë vende për 20 vjet shtet, ekzistencë shteti dhe 10 vjet pavarësi, vërtet shumë shpesh kjo konsiderohet sikur 'feld state', domethënë 'shtet i dështuar'. Kjo është fatkeqësi, po është një gjendje që e kemi.

Unë po dal te çështja e drejtësisë, këtu flitet për luftën kundër terrorizmit, krimit të organizuar dhe korrupsionit.

Megjithatë, kur të konkretizohet kjo te lufta e terrorizmit, unë po i nxjerr çështjet konkrete. Krejt kjo luftë kundër terrorizmit, në të vërtetë në dy vjetët e fundit, të mos them më shumë, është e orientuar kundër Lëvizjes Vetëvendosje, po e them kundër opozitës, me theks kundër Lëvizjes Vetëvendosje, prej vitit 2016. Kemi arrestimin, akuzën, gjykimin e aktivistëve, lirim të tyre nga shkalla e dytë për shkak të mungesës totale të dëshmive.

Njëri prej këtyre ka vdekur në paraburgim, kurse shkalla e dytë konstaton se për këta nuk ka asnjë fakt.

Kush e merr, askush nuk e ka marrë përgjegjësinë. Si ka ardhur deri te kjo? Po deri te kjo ka ardhur për një arsye, arsyeja është se kemi një prokurori, një gjyqësor dhe një polici, kreu i së cilës është i kriminalizuar, që e kanë udhëhequr krejt këtë fushatë kundër aktivistëve të Lëvizjes Vetëvendosje. Kjo nuk është e rastësishme.

Luftë kundër terrorizmit quhet zbulimi i organizatave fantazmë, si “Syri i Popullit”, ku përfshihen edhe anëtarët e Vetëvendosjes dhe kjo tregohet si luftë e suksesshme kundër terrorizmit. Kurse publiku përjashtohet nga këto seanca.

Luftë për mbrojtjen e drejtësisë trajtohet arrestimi i gjashtë aktivistëve të Lëvizjes Vetëvendosje në parkun e qytetit, që mbledhen për të festuar tetëvjetorin e organizatës studentore. Ata arrestohet, torturohen jashtë, aty në vend, edhe brenda u caktohet një muaj paraburgim për të humbur gjurmët e torturës.

Kemi raste të tjera, rastin e arrestimit, ndalimit, kidnapimit, sido ta quani, të gjashtë shtetasve turq, pa asnjë procedurë dhe asnjë nga funksionarët kryesorë të shtetit nuk di asgjë.

Edhe krejt Evropa shqetësohet, sidomos Bashkimi Evropian që nuk na harron, sepse kemi thyer kodin e fisnikërisë së sjelljes së tyre e tonin dhe janë gjashtë qytetarë, ky gjashtëshi është futur disi në kokën e policisë së Kosovës dhe askush nuk jep përgjegjësi!

Kush i udhëheq krejt këto procese? I udhëheq një prokuror që është përmendur në një dëgjim telefonik të aferës të ashtuquajtur “pronto”, Sylë Hoxha, në çdo rast të trajtimit të lëndëve në Prokurorinë e Kosovës e gjen emrin e Sylë Hoxhës, çka do të thotë kjo? Kush është Sylë Hoxha? Sylë Hoxha është njeri që përmendet po ashtu në dëgjimet e incizimit, që s’i ka bërë Vetëvendosja, të së ashtuquajturës afera “pronto” që është caktuar përmes telefonatave në atë pozitë.

Prokurori, një prokuror tjetër ngre aktakuzë kundër këtyre akteve, kurse aktorët kryesorë që përmenden aty nuk janë në aktakuzë, në mesin e tyre edhe kryetari i Kuvendit, edhe presidenti i shtetit. Këto krejt i dinë këta në Bashkimin Evropian dhe i përcjellin, i thamë ne apo nuk i thamë. Kjo është çështja që duhet ta kemi parasysh konkretizimi.

Ne kemi edhe çështjen e administratës publike. Te çështja e administratës publike ka konstatime të tmerrshme se nuk është profesionale, nuk ka kapacitete për të përcjellë, sidomos rekrutimin, po sidomos për të përcjellë edhe largimet politike nga puna, janë forma të ndryshme.

Në kuadër të kësaj administrate shtetërore futet në të vërtetë edhe Qeveria e Kosovës, e cila përmendet në këtë raport dhe thuhet “e stërmadhe”. Po kjo nuk është rastësi, në të vërtetë ka shkuar në atë vijë në të cilën është zhvilluar krejt administrata shtetërore tani e 18 vjet, i ka bërë 84 mijë njerëz që paguhet nga buxheti i shtetit, prej tare gjysma në nivelin qendror, që e ka thyer çdo kod dhe çdo vlerë evropiane që bën një dallim mes të punësuarve në nivel qendror dhe lokal.

Raporti minimal mes punësuarve në nivelin qendror dhe lokal është një me katër në të mirë të nivelit lokal. Ne e kemi një me një. Kjo me të vërtetë nuk është asgjë tjetër, vetëm një lloj tjetër i



shpërndarjes së pasurisë dhe parasë publike klaneve, partive, njerëzve të grupeve të tyre apo edhe të familjarëve të tyre. Edhe, çfarë ngjan? Me këtë gjendje administrata publike, pa marrë parasysh reformat që përmenden që mund të ceken diku, nuk është në gjendje të bëjë asnjë reformë, sepse as ministri nuk e ka guximin, as mundësinë, as lejen politike për të bërë reforma në administratën publike, sepse me këtë do të prekte klanet.

Kjo prekje do të thotë, do të prekte diku 150 milionë euro në vit që u shpërndahen klaneve, pjesëve të familjeve, grupeve dhe partive politike përmes këtij punësimi enorm që bërë në administratën publike.

Këto janë ato problemet kryesore që kur konkretizohen vërtet janë këtu, na shpërfaqen dhe ne duhet të merremi me to.

Unë mendoj se ne do të kemi tani mbi një vit kohë që të diskutojmë për këtë raport, për të gjeturat e këtij raporti dhe për rekomandimet.

Sigurisht diskutimi për këtë raport nuk do të përfundojë sot, nuk do të përfundojë as në gjashtë muaj dhe nuk do të përfundojë as vitin e ardhshëm. Faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit! Dukagjin Gorani e ka fjalën.

**DUKAGJIN GORANI:** Faleminderit!

I nderuar kryesues,

Anëtarë të Kabinetit,

Kolegë të nderuar deputetë,

Gëzohem që po ju shoh në numër kaq të madh për një temë kaq të rëndësishme dhe kritike.

Mendoj që ata që e kanë ftuar këtë debat sot kanë arsye të madha dhe unë përpiqem t'i kuptoj. Meqenëse përmbajtja e Raportit të Progresit ose Raportit të vendit është përnjëmend alarmante.

Në anën tjetër, e kam edhe problem t'i mirëkuptoj, për faktin që përmbajtja alarmante nuk paraqet absolutisht asgjë të re.

Ky raport nuk dallon prej shumë raporteve të viteve të mëhershme, andaj nuk e di nëse ngutja në interpretim dhe në diskutim të tij mund të ndërrojë diçka. Mirëpo ajo që po e hetoj është që edhe konfrontimi mes opozitës dhe mes përfaqësuesve të pushtit është po ai i njëjti, e ajo është që opozita përpiqet të jetë përmbajtjesore, të jetë strukturore, e pushteti përpiqet të jetë formal dhe teknik.

Unë mendoj që në këtë garë të vogël pushteti është kah e fiton betejën, meqenëse Raporti i Progresit është i shkruar pikërisht në këtë mënyrë, ai e analizon gjendjen shoqërore në Kosovë jo nga aspekti përmbajtjesor, por nga aspekti teknik.

Qysh mund ta kuptojmë ndryshe mënyrën qysh i referohet ky Raport i Progresit një gjendje shoqërore, të shndërruar më herët edhe kulturë shoqërore, çfarë është, për shembull, korrupsioni dhe krimi i organizuar. Raporti i Progresit këto gjëra i analizon nga aspekti teknik.

Të gjitha gjerat që thuhet në raport janë të vërteta, janë fakte, mirëpo janë fakte të dekontekstualizuara, janë të nxjerra nga konteksti i tyre historik dhe politik.

Hartuesi i raportit ta krijojë përshtypjen kinse për herë të parë është duke e analizuar Republikën e Kosovës. Kinse për herë të parë po bisedohet për situatën e vet shoqërore.

Hartuesi po ashtu harron që shtetësia e Kosovës është e pandashme nga asociimi, bashkëpunimi dhe asistimi i bashkësisë ndërkombëtare.

Prej proceseve, si privatizimi, e deri te ndërtimi i sistemit të drejtësisë, bashkësia ndërkombëtare ka qenë krahas angazhimeve vendore, hap më hap.

Sot rrallë mund të gjendet një institucion, një instancë, një departament, dikaster, ministri, e cila historianin e vet nuk e ka fal themelimit, bashkëpunimit dhe partneritetit me bashkësinë ndërkombëtare.

Si shkurt, shteti i Kosovës është i ndërtuar në bashkëpunim me bashkësinë ndërkombëtare.

Përgjegjësia për funksionimin tanë institucional, përgjegjësia për rrjetin tanë shtetëror ishte dashur të jetë e përbashkët.

Këtu është harruar të theksohet një send, të cilin unë megjithatë kisha pasur dëshirë nga aspekti përmbajtjesor ta theksoj edhe një herë.

Krimi i organizuar shtetëror, korrupsioni institucional, është çmim që ne ia kemi paguar stabilitetit politik.

Në emër të stabilitetit politik këtu janë ndërtuar qeveritë, janë ndryshuar qeveritë, në emër të stabilitetit politik gjithmonë është shkuar në favor të rrënimit të cilësisë shoqërore, duke favorizuar dëgjueshmërinë rajonale dhe ndërkombëtare.

Sot e kemi një shtet dhe një aparat shtetëror, i cili funksionon si i korruptuar, jo prej para 15 ose 18 muajve, po pse është pasojë e drejtpërdrejtë e një qasjeje politike, e cila ka qenë në njërin anë pragmatike, në kuptimin e stabilitetit rajonal, kurse ka qenë tmerrësisht e gabueshme, në kuptimin e funksionalitetit lokal.

Sot neve na tregohet ajo që ne e dimë, se korrupsioni në Kosovë është gjendje strukturore, që ajo moti është shndërruar në kusht edhe për sukses ekonomik, edhe shoqëror, madje është shndërruar dhe në kod të sjelljes shtetërore, sot na tregohet ajo që ne e dimë moti.

Fati i mirë është që prej neve nuk kërkohet ta ndryshojmë këtë gjendje përmbajtjesisht edhe strukturalisht.

Fati i mirë është që Raporti i vendit kërkon që ne me këtë gjendje të ballafaqohemi vetëm formalisht dhe teknikisht. Do të ekzistojë një numër i caktuar i rasteve, me të cilat do të matet suksesi i Kosovës në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit.

Ato raste, në njërin apo në tjetrën mënyrë, s'do të jetë edhe tepër vështirë të zgjidhen. Lufta e vërtetë politike karshi krimit të organizuar dhe korrupsionit këtë vit do të jetë përzgjedhja e rasteve të caktuara të krimit të organizuar dhe korrupsionit, ashtu që të ruhet stabiliteti politik, pra të mos përzgjidhen raste që mund ta trandin a mund ta kërcënojnë stabilitetin politik, mirëpo po ashtu të përzgjidhen raste që, në një mënyrë apo tjetrën, e plotësojnë kërkesën e vendosur në Raport të Progresit.

Kjo do të jetë lufta reale politike gjatë këtij viti ose deri te Raporti i ardhshëm i Progresit.

Meqenëse gjërat në politikë duhet ndryshuar, ashtu që ato të mbesin të njëjta.

Nuk mendoj që do të ketë ndryshim strukturor, nuk mendoj që shoqëria jonë do t'i shmanget korrupsionit dhe kulturës që ai e ka prodhuar, mendoj që do të shkojnë dekada e dekada derisa do të jemi në gjendje të jetojmë në një shoqëri korrekte dhe të drejtë, mirëpo së paku për Raport të Progresit mendoj që lehtë mund të gjejmë një zgjidhje, e ajo është zgjidhja të cilën e kanë gjetur edhe vendet e tjera të rajonit, të cilave vizat u janë liberalizuar më herët, e një pjesë e tyre janë edhe anëtare të plota të Bashkimit Evropian, e ajo është adresimi teknik.

Adresimi teknik për mua përbën pikërisht ironinë e madhe të raportit tonë me bashkësinë ndërkombëtare. Bëhet fjalë për disa detyra të shtëpisë, të cilat ne duhet t'i përzgjedhim dhe mundësisht t'i përmbushim, e me atë duke mos e prekur fare problemin e madh, i cili neve s'na lë të kemi spitale, as shkolla, as ekonomi korrekte, e sidomos jo drejtësi efikase.

Lufta kundër krimit të organizuar te ne në realitet nënkupton luftë kundër stabilitetit. Askush nuk është i interesuar të kërcënojë stabilitetin. Të gjithë janë të interesuar të gjenden mënyra se si lufta kundër krimit të organizuar të kuantifikohet në disa raste, të përmbushet si kriter teknik dhe të vazhdohet ajo që është avazi i vjetër shoqëror e institucional. Përndryshe, do të ishte paradoks i jashtëzakonshëm nëse, për shembull, zgjidhja për këto probleme shoqërore të kërkohet prej shkaktarit. Është situatë e pamundshme që shkaktarët e kësaj gjendjeje të jenë po të njëjtit, të cilët do ta nxjerrin shoqërinë prej kësaj situatë.

Përndryshe, krejt në fund, rastet e shteteve si Rumania, e cila luftën e vërtetë kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar e ka filluar së paku një dekadë pas anëtarësimit në Bashkimin Evropian, tregojnë që këto probleme gati kurrë nuk janë prekur substancialisht e as strukturalisht, mirëpo gjithmonë formalisht edhe teknikisht.

Nuk mendoj që ky forum dhe ky Kuvend ishte dashur t'i japë tepër shumë zor diskutimit të ndërsjellshëm, të pakuptimtë, meqenëse për ne bëhet fjalë gjetja e mënyrës se si të kuantifikohen në mënyrë teknike treguesit dhe indikatorët, të cilët do të na mundësojnë neve atë që është sot kritike, liberalizimi i vizave dhe vazhdimi i partneritetit me BE-në. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, Dukagjin! Fjalën e ka Korab Sejdiu.

KORAB SEJDIU: Qytetarë të dashur,

Kolegë të nderuar,

Kryesues,

Ministra, pakicë sot këtu,

Në fakt, unë dola të them që jam kundër diskutimit të këtij raporti, jo detyrimisht për mospërkthimin e këto gjërat teknike, por për të treguar të drejtën pse jam kundër diskutimit është se këto raporte gjithmonë hartohen, e vjen koha që ne rrimë në ethe. Këto hartohen prej zyrtarëve në Bruksel, të cilët nuk e dinë se si është të shkosh në QKUK me fëmijën tënd dhe t'i humbësh krejt shpresat. Fëmija yt të marrë diploma, me dhjetëra diploma, dhe të mos gjejë punë, ose punën e vetme që e gjen është kamerier, edhe atë me të njohshëm.

Nuk e din çka do të thotë të jetosh në shtet që ke politikë të jashtme, e cila përbëhet prej 4-5 personave që vrapojnë në për botë me agjenda personale pa asnjë koordinim. Ku ke president që bën takime e marrëveshje të fshehta, ke miliona euro të buxhetit të shtetit që shpenzohen jo për të lobuar për shtetin, por për një person. Ku lënda civile në gjykatë zgjat 15 vjet dhe në fund ke aktgjykim të kotë, me nivel të klasës së dytë. Ku lëndët penale i adresojnë vetëm ata të shkretit që i ka zënë vapa, ndërsa zyrtarët e lartë ose nuk gjykohen fare, ose dënohen me kusht, qysh e pamë edhe sot. Këta zyrtarë të Brukselit nuk jetojnë në një vend që mundohet t'i fundosë bizneset, përveç nëse dhënë donacione për fushatë, për partitë në pushtet. Këta persona s'kanë as qeveri që flet kundër korrupsionit, ndërsa një pjesë të Kabinetit e ka me aktakuza aktive.

Pra, ne i presim në ethe se çfarë terminologjie do të përdorin këta zyrtarë, a do të thonë “faza e hershme”, “pa progres”, “pak progres”. Unë mendoj që të gjithë ne që jetojmë në Kosovë kemi goxha disa fjalë që i dimë që mund ta përshkruajnë shumë mirë gjendjen aktuale në vendin tonë, por ato nuk i përkasin gjuhës parlamentare. Dhe, pse po ndodh e gjithë kjo? Fatkeqësisht, çdo gjë, çdo sektor në Kosovë po trajtohet dhe po shihet nëpërmjet prizmit të normalizimit të marrëdhënieve me Serbinë. Do të thotë, relacionet me Serbinë. Dhe, për këtë arsye ne kemi goxha shumë faje, sepse ne vetë po i votojmë disa prej këtyre personave, e çka është edhe më e keqe pikërisht kjo klasë e korruptuar që po na e sjell këtë gjendje dhe që e ka zaptuar shtetin po tolerohet, në fakt po ndihmohet në shumë raste edhe nga vetë bashkësia ndërkombëtare.

Dhe, natyrisht, edhe në këtë Raport të Progresit, por edhe ne që jetojmë këtu e dimë që këta nuk janë aq të zotët që ta zaptojnë 100% shtetin edhe aty-këtu u ikën ndonjë sukses i ndonjë personi të shkathtë që ka depërtuar diku. U përmendën disa, si Autoriteti i Konkurrencës, e kështu me radhë, që kanë arritur në aspekt teknik t’i bëjnë disa përmirësime. Unë për vete jam kundër diskutimit të raportit.

Kohë më parë e pata dëgjuar një përkufizim shumë të mirë për atë se çka do të thotë të jesh i çmendur, ku thotë “e përsërit të njëjtin veprim, por pret rezultat tjetër”. Dhe ne veprimet thjesht i kemi të njëjta tash vite me radhë dhe po presim çdoherë rezultat ndryshe. Çka na bën ajo neve? Unë thjesht nuk jam për t’u konsideruar i çmendur që çdo vit e diskutoj Raportin e Progresit, ose të regresit që u quajt sot, sepse i kemi bërë veprimet e njëjta si vend dhe tash po presim që po u dashka të ketë avancime.

Prandaj, unë më me dëshirë dhe më me interes nuk e kisha diskutuar këtë raport, as tash, as në të ardhmen, por do t’i kisha mobilizuar ata që janë me vullnet mirë, ata që ia dëshirojnë të mirën të vendit, i kisha ftuar ata që edhe t’i mobilizojnë edhe qytetarët, edhe elektoratin, dhe së bashku të punojmë drejt shkurtimit të jetës së kësaj qeverie, dhe rrjedhimisht të angazhohemi të gjithë që shumë shpejt një klasë e re politike, një klasë e cila ia do të mirën këtij vendi të dalë në sipërfaqe dhe njëherë e përgjithmonë t’u tregojmë edhe qytetarëve të vendit tonë, por edhe botës që nuk jemi të çmendur, që jemi goxha të zotë, veç na duhet një mundësi. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Fjalën e ka Fatmire Kollçaku.

**FATMIRE KOLLÇAKU:** Faleminderit!

Edhe parafolësi tha që shumë më mirë ta quajmë këtë “raport i regresit” dhe jo se ne si opozitë e dëshirojmë një gjë të tillë. Ta themi, por bazuar në konstatimet dhe vetëm krahasimin e këtij raporti me raportin paraprak, ku vetëm disa prej temave që fatkeqësisht nuk mund t’u ikim është rritja e varfërisë, në veçanti rritja e varfërisë ekstreme, rritja e papunësisë, korrupsioni dhe krimi endemik. Nuk ka asnjë progres në shëndetësi, e të mos e themi sesi është situata në arsim. Këto vetëm si hyrje për ta arsytuar fjalën pse mund ta quajmë “raport të regresit”.

Unë do të fokusohem më tepër në dy fusha që mbuloj fillimisht si anëtare e Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, sepse, tek e fundit, krejt çka bën Qeveria, krejt çka bëjnë të gjitha institucionet përgjegjëse ishte dashur të jenë në shërbim të përmirësimit të mirëqenies së qytetarëve. Ne nuk kemi nevojë për raporte, që të na hartojë dikush nga jashtë, dhe të na tregojë sesi është situata në vend. Të gjithë ne e dimë më së miri sesi është situata sa i përket mirëqenies së qytetarëve. Nëse flasim për punësim, e dimë se te politikat e punësimit Qeveria e ka hartuar Strategjinë Sektoriale 2018-2022, si dhe planin e aksionit, me theks të veçantë për punësim të të rinjve. Të mos flasim që një shifër prej 31% të papunësisë këtu tregon vetëm për ata që kërkojnë aktualisht punë, por shumë qytetarë të cilët janë të dëshpëruar dhe pa shpresë se mund të gjejnë punë, fare nuk evidentohen si punëkërkuar, prandaj edhe shifra e papunësisë është shumë më e lartë.

Prandaj, edhe fondet e kufizuara që i ka Ministria, nuk po them që nuk po bën asnjë përpjekje, por duke i pasur fondet shumë të kufizuara, në shumë raste e ka edhe të pamundur që të bëjë përmirësim të dukshëm sa i përket punësimit, mirëpo kisha dashur të fokusohem te ajo se papunësia te të rinjtë është 51%, të cilët ne mendojmë që t'i mbajmë këtu në vend dhe në veçanti është problematik punësimi i grave, meqë vetëm 13% figurojnë të punësuar, mirëpo pjesa më e madhe edhe nuk figurojnë si kërkuese në treg dhe nuk janë aktive në tregun e punës, që do të thotë që nuk lajmërohen si të papunësuar, sepse nuk kanë shpresë që nëpërmjet këtij fakti ato kur lajmërohen në shërbimet e caktuara do të gjejnë punë.

Po ashtu, mund të theksoj se nuk është aprovuar legjislacioni sekondar që mbron kundër diskriminimit. Këtu prapë po kthehem te pushimi i lehonisë, në fakt pushimi prindëror, kur nuk ndahet ky pushim ndërmjet dy prindërve dhe rrjedhimisht gruaja mbetet e diskriminuar sa i përket punësimit, e cila faktikisht edhe në momentin kur mbetet shtatzënë, sidomos në sektorin privat, ajo privohet nga puna, sepse nuk kanë dëshirë që pastaj t'ia kompensojnë pjesën e pushimit të lehonisë dhe këtu mendoj që Qeveria duhet ta marrë barrën kryesore në gjashtëmujorin e parë dhe ta mbulojë 100% pushimin e lehonisë. Dhe, pastaj sektori privat nuk do të kishte kaq shumë vërejtje për këtë gjashtë mujorin e parë.

Këtu, po ashtu denoncohet edhe puna e fëmijëve që nuk është zgjidhur, si dhe kontratat. Mosimplementimi i Kontratës Kolektive mbetet një shqetësim i vazhdueshëm, pasi vetëm 29% të punësuarve disponojnë me kontrata permanente, ndërsa krejt pjesa tjetër i kanë kontratat të tilla, ku nuk kanë asnjë siguri në punë dhe sidomos sektori privat ka mundësi që brenda ditës t'i largojnë nga puna pa i dhënë kurrkujt përgjegjësi. Këtu duhet theksuar numrin shumë të vogël të inspektorëve të punës, meqë një planifikim që është bërë nga ministria nuk është arritur të realizohet, sepse nga 49 inspektorë aktualisht është planifikuar që të jenë 65, por edhe kjo ende nuk është arritur.

Po ashtu, adresohet edhe nevoja e përfshirjes së fëmijëve me nevoja të veçanta në shkollat publike, e që ashtu ky është një problem shumë i madh dhe e dimë që edhe në Kuvend këtu nuk është arritur të votohet propozimi i zonjës Arbërie Nagavci për asistente për këta fëmijë dhe mbetet problem shumë i madh për familjet, të cilët kanë fëmijë me nevoja të veçanta, e të cilët jo vetëm që nuk kanë mbështetje financiare të duhur, por vazhdimisht ballafaqohen me probleme, e njëri ndër to është edhe përfshirja e fëmijëve në shkollat publike me gjithë fëmijët e tjerë, sepse kjo është një e drejtë e pamohueshme që u takon.

Kërkohet po ashtu dhe e dimë që është në plan amendamenti i Ligjit të punës, me theks të veçantë te siguria në punë, kur e dimë që prej 50 aksidenteve të evidentuara, 14 kanë pasur përfundim fatal, që do të thotë që ne punëtorët i kemi plotësisht të pambrojtur, sepse në fakt askush në fund nuk jep përgjegjësi për një jetë të humbur, të mos themi që një familje pastaj mbetet plotësisht e pambrojtur edhe në aspektin financiar, sepse e dimë si qëndron puna edhe me pensionet, edhe me përfitimet që mund t'i ketë një familje në fund nëse një familjar i tyre humb vendin e punës, pos nëse eventualisht diçka ka akumuluar në Trustin Pensional dhe krejt kjo është që mund t'i garantohet kësaj familje, e ky është sidomos problem në sektorin privat.

Prapë po e cek nevojën e rritjes si shumë të rëndësishme rritjen e numrit të inspektorëve, sepse faktikisht shumë vështirë është që të mbulohet kjo fushë nëse nuk ka kush t'i inspektojë. Që nga viti 2009, sa i përket mbrojtjes sociale, e kemi një alokim të grantit të përgjithshëm, meqë nuk kemi një distribuim të duhur nëpër komuna, dhe këtu, edhe pse shumë të drejta, këto institucione që merren me mbrojtjen sociale dhe familjare, qendrat për punë sociale, edhe pse kanë marrë shumë autorizime, ato nuk kanë fonde dhe ne në një vizitë që e kemi bërë, për shembull Qendrës për Punë Sociale në Mitrovicë, e kemi parë që punojnë me një veturë, edhe pse pjesa më e madhe e punës është në terren dhe është shumë e vështirë që t'u ofrohen shërbime sociale e familjare. Kur nuk kanë fonde të duhura, edhe pse kanë marrë, janë deleguar shumë kompetenca nga niveli qendror te niveli komunal. Dhe, kjo duhet të rregullohet me Ligjin për financat lokale.

Po ashtu, nuk ka licencim të ofruesve të shërbimeve sociale dhe të gjithë atyre që janë të interesuar të konkurrojnë në këtë drejtim.

Po flasim për liberalizimin e vizave, edhe pse dihet që tani për tani, edhe sikur të arrihet që të kemi liberalizim të vizave, krejt çka mund të bëhet është që të shëtisim, sepse nuk ka mundësi që të ofrojmë edhe punëtorë konkurrues në treg. Theksohet shumë qartë që asnjë përparim nuk është bërë në përmirësimin e cilësisë së arsimit dhe trajtimin e boshllëqeve të aftësive në tregun e punës. Çka do t'u ofrojmë ne kompanive edhe vendore, edhe kompanive tjera që vijnë në Kosovë kur ne kërkojmë punëtorë në regjion, ndërsa flasim për nevojën e madhe për punësim të punëtorëve kur nuk prodhojmë kuadër të kualifikuar, jo vetëm për vendin, por nëse nesër paraqitet nevoja dhe mundësohet që punëtorët tanë të dalin jashtë, kur në raport e kemi që nuk ka

aftësim, qoftë profesional, qoftë aftësim të duhur të punëtorëve që do të jenë konkurrues nesër kudo që kërkohet, apo paraqitet nevoja për punëtorë.

Sa i përket shëndetësisë, me keqardhje mund të them se në raport konstatohet që nuk është shënuar asnjë progres, edhe pse këtu një parafolës na ftoi neve si Lëvizje Vetëvendosje dhe unë me krenari mund të theksoj, megjithatë edhe pse këtu nuk përmendet në Raportin e Progresit që një shembull i mirë i shëndetësisë në nivel primar ka qenë Komuna e Prishtinës dhe me këtë rast e përgëzoi drejtorin Arben Vitia që e ka bërë një progres shumë të madh sa i përket nivelit primar në shëndetësi, dhe do të duhej të shërbente si shembull edhe për komunat e tjera, do të thotë në mandatin e kaluar.

Rreth 30% e popullatës nuk është në gjendje të marrë shërbime shëndetësore për shkak të varfërisë ekstreme dhe shpenzimet e ulëta publike për shëndetësinë mbeten një shqetësim në vazhdimësi dhe evidentohen edhe në raportin më të ri të regjesit. Vazhdon që vetëm 40% në total e nevojave vjetore për kujdes të shërbimeve publike të jenë mbuluar dhe kjo mbetet shqetësim. Fondet e alokuara përdoren kryesisht për t'i mbuluar kostot fikse, do të thotë përreth 68%, duke lënë vetëm 32% për kostot e drejtpërdrejta, për pacientët...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYESUESI: Faleminderit! Zafir Berisha, s'është! Shqipe Pantina e ka fjalën.

SHQIPE PANTINA: Faleminderit, kryesues!

Në fakt, do të ishte mirë që Qeveria të ishte këtu, sepse raporti për të cilin po diskutojmë, qenkan dy, por Qeveria i ka nja 22 ministra, nja 70 zëvendësministra, dhe 5 zëvendëskryeministra, kështu që raporti të cilin po e diskutojmë është përgjegjësi kryesisht e Qeverisë, po them kryesisht sepse janë disa fusha për të cilat edhe Kuvendi është përgjegjës, por edhe sektorët tjerë.

Unë do të doja të ndalesha në dy fusha, edhe për faktin se jam anëtare e Komisionit për Administratë dhe këto çështje i kemi diskutuar edhe më herët. Edhe për kolegët deputetë, për të cilët më vjen keq që për shkak të përkthimit nuk kanë mundur ndoshta ta lexojnë, nuk besoj se kanë humbur shumë, se e para këto që thuhet në raport nuk janë asgjë gjëra që nuk i kemi dëgjuar. Për më tepër, janë gjëra që i kemi thënë vetë, qoftë gjatë diskutimeve këtu, qoftë gjatë diskutimeve që i bëjmë në komisione, apo nëpërmjet pyetjeve parlamentare që ua bëjmë ministrave. Janë çështje që i kemi theksuar dhe probleme që i kemi shtruar disa herë. Dhe, çështja tjetër është se ka shumë pak dallim nga raporti i vitit 2016. Kështu që për ta krijuar të paktën një pasqyrë fillestare mjafton që të lexohet raporti i fundit, ai i vitit 2016, dhe pak a shumë të gjeturat janë të njëjta.



Sa i përket pjesës që flet për Administratën Publike theksohen të njëjtat probleme që janë theksuar edhe në raportin paraprak dhe edhe atë të viteve të mëhershme. Ministri Mahir Jaghillar e drejton këtë ministri tash e tri mandate radhazi. Për hir të së vërtetës, unë dua të theksoj sesa i përket raportit të këtij ministri me Kuvendin, ai ka qenë çdoherë korrekt. Ka ardhur në secilën mbledhje që e kemi thirrur në Kuvend, përkatësisht në komision, dhe u është përgjigjur të gjitha pyetjeve parlamentare, por duke e drejtuar këtë ministri për tri mandate me radhë, do të thotë më shumë se shtatë vjet, problemet që përmenden në raport janë të njëjtat. Pra, ai nuk ka bërë asgjë si ministër për t'i adresuar këto çështje. Hartimi i strategjisë nuk mjafton, prandaj mendoj se do të ishte kryeministri njeriu i cili do të duhej të jepte përgjigje në çështjet që adresohen në raport dhe ato, si në vijim: cili është plani i Qeverisë, përkatësisht si mendon kryeministri ta adresojë çështjen e politizimit të Administratës, i cili është problem që përsëritet në secilin raport që shkruhet nga Komisioni Evropian.

Si do ta adresojë Qeveria, përkatësisht kryeministri problemin tjetër, i cili po ashtu përsëritet në secilin raport, e që ka të bëjë me procesin e rekrutimit, sepse sërish thuhet se procesi i rekrutimit nuk bëhet në baza të meritës, por me ndërhyrje, të cilat kryesisht janë ndërhyrje politike. Cili është plani i Qeverisë për ta adresuar çështjen e numrit të madh dhe tejet të panevojshëm të agjencive, shumica e të cilëve më shumë e pengojnë në punën e njëra-tjetrës, sesa ndihmojnë, ose shumica e të cilave ekzistojnë për hir të punësimit të disa njerëzve, sepse janë përgjegjësitë e ministrive të linjave. Është po ashtu një çështje, e cila është adresuar edhe në Raportin e Progresit. Cili është plani, përfshirë edhe planin kohor, brenda të cilit Qeveria synon t'i adresojë këto të gjetura? Por, për më tepër, çka do të ndodhë nëse këto çështje nuk adresohen dhe nuk përmbushen afatet kohore të përcaktuara me plan, sepse ne kemi pasur strategji dhe kjo nuk është një punë e vështirë. Unë mendoj se edhe një student i studimeve, të themi pasdiplomike, mund ta hartojë një strategji, mund ta hartojë një plan veprimi se si të adresohen këto probleme, por çështja është se si të zbatohet ai.

Dhe, cilat janë pasojat që përgjegjësit për moszbatimin e tyre duhet t'i marrin? Deri më tani, pasojat i kanë vuajtur vetëm qytetarët e vendit. Ose për shkak, sepse nuk mund të lëvizin lirshëm pa viza, por më e keqja, sepse vazhdojmë ta kemi një numër të madh të të papunëve dhe një nivel tejet të ulët të zhvillimit ekonomik.

Çështja tjetër që adresohet, e që prapë kryeministri do të duhej të jepte përgjigje, ka të bëjë me raportet e Auditorit, përkatësisht me zbatimin e rekomandimeve që dalin nga këto raporte. E kemi diskutuar disa herë në komision, është çështje që po ashtu përmendet edhe në këtë raport. Cilat janë masat që do t'i ndërmarë Qeveria për ata zyrtarë që nuk i zbatojnë raportet, përkatësisht rekomandimet që dalin nga raporti i Auditorit, e ku keqmenaxhohen milionat e taksave të qytetarëve.

Dhe, një çështje tjetër që ngrihet e më shumë i takon Kuvendit, janë mediet. Përveç faktit që flitet se megjithatë mediet nuk e gëzojnë lirinë e plotë, dhe kjo është një çështje megjithatë për ta diskutuar, është shtruar po ashtu si shqetësim çështja e transmetuesit publik. Këtu mendoj se Komisioni për Medie megjithatë ka bërë disa hapa, sepse tashmë e kemi iniciuar hartimin e Projektligjit për transmetuesin publik dhe unë dua të besoj se të gjitha grupet parlamentare do t'i kenë në konsiderim edhe shqetësimet që janë ngrehur në raport, sidomos kur flitet për pavarësinë e transmetuesit publik. Pra, Qeveria do të duhej të ishte këtu, e pasi sot nuk është, shpresojmë që së shpejti do të vijë të na tregojë se si do ta adresojë raportin dhe të gjeturat e këtij raporti, në mënyrë që vitin tjetër të mos ngelin duke e fajësuar njëra-tjetrën, a më shumë faj ka kjo qeveri aktuale, apo qeveritë e mëhershme pse këto të gjetura janë tejet shqetësuese, e për të cilat, siç thashë, as nuk ka nevojë të lexohet raporti, sepse i dimë të gjitha dhe i kemi thënë edhe më herët. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Bunjaku e ka fjalën.

VALENTINA BUNJAKU: I nderuar kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të respektuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Fillimisht kur e morëm ftesën për këtë seancë të jashtëzakonshme për të debatuar për Raportin e Progresit kam menduar se i gjithë Kabineti qeveritar do të jetë këtu dhe pesë zëvendëskryeministrat, dhe kam menduar që s'ka për të pasur ulëse për të gjithë ata, sepse çështja është shumë serioze dhe nuk është në rregull prej Qeverisë të nënvlerësohet dhe të tejkalohet aq lehtë.

Raporti i Progresit e tregon më së miri gjendjen se ku e ka dërguar vendin kjo Qeveri. Ky raport është konstatim i konfirmuar edhe nga BE-ja për Kosovën, për atë që e kemi thënë ne për çdo ditë, në çdo seancë dhe në çdo paraqitje tonën publike. Është për keqardhje sesi qeveriset vendi në secilën fushë, veçanërisht në arsim, duke e ditur të gjithë se arsimi është shtylla kryesore dhe vendimmarrëse për suksesin e një shteti. Fatura për këtë raport bie direkt mbi këtë Qeveri.

Unë si anëtare e Komisionit për Arsim do të përqendrohem në sektorin e arsimit, sepse edhe të gjitha fushat sikur të ishin të vlerësuara mirë dhe arsimi të jetë i nënvlerësuar kaq keq në këtë raport, atëherë mund të themi se i gjithë Raporti i Progresit do të jetë negativ për krejt Kosovën, shto këtu se në të gjitha fushat është konstatuar se kemi vetëm zvarritje, ngecje dhe kthim prapa. Më brengosës del raporti se rekomandimet e raportit të mëhershëm nuk janë marrë fare seriozisht nga kjo Qeveri. Në raport konstatohet dhe rekomandohet se Kosova në veçanti duhet t'i bëjë këto veprime:

- Të miratohet një ligj i ri për arsimin e lartë, me qëllim të një reforme të bazuar në standardet më të mira, duke përfshirë sigurimin, autonominë dhe funksionimin e pavarur të institucioneve, të arsimit të lartë dhe mekanizmat e sigurimit të cilësisë.

- Të rriten përpjekjet për reformën kurikulare të arsimit parauniversitar, duke përfshirë edhe shkollimin profesional, programe edukimi dhe trajnimi, të fokusuara në mësimin e bazuar në kompetenca.

- Të përmirësohet qasja në arsim cilësor për regjistrimin parashkollor dhe të grupeve të lëna anash. Për arsimin dhe trajnimin niveli i shpenzimeve publike në arsim ishte 4,7% të prodhimit të brendshëm bruto. Nuk është menaxhuar në mënyrë efikase dhe mjaftueshëm për të siguruar arsim cilësor për numrin relativisht të madh të të rinjve tanë.

Sipas Raportit të Progresit, pika më e ndjeshme dhe me vlerësimin më negativ mbetet ajo që ua kemi tërhequr vërejtjen me kohë në çdo seancë dhe kemi parashtruar në deklaratimet jashtë rendit të ditës dhe ne si opozitë e kemi lëshuar seancën për shkarkimin e kundërligjshëm të Bordit Shtetëror të Cilësisë, duke i ditur pasojat e mëdha që do ta presin arsimin në Republikën tonë.

Po të na merrnit parasysh neve me kohë, pjesa më negative e këtij Raporti të Progresit, nuk do të ishte fjalia më e rëndë në këtë raport. Arsimi mbetet një sektor me rrezik të lartë për korrupsion dhe ndikim politik, sidomos në nivelin e lartë të arsimit.

Kolegë deputetë,

Të respektuar qytetarë,

Ku ka fjali më të rëndë për Kosovën sesa konstatimi i BE-së se arsimi mbetet me rrezik të lartë dhe ka korrupsion dhe ndikim politik?

Për ta përmbyllur se nuk ka nevojë as të kërkohet edhe detaji më i vogël për t'u bindur sesa keq është duke e udhëhequr shtetin kjo Qeveri dhe me sa pa vizion është duke e drejtuar arsimin, jemi dëshmitarë të skandaleve të njëpasnjëshme të kësaj Qeverie. Fatkeqësisht, LDK-ja asnjëherë dhe shumë vite me radhë nuk e ka udhëhequr me arsimin. Ne si deputetë dhe si anëtarë të komisionit me kohë i kemi adresuar vërejtjet dhe sugjerimet tona, por ndikimi i madh i kryeministrit në Ministrinë e Arsimit e ka penguar mbarëvajtjen e procesit në të mirë të studentëve tanë. E kemi lutur nga kjo foltore ministrin që të mos bjerë pre e kryeministrit, të bashkëpunojë me ekspertë të arsimit dhe me ne si Komision i Arsimit, sepse arsimi nuk është i individit, i kryeministrit, apo i një ministri. Arsimi është i të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës. Prandaj, nuk mbetet tjetër, përveçse kjo Qeveri të bindet vetë që nuk di të udhëheqë dhe t'ua lirojë rrugën qytetarëve që qytetarëve t'u jepet rasti të zgjedhin njerëz të dijes dhe të sjellin raport pozitiv nga BE-ja. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Ali Lajçi e ka fjalën.

ALI LAJÇI: Të nderuar qytetarë,  
Të pranishëm,  
Kolegë deputetë,

Kjo temë nuk është një temë e rëndomtë, është një temë shumë e rëndësishme. Ky raport shumë i rëndësishëm vetëm ka qenë shkas për të biseduar për një gjendje të përgjithshme të institucioneve tona shtetërore, politike, madje juridike e tjera, e tjera, ekzekutive. Në këtë rast, çështja se si u nxit e të tjera, nuk është me rëndësi, është me rëndësi që tema është e rëndësishme dhe debatohet kur kujdesi dhe klima e krijuar me këtë seancë, madje jo vetëm në këtë, tregon për një menaxhim, i cili do të duhej të përmirësohej.

Kurse sa i përket asaj që është thirrur seanca e jashtëzakonshme, Kryesia do të duhej të reflektonte dhe ta shikonte mundësinë që të mos thuhet Rregullorja ose është në fakt thirrja është tamam në frymën e saj. Kur flasim për këto tema, nuk është një temë që e cila faktikisht nga raporti tash e kemi fituar dijen rreth zhvillimeve të përgjithshme dhe mekanizmit shtetëror të vendit tonë, sepse kjo veç tashmë është e ditur, sepse jetojnë qytetarët e Republikës, madje jetojnë edhe vendimmarrësit, madje e jeton edhe Ekzekutivi i Republikës së Kosovës. Prandaj, shpesh shtrohet çështja, se ky raport a është i progresit. Qasja dhe emërtimi i tij është një çështje rutinë, që zakonisht bëhet nga faktorët ndërkombëtarë dhe dihet që e ka rëndësinë e veçantë dhe të mirëkuptimit, kurse si është vlerësuar gjendja e përgjithshme e institucioneve tona është një gjendje tjetër, që mund të themi se është mjaft reale.

Në këtë mes ne konstatojmë se ky raport faktikisht ka vlerësuar e përshkruar më shumë një gjendje të institucioneve tona të vendimmarrjes dhe rolit të tyre në jetën e qytetarëve, që faktikisht del si një jetë stagnuese, karshi synimeve të cilat shoqëria jonë dhe nevoja e vendit i ka. Me këto çështje ne e kemi përmend, pra shërbimet publike, e kemi përmendur me radhë sistemin e drejtësisë, e kemi përmendur rolin e përgjithshëm menaxhues dhe imazhin e përgjithshëm të Republikës së Kosovës në kuadër, jo vetëm të kësaj Qeverie, e cila s'ka ndryshuar gjë, por e kemi një vistër të gjatë ngjarjesh, vendimesh, dhe përgjithësisht të gjendjeve të cilat janë të determinuara nga menaxhimet e qeverive në vazhdim, jo vetëm nga kjo.

Dhe, ky raport si duket është një përsëritje dhe është një reflektim i një gjendjeje të mëhershme, por çka duhet të bëjmë ne sot, sigurisht në sistemin e drejtësisë janë marrë disa iniciativa a tentime për të përmirësuar diçka, e që koincidon edhe me raportin e atje të vlerësimit, por që nuk pritët të futet në thelb të problemeve, të cilat faktikisht do të mund ta ndryshonin cilësinë e sistemit të drejtësisë në kuadër të Republikës sonë.

Janë disa akte të cilat përmenden, atje diku përmenden shkarazi, diku edhe këtu në debat, siç është dëbimi a ekstradimi, apo kidnapimi i gjashtë banorëve të Republikës sonë me përkatësi

turke, e që bëhet fjalë për shkarjen, rënien, mosfunksionimin e sistemit juridik të drejtësisë në këtë mes Ligjit të ekstradimit, i cili nuk është më ekstradim, por e ka një kuptim krejt tjetër, sepse nuk mund të thuhet dëbimi i ekstradimit, sepse s'është ekstradim, por është ajo çfarë në fakt e kemi përjetuar dhe e kemi të shënuar në raportin e përshkrimit si një akt negativ i funksionimit të shtetit tonë.

Po përmendet shpesh edhe çështja e demarkimit e të tjera, që kur shikohet dhe është vlerësuar vetëm si nevojë e marrjes së përgjegjësive të një institucioni të Republikës për të bërë demarkimet, që është i drejtë në kuptim fundamental, por nuk flitet për një vlerësim tjetër, i cili qëndron brenda qytetarëve dhe pasojave që mund të ndodhin në rast të zbatueshmërisë dhe menaxhimit të tyre, e që më vonë mund të përkthehet në ndonjë notë negative, që do të mund ta dëshmonte koha. Kurse, definimi i demarkimeve - askush s'e mohon, sepse është një kapacitet i ri i definimit dhe i rumbullakimit të shtetit, por si dhe në çfarë variantesh ka qenë një menaxhim kryekëput i keq gjatë tërë kohës dhe ka sjellë edhe metoda, të cilat e kanë përcjellë atë menaxhim të keq dhe kanë qenë refleksion i atyre menaxhimeve të këqija, qoftë për shkak të jotransparencës dhe qoftë për shkak të materies sesi është trajtuar demarkimi dhe na ka dalë i dëmshëm dhe do të na dalë i dëmshëm dhe ngatërrues edhe në proceset tjera të zbatueshmërisë. Do të jetë kohë ajo sesi do të mund të kalohet.

Kur flasim për çështjet e menaxhimeve të përgjithshme, sigurisht se duhet t'i kemi parasysh qeveritë dhe programet e tyre, që futen në jetën praktike të qytetarëve. Dhe, tash këto qeveri që kemi pasur në vazhdimësi mund të themi se kanë pasur programe të njëjta, me objektiva të njëjta, me synime të njëjta, e që në fushën e zhvillimeve të përgjithshme ekonomike që reflektojnë dhe ndërliken me mpakte të shumanshme të regjenerimit të vendeve të punës ato nuk kanë ndodhur, për shkak se kapitali i përgjithshëm, ose buxhetet e përgjithshme të republikës sonë kalojnë më shumë në ndarjen e shërbimeve të mallrave dhe të pagave e mëditjeve, kurse në projekte kapitale të zhvillimit ekonomik nuk ndodhin dhe vazhdojnë të mos ndodhin dhe njëkohësisht në këtu marrim nota negative në këto procese dhe madje në këto programe, sepse nuk krijojmë vende të reja pune dhe zhvillime të përgjithshme ekonomike.

Prandaj, edhe këtu del një raport i cili ndërliken me vlerësimet e veta, për çfarë nuk jemi të kënaqur. Shumë shpesh ky menaxhim i dëmshëm ka ndikuar edhe në krijimin e një publiku, qoftë të brendshëm dhe të jashtëm, në imazhin e tij si shtet të Kosovës dhe nganjëherë dëgjojmë nëpër medie, madje të njerëzve të institucioneve, e tjera, pa ndonjë logjikë të menduar mirë, se shteti i Kosovës po falimenton, e tjera, e tjera... gjë që është shumë e gabueshme, sepse shteti i Kosovës si mekanizëm nuk falimenton dhe nuk do të falimentojë, por do të bien, do të ndryshohet, do të falimentojnë strukturat udhëheqëse të vendit tonë, të cilat kanë nevojë për ndryshime shumë të mëdha, për shkak se duhet të kemi projekte tjera.

Prandaj, në këtë mes mund të themi se dështojnë strukturat udhëheqëse të pushtetit, por jo edhe shteti i Kosovës.

Roli i Kuvendit dhe menaxhimi i Kuvendit në fakt ka denigruar edhe për shkaqe të shumta të faktorëve tjerë, por për shkak të menaxhimit dhe udhëheqjes që bëhet në Kuvend për shkak të largimit nga Rregullorja dhe respektimit të saj shpesh dhe madje për shkak se në Kuvend dhe madje rreth synimeve të disa njerëzve a grupeve, nuk debatohet për projektet, për konceptet politike, por shpesh debatohet për çështjet e grupeve, partive dhe kush-kujt po ia lë kile në ndonjë debat eventual, që faktikisht Kuvendi dhe roli i tij debatues për problemet e ndryshme zbrit në nivele apo degradime.

U përmendën dhe përmendet që për të pasur sukses në menaxhime në përgjithësi është nevoja e një konsensusi që mund të jetë shpesh nacional për interesa të ndryshme të tjera, që shpesh konsensusi nuk ka ndodhur, por është folur shumë dhe mungesa e konsensusit ka krijuar edhe vendime, të cilat shpesh kanë qenë me probleme në kuptim të materies, apo në kuptim të implementimeve që ne i themi shpesh.

Prandaj, nevojat e tilla çojnë atëherë kur ne kemi programe të mira qeverisëse dhe dakordohen bukur afër edhe me opozitën, gjë që këto s'kanë ndodhur...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYESUESI: Faleminderit! Visar Ymeri e ka fjalën.

VISAR YMERI: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,  
Qytetarë të nderuar,

U fol tashmë shumë për këtë raportin e vendit dhe natyrisht, si kur zakonisht diskutohen tema të tilla, ka dy lloj perceptimesh për atë se çka nënkupton ky raport dhe shpeshherë më ka rastisur t'i dëgjoj eksponentët e Ekzekutivit të Qeverisë, e jo vetëm të Qeverisë, por shpeshherë edhe të koalicionit qeverisës, që në njëfarë mënyre në tërësinë e tij e pranojnë raportin, shpeshherë e quajnë edhe si real, por në anën tjetër pastaj kanë mospajtim me faktet që dalin nga raporti. Këndvështrimi karshi këtij raporti, për mendimin tim, duhet të jetë o pasqyrim i drejtë i gjendjes në institucionet dhe shoqërinë tonë, o, në anën tjetër, nëse na duket që është tepruar, që është tepruar gjuha e cila nuk e reflekton realitetin në Republikën e Kosovës, atëherë do të duhej ta shpallnim si raport që e shtrembëron atë realitet. Pra, që tregon diçka tjetër prej asaj çfarë kemi.

Qeveria e Republikës së Kosovës, kjo Qeveri, por jo vetëm kjo, edhe të tjerat para saj, vazhdimisht e kanë përdorur këtë, të them kështu..., vlerësim të raportit sipas dy kuteve, pra kanë thënë edhe që është pasqyrim, është real, por, në anën tjetër, edhe real por jo në secilin aspekt.

Pra, në ato aspekte në të cilat Qeveria e ka gjetur një kundërshtim të drejtpërdrejtë të punës së tyre, ta zëmë, atëherë kanë thënë: eh, këtu e kanë tepruar nga pak, siç pak a shumë bëri sot zëvendëskryeministri Enver Hoxhaj. Sidoqoftë, unë po e kuptoj si një reflektim, një pasqyrim i gjendjes në të cilën jemi për periudhën për të cilën raportohet dhe mendoj se kur të lexohet raporti më vëmendje shihet që praktikisht në shoqërinë tonë, në Republikën e Kosovës, duhet se ka një padrejtësi të madhe. Mbase, jo çdoherë e shprehur në këtë mënyrë eksplicite, por sidoqoftë në mënyrë implicite ky është nënkuptimi që e përvijon raportin në përgjithësi. Ka një padrejtësi jashtëzakonisht në shoqërinë në Republikën e Kosovës, e cila padrejtësi është e nxitur nga institucionet qendrore të Republikës së Kosovës, pra prej Ekzekutivit e te Gjyqësori dhe institucionet tjera, agjencitë tjera, që do të duhej para së gjithash dhe mbi të gjitha t'ua mbronin interesin kolektiv qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Unë megjithatë dua të ndalem në njërin prej aspekteve të raportit, që mendoj se më së miri e pasqyron atë që e thashë pak më herët, pra për padrejtësinë. Ka një pjesë të raportit që merret së pari nivelin e punësimit në Republikën e Kosovës, së dyti pastaj me cilësinë e punësimit në Republikën e Kosovës dhe, së treti, me mekanizmat e asaj, që mund të quhet shteti social, pra ndihmës dhe lartësimit të pozicionit social të qytetarëve në Republikën e Kosovës dhe në këto shifra e përqindje mund të vërehet një padrejtësi jashtëzakonisht e madhe që ndodh për një kohë të gjatë në Republikën e Kosovës, e për të cilën shumë pak flitet, e aq më pak punohet.

Sipas Raportit të Progresit gjithnjë, një prej problemeve madhore, në të cilën duhet të përqendrohemi si institucione thotë që është ky kombinimi ndërmjet joaktivitetit, që është në nivel të lartë, pra kryesisht i atyre qytetarëve të Republikës së Kosovës të cilët janë në moshë pune e nuk janë të punësuar dhe që natyrisht kjo përcillet me punësim të ulët. Për shembull, thuhet që papunësia për periudhën në të cilën raportohet deri në vitin 2017 mbetet 31%, këto janë shifra zyrtare të papunësisë. Dhe, kur kjo zëritet në rrafshin gjinor dhe në dallimet moshore merr përmasa edhe më alarmante. Për shembull, thuhet se te gratë papunësia shkon deri në 37%; te të rinjtë shkon deri në 51%. Tash, kjo është papunësi e madhe, natyrisht, dhe mendoj se prapë nuk është se reflekton saktësisht atë që e kemi ne në Republikën e Kosovës, por ta zëmë se kjo është e vërteta absolute sa i përket punësimit, prapë e kemi një gjendje alarmante të papunësisë në Republikën e Kosovës.

Dhe, kur kësaj i shtohet edhe një aspekt tjetër, gjithnjë sipas raportit të vendit, aty thuhet se vetëm 29% e të punësuarve kanë kontrata pune, ndërkohë që 71% prej atyre që janë të punësuar kanë kontrata afatshkurtra. Kjo tregon se deri në ç'masë është përdorur e keqpërdorur ajo klauzola e Ligjit të punës, e cila e garanton një fleksibilitet jashtëzakonisht të madh të tregut të punës, i cili gjithnjë dhe vazhdimisht shndërrohet në eksploatim, në shfrytëzim dhe në padrejtësi ndaj të punësuarve, pra punëtorëve, kryesisht kjo ndodh në sektorin privat në Republikën e Kosovës, siç e thotë edhe raporti i vendit. Dhe, këtu vijmë deri te kjo pika e dytë, pra jo vetëm që kemi shumë të papunë, që është problem jashtëzakonisht i madh për shoqërinë tonë dhe për

ekonominë tonë, po këtu edhe ata që janë të punësuar keqtrajtohen si mos më keq. Dhe, në këtë drejtim kjo vetëm sa e shton problemin deri në atë masë, sa nganjëherë është vështirë ta përcaktosh nëse më mirë jeton një i papunë krahasuar me një të punësuar që e ka rrogën jashtëzakonisht të vogël, punon me orar të gjatë, i vonohet paga me muaj të tërë, e shpeshherë nuk i jepet fare, ndërkohë që është i rrezikuar në vendin e punës, sepse nuk ka kurrfarë masash të sigurisë dhe të kushteve të mira të punës, që do t'ia mbronin jo vetëm jetën, por edhe dinjitetin të punësuarit.

Pra, në raportin për vendin thuhet se së pari Kontrata Kolektive, marrëveshje e cila është nënshkruar ka një kohë të gjatë, nuk zbatohet fare si kornizë e krijimit të kushteve të domosdoshme për një punë të dinjitetshme për të punësuarit në Kosovë, ndërkohë që nuk ka fare mundësi të negociimit apo të dialogut në nivel kështu kolektiv, siç do të duhej të ishte pra edhe sipas Kontratës Kolektive dhe atëherë kur kemi raste të tilla, siç përmenden nganjëherë te Këshilli Ekonomik dhe Social, ato janë për çështje të caktuara dhe bëhen vetëm për t'u aplikuar në sektorin publik dhe as aty nuk aplikohen tërësisht. Pra, sektori privat është komplet i përjashtuar nga dialogu social dhe negociimet ndërmjet përfaqësuesve dhe punëtorëve, e që kanë të bëjnë me negocie kolektive. Pra, kështu, duke e zbërthyer fuqinë punëtore në individ të punësuar nëpërmjet kontratave të individualizuara afatshkurta është arritur një efekt i shkatërrimit të fuqisë kushtëzuese dhe negociuese nga pozita e të punësuarve në Republikën e Kosovës. Dhe, mund të na krijohet nganjëherë përshtypja që kjo është bërë pa qëllim, ose nga mosdija, por unë mendoj se kjo është bërë edhe me qëllim edhe për shkak të një arsyeje të caktuar.

Natyrisht se vendi i punës, punësimi, është i lidhur drejtpërdrejt me nivelin e zhvillimit shoqëror dhe ekonomik. Me nivelin e zhvillimit shoqëror, punësimi është një prej mekanizmave, që garanton një rishpërndarje më të barabartë të pasurisë, dhe kjo krijon drejtësi në shoqëri, sepse padrejtësia së pari fillon në shoqëri, e më së shumti në raportin ndërmjet investimit të kapitalit dhe trajtimit që ky kapital u bën punëtorëve. Dhe, në anën tjetër, kjo e ka dimensionin e menjëhershëm, të atypëratyshëm, të përditshëm dhe të vazhdueshëm në rritjen ekonomike. Pra, nuk mund të ketë rritje të qëndrueshme ekonomike, po nuk pati përbrenda kësaj ekonomie një mekanizëm të rishpërndarjes së drejtë të pasurisë, në mënyrë që të orientohemi, ashtu siç e përmendi më herët kryetari i grupit tonë parlamentar, zoti Dardan Sejdiu, te ekonomia e kërkesës, e jo vetëm të ngërthehemi në një kinse ndihmesë të ekonomisë së ofertës, sepse ekonomia e kërkesës rritet më së shumti duke u kujdesur që kërkesa agregate përbrenda një shoqërie dhe ekonomie të vazhdojë të rritet në mënyrë që ajo ekonomi të ketë edhe qëndrueshmëri dhe zhvillim, i cili do të përkthehet në zhvillim shoqëror.

Pra, pabarazia dhe padrejtësia në shoqëri në raport me nivelin e të ardhurave nga pasuria agregate shoqërore shkakton edhe padrejtësi, por në anën tjetër shkakton edhe çalim ekonomik dhe sipas raportit të vendit, edhe pse nuk thuhet në mënyrë implicite kjo nënkuptohet që hendeuku



ndërmjet të varfërve dhe të pasurve në Republikën e Kosovës po shkon vazhdimisht duke u rritur dhe kjo pastaj po i shkakton edhe dëmet e mëdha ekonomike, që i shohim për çdo ditë të rriten, e jo të zvogëlohen. Këtu më herët edhe ministri foli se ka pasur sukses në këto vlerësime që vijnë nga Banka Botërore për lehtësinë e të të bërit biznes për Republikën e Kosovës. Për çdo vit neve na raportohet se kemi përmirësim në këtë fushë, mirëpo kjo nuk po reflektohet aspak në gjendjen ekonomike në të cilën jeton shoqëria jonë. Dhe, kjo është një çështje të cilën duhet ta adresojmë, mbase mekanizmi që po e përdorim nuk është mekanizmi i duhur, sepse sukcesi në mekanizëm nuk po prodhon sukses në ekonomi dhe rrjedhimisht, mbase ky nuk është mekanizmi për të cilin...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Selmanaj e ka fjalën.

DRITON SELMANAJ: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar 13 a 14 kolegë deputetë që keni mbetur dhe po qëndroni stoikisht, a 15, për t'i dhënë seriozitetin kësaj tematike.

Në fakt, diku 90% e Raportit të Progresit ka të bëjë me Qeverinë, kjo Qeveri është duke u sjellë sikur të mos ishte Qeveri e Kosovës. Nuk e di çfarë punësh të tjera kanë, po del sikur të jetë e planifikuar që Kuvendi i Kosovës të demolohet publikisht dhe të denigrohet deri në mospërfillje nga çdokush, përfshirë edhe nga institucione të tjera, por edhe nga vetë njerëzit që jetojnë në Kosovë.

Unë, në fakt, tematikën që sot po e trajtojmë më tepër po e shoh si, pothuajse çdo vit si dy klishe. Klisheja e parë është që Komisioni Evropian duhet të nxjerrë raportin dhe ne më pas të mobilizohemi për të trajtuar tema.

Ndërkohë klisheja e dytë është që i njëjti raport lexohet ndryshe. Disa përfaqësues të Qeverisë ose të shumicës parlamentare provojnë të na ofrojnë disa të dhëna, të cilat unë as që i kam parë në raport.

Ndërkohë që pjesa tjetër, ne, provojmë ta lexojmë drejt dhe të ofrohen kritikrat, por gjithmonë në funksion që ta përmirësojmë jetën institucionale të përbashkët në Kosovë.

Unë kam përshtypjen se kjo po vjen edhe si rezultat i moskuptimit të këtij procesi, më duket sikur institucionet, po edhe një pjesë e shoqërisë në Kosovë akoma nuk e kanë kuptuar mirë procesin e integritit me Bashkimin Evropian. Më tepër po e shohin si një institucion ose, të them, si mekanizëm ndërkombëtar, i cili po na imponon disa vlera dhe ne vetëm në diskursin tonë publik e kemi fjalën 'evropian'. Kemi dëshirë të dukemi si evropianë, ndërkohë që çdo ditë nga mëngjesi deri në mbrëmje punojmë kundër këtyre vlerave dhe jemi pothuajse më

antievropianët e mundshëm, sepse shumicën e detyrave të cilat po na vijnë nga BE-ja i shohim si detyra të imponuara, të importuara, po jo si detyra që, në fakt, do të duhej të dilnin nga vetë populli i Kosovës, nga vetë ne dhe më pas t'i adresonim ato.

Një element tjetër që mua po më shqetëson është çështja se si kemi filluar si institucione të tregojmë njëfarë imuniteti karshi kërkesave dhe detyrave që na i përcaktojnë të tjerët, në këtë rast, qoftë BE-ja, qoftë miqtë tanë ndërkombëtarë, sikur kemi filluar të krijojmë një komoditet ku s'po na lë përshtypje asgjë më, as kush thotë, as çka thotë, por ne vazhdojmë avazin tonë të vjetër, duke e vazhduar devalvimin e përgjithshëm të shtetit tonë.

Dhe, kjo është konstatuar edhe me një thënie në vetë Raportin e Progresit, ku thotë sa i përket përshtatjes me standarde evropiane, Kosova është në fazën e hershme.

Unë po u referohem dy gazetave prestigjioze, të cilat të dyja e kishin pasur në titull këtë çështje, thoshin kështu: “Kosova është në fazat e hershme të rrugës së saj për BE”, domethënë në çdo aspekt, në çdo segment të jetës shoqërore, politike dhe publike në Kosovë ne jemi në fazat e hershme.

Tash unë po i prek vetëm 2-3 çështje që lidhen me tematikat, për të cilën unë kam interes më shumë, që lidhen me gjyqësorin.

Në raport thuhet kështu: “Gjyqësori është ende i prekshëm nga ndikimet e panevojshme politike dhe institucionet e sundimit të ligjit kërkojnë përpjekje të vazhdueshme për të ndërtuar kapacitetet e tyre. Administrimi i drejtësisë mbetet i ngadalshëm dhe joefikas”.

Në çështjen tjetër që lidhet me korrupsionin thotë: “Kosova është në fazën e hershme të përgatitjes në luftën kundër korrupsionit”, që i bie jo që jemi në fazën e hershme për ta luftuar, po edhe në përgatitje për të planifikuar forma se si luftohet korrupsioni ne jemi në fazën e hershme.

Kur lidhet me krimin e organizuar thotë: “Kosova është në fazën e hershme në luftën kundër krimit të organizuar”. Unë po ju kujtoj se në vitin 2010 Qeveria e atëhershme pati sjellë në programin legjislativ kërkesën për të draftuar Ligjin kundër krimit të organizuar në Kosovës. Proces-draftimi e ndërron këtë emër dhe ia lë kështu: “Ligji për kompetenca të zgjeruara për konfiskimin e pasurisë për vepra penale”, kjo në fakt tregon që ky shtet as që ka qenë i interesuar ndonjëherë për ta luftuar krimin e organizuar.

Sepse ligjet e tilla antimafia kanë pasur rezultat në ato shtete, në të cilën përballë mafisë ka ekzistuar antimafia, e kush është anti, është shteti, po në Kosovë a kemi anti? Unë mendoj që jo, në Kosovë mafia ka shtrirë rrjetin e saj si oktapodi në të gjitha institucionet publike në Kosovë

dhe si të tillë, ne edhe po të miratonim Ligjin antimafia, s'e kemi instrumentin anti që do ta luftonte mafinë, që në fakt del që shteti është vetë mafia.

Po prekemi sot, po themi pse institucionet e BE-së dhe pse Raporti i Progresit thotë se institucionet e Kosovës janë të kapura. Para dy ore presidenti i vendit, bashkë me kryeministrin, emëron Shpend Maxhunin shef të AKI-së.

Ne kërkonim që zoti Shpend Maxhuni të shkarkohej nga Policia e Kosovës për shkak të pjesëmarrjes direkt të tij në arrestimin e Gulenistëve dhe çka ndodh? Hashim Thaçi dhe Ramush Haradinaj na tregojnë jo që se kemi në plan 'çkapjen' e shtetit, po flisni gjithë ditën në Kuvend atje, ne do të vazhdojmë avazin tjetër dhe kapja e shtetit do të konsolidohet. Cili është mesazhi që e bartim te njerëzit, është që ne duhet të mobilizohemi si parti politike, si shoqëri, të ndalen këta njerëz, cila do të jetë forma, akoma nuk e di as unë.

Tash kur po e shoh sjelljen e Qeverisë së Kosovës, duke mos ardhur këtu, duke u marrë me emërimet të tilla, besoni po ma kujtoni një kohë, kohën e Qeverisë së Përkohshme, edhe në përbërje kjo Qeveri është e ngjashme si Qeveria e Përkohshme, por edhe në pasojat që ia ka sjellë vendit ajo Qeveri e Përkohshme dhe kjo tash po sillet sikur të ishte e përkohshme.

Krejt në fund, gjithë debatin që e dëgjova, të gjitha kërkesat që dolën nga shumë deputetë kam vetëm një përgjigje: mos po kërkojmë shumë prej kësaj Qeverie, se kjo as s'ka potencë politike, as intelektuale dhe as kadrovike për t'i adresuar këto!

Ne kemi Qeveri me shumë impotencë në çdo aspekt, këta janë të pazotë, ne po kërkojmë diçka që këta nuk mund ta bëjnë. Prandaj, të mos i marrim në qaf, të mos i ngarkojmë më shumë, sepse është keq edhe për këta. Të provojmë t'i bindim që nuk janë për këtë punë, le ta marrim drejtimin tjetër, le të shkojnë në forma të organizimit tjetër politik, për instrumenteve demokratike që janë zgjedhjet dhe më pas provojmë t'i japim shtetit një Qeveri edhe legjitime, edhe të dinjitetshme dhe që do të provojë, nuk them që do të arrijë, po do të provojë t'i kthejë dinjitetin e këtij vendi.

Përndryshe, do të mbesim në një rreth vicioz, ku ne këtu diskutojmë mes veti 12-13 deputetë, ata atje i kryejnë punët e mëdha për këtë shtet, në vazhdimin e kapjes së shtetit dhe njerëzit çfarë? Humbin shpresën për të jetuar në këtë vend dhe provojnë t'i gjejnë 1 000, 2 000, 3 000 euro se si të ikin ose si të marrin një vizë për të ikur nga Kosova.

Prandaj, po them, të jenë raste të tilla, përkundër që, nuk e di nëse ka mbetur ndokund ndërgjegje për t'i prekur ata që të provojmë, edhe forcat e fundit t'i gjejmë që t'i japim rrugë demokratike zgjidhjes së problemeve, për të cilat unë po besoj që ky vend është katandisur. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka Rexhep Selimi.

REXHEP SELIMI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Shpresoj të jemi në transmetim, bile së paku të na dëgjojnë qytetarët, sepse ne kemi mbetur shumë pak këtu, por kjo është edhe një shenjë që edhe simbolikisht Qeveria e Kosovës, them kështu, nuk çan kokën për Parlamentin. Pra, nuk po na dëgjojnë.

Në seancën e sotme pashë diku pakënaqësi, diku një farë nervoze, shkallë të nervozizmit pse raporti nuk është përkthyer edhe në gjuhët që ne i flasim, në gjuhën shqipe përkatësisht.

Por gjithë këtë e bënë deputetët e mazhorancës, të cilët ankoheshin nga thirrësit, e jo ndaj institucioneve që kanë pasur detyrë ta bëjnë këtë, qoftë ministria përkatëse, qoftë edhe administrata e Parlamentit apo Kryesia.

Por, unë ndoshta do të fokusohesha pikërisht te roli i Parlamentit në Raportin e Progresit dhe pashë diçka që i bie një konstatim për rolin mbikëqyrës të Parlamentit, madje do të doja që me ju ta ndaj veç një fjali. Ndonëse këtu është anglisht, unë do ta them në shqip dhe bëhet fjalë për mbikëqyrjen parlamentare të Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe të Kosovo Intelligence Agency, të AKI-së, ku thotë që vazhdojnë të jenë ineffiçiente, kjo nënkupton që kjo ka qenë edhe kështu më përpara.

Po tash duke qenë unë pjesëtar dhe deputet në Komisionin Parlamentar për Siguri, një komision i cili në njërin prej këtyre dy institucioneve e ka nën domenin e mbikëqyrjes, në këtë rast Forcën e Sigurisë së Kosovës, atëherë i bie që t'i them jo në formë arsyetimi, por edhe në formë konstatimi se për se ky komision s'e ka arritur asnjëherë ndoshta, ose s'e ka arritur nevojën e duhur ta mbikëqyrë këtë.

Si mund ta mbikëqyrim ne Forcën e Sigurisë së Kosovës me një rutinë të nevojshme, në këtë rast, kur kemi pasur t'i mbikëqyrim të gjithë ato skandale të krijuara në Ministrinë e Brendshme, në Inspektoratin e Policisë dhe në institucione të tjera, të cilat janë nën domenin e mbikëqyrjes.

Pra, deri më tash, për fat të mirë, në Forcën e Sigurisë së Kosovës nuk ka pasur skandale, siç është ai i vjedhjes së dëshmive që ka ndodhur në Policinë e Kosovës, në Forcën e Sigurisë së Kosovës nuk ka pasur skandale sikur ai i humbjes së gjërave që ruhen atje, por s'ka pasur në Forcën e Sigurisë së Kosovës as skandale, ku pjesëtarët e këtij institucioni rrihen ose rrahin njerëz rrugëve. Pra, sikur të mos ishin këto skandale të mëdha në institucione të tjera, ndoshta edhe komisionet do të kishin mundësi ta mbikëqyrin edhe Forcën e Sigurisë së Kosovës, ndonëse ka pasur mbikëqyrje, po këtu po vazhdon në mënyrë që për momentin të konstatohet që s'ka pasur.

Po këtu thotë që s'ka pasur mbikëqyrje as ndaj Agjencisë së Inteligjencës së Kosovës, e me shkas sot po marr edhe atë çfarë tha kolegu më herët, emërimin në krye të kësaj agjencie të një

personi tashmë, i cili ka qenë prodhues vendor i skandaleve brenda institucioneve ku ka udhëhequr.

Ne kemi kërkuar që atë ta ngarkojmë me përgjegjësi për ato çfarë ka ndodhur në institucione të tija, kryeministri dhe presidenti e ngarkojnë me detyra të reja, duke e avancuar atë në krye të një institucioni shumë delikat.

Tash unë do të paragjykoja, por kam frikë që nuk po paragjykoj, se si do të jetë raporti i vitit 2019, do të fillojë nga sot raporti i 2019. Për shembull, nuk është çudi nëse në raportin e 2019-tës shkruhet që raporti i 2018-tës nuk është marrë seriozisht as që nuk është përkthyer madje.

Kurse po ashtu në raportin e 2019-ës nëse ka një vlerësim real, mund të shkruhet dhe ma merr mendja që do të shkruhet që në krye të agjencisë, në këtë rast në krye të AKI-së, u vu një person i cili sa ishte polic nuk e kaloi verifikimin e sigurisë, të kryer nga vetë AKI-ja. Paramendojeni ai që është emëruar sot në krye të AKI-së. kohë më parë nuk e ka kaluar verifikimin e sigurisë, këtë vetingun që po bëjmë fjalë, që është kryer nga AKI-ja e atëherëshme kundrejt institucionit që ka qenë ky, në Policinë e Kosovës. Ja deri ku shkoi arroganca e krerëve të institucioneve të Republikës së Kosovës.

Dhe, sot edhe një herë, me emërimin e këtij njeriu në krye të AKI-së, është një manifestim i arrogancës së hapur që ne e bëjmë edhe këtë dhe Parlamenti i Kosovës, qytetarët e Kosovës nuk kanë çka bëjnë, përveç që të na shohin në televizor për ato çka po bëjnë.

Prandaj, ne edhe mund ta diskutojmë Raportin e Progresit, por të jeni të bindur që deri në raportin tjetër ne kemi çka të flasim, ne kemi çka të analizojmë këtë raport, edhe për fat të keq, më keq është gjendja se sa është e përshkruar në këtë raport, për fat të keq ka rrezik që edhe të përkeqësohet gjendja më shumë se sa është përshkruar në këtë raport, sepse kursi i ecjes së këtij shteti është tashmë në kahun jo të duhur, e po ashtu nëse e krahasojmë Kosovën me një anije nëpër, atëherë kjo anije, edhe pse është në dallgë shumë të mëdha, është në kursin e gabuar, por gjithsesi edhe me kapiten të gabuar dhe s'kemi se si ta arrijmë kështu, me këtë kurs dhe me këta njerëz në krye të këtij shteti, atë çfarë vërtet pretendojmë ose cakun që do të duhej të arrinim si një shtet normal.

Prandaj, do të doja që të lexoja diçka më të mirë në këtë raport, por për fat të keq nuk kemi.

**KRYESUESI:** Faleminderit! Zoti Abdixhiku e ka fjalën.

**LUMIR ABDIXHIKU:** Faleminderit, nënkryetar!

Ju 16-17 kolegë deputetë që keni mbetur në sallë, unë sinqerisht s'e di çfarë qëllimi ka kjo seancë. Të bëhet debat parlamentar kur s'i kemi as tanët në këtë sallë, edhe më pak s'e kemi

asnjerin prej ministrave këtu. Ndoshta së paku ministrja e Integrimi Evroplane ishte dashur të ishte këtu, sepse nuk besoj që ka punë më të rëndësishme gjatë gjithë vitit se sa Raporti i Progresit.

Pra, po, këta deputetë në sallë do të mund të uleshim sot këtu në vend të ministrave të Qeverisë.

Tash për qytetarët tanë, jo për referat, se çka thotë Raporti i Progresit, por janë dy lloj mesazhesh që jepen aty.

Mesazhi i parë, më i rëndësishmi që i intereson qytetarëve tanë është çështja e liberalizimit të vizave dhe raporti i Kosovës e sheh si pozitiv ratifikimin e demarkacionit, por kur vjen puna te luftimi i korrupsionit, s'e përmend fare një gjë të tillë, pra e trajton si me sy të mbyllur, në njëfarë forme e bën një farë favori ndaj Kosovës dhe qytetarëve tanë, se këtë herë po i mbyllim sytë, në mënyrë që të marrë Kosova një rekomandim pozitiv.

Por, në pjesën tjetër ky raport e jep një pasqyrë bukur alarmante të Kosovës si shtet dhe ka disa elemente shqetësuese në këtë pasqyrim alarmant.

Pra, fillimisht e paraqet Kosovën si shtet jofunksional, në fazë krejtësisht të hershme të zhvillimit të tij. Po e shfaq edhe jofunksionalizimin e institucioneve kryesore të vendit, por më shqetësuesja dhe më e reja për Kosovën, e paraqet elitën politike vendimmarrëse në Kosovë si joserioze.

Dhe, fjala 'progres', që ta keni parasysh, e përmendur 130 herë, rrafsh 130 herë përmendet në raport, në të gjitha konotacionet, qoftë pozitiv, qoftë negativ, kështu është terminologjia e raportit.

Vetëm në 30 raste ka pikëpamje pozitive, pra vetëm 30 herë thotë që ka ndodhur progres në Kosovë, në 100 herë të tjera thotë se s'ka progres, ose është progresi i mangët, ose është simbolik.

Dhe fjalia më përkufizuese e raportit, ajo më e rëndësishmja është në fillim të tij dhe po citoj thotë: "Koalicioni qeverisës i dalë pas zgjedhjeve të fundit nuk ka pasur sukses në afrimin e Kosovës drejt BE-së". Koalicioni qeverisës nuk ka pasur sukses në afrimin e Kosovës drejt BE-së, kjo është fjalia më përmbyllëse e punës së koalicionit të qeverisë. Ka adresë të saktë, ka edhe vlerësim të saktë. Koalicioni qeverisës nuk ka pasur sukses në afrimin e Kosovës drejt BE-së, gjithçka tjetër është e parëndësishme.

Dhe ky përkufizim bëhet jashtëzakonisht i rëndësishëm kur vendet fqinje ecin me hapa jashtëzakonisht të mëdhenj, dy prej tyre hapin negociatat me BE-në, e të tjerat janë në fazë

shumë avancuese se Kosova, në veçanti kur Serbia është shumë më përpara, e ne jemi dhe kemi humbur një vit duke mos pasur kurrfarë afrimi me BE-në.

Dhe goditja e parë që i jepet në këtë raport Kosovës ndërlidhet me natën e 22 dhjetorit, për mënyrën klandestine, po e rikujtoj, të provimit të shfuqizimit të Gjykatës Speciale dhe shfuqizimi i Gjykatës Speciale merr vëmendje thelbësore aty dhe është vetëm fal veprimeve të pamatura si këto dhe vendimeve të pamenduara mirë që Kosovës i vihet një njollë e tillë në vlerësimin e përvitshëm.

Në këtë raport klasa politike përshkruhet si e paqëndrueshme dhe jobindëse përballë obligimeve ndërkombëtare, pra thuhet se nuk mund t'i zihet besë kësaj klase politike që në mënyrë krejtësisht klandestine merr vendime për shfuqizimin e relacioneve të rëndësishëm ndërkombëtare.

Raporti gjithashtu kritikon atë që praktikisht e kemi kritikuar të gjithë këtu në këtë Parlament: madhësinë e Qeverisë. Thotë se është e madhe, ka zëvendësministra të vendosur pa ndonjë kriter dhe, dorën në zemër, të padobishëm, siç e kemi këtë takim sot këtu, nuk e kemi as ministrin, por nuk i kemi as pesë zëvendësministrit e kësaj ministrie që së paku do të duhej të ulerin aty mbrapa për të dëgjuar se çfarë po diskuton Parlamenti i Kosovës.

Pra, në një rrethanë të tillë, kjo madhësi e Qeverisë është më tepër apetit dhe apetiti për kapje të institucioneve thuhet qartë në raport.

Raporti e vlerëson si rikthyese çështjen e kapjes ose zaptimit të institucioneve publike.

Derisa flasim ne këtu, një praktikë e re ka filluar të ndodhë gjithandej, vetëm në Telekom të Kosovës gjatë javës së kaluar kemi pasur me qindra njerëz që presin rend për t'u punësuar. Pra, është një fenomen i ri që po ndodh në Kosovë, sepse ka shumë partnerë qeverisës, janë 22 parti që duhet adresuar secilin anëtar të tyre nëpër këto institucione të pavarura publike dhe kjo natyrisht lë brengë, njollë të zezë në këtë raport.

Kritika të mëdha raporti i jep edhe këtij Parlamenti, po në veçanti e adreson kritikën te kryetari i Parlamentit. Thotë kryesuesi i Parlamentit nuk ka arritur të shtrojë përpara agjendën e këtij Kuvendi dhe propozon që të kemi një agjendë të saktë për gjashtë muajt e ardhshëm, me data të sakta se çfarë duhet të bëjë ky Parlament, në mënyrë që të mos kemi seanca si në këtë javë, kur i kishim katër ditë parlamentare dhe tash pa ndonjë vëmendje të madhe, siç po ndodh tani.

Po arsyeja e vonësës dhe ngatërimit të Kuvendit ka qenë më tepër politike, sepse shumica për të dobësuar opozitën i ka grumbulluar dhe vonuar të gjitha interpelancat dhe kërkesat tona

parlamentare që i kemi pasur, me qëllimin e vetëm që të njëjtat të devalvohen e të trajtohen siç po i trajtojmë tani.

Mungesë e plotë e progresit evidentohet edhe në tri fusha esenciale për Kosovën: në arsim e shkencë thuhet s'ka progres, pra s'ka progres për një vit në arsim dhe shkencë.

Thotë s'ka progres në media dhe liri të shprehjes, s'ka kurrfarë progresi.

S'ka progres as në respektimin e të drejtave të njeriut. Pra specifikohet rasti i gjashtë shtetasve turq të deportuar në Turqi dhe njerëzit përgjegjës për skandalin e tillë që merr notë negative në Evropë, sot promovohet si shef i Inteligjencës.

Në qoftë se deklaratat e deputetit Selimi janë të vërteta, se shefi i Inteligjencës nuk e ka kaluar atë testin e sigurisë, atëherë kemi të bëjmë me një situatë alarmante, ku rrezikohet seriozisht integriteti politik i Republikës.

Dhe, për fund, në pjesën e ekonomisë, në pjesën financiare, ndonëse lëvdohet stabiliteti buxhetor, ka kritika të theksuara për skandalin e fundit, për listat e fryra të veteranëve.

I njëjti vlerësim që është dhënë në këtë Parlament, thuhet edhe në raport, se listat e fryra të veteranëve e rrezikojnë stabilitetin financiar të Kosovës dhe deri më tani nuk kemi pasur asnjë akt në këtë drejtim.

Pra, në fjalë të tjera, për fund raporti vlerëson dhe vulës dështimin e kësaj Qeverie në përafrimin minimal me BE-në, e shpërfaq atë si të dobët dhe me apetit të madh për zaptimin e institucioneve, e lidërshpin e vendit e vlerëson si jokredibil në përkushtimin evropian.

Raporti në fjalë duhet të na shërbejë veçse si pasqyrë rikujtuese e gjendjes së rëndë në të cilën është Kosova.

Prandaj, Kosovës i duhet sa më shpejt kthimi në rrugën evropiane, kthim i cili duhet të ndodhë sa më shpejt dhe në hap me ritmin e shteteve të rajonit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Nagavci e ka fjalën.

ARBËRIE NAGAVCI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar qytetarë,

Deputetë,



Ishte interesant të shihet që nga fillimi i kësaj seance tendenca për të penguar debatin për këtë temë kaq të rëndësishme, e cila i adreson ngecjet dhe madje regresin në shumë sfera të rëndësishme.

Pajtohem që është e drejtë e secilit që të kemi materialin në gjuhën shqipe, gjegjësisht në gjuhën amtare për secilin prej deputetëve, por në fakt, kjo është një vërejtje për Ministrinë e Integritetit Evropian, e cila ishte dashur ta sillte të përkthyer këtë dokument për secilin prej deputetëve.

Dhe përderisa ministrja ka të drejtë të dalë në konferenca dhe në paraqitje për të lavdëruar raportin, do të duhej të merrte obligim që të njëjtin ta sillte në gjuhën shqipe, gjegjësisht në gjuhën amtare për secilin prej deputetëve.

Kjo sigurisht nuk e arsyeton mungesën e deputetëve, për më shumë nuk është asgjë e re, jo më larg se në seancën e fundit, kur u fol për sigurinë e fëmijëve në internet, pra dy ditë përpara dhe pothuajse në secilën seancë nuk ishim të pranishëm më shumë se 20 deputetë, domethënë ishte ngjashëm situata sikurse edhe tani.

Ndërsa për praninë e Qeverisë, ministrave në seanca, është më shumë befasi kur ata i shohim që vijnë dhe qëndrojnë për një kohë, edhe pse jo të gjatë, sepse mungesa e tyre është e zakonshme në pothuajse në secilën prej seancave.

Meqenëse u kërkua disa herë të përmendet diçka pozitive nga raporti, do të doja të theksoja se ishte një lajm i mirë vlerësimi pozitiv, për shembull, vlerësimi për Institucionin e Avokatit të Popullit, si institucioni më i besuar në Kosovë dhe se është i vetmi institucion që ka zbatuar në shkallën 100% programin kombëtar për zbatimin e MSA-së. Por, fatkeqësisht, përkundër dëshirës sonë dhe përpjekjes për të gjetur situata të tilla pozitive, përpjekja ishte e kotë, sepse sikurse u fol edhe nga parafolësit, domethënë nga kolegët e mi, raporti i përmend ngecjet në secilën prej fushave, të cilat i ka adresuar. Sigurisht, adresoi edhe çështjen e cilësisë së arsimit, duke e specifikuar si tejet të dobët. Derisa raporti i kaluar theksonte se nuk është bërë progres në përmirësimin e sistemit të edukimit, ky raport theksoi se gjetjet në sistemin e arsimit mbeten të papërmirësueshme.

Pra, theksohet qartë se nuk ka fare progres, më saktësisht, nuk është bërë asnjë hap përpara në përmirësimin e cilësisë në edukim dhe adresimin e boshllëqeve apo zbrazëtirave të shkaktuara në raport me tregun e punës. Pra, pamundësi në përmbushjen e kërkesave në tregun e punës dhe po ashtu zhvillimeve të nevojshme të shkathtësive të rinjve tanë. Një pjesë e veçantë e këtij raporti i adresohet edhe shkencës dhe hulumtimit. Pasi që disa nga kolegët veçse diskutuan për pjesën për arsim, unë do të ndalem pak më shumë te kjo pjesë.

Edhe këtu, si në shumicën e rasteve apo në të gjitha rastet e tjera theksohet se Kosova është në fazën e hershme të përgatitjeve për shkencë dhe hulumtime dhe se nuk është bërë asnjë përparim në vitet e fundit. Është vërtet brengosje të dihet se edhe këtë vit buxheti i planifikuar për arsimin e lartë në përgjithësi dhe për hulumtimet dhe shkencë në veçanti, është shumë i vogël. Dhe, kjo tregon që tani se as në raportin e ardhshëm nuk do të ketë përmirësim, pasi nuk ka asnjë planifikim për rritje të buxhetit në këtë drejtim, as këtë vit e as vitin e ardhshëm. Përkundër që raporti e theksoi dhe rekomandonte një gjë të tillë, pra që Qeveria do të duhej të rriste buxhetin për hulumtime dhe t'i stimulojë investimet nga sektori privat. Është adresuar po ashtu në raport edhe aspekti ligjor, gjegjësisht mosimplementimi i ligjit për shkak të mungesës së buxhetit. Në vend të rritjes së investimeve në hulumtime, ka ndodhur e kundërta, pra shpenzimet për hulumtime janë zvogëluar në 0.1% të GDP-së dhe madje, as kjo shumë nuk shpenzohet as 50% nga planifikimi. Edhe në këtë fushë situata do të jetë e njëjtë edhe në raportin e ardhshëm, pasi edhe në këtë qeverisje jo vetëm që nuk po punohet asgjë në këtë drejtim, por kemi parë edhe veprime dekurajuese për shkencëtarët dhe hulumtuesit e rinj.

Ministria e Arsimit së fundi, në vend që të gjejnë mundësi për motivim dhe përkrahje të hulumtuesve dhe shkencëtarëve të rinj, ka marrë vendim për anulimin e konkursit për shkencëtarët dhe shkencëtarët e rinj dhe për mosshpalljen e tyre. Përkundër se ishte alokuar buxheti për të ndarë çmimet për përfituesit dhe ky anulim i konkursit nuk erdhi për shkak të mungesës së shkencëtarëve të rinj apo mosgatishmërisë së tyre për të aplikuar, por për shkak të shkeljeve procedurale, ligjore të vetë ministrisë, për çfarë sikurse edhe në të gjitha rastet e tjera, askush nuk mori përgjegjësi. Të vetmit që pësuan ish-in ata pak shkencëtarë të rinj entuziastë, të cilët me punën dhe përkushtimin e tyre kanë treguar suksese jo vetëm në vend, por edhe në shtetet e tjera.

Raporti adreson po ashtu edhe cilësinë e dobët të programeve të arsimit të lartë, gjegjësisht të programeve postdiplomike në përgatitje të hulumtuesve si në institucionet e edukimit publik, ashtu edhe në atë privat, ku ka kritere shumë të pabarabarta për promovimin e bazuar në arritjet e bazuara në hulumtime dhe publikime. Edhe në këtë drejtim, përkundër dëshirës, nuk shoh se do të ketë përparime deri në raportin e ardhshëm, kështu tashmë dihet se Universiteti Publik, për shembull, "Hasan Prishtina" nuk shpenzon as 0.1% të buxhetit për hulumtimet shkencore. Adresohet po ashtu në raport se nuk ka pasur arritje në integrim në zonën evropiane të kërkimit, pjesëmarrja e Kosovës në "EU Horizont 2020" shënon një rritje të lehtë, thuhet në raport, krahasuar me vitet e kaluara, por akoma ky nivel i pjesëmarrjes nuk përfaqëson potencialet e Kosovës dhe duhen marrë masa për përmirësim. Dhe, edhe në këtë drejtim, nëse e kemi në vëmendje vetëm një nga vendimet e para të kësaj qeverisje, për shkarkimin e Këshillit Shtetëror të Cilësisë të Agjencisë Kosovare të Akreditimit, e cila është përgjegjëse për sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë, atëherë rezultatet nuk mund të jenë pozitive.

Është e qartë se Raporti për Kosovën i Komisionit Evropian edhe këtë vit ua rikujtoi institucioneve të Kosovës obligimet, të cilat duhet t'i përmbushin, në mënyrë që Kosova të shënojë përparim në proceset integruese evropiane. Mjaft nga këto rekomandime është e qartë që tani se nuk do të realizohen, këtë e them jo nga dëshira apo nga vullneti për të kritikuar, por duke pasur parasysh buxhetin e planifikuar, por edhe veprimet e Qeverisë dhe të ministrive veç e veç, të cilat thuajse janë në garë për punësime të zëvendësministrave e këshilltarëve, po vazhdojnë punësimet e zëvendësministrave, dje kishim edhe një zëvendësministër të ri dhe shumica prej tyre nuk janë as kompetentë për pozitën që i mbajnë.

Andaj, edhe duhet të jetë një debat dhe monitorim i vazhdueshëm i punës në Qeveri, pajtohem me atë që e përmendën edhe disa kolegë këtu që ky duhet të jetë një debat që duhet të vazhdojë gjatë dhe duhet të ketë një monitorim dhe mirëfunksionim të Kuvendit, në mënyrë që të punohet në zbatim të rekomandimeve, jo vetëm që të kemi një raport më të mirë në vitet në vijim, por që të përmirësohet jeta e qytetarëve të Republikës. Edhe pse kjo jo vetëm se nuk është një betejë e lehtë, por nuk duket shpresëdhënëse. E përmendën edhe dy kolegët e mi më herët, se lajmi i fundit për emërimin e Shpend Maxhunit si drejtor të AKI-së e vërteton këtë. Nga një person, për të cilin kërkohej shkarkimi për shkak të përgjegjësisë së tij direkte në skandalin e fundit në deportimin e gjashtë qytetarëve turq, ai avancoi në pozitë, duke u caktuar drejtor i një institucioni të rëndësishëm siç është AKI-ja, personi i cili as vetë nuk arriti paraprakisht të kalonte verifikimin e testit, pra të këtij institucioni. Dhe, kjo nuk është as rruga drejt BE-së, as gjasat për raportin më të mirë në vitet e ardhshme, por ajo që është më e keqja, nuk është as mënyra për përmirësimin e jetës së qytetarëve. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Ismajl Kurteshi, e keni fjalën.

ISMAJL KURTESHI: Faleminderit, nënkryetar!

Përsëritje për deputetët e pranishëm, mendoj në këtë shqyrtim shumë të rëndësishëm që, bazuar në diskutimet e tyre, një pjesë e deputetëve nuk e kanë kuptuar ashtu siç do të duhej, sepse në një formë u ndamë në ata që e mbrojtën Qeverinë, bashkë me ata pak ministra që ishin këtu, dhe të tjerët, të cilët edhe pse jepnin detale nga raporti, u konsideruan si sulmues të drejtpërdrejtë të Qeverisë aktuale.

Mendoj që së pari do të ishte e padrejtë që fajin për gjendjen të cilën jemi ta adresojmë te kjo Qeveri, sepse duhet pranuar se për gjendjen në të cilën jemi fajtorë janë të gjitha qeveritë, njëra pas tjetrës, fajtor është edhe ajo pjesë e faktorit ndërkombëtar që ka marrë pjesë në ndërtimin e institucioneve tona dhe ka kontrolluar ato për një kohë të gjatë. Po ashtu fajtor është edhe ky Kuvend, jo ky aktual, po të gjitha kuvendet që veprojnë që nga viti 2002, pra të gjitha legjislacionet, për arsyen e thjeshtë sepse kuvendet janë ato, të cilat i kanë zgjedhur qeveritë që po i kritikojmë, kuvendet janë ato, të cilat i kanë zgjedhur presidentët të cilët po i kritikojmë, Kuvendi është institucioni që i ka zgjedhur gjykatësit dhe prokurorët, me të cilët jemi të

pakënaqur, prandaj nuk mund t'i iket përgjegjësisë as Kuvendi dhe as institucionet e tjera. Meqë jemi të gjithë përgjegjës, mendoj që do të ishte më mirë që ta kuptojmë përgjegjësinë dhe në vend se të shtyhem se a është gjendja reale ashtu, siç përshkruhet në këtë raport, apo është ndryshe, do të duhej që vetëm t'i identifikojmë të metat që i kemi në këtë shoqëri, e që janë të shumta dhe të angazhohemi të gjithë që t'i zgjidhim këto çështje.

Njëri nga parafolësit tha se asgjë nuk është alarmante, sepse vlerësime të tilla për gjendjen në Kosovë janë dhënë edhe në raportet e mëhershme. Unë konsideroj se pikërisht ky fakt është alarmant, sepse gjendja këtu nuk po ndryshon, tani e shumë vjet me radhë dhe të qenit në të njëjtën gjendje, flet jo vetëm për stagnimin, por edhe për degradimin. Se gjendja është e njëjtë, po i parafrazoj vetëm dy konstatime të dy raporteve të ndryshme të progresit për gjendjen në arsim, në të cilën unë jam fokusuar edhe për shkak se i përkas kësaj sferë, jam në Komisionin e Arsimit, edhe pse konsideroj se arsimi është njëri nga elementet më të rëndësishme në të cilën do të angazhohemi ta përmirësojmë, se pa përmirësimin e gjendjes në këtë sferë të jetës, nuk do të ketë mundësi që gjendja të përmirësohet në fushat e tjera.

Në Raportin e Progresit të vitit 2016, në lidhje me arsimin thuhet: “Nuk është bërë fare progres në përmirësimin e sistemit të edukimit”, kurse në Raportin e Progresit të cilin sot po e shqyrtojmë, pra të vitit 2018, thuhet se “asnjë përparim nuk është bërë në përmirësimin e cilësisë në arsim”. Konsideroj që kjo është alarmante!

Më tutje, sa i përket arsimit thuhet se cilësia në arsim ka nevojë për një ngritje të konsiderueshme. Raporti sugjeron që sivjet në Kosovë duhet të procedohet dhe të kalojë Ligji për arsimin e lartë, i cili do t'i hapë rrugë reformës sipas standardeve më të mira, duke përfshirë këtu edhe autonominë e institucioneve të arsimit të lartë dhe duke krijuar mekanizma që garantojnë cilësi. Në raport përmendet edhe nevoja e reformës së kurrikulave për arsim parauniversitar, duke përfshirë këtu edhe shkollat profesionale dhe mungesën e punës praktike, që është një ndër problemet shumë të rëndësishme. Është i rëndësishëm edhe konstatimi se 4.7% e GDP-së që shpenzohet për arsim publik, nuk menaxhohet mirë, në mënyrë që të avancohet cilësia në arsim dhe që gjendja të ndryshojë. Si problem serioz evidentohet edhe përqindja e vogël e fëmijëve në arsimin parashkollor, ku thuhet që vetë 18% e fëmijëve nga moshën 0 deri në moshën 5-vjeçare përfshihen në institucionet e licencuara parashkollore. Neve na janë prezantuar këtu edhe shifra të tjera për një numër më të madh të fëmijëve të përfshirë në institucionet parashkollore, por ata shkojnë në institucione, të cilat nuk janë të licencuara dhe që ne nuk e dimë se çka në të vërtetë iu ofrojnë fëmijëve tanë këto institucione të palicencuara, e ndoshta më mirë do të ishte që fëmijët të mos shkojnë në këto institucione, sesa të shkojnë atje ku institucionet edhe nuk janë të licencuara dhe janë jashtë çdo kontrolli.

Numri i studentëve në Kosovë, sipas raportit, por bazuar edhe në njohuritë tona të mëhershme, është qind për qind më i madh se në vendet e Bashkimit Evropian, por numri i atyre që i

përfundojnë studimet është dukshëm më i ulët që po ashtu, flet për investime të cilat nuk e realizojnë qëllimin përfundimtar të këtyre investimeve që edhe ashtu nuk janë të mëdha. Në raport kritikohet shkarkimi i Agjencisë Kosovare të Akreditimit në vitin 2017 që ka çuar në përjashtimin e kësaj agjencie, do të thotë të Këshillit Shtetëror të Cilësisë nga Regjistri Evropian për Mbrojtjen e Cilësisë. Në raport po ashtu bëhet fjalë edhe për arsimin e lartë, ku thuhet se ajo është një rrezik për përfshirjen në korrupsion dhe në ndikimin politik që mund të ndodhë në këtë nivel të arsimit.

Plani Strategjik i vitit 2017-2021 i arsimit në Kosovë dhe plani aksional i aprovuar në vitin 2017, duhet të fillojë të jetësohet, sepse edhe në raport, edhe nga njohuritë që i kemi, ky plan ka mbetur vetëm i shkruar në letër dhe nuk ka filluar as të implementohet dhe as të ndahen mjete për implementimin e tij. Në raport insistohet që edhe në komuna të formohen mekanizma të ngritjes së cilësisë dhe nuk është përmendur, por dihet se sidomos arsimit në komuna është tepër i politizuar, pasi që kompetenca të mëdha u janë dhënë organeve komunale, të cilat jo vetëm që kontrollohen nga kryetarët e komunave, por ata edhe bëjnë përzgjedhjen qoftë të drejtorive komunale të arsimit, qoftë të drejtorëve të shkollave, e shpesh kryetarët e komunave janë larg problemeve të arsimit, por ata kur emërojnë njerëz të rëndësishëm të arsimit, i kanë parasysh më tepër agjendat partiake, se sa nevojat e arsimit.

Plani i Ministrisë së Arsimit në lidhje me profilizimin e mësuesve për nxënësit nga klasa e parë deri në klasën e pestë me të drejtë paraqitet si e papërgatitur mirë dhe si e tillë mund të jetë edhe e dëmshme. Rreth 50% të nxënësve të shkollave të mesme, bazuar në raport, mësimet i vijnë në shkollat profesionale, por në këto shkolla mungon puna praktike, e kjo ndikon që nxënësit kur e përfundojnë shkollën profesionale...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYESUESI: Faleminderit! Liburn Aliu e ka fjalën.

LIBURN ALIU: Faleminderit!

Më herët e patëm edhe fjalën e ministrit Hoxhaj, i cili gjatë diskutimit të tij më bëri përshtypje që në një moment tha që ne do të duhej të gjithë bashkë të jemi të unifikuar, në mënyrë që të bëjmë progres drejt Bashkimit Evropian dhe në raportin e radhës të kemi një raport krejtësisht tjetër nga ky.

Kjo u duk interesante në atë që ai e prezantoi, por se a është e besueshme, ai mori shembull Kroacinë e kështu me radhë. Unë do të kisha dashur të jap vetëm disa shembuj që një gjë e tillë ka pasur tendenca këtu edhe në Kuvend, edhe në përgjithësi në këto vitet paraprake që të ketë unifikim për shumë çështje. Ta zëmë, sa i përket çështjes së bujqësisë, në të gjitha debatet që janë mbajtur me sa mbaj mend unë këtu në Kuvend, prej kohës kur kam qenë në legjislacionet e

mëhershme, asnjëherë opozita dhe pozita nuk kanë pasur ndonjë ballafaqim të madh për sa i përket çështjeve në bujqësi. Ka pasur një pajtim dhe një konsensus të përgjithshëm kudo, të gjithë, sado që kanë diskutuar, kur ka qenë çështje bujqësia, pothuaj që janë pajtuar të gjithë, ka mundur të ketë kritikë që s'po ecët tutje, por për atë se a duhet të bëhet apo jo një çështje, ka pasur kundërshtime në ide, absolutisht jo. Asokohe, më kujtohet në fillim të vitit 2012 ka hyrë në fuqi edhe Ligji për rregullimin e tokës bujqësore, i cili u pati votuar nga të gjithë. Ka pasur monitorim të Ligjit për mbrojtjen e tokës bujqësore dhe në këtë pikë të gjithë deputetët kanë qenë unikë për sa i përket mbrojtjes së tokës bujqësore. Dhe, tash nëse në një anë kemi unitet në qëndrime për sa i përket bujqësisë dhe, në anën tjetër i kemi raportet e progresit që janë të njëjta njëri pas tjetrit, a duhet ne të besojmë në këtë Qeveri që, po qe se do të kishim qenë unikë, do të kemi ndonjë ndryshim në të ardhmen, mendoj që jo.

Në këtë raportin që tani e kemi përpara unë do të doja të flas pak për pjesën e raportit që lidhet me programin e reformës në ekonomi. Një çështje, jashtëzakonisht një fjalë interesante që përmendet këtu është çështja e qasjes së procesit, duke shikuar në aspektin zinxhiror të ndërlikohjes së hallkave të ndryshme në bujqësi dhe ky raport e thotë pikërisht se ka munguar dhe vazhdon të mungojë ideja e qasjes së një mënyre të integruar të shumë faktorëve në lidhje me bujqësinë. Në këtë aspekt, në diskutimet e mëhershme prapë kanë qenë unikë të gjithë. Pra, të gjithë janë unikë që nuk mund të ketë zhvillim të bujqësisë nëse për bujqësinë punohet vetëm një drejtim, por janë shumë hallka, zinxhirë të lidhur mes vete, të cilat do të sillnin në fund një bujqësi të zhvilluar, e hallka e vetme e cila po punohet tash në bujqësi, është ajo e subvencioneve. Pra, na u ka bërë shprehi të shohim kudo subvencione, subvencione në të gjitha anët, e në anën tjetër të mos kemi aspak rezultat e aspak zhvillim pikërisht nga këto subvencione. Kemi komuna ku janë derdhur shumë para në subvencione, ka pasur edhe subvencionim të kafshëve, e kështu me radhë, por numri i fermave është zero.

Të mos harrojmë që nuk mjafton dhe nuk siguron gjë subvencioni, madje përkundrazi, në shumë raste subvencionet nëse nuk janë të lidhura në një proces zinxhiror, ato madje mund të humbin totalisht dhe të mos kenë asnjë efekt të vetëm. Gjithmonë jemi pajtuar që duhet të bëjmë rregullimin e tokës, e kemi miratuar edhe ligjin. Jemi pajtuar që duhet të ketë pika grumbulluese, jemi pajtuar që duhet të ketë industri të përpunimit dhe jemi pajtuar që duhet të ketë mbrojtje të prodhimit, sigurim të tregut nga ana e Qeverisë, pra politika të ndërlikohura, të cilat e mbrojnë bujkun, jo vetëm duke i dhënë atij subvencione, por duke e mbrojtur komplet sistemi shtetëror, duke mbrojtur prodhimin e vendit dhe duke e mbrojtur prodhimin sidomos në bujqësi.

Tash, të gjitha vërejtjet në Raportin e Progresit janë pikërisht vërejtje që lidhen në të gjitha këto hallka, ku shohim shumë qartë që në secilën njeje të këtij zinxhiri, në secilën hallkë të këtij zinxhiri kemi dështim të plotë, madje-madje kemi dështim edhe në pjesën ku flitet edhe për subvencionet, sepse këtu kur bëhet fjalë për subvencionet, tregon shumë qartë që çështja e subvencioneve, në mungesë të stafit, në mungesë të monitorimit të brendshëm, të vlerësimeve të

ndryshme e krejt lë shumë për të dëshiruar në mënyrën se si bëhet ai subvencionim. Të mos harrojmë se kjo mund të ketë edhe kontraproduktivitet, se nëse fillojmë të mendojmë që brenda një zone rurale, pra brenda një fshati disa subvencionohen dhe disa jo, të mos harrojmë se kur shohim padrejtësi në subvencionim dhe subvencionim në baza politike, atëherë në fund do të ketë një demoralizim total në fushën e bujqësisë dhe nuk do të kemi punim fare as të tokës, këtë keni rast ta shihni sot kudo.

Do të doja ta përmend një shembull që në kohën kur ka pasur reciprocitet mes Serbisë dhe Kosovës, asokohe patëm shkuar në vizitë në fabrikën e vajit në Llap, në fshatin Llugë dhe vizita pati ndodhur pak javë pasi që kishte mbaruar reciprociteti dhe pronari i fabrikës thoshte se ne po vazhdojmë të mbijetojmë dhe të jemi stabil pikërisht fal atyre muajve, atyre ditëve të reciprocitetit me Serbinë, se thotë në atë kohë filluam të gjallërohemi dhe, në anën tjetër, fshatarët e zonës filluan të mbjellin luledielli me shpresën që do t'ua marrë produktin ajo fabrikë dhe do t'i përpunojë dhe kësi soji u rrit mundësia që të kemi pikërisht një zhvillim zinxhiror brenda zonës aty. Çka ndodhi?! U hodh poshtë ai reciprocitet, vazhdon të futet malli i Serbisë, vaji i Serbisë me çmim jashtëzakonisht të lirë në Kosovë dhe për pasojë kemi mbylljen e asaj fabrike. Nëse do ta shikonim çështjen e tokave që këtu e përmend shumë qartë çështjen e rregullimit të tokës, është njëra prej nyjave shumë të rëndësishme në zhvillimin e bujqësisë, ligjin të cilin ne e kemi miratuar në vitin 2011 dhe në fuqi është në fillim të vitit 2012. Prej atëherë e deri sot nuk ka asnjë progres në këtë drejtim dhe kjo thuhet qartë edhe në këtë raport.

Po ashtu, është jashtëzakonisht e rëndësishme të përmendet edhe kjo që thotë se “nuk keni pasur fare progres në çështjen e organizimit të një tregu të përbashkët” dhe kjo prapë është një nyje tjetër, e cila mungon si hallkë në komplet zinxhirin e zhvillimit në bujqësi dhe kështu nuk do ta kemi në fakt idenë, që as në raportet e ardhshme të progresit të kemi ndonjë zhvillim apo ndryshim në këtë aspekt. Përmendet po ashtu çështja e inventarizimit dhe ndërlidhjes së Ministrisë së Planifikimit dhe asaj të Bujqësisë, që bën fjalë për mbrojtjen e tokës bujqësore, ta kemi të qartë idenë se sa tokë bujqësore në vit humbim dhe këtu kur flasim nuk duhet ta kemi idenë vetëm sa tokë humbim për shkak se ndërtohet mbi të, por duhet ta kemi edhe idenë se sa tokë tanimë do të humbë për shkak të planifikimeve që janë bërë nëpër komuna, ku komplet planet e reja hapësinore parashohin ndërtime dhe i kanë zgjeruar zonat urbane edhe nëpër toka bujqësore.

Pra, duhet bërë një analizë jo vetëm e ndërtimeve të tanipërtanishme çdo vit, se sa humbim tokë, por duhet ta kemi idenë që në bazë të planeve hapësinore gjatë dhjetë vjetëve të ardhshme, apo pesë vjetëve të ardhshme, sa ata t'i kenë ato plane, do të humbë Kosova tokë bujqësore dhe të merren masa urgjente në këtë aspekt.

Sa i përket çështjes së mjedisit - edhe në çështjen e mjedisit Raporti i Progresit të këtij viti nuk dallon fare prej atij të vitit 2016. Si në bujqësi, që nuk kemi asnjë lloj ndryshimi në Raportin e

Progresit, e njëjta gjë vlen edhe në raportin për mjedis. Po ashtu, te çështja e kontrollit dhe AVUK-ut duhet vetëm të përmend që komplet e njëjta gjë edhe në këtë raportin e vitit 2018 na përsëritet plotësisht dhe së fundmi patëm rastin ta kemi skandalin e mishit. Sikur ta kishim respektuar Raportin e Progresit të vitit 2016 nuk do të kishte ardhur puna te debati që e patëm, se ne po mbajmë debate dhe po pajtohemi në ato debate, që duhet të gjithë së bashku të marrim masa dhe në të gjitha institucionet në nivelet institucionale, si ato komunale, si ato qendrore, inspektoratet e kështu me radhë, të gjithë të marrin masa. I njëjti debat ka ndodhur edhe në raportin e mëhershëm të progresit, të gjithë janë pajtuar, por të kota po janë debatet, meqenëse po na mungon plotësisht veprimi konkret i integruar ndërmjet institucioneve në nivelin qendror, në nivelin lokal, në mënyrë që të kemi progres.

Pra, këtu thuhet shumë qartë, që duhet të transferohen përgjegjësitë e inspektimit tek AVUK-u dhe i njëjti...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYESUESI: Faleminderit! Xhelal, e zure ndërrimin. A dëshiron të flasësh menjëherë, apo pas... Mirë! Zonja Millaku e ka fjalën.

DRITA MILLAKU: Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,  
Po u drejtohem qytetarëve, se vetëm ata janë duke na përcjellë.

Debati i thirrur sot nga Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje për Raportin e Progresit, përveç tjerash, synon edhe të paraqesë te Qeveria vërejtjet dhe kritikën, që në mënyrë të vazhdueshme ia ka bërë, jo vetëm Lëvizja Vetëvendosje, por edhe shoqëria civile.

Meqenëse Qeveria neglizhon të marrë parasysh çka sugjerojnë aktorë të ndryshëm të shoqërisë, sidomos kur ata paraqesin kritika kundrejt Qeverisë, atëherë na lind nevoja të paraqesim këtu në Kuvend në deputetët, ndaj unë sot dua t'i paraqes rekomandimet e përgatitura nga Instituti Demokratik i Kosovës, të cilët janë po ashtu edhe partnerë lokal i Transparency International, që me kohë e shumë shpesh i ka adresuar çështjet e korrupsionit dhe keqfunksionimit të institucioneve, si Qeveria, apo sistemi gjyqësor.

Po ashtu, është mirë të theksojmë se përveç gjetjeve që shënonin në Raportin e Progresit, ne si deputetë, organizatat e Kosovës dhe qytetarët ë përgjithësi e kanë të qartë dhe pareshtur paraqesin shumë prej problemeve që adresoheshin në këtë raport. Raporti për Kosovën i Komisionit Evropian edhe këtë vit ua rikujtoi institucioneve të Kosovës obligimet të cilat duhet t'i përmbushin, në mënyrë që Kosova të shënojë përparim në proceset integruese evropiane. Vlerësimi i përgjithshëm i raportit thekson përparim të ngadalshëm të shtetit në Agjendën e Reformës Evropiane. Sikurse edhe në vitet paraprake, Kosova mbetet në fazën e hershme në



luftimin e korrupsionit dhe krimit të organizuar. Përkitazi me gjetjen e këtij raporti, Instituti Demokratik i Kosovës jep rekomandime për institucionet për përmirësimin e gjendjes në sektorët që bien në fushëveprimtarinë e KDI-së, si në vijim:

- Raporti konfirmon shqetësimet e adresuara paraprakisht nga KDI-ja lidhur me angazhimet e institucioneve në luftën kundër korrupsionit;

- Ligji për parandalimin e konfliktit të interesit, i rishikuar dhe i miratuar rishtazi nga Kuvendi i Kosovës si përpjekje për ta sjellë atë më afër standardeve evropiane, dështoi ta rregullojë çështjen e suspendimit dhe largimit të zyrtarëve publikë të akuzuar për korrupsion;

- Financimi i partive politike dhe shpenzimet e tyre gjatë fushatës vazhdojnë të karakterizohen me nivel të ulët të transparencës, e që lë proceset demokratike të ekspozuara ndaj rreziqeve të mëdha të korrupsionit dhe ndikimeve nga jashtë;

- Publikimet e fundit të raporteve të auditimit të jashtëm të financave të partive politike kanë konfirmuar shkelje të rënda të legjislacionit dhe mangësi të kontrollit financiar;

- Ligji për mbrojtjen e informatorëve ende nuk është në përputhje me skandalet ndërkombëtare, si dhe duhet përmirësuar mekanizmat dhe kërkesat e mbrojtjes së informatorëve si ligj, po ashtu edhe në praktikë;

1. Përfundimi sa më i shpejtë i rasteve të mëdha, siç është rasti stenda, rasti i ish-kryetarit të Lipjanit, Shukri Buja, rasti i ish-kryetarit të Skenderajt, Sami Lushtakut, Arben Gjuka, drejtor i KEK-ut dhe ish-kryesuesi i OSHP-së, Hysni Hoxha, rasti “Toka”, Azem Sylja dhe shumë raste të tjera.

Gjykata Themelore në Prishtinë, si më e madhja në Prishtinë, e ka shumicën e rasteve të shënuara, përfshirë edhe këto raste. Raporti i Progresit për Kosovën për vitin e kaluar ka vendosur si obligim që këto raste duhet të gjykohen dhe të përfundohen, që Kosova të shënojë progres në luftën kundër krimit dhe korrupsionit. Përfundimi i këtyre lëndëve njëherësh është edhe kriter për liberalizimin e vizave. Gjykatat duhet t’u japin prioritet këtyre rasteve dhe atë në afat sa më të shpejtë t’i përfundojnë gjykimet.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës duhet të jenë të gatshëm t’i ndihmojë gjykatat dhe t’i plotësojë çdo kërkesë që ato kanë në rastet e korrupsionit dhe krimit të organizuar. Përfundimi i këtyre rasteve është edhe respektim i të drejtave dhe të drejtave të akuzuarve në këto raste, gjykimi i drejtë dhe në kohë të arsyeshme.

2. Veprimet e menjëhershme që Prokuroria e Shtetit në fillimin e hetimeve apo përfundimeve në rast ku dyshohet për korrupsion, si ndërtimi i autostradave, shitja e KEK-ut, respektivisht Rrjeti i Shpërndarjes, pagesa e penalltive prej 60 milionë eurove të Bechtel&Enkës, dështimi i privatizimit të Postës dhe Telekomit të Kosovës, privatizimi i ndërmarrjeve publike nga Agjencia e Privatizimit të Kosovës dhe të tjera. Ndjekja penale dhe gjykimi i njerëzve të pushtetshëm, të cilët dyshohen për korrupsion dhe krim të organizuar duhet të jetë prioritet i prokurorit të shtetit. Përfundimi i hetimeve nga mbledhja e provave në mënyrë profesionale, si dhe dërgimi para gjykatës së këtyre rasteve do të ndikonte pozitivisht në rritjen e besimit të qytetarëve në luftën e krimit dhe korrupsionit.
3. Prokuroria e Shtetit duhet të kujdeset që të sekuestrojë sa më shumë pasuri nga personat që janë të dyshuar për korrupsion e gjykata, pasi t'i shpallë aktgjykimet, nëse i gjen fajtor atëherë të konfiskojë sa më shumë pasuri të fituar me vepër penale. Konfiskimi i pasurisë është përmendur si dështim i vazhdueshëm i Kosovës në Raportin e Progresit.
4. Dekriminalizimi i Policisë dhe vendosja para përgjegjësisë e të gjithë zyrtarëve të Policisë të përfshirë në korrupsion dhe krim të organizuar me një transparencë të shtuar rasteve, të cilat janë bërë publike në medie.
5. Detyrimi i subjekteve politike që t'i paraqesin raportet profesionale dhe me të dhëna të sakta në lidhje me financimin e tyre me shpenzimet gjatë fushatave zgjedhore.
6. Detyrimi i ndërmarrjeve publike të nivelit qendror e lokal të jenë më transparente dhe më llogaridhënëse përpara publikut.
7. Mbyllja ose bashkimi i disa agjencive të pavarura, të cilat nuk kanë kurrfarë funksionesh pos harxhimit të parasë publike dhe mundësisë për korrupsion.
8. Kuvendi i Kosovës duhet të kujdeset që të depolitizohet institucionin e Organit Shqyrtues të Prokurimit, si dhe Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik, si dhe rekomandimet tjera të dala nga Raporti i Progresit.
9. Institucionet shtetërore duhet të fillojë procesin e vetingut për të gjithë zyrtarët e prokurimit, në të gjitha autoritetet kontraktuese, që shpenzojnë para publike.
10. Zyra Kombëtare e Auditorit duhet të obligohet që ex officio t'i paraqesë para prokurorit të shtetit të gjitha rastet e shkeljeve, të cilat gjenden nga auditorët gjatë auditimit të institucioneve shtetërore.

11. Kodi Penal i Kosovës duhet të parashohë si vepër penale humbjen e parasë dhe pronës publike me qëllim të përfitimit privat të zyrtarëve publikë.

12. Organi Shqyrtues i Prokurimit duhet të obligohet që të gjitha shkeljet të cilat gjejnë gjatë ekzaminimit dhe vendosjes së tenderëve të ndryshëm nga autoritetet kontraktuese apo palët në procedurë, që automatikisht me kallëzim penal së bashku me prova ta paraqesin çështjen në Prokurorinë e Shtetit.

13. Hapja e të gjitha kontratave të pagesave që realizohen me para publike, lejimi i kontrollit të rreptë në procedurat tenderuese, duke e ndryshuar qasjen në vlerësimin e ofertave.

14. Lehtësimi i qasjes në informata për gazetarë, shoqëri civile dhe qytetarë të interesuar dhe

15. E ftojme Agjencinë Kundër Korrupsionit që të mos bëjë propozime për mbylljen e pjesshme të deklaramentit të pasurisë për zyrtarët e lartë, por të merret me forcimin e mekanizmave dhe verifikimin e pasurisë së deklaruar në nxjerrjen e pronave dhe materialet për Prokurimin e Shtetit.

Sigurisht se ka edhe shumë prej këtyre pikave që pajtohet Lëvizja Vetëvendosje, që e ka trajtuar dhe adresuar me kohë, sikundër që ka edhe plotë detaje të tjera, që i adresuan kolegët tanë paraprakisht. Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti Sveçla e ka fjalën.

XHELAL SVEÇLA: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar qytetarë,

Të nderuar deputetë,

Kur po i dëgjoj anëtarët e Qeverisë, e qe besa edhe disa deputetë të pozitës, nuk e kam të qartë a po flasim për të njëjtin dokument apo ndryshe e kuptoj unë gjuhën angleze, e ndryshe ata! Nuk e di si mund të flasim për progres apo përparim, nëse për gati çdo kriter thuhet Kosova është në një fazë të hershme.

19 vjet pas luftës dhe 10 vjet pas shpalljes së pavarësisë, në çdo Raport të Progresit, fraza e përhershme është: Kosova është në një fazë të hershme.

Një çështje mjaft shqetësuese që e përfshin raporti është ndikimi dhe presioni i Listës serbe të komuniteti serb. Duke ditur faktin se Lista serbe është instrument i Beogradit, këtu kemi të bëjmë drejtpërdrejt me presion të Serbisë mbi qytetarët serbë të Kosovës, e që nuk janë në një vijë të drejtë me politikën e tyre. Kjo paraqet shkelje të të drejtave të njeriut.

Në faqen 3 të raportit, pika 1.2, thuhet: Format e frikësimit të kandidatëve të komunitetit serb, të ata që nuk i përkasin Lista serbe është mjaft shqetësuese. A e imagjinoni dot se çfarë reagimesh dhe çfarë pasojash do të kishim sikur ky presion dhe ky ndikim të bëhej nga pala shqiptare? Këtu, përveç mungesës së reagimit, kemi të bëjmë edhe me dështimin e instrumenteve shtetërore të Kosovës në ofrimin e sigurisë dhe mundësisë së konkurrimit të barabartë për pjesëtarët e komunitetit serb.

Lista serbe, përveç që është filial i Beogradit në Kuvend, po del se është e preferuara dhe e privileguara e qarqeve të caktuara shtetërore të Kosovës. Paramendoni, Serbia e imponon Listën serbe, e cila nuk e njeh shtetin e Kosovës, e ajo nëpërmjet kërcënimit i frikëson qytetarët serbë të Kosovës. Besa-besë, shpesh nuk mbetet vetëm në kërcënime dhe ne si Kosovë fajsohemi për dështimin e integritet të pakicës serbe.

Në Raportin e Progresit për Kosovën, në faqen 48, pika 5, kur flitet për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë bëhet vlerësimi i përmbushjes së marrëveshjeve të arritura gjatë procesit të tmerrshëm të dialogut. Këtu qartë theksohet fakti se Serbia është ajo që nuk i respekton marrëveshjet, si marrëveshja për energjinë, marrëveshja për urën e Lumit Ibër e disa marrëveshje tjera.

Në faqen 49, po ashtu pika 5, të marrëveshja për vendkalimet e përbashkëta kufitare apo IBM-i, thuhet qartë se Serbia është ajo që në vazhdimësi u bën obstrukcione ndërtimit të 4 vendkalimeve të përbashkëta, të përhershme, si në vendkalimet Bërnjak, Jarinjë, Konçul dhe Myçibabë, nga 6 sa janë paraparë gjithsej nga këto marrëveshje. Deri këtu qartë theksohet se kush po bën obstrukcione dhe nuk po u përmbahet marrëveshjeve. Mirëpo, për çudi, në faqen e njëjtë, domethënë në faqe 49, i bëhet thirrje Kosovës që të angazhohet më tepër dhe të japë kontribut në normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë. Me fjalë tjera, marrëveshjet nuk i përmbush Serbia, kurse benefitet dhe përafrimin me BE-në i fiton Serbia. E, në anën tjetër, në vazhdimësi kërkohen koncesione shtesë nga Kosova.

Nëse ia bëjmë një analizë, ose bëjmë një krahasim me raportet e mëhershme, konkretisht të viteve 2014, 2015 dhe 2016, ajo që lehtë mund të konstatojmë është fakti që vazhdimisht na përsëritet e njëjta, për sa i takon dialogut, energjia, Ura e Mitrovicës, Telekomit, pikat kufitare. Shumë energji e shpenzuar në dialog, shumë mund e shumë koncesione, Serbia gjithnjë e më afër integriteteve evropiane e për Kosovën, e qytetarët e saj as edhe një të mirë në horizont. Kosova dhe dialogu po shërbejnë si trampolinë e Serbisë drejt integriteteve evropiane.

Në faqen 74, pika 6.25, të kontrollit financiar, raporti fillon me shprehjen: Kosova është në një fazë të hershme në rrafshin e kontrollit financiar.

Deputetë të pranishëm,

Është shqetësues fakti që saktësisht me të njëjtën fjali fillon edhe raporti i vitit 2016. Veç numri i pikës ndryshon. Në raportin e vitit 2016, përsëri për çështjen e kontrollit financiar janë dhënë disa rekomandime, se çfarë duhet të bëjnë institucionet e vendit me qëllim të progresit në këtë fushë. Pra, janë dhënë rekomandime të caktuara, si: implementimi i aktiviteteve të përcaktuara në strategjinë e kontrollit të brendshëm financiar 2015/2017; miratimi i Ligjit të kontrollit të brendshëm financiar të financave publike; si dhe ndjekja sistematike e rekomandimit të auditimit të jashtëm nga Kuvendi dhe të audituarit. Me këto rekomandime nuk është kërkuar asnjë shpikje apo zbulim, thjesht është kërkuar realizim i këtyre rekomandimeve.

Është me të vërtetë shumë dëshpëruese që në raportin e ri, pra të vitit 2018, konstatohet se rekomandimet e vitit 2016 të Komisionit nuk janë përmbushur. Për dy vjet, tri rekomandime, pra tri detyra të përshkruara qartë dhe asnjë përparim. Është e qartë se titulli i këtij dokumenti nuk korrespondon me realitetin në Kosovë, më shumë i përshtatet titulli “Raporti i regresit...” e në rastin më të mirë “Raporti i stagnimit të disa pika”.

Për përfundim, kur ne në Parlament votojmë për Komision Hetimor Parlamentar lidhur me kidnapimin e gjashtë shtetasve turq, njëri nga aktorët kryesorë të këtij kidnapimi promovohet në detyrë, e zëvendëson bashkëpunëtorin në këtë veprim katastrofal për Kosovën dhe marrëdhëniet e saj me të tjerët. Me këtë hap, Hashim Thaçi dëshiron t’i dërgojë mesazh këtij Parlamenti se pavarësisht dështimeve e dëmeve që ky i bën Kosovës, ai është i paprekshëm. Gabim e ka! Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Ramadani e ka fjalën. S’është këtu. Zonja Bogujevci, urdhëro!

SARANDA BOGUJEVCI: Faleminderit, kryesues!

Të dashur qytetarë,

Të nderuar deputetë,

Vetëm dua ta paraqes një përmbledhje me të gjeturat e Raportit të Progresit që lidhet me të drejtat e fëmijëve, që është prezantuar nga koalicioni i OJQ-ve për mbrojtjen e fëmijëve. Kjo gjithashtu lidhet edhe me disa procedura brenda Rregullores së Kuvendit sa u përket projektligjeve që vijnë në komisionet apo në Kuvend, ku lidhet direkt me Projektligjin për mbrojtjen e fëmijëve, i cili është punuar dhe përfunduar në legjislaturën e kaluar, por për shkak të procedurave është kthyer mbrapa në Qeveri dhe ende nuk ka ardhur në Kuvend për miratim të këtij projektligji, gjë që ka ndikim të drejtpërdrejtë te një pjesë e shoqërisë, që kur po flasim për çështjen e fëmijëve shumë procedura nuk janë duke u mundësuar të ecin përpara për shkak të ligjit.

Sa u përket të drejtave të fëmijëve, raporti vë në pah se korniza ligjore e Kosovës është kryesisht në përputhje me standardet ndërkombëtare, por zbatimi mbetet i përkufizuar. Aktualisht është

duke u hartuar Ligji për mbrojtjen e fëmijëve. Autoritetet duhet të sigurojnë që ligji të përcillet me një buxhet të përshtatshëm dhe me këtë pronësinë institucionale. Mbrojtja dhe menaxhimi i të dhënave mbetet një sfidë për shumë çështje që lidhen me fëmijët. Puna e fëmijëve vazhdon të jetë shqetësuese. Me rreth 11% të fëmijëve të përfshirë në punë me përqindje më të lartë në mesin e komuniteteve romë dhe shkali, kjo përqindje rritet në 17%.

Ky shpesh çon në ekspozimin e tyre ndaj formave të ndryshme të dhunës, megjithatë mungojnë të dhënat. Inspektorati i Punës e ka identifikuar dhe ka trajtuar vetëm një rast të fëmijës të angazhuar në punë gjatë periudhës raportuese. Duhet të bëhen përpjekje për parandalimin e martesave të fëmijëve, sidomos të vajzave. Përpjekjet për t'i parandaluar të gjitha format e dhunës ndaj fëmijëve janë të pamjaftueshme dhe korniza ligjore nuk e ndalon në mënyrë eksplicite ndëshkimin trupor. Strehimi familjar duhet të shtrihet në të gjitha komunat. Qendra e re edukative korrektuese, e inauguruar në shtator 2017, duhet të ndihmojë në ofrimin e mundësive të mëtejme për të miturit në konflikt me ligjin. Fëmijët me aftësi të kufizuara përballen me kufizime të të drejtave të tyre, posaçërisht qasjes në arsim dhe qasjes në shërbimet adekuate të ndryshme.

Institucionet duhet ta rritin mbështetjen financiare për qendrat ditore për rehabilitim dhe të bëjnë më shumë përpjekje për t'i integruar në mënyrë efektive fëmijët me aftësi të kufizuara në institucionet arsimore.

Për përfshirjen dhe mbrojtjen sociale, raporti rekomandon që Kosova duhet të sigurojë që komunat të kenë burime të mjaftueshme për të ofruar shërbime sociale, që bie në përgjegjësinë e tyre. Për mbrojtjen sociale, që nga viti 2009 fondet e mirëqenies sociale janë ndarë nëpërmjet grantit të përgjithshëm pa ndonjë përcaktim për buxhetin komunal të disponueshëm për shërbimet sociale. Një dispozitë që përcakton fonde specifike nga granti i përgjithshëm për shërbime sociale duhet të përfshihet në projektligjin e ardhshëm për financat e pushtetit lokal.

Sa i përket shëndetit publik, Kosova ka hartuar disa udhëzime administrative dhe një strategji komunikimi në mbështetje të Ligjit për sigurimin shëndetësor. Por, zbatimi i tij mbetet i ngadalshëm dhe është punuar më tej, pasi fillimi i mbledhjes së premiumeve është shtyrë deri në fund të vitit 2018. Rreth 30% e popullsisë së Kosovës nuk mund të marrin shërbime shëndetësore për shkak të varfërisë ekstreme. Shpenzimet e ulëta publike për shëndetin mbeten një shqetësim. Për pabarazitë në sistemin shëndetësor, Kosova momentalisht nuk siguron sigurime shëndetësore të përgjithshme dhe për këtë arsye shpenzimet private nga xhepi për shërbime shëndetësore mbeten të larta.

Vlerësohet se pothuajse 1/3-a e popullsisë nuk ka qasje të lehtë në shërbimet e kujdesit shëndetësor, ose kanë qasje të kufizuara për shkak të mungesës së fondeve dhe se 18% e popullatës për arsye ekonomike nuk kërkojnë shërbime mjekësore në raste të sëmundjeve.

Lidhur me imunizimin, mbulimi i komuniteteve rom dhe ashkali mbetet shqetësim, ku vetëm 3 në dhjetë fëmijë janë plotësisht të imunizuar.

Vetëm 18% e fëmijëve të moshës zero deri në pesë vjeç janë të përfshirë në institucionet e licencuara të parashkollimit. Regjistrimi i ulët i fëmijëve në nivel parashkollor mbetet shqetësim dhe Kosova duhet ta rrisë numrin e objekteve për kujdesin ndaj fëmijëve.

Cilësia e arsimit vazhdon të jetë një sfidë në të gjitha nivelet sipas vlerësimit të programit për vlerësimin ndërkombëtar të nxënësve PISA. Në vitin 2015, Kosova renditet e treta nga fundi i listës së mbi 70 sisteme të testuara.

Nevojiten më shumë përpjekje për të siguruar qasje në arsimin cilësor për fëmijët me aftësi të kufizuara.

Dhe, duhet të trajtohen më shumë mësues dhe asistentë. Duhet të ndërmerret masa për ta adresuar shkallën e lartë të braktisjes së shkollës nga fëmijët romë dhe ashkalinj. Rritja e pjesëmarrjes së tyre në institucionet parashkollore do ta përmirësonte ndjeshëm pjesëmarrjen dhe suksesin e tyre në shkollimin e mëvonshëm.

Pra, duhet që sa më shpejt që të jetë e mundur Qeveria ta dorëzojë Projektligjin për mbrojtjen e fëmijëve që të gjejë zbatim dhe të punojmë më shumë që sidomos fëmijët nga komunitetet joshumicë, të cilët janë më të diskriminuar në shoqëri, të trajtohen dhe ta kenë arsimin e duhur, por edhe çështjet që u përmendën në bazë të rekomandimeve të raportit. Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti Adem Mikullovc i ka fjalën.

ADEM MIKULLOVCI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Deputetë të nderuar,

Të ju them të drejtën, goxha me një hamendje dhe me një zhgënjim desha t' i them edhe unë disa fjalë për këtë raport.

E quajten raport të progresit dhe të regresit, më e mira do të kishte qenë, të ju them të drejtën, që këtë raport ta marrim dhe ta hedhim poshtë dhe të mos e pranojmë kurrësi, të mos e votojmë, sepse është i përpiluar keq, amatoresk, por e keqja është që, megjithatë, ky raport është pasqyrë e gjithë atyre ngjarjeve që kanë ndodhur e vendimeve që janë marrë gjatë vitit 2017. Kjo është e dhimbshme.

Megjithatë, ky raport e thotë të vërtetën. Është zhgënjyese, të ju them të drejtën, që gjatë gjithë ditës po i dëgjoj kolegët e mi secilin duke dhënë vërejtje e duke u ankuar dhe duke e kritikuar këtë raport. Dhe, për kë po flasim ne? Për vesh të shurdhër!

Unë personalisht nuk dua të ju flas për importin dhe eksportin. Nuk dua të ju flas për zhvillimin ekonomik, as për vendimet juridiko-ekonomike-politike, që janë ndërmarrë në këtë vend. Nuk dua të flas as për arsimin, as për shëndetësinë, se folën të gjithë, por dua të ndalem me pak fjalë shumë shkurt për kulturën dhe artin.

Si duket, për këtë Qeveri, për qeverinë e kaluar me të vërtetë, po në këtë raport, arti dhe kultura janë si të them cikërrima me të cilat s' duhet të merret njeriu fare, ashtu si edhe nuk janë marrë.

A e dinë këta njerëz që e kanë përpiluar këtë raport që është dashur të hyjnë në detaje për krijimtarinë individuale dhe krijimtarinë kolektive? A e dinë këta njerëz që krijues individual është shkrimtari, piktori, kompozitori, ndërsa kolektiv është teatri, baleti, opera, ansambli, biblioteka, televizionet, programet e ndryshme e tjera e tjera.

Aq pak ka për kulturë dhe artin këtu, sa që nuk vlen as të shfletohet fare. Pak e ka cekur trashëgiminë kulturore dhe aty e përziën vetëm Kishën serbe dhe Hoçën e Madhe, si të ruhen si monumente historike e tjera e tjera. Ndërsa monumente tjera historike, as që përmenden fare.

Posaçërisht kisha për ta përmendur kah fundi edhe çështjen e RTK-së, Radiotelevizionin e Kosovës. Raporti e përmend Televizionin e Kosovës vetëm si një problem financiar dhe vërtet është qesharake dhe e dhimbshme që 18 vjet asnjë legjislacion i Kuvendit nuk po mund ta zgjidhë problemin e RTK-së.

Tash është duke u përpiluar një ligj, e ta shohim çfarë do të na thotë ai ligj.

Unë dua vetëm ta them këtë - ai televizion është i themeluar nga Kuvendi, është organ i Kuvendit, është zëvendës i Kuvendit, është televizion shtetëror dhe Kuvendi duhet ta financojë dhe të merret me të.

A e dinë këta njerëz që e kanë bërë këtë raport që duhet të hyjnë edhe në detaje? A e dinë që përpara drejtorët e teatrove i ka zgjedhur Kuvendi, e jo një ministër, dhe kanë qenë njerëzit më të njohur të letërsisë, Hasan Mekuli, Ramiz Kelmendi, Azem Shkreli, emra të njerëzve që sot e kësaj dite janë nëpër librat shkollorë, nëpër biblioteka. E sot, ministri, herë e heq një drejtor, e vë një tjetër, po ju them një cirkushane, një mozemakeq. Dhe, po e përsëris, si duket nëse është ky raport pasqyrë e ngjarjeve të vërteta 2017, atëherë më lejoni ta përfundoj me vargjet "lakuriq dhe i dregosur, trup e shpirt i sakatosur". Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Mikullovc! Konsideroj që debati ka përfunduar. Zonja Pacolli e ka fjalën për rekomandime, kuorum ashtu-kështu s'kemi, por rekomandimet do t'i hedhim në seancën e ardhshme për t'u miratuar. Fjalën e keni, zonja Pacolli!



FITORE PACOLLI: Faleminderit!

të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Ky debat është thirrur me iniciativë të Lëvizjes Vetëvendosje, pra nga Lëvizja Vetëvendosje dhe është përkrahur nga Lidhja Demokratike e Kosovës dhe nga deputetët e grupeve tjera, si deputeti Salih Salihu dhe Nait Hasani.

Këtë debat e kemi thirrur për shkak se konsiderojmë që raporti është shumë i rëndësishëm për Kosovën dhe se duhet të diskutohet menjëherë pasi të publikohet. Po ashtu, mendojmë që ky raport duhet të diskutohet në Kuvend, përderisa Qeveria e ka filluar diskutimin dhe po i transmeton të gjeturat e këtij raporti në gjuhën e saj, pra pa ofruar përkthimin zyrtar për qytetarët e Kosovës. Dhe, ne, nëpërmjet këtij debati ua dhamë mundësinë qytetarëve të Republikës së Kosovës që të kuptojnë më qartë dhe drejtë nga përfaqësuesit e tyre se çfarë përmban raporti.

Prandaj, konkludimet e mëhershme se ishte nxitim që ky debat të thirret në Kuvend dhe që deputetët nuk kanë pasur mundësi ta lexojnë dhe ta kuptojnë raportin, mua më vjen keq për deputetët, të cilët nuk kanë pasur mundësi për shkak se nuk e kuptojnë gjuhën angleze, por nuk duhet të fajësohemi ne, sepse për këtë gjë duhet të fajësohet ministria përkatëse.

Të gjitha shtetet kur marrin raporte apo dokumente shumë të rëndësishme, sikur ky, punën e parë që e bëjnë është që ta përkthejnë në gjuhët zyrtare të vendit. Pra, përderisa ky raport nuk është përkthyer në gjuhët zyrtare të vendit, Qeveria ka vazhduar të mbajë konferenca të gjata për t'i transmetuar të gjeturat e këtij raporti. Pra, diskutimi po ashtu është i rëndësishëm në Kuvend, sepse ju e dëgjuat që kryeministri tha se i kanë përpiluar dy dokumente, dokumenti i parë me përmbledhjen e raportit dhe dokumenti i dytë me sfidat. Atëherë, kjo ishte një mundësi që edhe ne si përfaqësues të popullit t'ia japim rekomandimet dhe mendimet tona Qeverisë që ata t'i përfshijnë në dokumentet e tyre, të cilat i përmendi dhe kryeministri.

Po ashtu, u tha se ky diskutim do të shkojë pa vëmendje nga deputetët dhe nga Qeveria. Mua më duhet t'ua bëj të qartë qytetarëve, të cilët na kanë përcjellë gjatë gjithë kohës, se kjo nuk është hera e parë kur Qeveria e bojkoton seancën, pra askush nga qeveria nuk merr pjesë as në debate parlamentare dhe as në seanca të rëndësishme për vendin dhe të njëjtën gjë e bëjnë edhe disa deputetë të këtij Kuvendi.

Prandaj, ky debat nuk ishte nxitim, por ishte diçka që duhej ta bënim dhe kemi përgjegjësi ta bëjmë. Debatit rreth këtij raporti vetëm sa ka filluar, nuk do të përfundojë sot, nuk përfundon as nesër, as muajin që vjen, por do të vazhdojë të debatohet sa herë që është nevoja. Ne deputetët e Lëvizjes Vetëvendosje, në koordinim me deputetët e Lidhjes Demokratike, i kemi përpiluar rekomandimet, të cilat tani do t'i prezantoj:

## R e k o m a n d i m e t

1. Të fillojmë një dialog të brendshëm për të ndërtuar një strategji shtetërore për rrugën që duhet të ndjekim drejt integritit evropian.
2. Qeveria brenda 30 ditësh duhet të përcjellë në Kuvend një plan të veprimit për të adresuar të gjeturat në raportin e vendit.
3. Hapa urgjentë në departizimin e Administratës Publike, duke filluar me bordet e ndërmarrjeve dhe agjencive publike.
4. Në përputhje me kriteret e kapitujve 23 dhe 24, të hartohet plani aksionar për sundimin e ligjit dhe forcimin e sundimit të ligjit, si dhe plotësimi i legjislacionit me miratimin e ligjeve antimafia dhe konfiskimin e pasurisë së paligjshme.
5. Krijimi i vendeve të reja të punës përmes investimeve direkte në zhvillimin e prodhuesve vendorë, duke u pasuar me miratimin dhe zbatimin e Ligjit për mbrojtjen e prodhimeve vendore për të ndikuar në uljen e papunësisë në vend.
6. Qeveria obligohet që të bëjë sigurime shëndetësore për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës, në mënyrë që asnjë qytetar të mos mbetet pa shërbim shëndetësor primar.
7. Investime në hapjen e çerdheve të nevojshme nëpër komuna dhe investimi në shkolla profesionale dhe ndërlidhja e tyre me nevojat e tregut vendor dhe ndërkombëtar.
8. Kërkohet ta kemi një plan të veprimit për vendosjen e raporteve të mira me pesë shtetet e BE-së, të cilat nuk e kanë njohur Kosovën.
9. Plan veprimi për thellimin e marrëdhënieve bilaterale me të gjitha shtetet e BE-së, të cilat e kanë njohur Kosovën.
10. Pastrimi i listave nga personat që kanë bërë deklaram të rrejshëm për ta fituar padrejtësisht këtë status, si dhe plotësim-ndryshimi i Ligjit për veteranët e Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.
11. Hartimi i një plani të detajuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, me të cilin kërkon nga Qeveria që në çdo periudhë gjashtëmujore të raportojë për realizimin e këtyre rekomandimeve. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë me kaq e përfundojmë seancën e sotme. Mirupafshim në seancën e ardhshme!

\* \* \*

*E enjte, më 31 maj 2018*

*Vazhdimi i mbledhjes së jashtëzakonshme, e filluar më 20 prill dhe 31 maj 2018*

*Mbledhjen e drejton nënkryetari i Kuvendit, z. Kujtim Shala.*

KRYESUESI:

***1. Votimi i rekomandimeve nga debati parlamentar në lidhje me Raportin e Progresit për Republikën e Kosovës***

Në sallë janë 76 deputetë, Po, urdhëro Fitore!

FITORE PACOLLI: Të nderuar deputetë,

Pas debatit të mbajtur më 20 prill të këtij viti lidhur me Raportin e Progresit, Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje në harmonizim të plotë me Grupin Parlamentar të LDK-së kemi propozuar këto pika, të cilat duhet të përkrahen dhe të votohen sot:

1. Të fillojmë një dialog të brendshëm për të ndërtuar një strategji shtetërore për rrugën që duhet të ndjekim drejt integritimit evropian.
2. Obligohet Qeveria që brenda 30 ditëve të sjellë në Kuvend një plan të veprimit për të adresuar të gjeturat në Raportin për vendin.
3. Urgjentisht të merren hapa për departizimin e administratës publike, duke filluar me bordet e ndërmarrjeve dhe agjencive publike.
4. Në përputhje me kapitujt 23 dhe 24, të hartohet plani aksional për sundimin e ligjit dhe forcimin e sundimit të ligjit, si dhe plotësimi i legjislacionit me miratimin e ligjeve antimafia dhe konfiskimet e pasurisë së paligjshme.
5. Krijimi i vendeve të reja të punës përmes investimeve direkt në zhvillimin e prodhuesve vendorë, duke u pasuruar me miratimin dhe zbatimin e Ligjit për mbrojtjen e prodhimeve vendore për të ndikuar në uljen e papunësisë në vend.
6. Sigurime shëndetësore për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës që asnjë qytetar të mos mbetet pa shërbim shëndetësor.
7. Investime në hapjen e çerdheve të nevojshme nëpër komuna dhe investime në shkolla profesionale dhe ndërlidhjen e tyre me nevoja të tregut vendor dhe ndërkombëtar.

8. Plan të veprimit për vendosjen e raporteve të mira me pesë shtete të BE-së, të cilat ende nuk e kanë njohur Kosovën.

9. Plan të veprimit për thellimin e marrëdhënieve bilaterale me të gjitha shtetet e BE-së, të cilat e kanë njohur Kosovën.

10. Pastrimin e listave të veteranëve nga personat, të cilët kanë bërë deklaram të rrejshëm për të fituar padrejtësisht këtë status si dhe plotësimin e ndryshimin e Ligjit për veteranët e Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

11. Hartimi i një plani të detajuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, përmes të cili Kuvendi kërkon nga Qeveria që të raportojë çdo gjashtë muaj për realizimin e rekomandimeve.

Atëherë, lus të gjithë deputetët që të përkrahin këtë rezolutë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në sallë janë 70 deputetë. Shefi i Grupit Parlamentar të PDK-së, zoti Memli Krasniqi, e ka kërkuar fjalën.

MEMLI KRASNIQI: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

Të nderuar deputetë,

Besoj që sipas praktikës do të ishte mirë që edhe rezolutat, edhe rekomandimet fillimisht të harmonizohen, ose të paktën të ketë një tentim për t'u harmonizuar, para se të vendosen për votim. Në lidhje me projekt-rezolutën e lexuar, ne nuk kemi qenë të informuar, s'ka qenë asnjë përfaqësues i Grupit Parlamentar të PDK-së pjesë e harmonizimit apo çfarëdo takimi për këtë çështje, andaj unë do të propozoja që fillimisht të ketë ndonjë takim, qysh e kemi bërë për të gjitha rastet e tjera deri tash, para se të shkohet në votim.

Përndryshe, unë mund t'ju them që ne s'mund të marrim pjesë në votim, sepse është njëfarë imponimi i njëanshëm për një çështje tepër të rëndësishme dhe për rekomandimet, të cilat do të duhej të ishin edhe obliguese për Qeverinë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fitore Pacolli-Dalipi, urdhëro për një sqarim.

FITORE PACOLLI-DALIPI: Vetëm sa për sqarim, ne atë ditë kur kemi diskutuar në Kuvend, në fund të seancës kanë mbetur vetëm deputetët e Lidhjes Demokratike dhe deputetët e Lëvizjes. Ne kemi ftuar ata qysh në fillim të seancës, të gjitha partitë që të kontribuojnë, të sjellin rekomandimet e tyre, mirëpo ne ende mbesim të hapur që edhe partitë e tjera të sjellin rekomandimet e tyre, të cilat mund t'i fusin në këtë rezolutë dhe t'i harmonizojmë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Muharrem Nitaj, urdhëro!

MUHARREM NITAJ: I nderuar kryesues i seancës!

Nuk është e vërtetë që në fund kanë ngelur vetëm deputetët e Lidhjes Demokratike dhe të Vetëvendosjes, ka pasur edhe deputetë të tjerë. Ndërkaq, rekomandimet përfshijnë një gamë shumë të gjerë që është përtej propozim-rezolutës nga debati parlamentar në lidhje me Raportin e Progresit, që nga sigurimet shëndetësore deri te veteranët. Nuk ka pasur përpjekje për harmonizimin e rekomandimeve, kështu që as deputetët e Aleancës nuk do të marrin pjesë në votim, në këtë situatë që është aktualisht.

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka kërkuar edhe shefi i Grupit Parlamentar të Nismës, zoti Bilall Sherifi.

BILALL SHERIFI: Faleminderit, kryesues!

Deri më tani ka pasur një praktikë që pas debateve janë ulur përfaqësuesit e grupeve dhe së bashku i kanë harmonizuar qëndrimet, rekomandimet. Tash po na del një praktikë e re, shikoni, ne i kemi rekomandimet, kush ka diçka le të na i dërgojë, pastaj nëse na hyn në punë e marrim, nëse s'na hyn, nuk e marrim. Mendoj që kjo nuk është praktikë që shkon drejt unifikimit të qëndrimeve, sidomos kur kërkohet vota për çështje të tilla, e të gjithë deputetëve apo të gjitha grupeve parlamentare.

Mendoj që nëse ka vullnet që kjo çështje të shndërrohet në një çështje të të gjithë deputetëve, të të gjitha grupeve parlamentare, atëherë do të ishte mirë të ndiqet e njëjta praktikë që përfaqësuesit e grupeve të ulen së bashku të harmonizojnë qëndrimet në mënyrë reciproke. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka kërkuar edhe deputeti Armend Zemaj. Urdhëro, Armend!

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, nënkryetar!

Po, është e vërtetë që ka qenë një numër i vogël i deputetëve në fund të seancës, ashtu siç e potencoi edhe zoti Nitaj, sepse ka qenë ndoshta i vetmi pothuajse nga mazhoranca. Ne i kemi deleguar propozim-rekomandimet tona, sugjerimet në dakordim ashtu siç mblidhen në fund të seancës. Më tutje, sigurisht që e potencoi edhe kolegja që jemi të hapur nëse ka diçka që mund ta plotësojë apo edhe ta kundërshtojë, besoj që edhe një 10-minutësh do të ishte një dakordim i plotë dhe ta ruajmë praktikën e mirë.

KRYESUESI: Faleminderit! Blerta Deliu-Kodra e ka fjalën.

BLERTA DELIU-KODRA: Faleminderit, zoti Kujtim!

Atëherë, po, është e vërtetë atë që e tha edhe shefi i Grupit Parlamentar, Partia Demokratike e Kosovës as që është kontaktuar lidhur me rekomandimet për propozim-rezolutën rreth Raportit të

Progresit për Republikën e Kosovës. Unë e kam përfaqësuar Partinë Demokratike në këtë debat dhe po ashtu, ne si Komision për Integritetë unanimisht kemi vendosur që të kërkojmë që ky raport të diskutohet në njërin prej seancave të Kuvendit, prandaj pajtohem me atë që u tha që për herë të parë po ndodh që praktikat parlamentare të selektohen dhe të ftohen disa përfaqësues të partive politike dhe disa të tjerë të mos ftohen fare dhe kjo mendoj që nuk i bën mirë procesit, e veçanërisht procesit të integritetit evropian, Raportit të Progresit, ku në radhë të parë kërkohet që ne të kemi një unifikim dhe një konsensus lidhur me çështjet që janë diskutuar në seancë.

KRYESUESI: Faleminderit! Tani fjalën e ka deputeti Ilir Deda dhe s'ka kolegë të tjerë të paraqitur. Urdhëro, Ilir!

ILIR DEDA: Unë mendoj që nuk është mirë të vazhdojmë me procedim të votimit të rezolutës pa e harmonizuar të gjitha grupet parlamentare, sepse ky Kuvend, i cili ka marrë përgjegjësi dhe ku të gjithë jemi për zbatim të Raportit të Progresit, nuk mund të dështojë në votim sa u përket rekomandimeve, të cilat janë faktikisht të lidhura me Raportin e Progresit. Unë vetëm kisha kërkuar prej kolegëve të tjerë që të rikthehen në diskutim të propozimeve për këtë rezolutë dhe që kjo të kalojë njëzëri, që të mos jetë tash peng kualiteti i mungesës së komunikimit. Faleminderit!

KRYESUESI: Përfundimisht, në emër të propozuesit, Fitore Pacolli-Dalipi e ka fjalën. Fitore, të lus që të jesh sa më konkrete, që të japësh një zgjidhje për këtë.

FITORE PACOLLI-DALIPI: Së pari, nuk ka pasur grupe të caktuara, të cilat jemi mbledhur, pra selektim të njerëzve me të cilët kemi diskutuar. Kemi diskutuar me deputetët, me grupet parlamentare që kanë të pranishme në seancë, pra kanë qenë vetëm deputetët e LDK-së dhe të Vetëvendosjes ata të cilët kanë marrë pjesë deri në fund të kësaj seance dhe nuk ka pasur interesim nga partitë e tjera. Pra, ne prapë mbesim të hapur, unë kërkoj disa minuta pauzë që të bëjmë harmonizimin e kësaj rezolute me grupet e tjera dhe të vazhdojmë tutje.

KRYESUESI: Faleminderit! Propozimi është konkret, por tani janë paraqitur edhe kolegë të tjerë, meqë disa folën, kanë të drejtë të flasin të gjithë ata që dëshirojnë. Fjalën e ka deputeti Arben Gashi.

ARBEN GASHI: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

Mendoj se nuk ka nevojë të ndërpritet seanca, nga një përfaqësues prej secilit grup mund të shkojë ta negociojnë këtë çështje. Në emër të grupit parlamentar mund të shkojë ose Iliri, ose Armendi dhe vazhdojmë, nuk kemi nevojë ta ndërpresim seancën për disa minuta. Unë pashë vullnet pozitiv edhe prej partive të partnerëve të koalicionit, edhe ata e propozojnë nga një përfaqësues dhe kur të harmonizohet teksti, e nxjerrin në votim dhe e kryejmë këtë punë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, Arben! Tani fjalën ia jap deputetes Ganimete Musliu.

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, nënkryetar!

I nderuari kryeministër,

Të nderuara kolege dhe ju kolegë deputetë,

Kabinet qeveritar,

Unë mendoj që nuk është etike të thuhet që s'ka qenë kurrkush prej partive të tjera në sallë atë ditë kur ka përfunduar debati. Sepse, e them me kompetencë të plotë se kemi qenë këtu. Prandaj, është mirë që të mos manipulohet me opinionin, të pranohet gabimi që e ka bërë, në mënyrë të njëanshme i ka nxjerrë ato rekomandime, le të kërkojë të dalin të konsultohen dhe të mos na mbajnë moral se kush ka qenë dhe kush s'ka qenë atë ditë në seancë.

Unë mendoj që nuk duhet të ndërpritet seanca, sepse kemi humbur edhe ashtu mjaft kohë, por thjesht le të vazhdojmë me një pikë tjetër të rendit të ditës derisa ata të dakordohen për ato rekomandime, të cilat ajo i propozoi, apo që të ketë edhe rekomandime shtesë.

KRYESUESI: Faleminderit! Sipas radhës, fjalën ia jep deputetes Vjosa Osmani-Sadriu.

VJOSA OSMANI-SADRIU: Faleminderit, zoti kryesues!

Dy-tri çështje, e para ju kisha lutur që gjatë harmonizimit të tekstit final ta keni parasysh që termi "Raport i Progresit" nuk përdoret më, ka dy vjet. Pra, të përdoret termi i saktë "Raport për vendin". E dyta, po shpresoj që Qeveria mund ta sqarojë në qoftë se dy nga strategjitë që u përmendën aty tashmë ndoshta veç janë të gatshme, së paku nga ajo që kemi dëgjuar nga ministrja e Integritimit Evropian. Do të ishte mirë që të sqarohet sot ose nga kryeministri ose nga ministri i Drejtësisë, e kam fjalën për strategjinë që ka të bëjë me sundimin e ligjit dhe, po ashtu, strategjia apo plani i veprimit që ka të bëjë me zbatimin e çështjeve që dalin nga Raporti për vendin.

Ministrja Hoxha ka deklaruar se janë në proces të përfundimit të këtyre dy dokumenteve, por do të ishte mirë që vetë Qeveria të deklarohet për këtë temë. Dhe, e treta është për keqardhje që përderisa dëgjuam një pikë nga këto rekomandime të thotë që duhet të depolitizohen bordet, ishin pikërisht propozuesit e kësaj rezolute që sot nëpërmjet pjesëmarrjes në votim ndihmuan që të bëhet pikërisht kjo, pra politizimi i Bordit të AKP-së. Nuk ka rëndësi vota kundër, mospjesëmarrja në votim sot do të parandalonte politizimin e atij bordi, por nëpërmjet pjesëmarrjes në votim, ndihmuan fatkeqësisht Qeverinë që të realizonte pikërisht politizimin e një prej bordeve më të rëndësishme që ka të bëjë me një proces kyç për Kosovën. Kaq!

KRYESUESI: Faleminderit! Memli Krasniqi e ka kërkuar fjalën edhe një herë, në emër të grupit.

MEMLI KRASNIQI: Faleminderit, zoti kryesues!

Unë e fillova këtë debat, besoj, në mënyrë shumë korrekte, duke thënë që as që kemi qenë të informuar dhe as që kemi qenë të kontaktuar dhe është kundër çdo praktike parlamentare të këtij Kuvendi, besa edhe të kësaj legjislature, ndoshta, në veçanti për sa u përket rekomandimeve dhe rezolutave, të cilat deri tash zakonisht bile kemi arritur për të mirë t'i dakordojmë dhe t'i unifikojmë të gjitha grupet parlamentare.

Tash, këtu janë dy mundësi: ose duhet të mundohemi të merremi vesh, sepse s'është e domosdoshme të pajtohemi për secilën fjalë, nuk ndodh gjithmonë, ose mund të votojmë kundër. Unë mendoj që s'është e drejtë të votohet kundër një rezolute, e cila i adreson gjetjet e Raportit për vendin, të cilat janë relevante jo vetëm për Qeverinë, por për të gjitha institucionet, duke përfshirë edhe këtë Kuvend. Qasja do të duhej të ishte më pak arrogante edhe nga propozuesi, të mos ketë asi kualifikimesh se s'ka pasur interesim, sepse s'është e vërtetë, tek e fundit. Ne, në mënyrë shumë korrekte, po besoj, po kërkojmë të mos votohet tash, por të shtyhet për fund të rendit të ditës të këtij vazhdimi të sotëm të seancave të kaluara, me përpjekjen në ndërkohë për të arritur një pajtueshmëri përfaqësuesit e të gjitha grupeve parlamentare. Praktika e dërgimit të emailit dhe të thuhet këto janë rekomandimet, a keni të shtoni diçka, nuk është praktikë e dakordimit, ajo është praktikë e imponimit. Ajo është të mos duash të kryesh punë. Nëse duam të kryejmë punë, të arrijmë një pajtueshmëri, si gjithmonë, ne e caktojmë secili, e kemi pasur të përcaktuar edhe atë ditë në debat kush e përfaqëson, kush flet në emër të grupeve parlamentare, mund të takohen në një nga sallat si zakonisht, të bëjmë përpjekje për të ardhur me një tekst të përbashkët, të cilin pastaj mund ta vendosim në votim. Kjo besoj, sa i dëgjova edhe disa prej kolegëve nga grupet e tjera parlamentare, është e pranueshme, kështu që do të ishte mirë në mënyrë që të shkojmë me një votim të suksesshëm, përndryshe ne edhe mund të votojmë ndryshe. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Tani fjalën e kanë kërkuar edhe dy kolegë, unë natyrisht që duhet t'ua jap fjalën, por po më duket si situatë është e qartë, propozuesja është gati të diskutojë për përmbajtjen e tekstit, unë mendoj që do të mund të vepronin si në rastin e një mocioni që grupet parlamentare të dërgojnë përfaqësuesit dhe të tentojnë të harmonizojnë tekstin. Nëse jo, prapë kthehem këtu ku jemi në këtë pikë. Fjalën e ka deputeti Ahmet Isufi.

AHMET ISUFI: Faleminderit, kryesues!

Propozimi është konkret, nga një prej anëtarëve të grupeve parlamentare të ofrohen edhe nëse mund të harmonizojnë qëndrimin, le ta bëjnë, nëse s'munden, mund të mos pajtohen dhe kryhet.

KRYESUESI: Faleminderit! Dhe, i fundit deputeti Shkumbin Demaliaj.



SHKUMBIN DEMALIAJ: Faleminderit, kryesues!

Lidhur me çështjen se a do të kompletohen grupet parlamentare tash edhe të vendosin me rekomandime, desha t'i shtoj fjalës së zonjës Osmani, se përpos atyre dy pikave që i tha më herët, duhet të tërhiqet nga rekomandimet edhe çështja e listave të veteranëve, për shkak se sot është në domenin e drejtësisë, është në duart e Prokurorisë Speciale të Kosovës. Dua t'ju njoftoj se jam intervistuar personalisht nga Prokuroria e Shtetit lidhur me këtë çështje dhe të mos ndërhyjmë në drejtësi. Unë edhe 15 anëtarë të tjerë të komisionit dhe t'ia lëmë në dorë drejtësisë këtë çështje, jo të merremi me çështje të rekomandimeve e të rezolutave për fushata politike. Faleminderit!

KRYESUESI: Atëherë, a dëshirojnë shefat e grupeve parlamentare të propozojnë përfaqësuesit. LDK-ja ka propozuar, PDK-ja? Memli Krasniqi!

MEMLI KRASNIQI: Blerta Deliu-Kodra.

KRYESUESI: Faleminderit! Lëvizja Vetëvendosje, besoj e ka përfaqësuesen. PSD? Dardan Sejdiu e ka fjalën.

DARDAN SEJDIU: Frashër Krasniqi.

KRYESUESI: Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, Ahmet Isufi.

AHMET ISUFI: Muharrem Nitaj.

KRYESUESI: Faleminderit! Lista serbe? S'është paraqitur askush. Nga Nisma, Bilall Sherifi.

BILALL SHERIFI: Deputetin Enver Hoti.

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi 6+, Albert Kinolli, urdhëro!

ALBERT KINOLLI: Deputetin Bahrim Shabani.

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë, u kërkoj përfaqësuesve të grupeve që të koordinohen bashkë me propozuesen dhe që të takohen, ta harmonizojnë tekstin e rezolutës. Ne kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës:

\* \* \*

*E premte, më 1 qershor 2018*

*Vazhdimi i mbledhjes së jashtëzakonshme, e filluar më 20 prill 2018*

*Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.*

KRYETARI:

***1. Votimi i propozim-rezolutës nga debati parlamentar lidhur me Raportin e Progresit për Republikën e Kosovës***

Vazhdojmë me votimin e propozim-rezolutës. Urdhëro, zonja Pacolli.

FITORE PACOLLI-DALIPI: Atëherë, të nderuar deputetë!

Pas debatit që e kemi mbajtur më 20 prill të këtij viti për Raportin për vendin, Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje pati propozuar disa rekomandime dhe në harmonizim të plotë me Grupin Parlamentar të LDK-së i patëm sjellë në votim. Pasi grupet e tjera dje insistuan që të kemi harmonizim, tentuam ta bëjmë harmonizimin e dytë me grupet e tjera parlamentare dhe i ftuam të gjitha në takim, mirëpo nuk arritëm të pajtohemi dhe këto pika, të cilat do t'i lexoj tani, janë në koordinim të plotë me Grupin Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje, LDK-së dhe të PSD-së.

Pra, po filloj nga pika e parë:

1. Të fillojmë një dialog të brendshëm për të ndërtuar një strategji shtetërore për rrugën që duhet të ndjekim drejt integritit evropian.
2. Obligohet Qeveria që brenda 30 ditëve të sjellë në Kuvend një plan të veprimit për t'i adresuar të gjeturat në Raportin për vendin.
3. Urgjentisht të ndërmerren hapat për departizimin e Administratës Publike, duke filluar me bordet e ndërmarrjeve dhe agjencive publike (te kjo pikë kërkesa e PDK-së, AAK-së, Nismës dhe 6+ ka qenë që të ndërrohet fjala “departizim” me “depolitizim”. Ne ua bëmë të qartë se këto dy koncepte janë shumë të ndryshme dhe nuk ka mundësi, ne s’po kërkojmë depolitizimin, por pikërisht po kërkojmë departizimin e Administratës.)
4. Në përputhje me kriteret e kapitujve 23 dhe 24 të Raportit për vendin, të hartohet plani aksional për formimin e sundimit të ligjit, si dhe të bëhet plotësimi i legjislacionit me miratimin e ligjeve antimafia dhe Ligjin për konfiskimin e pasurisë së paligjshme.

5. Obligohet Qeveria që brenda periudhës 6-mujore pas hyrjes në fuqi të kësaj rezolute të prezantojë në Kuvend një plan të veprimit konkret për krijimin e politikave për hapjen e vendeve të reja të punës nëpërmjet investimeve direkte në zhvillimin e prodhuesve vendorë.

6. Obligohet Qeveria që brenda periudhës gjashtëmujore pas hyrjes në fuqi të kësaj rezolute të iniciojë dhe ta sjellë në Kuvend për miratim Ligjin për mbrojtjen e prodhimeve vendore.

7. Obligohet Qeveria që të bëjë sigurime shëndetësore për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës, në mënyrë që asnjë qytetar të mos mbetet pa shërbim shëndetësor.

8. Obligohet Qeveria që në koordinim të plotë me komunat brenda periudhës gjashtëmujore pas hyrjes në fuqi të kësaj rezolute ta prezantojë një plan të veprimit konkret për investime në hapjen e çerdheve të nevojshme nëpër komuna dhe që hapja e çerdheve të bëhet prioritet.

9. Obligohet Qeveria që në koordinim të plotë me komunat brenda periudhës gjashtëmujore pas hyrjes në fuqi të kësaj rezolute ta prezantojë një plan të veprimit konkret për investime në shkolla profesionale dhe ndërlidhjen e tyre me nevojat e tregut vendor dhe ndërkombëtar.

10. Obligohet Qeveria që brenda periudhës gjashtëmujore pas hyrjes në fuqi të kësaj rezolute të prezantojë plan të veprimit konkret për vendosjen e raporteve të mira me 5 shtetet e BE-së, të cilat nuk e kanë njohur ende Kosovën.

11. Obligohet Qeveria që brenda periudhës gjashtëmujore pas hyrjes në fuqi të kësaj rezolute të prezantojë plan të veprimit konkret për thellimin e marrëdhënieve bilaterale me të gjitha shtetet e BE-së, të cilat e kanë njohur Kosovën.

12. Kuvendi i Republikës së Kosovës të krijojë komision për hetim parlamentar për pastrimin e listave të veteranëve nga personat që kanë bërë deklaram të rrejshëm për ta fituar padrejtësisht këtë status, si dhe të iniciohet plotësim-ndryshimi i Ligjit për veteranët e luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, dhe

13. Të bëhet hartimi i një plani të detajuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, nëpërmjet të cilit kërkohet nga Qeveria të raportojë çdo gjashtë muaj për realizimin e këtyre rekomandimeve.

Po ashtu, më duhet të ju njoftoj se grupet parlamentare të PDK-së, Nismës, 6+ dhe të AAK-së kanë kërkuar, pra kanë kushtëzuar që të largohen pikat që kanë të bëjnë me politikën për krijimin e vendeve të reja të punës dhe mbrojtjen e prodhimeve vendore. Kanë kërkuar që të largohet pika që ka të bëjë me sigurimet shëndetësore për të gjithë qytetarët, kanë kërkuar që të largohet pika që ka të bëjë me hapjen e çerdheve në tërë territorin e Kosovës. Pra, unë u kisha bërë thirrje deputetëve të tjerë që u takojnë këtyre grupeve që këtë rezolutë ta votojnë, për shkak se ne kemi

nevojë për çerdhe, ne kemi nevojë për shërbime shëndetësore dhe kemi nevojë për vende të reja të punës dhe mbrojtjen e prodhimeve vendore. Në pyetjen time pse duhet të largohet pika për krijimin e vendeve të reja të punës...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYETARI: Zonja deputete, në qoftë se do të bësh debat politik, luftë politike, po e shoh, a e solle të harmonizuar apo nuk jeni harmonizuar dhe shkoni në votim pa u harmonizuar. Ti po sillësh sikur s'po jetojmë në Kosovë. Të gjithë njerëzit po e dinë se partitë politike, përfshirë Lëvizjen Vetëvendosje më së shumti, e angazhon edhe nepotizmin dhe në të njëjtën kohë, edhe dje pikërisht kjo zhurma që u bë, emërojnë vëllain e njëri-tjetrit dhe e shkarkojnë, secila parti.

Shkojmë te rezoluta, se ka reagime, tash Memli erdhi këtu, Muharremi po e shoh reagon. Nuk është harmonizuar, shkojmë në votim. Shkojmë, por s'është harmonizuar. Ama, dëgjo, dilet në emër të harmonizimit, përmenden emocionet individuale, personale, të cilat kanë dalë, për besë, jo mirë. Ky nuk është harmonizim, ky është qëndrim i ndarë. Shkoni, votoni, shkojmë në bazë të Rregullores, votojmë drejtpërdrejt.

*(Ndërhyrje)*

Ama, praktikë jo e mirë vihet në emër të harmonizimit. Shkojmë nga Lidhja Demokratike e Kosovës, pra shkojmë te secili grup parlamentar, por herët tjera, në qoftë se s'harmonizohet, le të jenë korrektë, s'harmonizohet dhe mirë. Kërkoj falje, vetëm konsultim me nënkryetarin.

Nënkryetari i Kuvendit qenka më i familjarizuar me çështjen, por megjithatë po dalim te e njëjta. Grupet parlamentare me shkrim janë harmonizuar, por kjo çka doli aktualisht tregoi se s'është harmonizim, nuk qëndron. A është kështu? A po shkoni drejt në votim? A jeni për çfarë folëm?

*(Ndërprerje e incizimit)*

Zonja Fitore Pacolli le ta lexojë edhe një herë, por pastaj do t'ia jap fjalën secilit grup parlamentar, por në parim është mirë me atë që e dorëzon të shkruar dhe çka e flet të mbahet një korrespondencë, për arsye se në votim merret kjo të cilën e flet në foltore. Ky është adresimi i fundit, e ky ishte edhe reagimi.

Urdhëro, zonja Pacolli edhe një herë, i ke pesë minuta.

FITORE PACOLLI-DALIPI: Unë vetëm desha ta bëj një sqarim, kur thashë se këto pika kanë ndryshuar, e nënkuptova se kanë ndryshuar pas harmonizimit që e kemi bërë dhe normalisht duhet të lexohen para deputetëve. Pastaj, e sqarova që harmonizimi ka ndodhur vetëm ndërmjet

grupeve parlamentare të Lëvizjes Vetëvendosje, LDK-së dhe PSD-së. Grupet e tjera parlamentare, PDK-ja, AAK-ja, Nisma dhe 6+ kanë kërkuar të ndryshohet pika 3, ku thotë “departizim”, të ndryshohet me fjalën “depolitizim” dhe këtë nuk e kemi pranuar.

Kanë kërkuar që të largohen pikat që kanë të bëjnë me hapjen e vendeve të reja të punës, me çerdhe dhe me shërbime shëndetësore dhe ne nuk i kemi larguar as këto pika, pra nuk është bërë harmonizimi me partitë tuaja, me PDK-në, AAK-në, Nismën dhe 6+. T’i lexoj edhe një herë, a? Në rregull!

1. Të fillojmë një dialog të brendshëm për të ndërtuar një strategji shtetërore për rrugën që duhet të ndjekim drejt integrimit evropian.
2. Obligohet Qeveria që brenda 30 ditëve të sjellë në Kuvend një plan të veprimit për t’i adresuar të gjeturat në Raportin për vendin.
3. Urgjentisht të ndërmerren hapat për departizimin e Administratës Publike, duke filluar me bordet e ndërmarrjeve dhe agjencive publike.
4. Në përputhje me kriteret e kapitujve 23 dhe 24 të Raportit për vendin, të hartohet plani aksional për formimin e sundimit të ligjit, si dhe të bëhet plotësimi i legjislacionit me miratimin e ligjeve antimafia dhe Ligjin për konfiskimin e pasurisë së paligjshme.
5. Obligohet Qeveria që brenda periudhës 6-mujore pas hyrjes në fuqi të kësaj rezolute të prezantojë në Kuvend një plan të veprimit konkret për krijimin e politikave për hapjen e vendeve të reja të punës nëpërmjet investimeve direkte në zhvillimin e prodhuesve vendorë.
6. Obligohet Qeveria që brenda periudhës gjashtëmujore pas hyrjes në fuqi të kësaj rezolute të iniciojë dhe ta sjellë në Kuvend për miratim Ligjin për mbrojtjen e prodhimeve vendore.
7. Obligohet Qeveria që të bëjë sigurime shëndetësore për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës, në mënyrë që asnjë qytetar të mos mbetet pa shërbim shëndetësor.
8. Obligohet Qeveria që në koordinim të plotë me komunat brenda periudhës gjashtëmujore pas hyrjes në fuqi të kësaj rezolute ta prezantojë një plan të veprimit konkret për investime në hapjen e çerdheve të nevojshme nëpër komuna dhe që hapja e çerdheve të bëhet prioritet.
9. Obligohet Qeveria që në koordinim të plotë me komunat brenda periudhës gjashtëmujore pas hyrjes në fuqi të kësaj rezolute ta prezantojë një plan të veprimit konkret për investime në shkolla profesionale dhe ndërlidhjen e tyre me nevojat e tregut vendor dhe ndërkombëtar.

10. Obligohet Qeveria që brenda periudhës gjashtëmujore pas hyrjes në fuqi të kësaj rezolute të prezantojë plan të veprimit konkret për vendosjen e raporteve të mira me 5 shtetet e BE-së, të cilat nuk e kanë njohur ende Kosovën.

11. Obligohet Qeveria që brenda periudhës gjashtëmujore pas hyrjes në fuqi të kësaj rezolute të prezantojë plan të veprimit konkret për thellimin e marrëdhënieve bilaterale me të gjitha shtetet e BE-së, të cilat e kanë njohur Kosovën.

12. Kuvendi i Republikës së Kosovës të krijojë komision për hetim parlamentar për pastrimin e listave të veteranëve nga personat që kanë bërë deklaram të rrejshëm për ta fituar padrejtësisht këtë status, si dhe të iniciohet plotësim-ndryshimi i Ligjit për veteranët e luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, dhe

13. Të bëhet hartimi i një plani të detajuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, nëpërmjet të cilit kërkon nga Qeveria të raportojë çdo gjashtë muaj për realizimin e këtyre rekomandimeve.

Pra, këto janë rekomandimet për të cilat jemi koordinuar me LDK-në dhe PSD-në.

**KRYETARI:** Faleminderit! Në rregull është tash, është situatë shumë e qartë. Tash, a ka mundësi këto tri grupe parlamentare e kanë qëndrimin, t'i pyes grupet parlamentare që s'kanë qëndrim. Partia Demokratike e Kosovës, Memli Krasniqi, e ka fjalën.

**MEMLI KRASNIQI:** Faleminderit, kryetar!

Sa i përket kësaj çështjeje, ne po ballafaqohemi me një manipulim të organizuar. Populli e ka një fjalë: "Njeri që të rren dy herë, ai të rren gjithë". Kjo zonja që i lexoi këto, manipuloi, si doli aty tha "s'kemi arritur njëherë harmonizim".

Harmonizimi është arritur dje, por mashtrimi është bërë më vonë, sepse pasi janë pajtuar përfaqësuesit e krejt grupeve parlamentare për disa prej këtyre pikave, këta në mënyrë të njëanshme kanë ardhur dhe janë munduar ta imponojnë këtë rezolutë. Qysh e kanë bërë këtë farë marrëveshjeje me LDK-në dhe me PSD-në, është çështje e tyre, bile po habitem, për LDK-në po habitem, se për këta nuk habitem asnjëherë, se këta veç ëndrra mund të shohin ta obligojnë Qeverinë për të gjitha këto fusha. Por, këta që sapo kanë dalë prej Qeverisë, të thonë e mbështetim një rezolutë të tillë, kjo është përtej papërgjegjësisë politike. Kjo është e përçudnuar si qasje. Tjetra, u manipulua këtu, duke thënë s'e kanë dashur këtë pikë, e kanë dashur atë pikë. Kjo nuk është rezolutë, kjo është fontanë dëshirash. Këto janë 10 pika, ky është traktat politik. Kjo veç rezolutë nuk është. Këtu flitet për dhjetë pika, dhjetë fusha të ndryshme. Kjo s'ka të bëjë me çështjen e Raportit për vendin, as nuk ka qëllim të arrihet harmonizim, s'e di a jeni duke e kuptuar? Qëllimi i Vetëvendosjes me këtë rezolutë, e po habitem qysh po bëhet shërbëtoare e tyre LDK-ja, mbi të gjitha, nuk është të arrihet harmonizim, as nuk është të kalohet rezoluta, qëllimi i

tyre është të bëjnë politikë ditore, të thonë këqyr, vëlla, këta e kundërshtuan, ne e kaluam, ose diçka tjetër.

Kjo është e turpshme të prezantohet në Kuvendin e Kosovës, e para; e dyta, absolutisht është e papranueshme; e treta, qasja, të cilën unë dje e kam përmendur në një nga fjalët gjatë ditës që kemi arritur njëfarë praktike të bëjmë harmonizimin për shumë tema që i ka iniciuar opozita, nga ajo çka po e shoh sot, me sot po merr fund dhe besoj që merr fund, është keq për Kuvendin e Kosovës, sepse ne me këtë qasje normalisht që më së lehti e kemi të shkojmë në votim, i matim votat dhe s'lodhemi hiç, as për Contour Globalin, as për këtë çështje, as për çështjen që vjen pas saj.

Është e dhimbshme nëse ne duam ta humbim këtë farë praktike, por normalisht ne me zor s'mund ta marrim me të mirë opozitën, sepse ata mund të duan diçka tjetër, por absolutisht nuk janë të interesuar për të pasur pajtueshmëri as për këtë temë, e duket edhe për ato temat, të cilat janë në diskutim, ose që janë diskutuar dje. Kështu që ne jemi kundër 100%. Pse? Sepse, s'është rezolutë, e cila i adreson problemet, për të cilat kemi diskutuar në seancën e kaluar. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Vetëm pak, Glauk, Fitore, nga 2-3 të një grupi parlamentar... Jo, jo, vetëm pak! Nuk mund ta hapim si debat, jemi në përfundim. Unë e mirëkuptoj, le ta marrë fjalën një herë secili grup parlamentar. Armend Zemaj! Nga një prej secilit grup parlamentar, ju kisha lutur, për arsye se po e humbim fillin, nuk e kam hallin që s'po dua t'ju lë të flisni.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, kryetar!

Më shumë desha të sqaroj, sepse po duket që për informim po krijohen keqkuptime për qëllimin e harmonizimit të qëndrimit rreth një rezolute.

Kjo ka të bëjë me debatin e 20 prillit 2018, ashtu siç e potencuat edhe ju dhe u theksua edhe dje që në fund të debatit ka qenë një numër minimal i deputetëve të pranishëm në sallë. Rekomandimet që kanë dalë më 18 prill kanë qenë 8 pika të propozuara nga sponsorizuesi i këtij debati, Lëvizja Vetëvendosje.

Lidhja demokratike e Kosovës përmes përfaqësuesit të vet i ka shtuar edhe 4 pika. Nëse doni, po ua lexoj cilat janë pikat tona, por kjo nuk ka të bëjë tash me këtë që po flasim sot në tërësi. Dje është kërkuar që të jetë takimi shtesë, ku kanë marrë pjesë shumica e grupeve parlamentare. Unë e kam shprehur qëndrimin, që pajtohem me çdo pikë që pajtohen edhe grupet tjera politike. Përfaqësuesi i Nismës për tri pika që i potencuan se janë kundërshtuar, ka thënë se janë pjesë e programit politik qeveritar dhe nuk ka nevojë që të jenë pjesë e kësaj rezolute. Ky ka qenë ai dakordimi përtej kësaj.

Unë qëndroj prapa rekomandimeve që i ka dhënë Lidhja Demokratike e Kosovës, por kam qenë fleksibil ndaj propozimeve që më është dukur se janë adekuate për kohën dhe mundësitë dhe kapacitetet që i ka edhe Kuvendi edhe Qeveria e Republikës së Kosovës, qoftë në raportet integruese, qoftë në zhvillimin ekonomik dhe qoftë të gjitha që i potencoi dhe i lexoi edhe sponsorizuesja.

Kështu që, ne pajtohemi për të gjitha pikat në fjalë. Nëse ka dëshirore tjetër të shtohen, ose të eliminohen, prapë le të mbetet përgjegjësi e grupeve politike, por sa na përket neve, ne dakordohemi me të gjitha këto pika dhe nuk e kemi asnjë lloj dileme dhe s'ka asnjë lloj manipulimi. Nuk e di pse po tentohet që të zgjerohet apo të hidhet në luftë të taborëve politikë.

**KRYETARI:** Faleminderit! Lëvizja Vetëvendosje, zonja Fitore, paraqet edhe qëndrimin e partisë. Atëherë, zoti Glauk Konjufca.

**GLAUK KONJUFCA:** Ta them të drejtën, fillimisht nuk e kuptova këtë shpërthimin e Memlit, që e pati, sepse i lexova edhe një herë këto të dhjetë propozimet që janë, më duken shumë të mira. Duke i lexuar edhe një herë mu duk që tash e mora vesh ku është problemi. Po më duket, se është te pika 4 se është Ligji antimafia edhe me prurje një ligj për konfiskimin e pasurisë së paligjshme. Po më duket se kjo po e prek dikë, dikë që po më duket Memlit i ka rënë hise ta mbrojë edhe po shkakton probleme kjo pikë.

Pra, unë thelbin e kësaj që shoh e që të gjitha më duken pika të mira, për shembull një strategji shtetërore për integrimet evropiane, pas 30 ditëve me e adresua këtu të gjeturat e raportit të progresit, depolitizimi i administratës. Unë nuk e di pse, kujt i pengojnë këto dhe pse qenkan qëllime ogurzeza të Vetëvendosjes këto. Përnjëmend nuk po mund ta kuptoj.

Këto më duken shumë universale, shumë të mira për Kosovën. Është aty edhe një plan aksionar për luftimin e korrupsionit. Kështu që, le të na kallëzojnë më saktë ku e kanë problemin këta, se Fitorja e sqaroi faktikisht që ato dallime, për të cilat këtu po qohet shumë pluhur edhe nuk janë esenciale bre. Këto dallime nuk janë esenciale. A është departizimi i administratës, a është depolitizimi, nuk po e kuptoj këtë barrikadim të Partisë Demokratike të Kosovës kundër kësaj rezolute.

Shikoni edhe një herë, pavarësisht çfarë ka thënë Memli, lexoni edhe një herë edhe do të bindeni që janë shumë të mira për Kosovën. Nuk janë për kurrfarë përfitimi të Vetëvendosjes, e bëjnë më të mirë shtetin e Kosovës dhe nëse nuk bëhen këto dhjetë pika që ne po i propozojmë, me të cilat jemi dakorduar edhe me Lidhjen Demokratike edhe me Partinë Socialdemokrate, mendoj se mund ta përmirësojmë gjendjen, që të mos kemi më një raport tjetër të keq të progresit në vitin e ardhshëm. Ju a e keni vërejtur që qe katër vjet po na vijjnë raporte të njëjta të progresit?



Si ta hapësh faqen e parë thotë “Administrata e politizuar”, Gjyqësori i influencuar politikisht”, “lufta kundër korrupsionit e ulët, jo efektive”, me raste shumë të vogla dhe të kufizuara të gjykatave me vendime të prera të dënimi. A i keni këtu në raport të progresit? Për çdo vit e keni të njëjtin raport të progresit.

Pra, kështu nuk mund të keni as liberalizim të vizave, as nuk mund të keni përsheptim të procesit të integriteteve evropiane. E nëse merren këto masa, për shembull, pika 7 - sigurime shëndetësore për të gjithë qytetarët e Kosovës. Çka ka Memli Krasniqi kundër kësaj, ose Partia Demokratike? S’po mund ta kuptoj! Sa i përket asaj që s’jeni pajtuar me Fitoren diku e pastaj jeni pajtuar diku, ato po më duken jo esenciale për të mos i votuar këto pika kaq të mira, të cilat ndikojnë që vitin e ardhshëm të vijë një raport shumë më i mirë i progresit.

KRYETARI: Replikë, po e përfundojmë. Memli, replikë veç një minutë.

MEMLI KRASNIQI: Glauk Konjufca, unë kur shpërthej, shpërthej veç ndaj dyfytyrësisë dhe ndaj pafytyrësisë. Kështu që, reagimi im ishte ndaj pafytyrësisë dhe dyfytyrësisë së përfaqësuesve tuaj në këtë çështje, e para. E dyta, mos manipulohet se është e ulët dhe s’të beson kurrkush të thuash çka ka ky e çka ka ai kundër. Këto janë pjesë e programit të Qeverisë, i rregullon Qeveria e Republikës së Kosovës që e ka votuar ky Kuvend edhe janë të përfshira aty. Nuk u ka mbetur juve të bëni propozime të tilla, së paku jo tash, e para.

E dyta, çështjet që i përmende, që me e ditë ti, jo gjashtë muaj, më 12 qershor votohet Ligji për konfiskimin e pasurisë. Krejt kush e ka “mizën pas veshit”, le të shtrëngohen. Jo gjashtë muaj, që po i lyp ti, më 12 qershor ai ministri përballë teje e voton në Qeveri, kemi me e prurë në Kuvend edhe kemi me e votuar. Qysh i kemi prurë krejt pakon e ligjeve për sundimin e Ligjit në këtë vend edhe tërë këto punë janë duke u kryer, shërbimet shëndetësore edhe sigurimet shëndetësore është duke i bërë pikërisht ministri i PDK-së, që s’i ka bërë kurrë Kosova që sa vjet. Kështu që, është...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYETARI: Kundër-replikë edhe ti një minutë, në fakt gjysmë minute, regjia. Se e kam zvogëluar në një minutë, është dashur dy, një dhe 30 sekonda. Glauk nuk po ta bëj të padrejtë për shkak... po.

GLAUK KONJUFCA: Këtu e kam një raport të BE-së, po thotë autor: Mauricio Varaneze, Teobyl dhe Kamelia Bogdan, është raport shumë kredibil. 90% e krimit të organizuar të aseteve që i krijon krimi i organizuar nuk konfiskohen në Kosovë. Edhe ai shoku i Memlit, edhe ata që e kanë pasurinë të paligjshme nuk i konfiskojnë.

KRYETARI: Për atë, për fat të mirë, është shumë shpejt duke ardhur ligji. PSD-ja nuk ka askush. Aleanca, Muharrem Nitaj, shkojmë drejtë votimit. Shkoni në veting i kryeni këto çështje më të mira, vetingu i përfundon.

MUHARREM NITAJ: I nderuar kryetar i Kuvendit,

Të nderuar kolegë deputetë,

E para, teksti i rezolutës që është lexuar dje në Kuvendin e Kosovës ka pasur 11 pika. Sot na ka mbërri me 13 pika.

E dyta, nuk ka qenë fare problematike ajo që po thotë Glauku, pika 4. Nuk është diskutuar fare. Zonja Pacolli po thotë se Kosova ka nevojë për çerdhe, ka nevojë për vende pune, e tjerë, e tjerë... Realisht, ne pajtohemi që Kosova ka nevojë edhe për shumë gjëra tjera, ka nevojë që të shkojnë disa njerëz edhe në deti, po ja që natyra e rezolutave të Kuvendit të Kosovës është tjetër.

Ne kemi kërkuar që të hiqen tri pika dhe kemi kërkuar që të ndryshohet pika e dhjetë, kam përshtypjen se ka qenë për veteranët dhe në vend të kësaj ata kanë futur një Komision Hetimor për Listat e Veteranëve, një herë e kanë pasur në formë e në iniciale që Qeveria e Kosovës të bëjë spastrimin e listave të veteranëve, në ndërkohë që Qeveria e Kosovës nuk merret fare me këtë punë. Kemi kërkuar që kjo të hiqet. Në vend të asaj tash është kërkuar Komision Hetimor.

Unë besoj që Lëvizja Vetëvendosje po duket se nuk e ka fare qëllimin që ta kërkojë konsensusin e partive politike, në mënyrë që ky tekst të kalojë. Meqenëse është kështu, deputetët e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës nuk do të marrin pjesë fare në votim. Ne nuk jemi pjesë e përpilimit të këtij teksti, nuk janë përfillë sugjerimet tona, edhe pse aty u the se do të përfillëshin. Nuk jemi pjesë e këtij dokumenti dhe nuk marrim pjesë në votim. Po ashtu, kërkoj edhe prej kolegëve deputetë të Partisë Demokratike edhe të Nismës e 6+-it, që po ashtu të mos marrin pjesë në votim, sepse nuk është një projekt i përbashkët.

KRYETARI: Faleminderit! Bilall Sherifi fjala për ju.

BILALL SHERIFI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë,

Nuk do të kisha dalë të marr fjalën, sikur përfaqësuesja e Vetëvendosjes t'i kishte lexuar 12 pika, 13 pika, 15, sado që do të ishin bërë edhe Kuvendi të ishte ftuar për të votuar, pa marrë parasysh se si ka ardhur deri në këtë pikë.

Por, në momentin kur përfaqësuesja e Vetëvendosjes merret me propagandë të qëllimshme, unë ndihem i detyruar të dal para qytetarëve të shpjegoj se pse nuk është ashtu dhe të shpjegoj ku qëndron manipulimi.

Thotë që janë kërkuar të hiqen pikat që kanë të bëjnë me punësimin, që do të thotë se këta janë kundër punësimit. Nuk e tregon arsyen se pse është kërkuar që kjo pikë të mos përfshihet në rezolutë, domethënë nuk e tregon, e fsheh këtë. Domethënë, arsyeja, argumenti i përfaqësuesit të Nismës, po kjo është në Program Qeveritar. Nuk ka kuptim të fusim pika të rezolutës në program qeveritar.

Pra, e fsheh të vërtetën e plotë. Këtu qëndron manipulimi, kur ti qëllimshëm e fsheh tërësinë e së vërtetës, një.

Dy, thotë: “kanë kërkuar të hiqet pika që ka të bëjë me sigurime shëndetësore, pra këta janë kundër sigurimeve shëndetësore. Pra, këta janë kundër sigurimeve shëndetësore, qytetarë të nderuar, dine.” Këtu qëndron manipulimi.

Tre, thotë “kanë kërkuar që të hiqet pika që ka të bëjë me ndërtimin e çerdheve, pra, këta janë kundër ndërtimit të çerdheve...”, këtu qëndron manipulimi.

Pastaj, nuk e tregon krejt të vërtetën që përfaqësuesi i Nismës thotë, po përditë more, po ndërtohen çerdhe. Shih, veç në Prishtinë sa çerdhe janë duke u ndërtuar. Apo tash, çerdhet e Prishtinës më nuk i shohin. Deri dje një çerdhe e ndërtonin tre i proklamoni, tash tre ndërtohen asnjë nuk e pranojnë, këtu qëndron manipulimi.

Dhe, arsyeja se pse është kërkuar të hiqet çështja e veteranëve, sepse është çështje e drejtësisë. Nuk mund ne ministrin ta obligojmë të merret me këtë çështje. Sa i përket Qeverisë, ministrave, të gjitha strukturat që janë marrë me këtë çështje e kanë përfunduar punën e tyre, tash është çështje e prokurorisë. Tha dje deputeti, unë jam marrë tha në pyetje, jam pjesë e komisioneve, jam marrë në pyetje. Ky proces do të vazhdojë si i tillë.

Dhe për fund, të nderuar kolegë, unë me pak fjalë ju tregova ku qëndron manipulimi, se kolegu im, kryetari i Grupit Parlamentar të Vetëvendosjes nuk e din te ku është manipulimi dhe meqë nuk e dinte hyri në supozime. “Aaa, ju pra duhet të jeni kundër këtij ligji që ua ndjek shokët, ua ndjek miqtë, prandaj ju nuk e votuat, prandaj ju nuk pranuat të harmonizohet”. Kjo është asgjë më pak e as më shumë, se propagandë e mbushur me të pavërteta dhe insinuata.

Dhe për fund, kushdo që beson se ka një program më të mirë, duhet ta bëjë, të dalë në zgjedhje dhe t’i fitojë zgjedhjet dhe programin e tyre ta bëjnë program qeveritar. Nuk mund nga pozicioni i opozitës t’ua diktosh programin qeveritar, asnjë qeverie, as unë nesër nuk do të mundem tënden, nëse ndonjëherë vjen, po kështu s’ma mbushni mendjen që do të vini një herë, pa asnjë aleat, ama bash kurrkund, madje as me ata me të cilët për vite, madje edhe për dekada, keni ecur së bashku. Kjo ishte arsyeja përse dola dhe pse Nisma e mori fjalën, se ndërmend s’e kemi pasur me e marrë fjalën, sikur përfaqësuesja të kishte treguar edhe arsyet, se pse kanë kërkuar që këto

pika, jo të hiqen, po fare mos të figurojnë, sepse janë të panevojshme. Nuk mund të bëjmë rezolutë për diçka që është duke punuar, sot, nesër, bëhen veprime konkrete në vazhdimësi për këto çështje.

KRYETARI: Njëri merreni, ose ti, ose Fitorja, të lutem! Mos ta abuzojmë më shumë. Edhe merre një minutë, Fitore merri, ju jeni Vetëvendosje, një jeni. Fitore e ke një minutë, edhe Glauku një minutë.

FITORE PACOLLI: Kryetar,

Nuk është abuzim. Abuzim është kur flasin pa e ditur se çfarë po thonë. Turp nuk është të kërkosh çerdhe, sigurime shëndetësore dhe departizimin e Administratës Publike dhe vende të reja të punës.

Zoti Bilall Sherifi dhe zoti Nitaj, ju keni kërkuar që të tërhiqen këto pika dhe kur kam thënë, pse të hiqet pika për krijimin e vendeve të reja, përgjigja juaj ka qenë se Qeveria nuk krijon vende të punës. E unë ju kam thënë, se Qeveria ju si koalicion keni garuar me 300 mijë vende të punës, u keni premtuar qytetarëve, i keni gënjyer ata. Tha, jo tha ky ka qenë në kontekst tjetër, atëherë ka qenë fushata dhe Blerta Deliu u pajtua me këto të tria, kështu që unë nuk kam çka shtoj më tepër.

Raporti i progresit pikërisht thotë, se duhet të bohet departizimi i administratës, duhet të hapen çerdhe të reja, duhet të bëhen sigurimet shëndetësore, duhet të krijohen politika të reja për mbrojtjen e prodhuesve vendor. Asgjë nuk ka...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYETARI: Glauk, prit pak, në mujsha me te heq nervozën pa folur e ke një minutë. E kemi pasur një çerdhe, kur e përmendi Fitorja, e kemi pasur një çerdhe në legjislaturën e kaluar në Malishevë. Edhe, ne u morëm vesh, ju e dini të gjithë që me votua 50 mijë euro për ta ndërtuar çerdhen, se e meritonte Malisheva, ama kemi pas folur 3 orë pastaj veç tu fol. Urdhëro, Glauku një minutë.

GLAUK KONJUFCA: Jo, unë jam shumë i qetë, po mazhoranca është shumë e trazuar. Edhe s'po kuptoj pse, me të vërtetë, ende s'po mund ta zbuloj. E pash që menjëherë këtë që foli zoti Bilall Sherifi, krejt ia ka huqur.

S'e paska lexuar ky pikën 12 hiç. Këtu thuhet: "Komision Parlamentar", jo ministrit t'i gjuhet ajo përgjegjësi, Komision Parlamentar të krijohet, pse na dolën 60 mijë veteranë, garant më shumë se 1/3-ta e tyre të rrejtshëm. E të hulumtohet kjo çështje, se Raporti i Progresit po thotë janë fryrë listat e veteranëve edhe keni me pas probleme financiare. E pse të mos krijohet në Kuvend edhe

ta zbulojë Kuvendi me Komisionin e vet Hetimor, kush ishte ai që e bëri këtë manipulim. Manipulim është ai, zoti Sherifi, nuk është manipulim kjo që po kërkojmë...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYETARI: Vetëm, a ka mundësi, se po i ngatërrojmë gjërat, Glauku e përmendi. Glauk pse s'e marrim një moment tjetër, mosni se nuk mund të kryhen përnjëherë të gjitha. Për çështjen, nuk është mirë me luftëtarë me qenë objekt i diskutimit në këtë sallë. Po, se kanë... më fal, më fal, se aty do dal. Po, se është mirë të krijohet një Komision Hetues Parlamentar, ne e bëjmë të gjitha partive, vetëm kine parasysh është mirë me e bë edhe të kërkohet nga institucionet e Republikës së Kosovës që të shkohet deri në fund, që të mos abuzohet me luftëtarë të cilët janë të vërtetë, se po goditen luftëtarët. Ata manipuluesit pastaj po mbeten anash, sa janë zoti e di, por janë shumë.

Po, edhe diçka dua të them, me ia nisë prej neve të Shtabit të Përgjithshëm, veç me shikua a i kemi shti krejt familjet tona. Eh, me fillua tani tu ata që s'janë kon kurrë në luftë e kanë sharë UÇK-në e janë bërë veteranë. Unë fillova prej Shtabit të Përgjithshëm ku kam qenë, e ata si e kanë sha UÇK-në si e kanë quajt të mallkime e deri tash e mbarojmë një komision, inicione, unë e jepi nënshkrimin i pari, vetëm mos të abuzohet me luftëtarë. Jo, jo aty nuk bëhet ajo. Bëhet i veçantë, u ndihmohet organeve të jurisprudencës, Prokurorisë, Gjyqësisë, dalin, më fal, në medie, dalin të gjitha publike emrat, kush i ka anëtarësuar të gjithë ata luftëtarë që s'i kemi parë ndoshta në momentin kur ka qenë më së rëndi. E bëjmë, e bëjmë edhe mirë është, po të përgëzoj, por nuk është mirë aty të jetë. Për këtë reagoja. Aty nuk është mirë të jetë. E bëjmë një komision të veçantë të gjitha partitë.

Shkojmë në votim, ju kisha lutur të shkojmë në votim!

Replikë? Glauk, a e ke përmendur emrin e Muharremit e të Bilallit në fjalën tënde. Muharrem, një minutë, Bilall një minutë!

MUHARREM NITAJ: Përgjigje për zonjën Pacolli: Qeveria e Republikës së Kosovës nuk krijon vende pune. Sa i përket çështjes së veteranëve, në pikën e tekstit të djeshëm ka qëndruar kërkesa juaj eksplicite që Qeveria urgjentisht t'i spastrojë listat e veteranëve. Qeveria nuk e bën këtë punë dhe propozimin që të ndryshohet pika e kam dhënë unë që të krijohet një Komision Hetimor Parlamentar. Është mirë që ta kishit vendosur këtë.

Tri pikat që janë hequr, është mirë dhe e ndershme që të kishit dalë zonjë përpara deputetëve dhe deklarorit se është kërkuar jo pse deputetët dhe partitë kanë problem me përmbajtjen e pikave, por këto pika nuk e kanë vendin në një rezolutë, sepse janë të mbuluara në linja të tjera.

Ky ka qenë problemi ynë. Këtë e kemi kërkuar, që të hiqen dhe të miratohet rezoluta me pikat e domosdoshme. Ju nuk e keni dashur, ja ku e keni.

KRYETARI: Faleminderit! Bilall, edhe po shkojmë në votim.

BILALL SHERIFI: Beso që do ta kem më shkurt me Glaukun se një minutë. Gauk, a po e sheh ku qëndron manipulimi, u bëre pjesë e manipulimit. Dje nuk ka qenë komisioni, sot e keni futur komisionin Glauk, njëanshëm e keni shtuar Glauk komisionin. Pra, Sami mos e këshillo se e di ajo vetë të shpifë më mirë se ti, besomë!

Pra, unë po them që mos u bëj tash krejt pjesët ta nxirrni manipulimin si të vërtetë, se nuk e fshihni dot manipulimin.

Këtu problemi qëndron te fakti që në mënyrë të njëanshme kanë shtuar, pastaj thonë s'po e duan komisionin. Dje, përfaqësuesi ynë kur është bisedua nuk ka qenë për komision, pra nuk mund ti njëanshëm t'i ndryshosh harmonizimet.

Prandaj, Glauk, merre edhe të djeshmin, edhe të sotmin, nëse dëshiron të përfshihesh në debat pa e huq.

KRYETARI: Jo, janë biseda ndërmjet miqsh, për opinionin publik kur po përdoren emrat, të shumtën kanë konotacion pozitiv. Janë ndërmjet miqsh, janë raporte, pavarësisht partive të ndryshme.

Ne shkojmë në votim. E votojmë atë të cilën e ka lexuar zonja Fitore Pacolli-Dalipi. Votoni për, kundër, abstenim, është çështja juaja. Nënkryetari i Kuvendit, vetëm ju kisha lutur... Urdhëro, zoti nënkryetar!

KUJTIM SHALA: Faleminderit, zoti kryetar!

KRYETARI: Ju kisha lutur! Albulenë! A do të kishte mundësi, nënkryetari e ka fjalën.

A ka mundësi Lumir, Vjosë, ju kisha lutur! Nënkryetar, fjala për ju, vëmendje pak!

KUJTIM SHALA: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar kolegë,

Meqë unë ju dëgjova të gjithëve dhe po flas i fundit për këtë çështje, ju lus që të keni pak durim.

Unë besoj që ky debat s'është aspak i vërtetë, sepse s'ka të bëjë me çështjen. Mendoj që s'ka kurrfarë manipulimi, por po diskutojmë për çështje përreth.

Pse s'ka manipulim? Sepse si procedurë, ne mund të punojmë me tekstin edhe tani. Do të thotë, është i hapur, por unë pajtohem që prapë si procedurë propozuesi para votimit kur ta lexojë tekstin s'ka të drejtë të komentojë, as të mbajë qëndrim politik, por duhet ta lexojë tekstin fjalë për fjalë.

Çështja tjetër që ka të bëjë me përmbajtjen. Unë nuk pashë ndonjë refuzim konkret, përpos pikës dymbëdhjetë, sepse do të ishte shumë e rëndësishme të shihnim çfarë nuk pranon koalicioni, çfarë nuk pranon shumica, çfarë është e papranueshme për ta. Domethënë problemi është vetëm te pika 12 dhe aty edhe unë vërej që ka një keqkuptim, sepse nuk është formuluar si duhet.

Nuk mund Kuvendi me një rezolutë ta obligojë Qeverinë që të krijojë Komision Hetimor Parlamentar, sepse është mandat i Kuvendit dhe Kuvendi e krijon vetë. Besoj që ideja ka qenë për një Komision verifikues.

Ndërkaq Bilall, teksti është autentik, sepse unë këtë tekst e kam marrë dje, kam qenë drejtues i seancës, është i protokolluar, i dorëzuar më 31. 5. 2018, pika 12 është autentike, domethënë nuk është prekur, dhe në këtë rast nuk ka kurrfarë manipulimi.

Tani, problemi që po e paraqitni ju, domethënë shumica, që teksti është i gjatë, që ka përmbajtje shumë dhe pjesë të rëndësishme të saj janë pjesë e Programit qeveritar. Shumë mirë, unë nuk e di pse është problem.

Nëse ky tekst e merr Programin qeveritar dhe e replikon i kujton Qeverisë që të bëjë ato punë të cilat ajo i ka ndërmend. Nëse Qeveria e kryen një pikë të caktuar, një kërkesë të caktuar i shkruhet si një plus, si një favor, domethënë si një përmbushje e kësaj rezolute, ose një pjesë e saj.

Tani unë konkretisht, meqë po më duket që ka mundësi, ju mund të vendosni, jemi në procedurë, mund të votojmë, por ndoshta do të ishte mirë që tentonim edhe një herë ta harmonizonim tekstin, ose së paku t'i eliminonim pretendimet për manipulim të këtij procesi. Faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit! Zonja Fitore Pacolli-Dalipi, të lutem, e ka lexua një projekt-rezolutë. Në qoftë se dëshironi ta votoni, e votoni; nuk e votoni është përgjegjësi juaja. Më vjen keq Bilall, është nënkryetari i Kuvendit, proceduralisht ka biseduar. Shkojmë në votim, ju lutem!

Regjia e deputetët të përgatiten për votim, a jemi gati? Një orë e kemi harxhuar për këtë çështje. Votojmë tash!

Kanë votuar 45 deputetë, 40 për, 8 kundër asnjë abstenim. Po rikthehem edhe një herë.

E votojmë edhe një herë këtë propozimin e projekt-rezolutës së Fitore Pacollit-Dalipit? Ta provojmë dy herë, se zakonisht... Shkojmë edhe një herë, se zakonisht çdo herë e provojmë dy herë.

Përgatitemi për votim për atë që e ka lexuar zonja Fitore Pacolli-Dalipi. Votojmë tash!

Kanë votuar 48 deputetë, 41 për, 7 kundër, abstenim. Përsëri mungesë e kuorumit.

\* \* \*



*E enjte, më 4 qershor 2018*

*Vazhdimi i mbledhjes së jashtëzakonshme, e filluar më 20 prill dhe 1 qershor 2018*

*Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.*

KRYETARI:

***1. Votimi i propozim-rezolutës nga debati parlamentar në lidhje me Raportin e Progresit për Republikën e Kosovës***

Diskutimet për këtë pikë i kemi përfunduar më 20 prill 2018. E ftoj deputeten Fitore Pacolli që në cilësinë e propozuesit ta paraqesë tekstin.

Atëherë ke folur, zonja Fitore a pajtohesh që të shkojmë drejt në votim. Shkojmë drejt në votim me mirëkuptimi tuaj. Po e shoh edhe reagimin e zonjës Pacolli. Ju lutem, për mirëkuptim! Është pozitiv, megjithëse ajo ka të drejtë po të donte. Mund të lodheni, por ka pasur të drejtë.

Përgatitemi për votim. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Kanë votuar 77 deputetë, 36 për, 39 kundër, 2 abstenime; pastaj 2 me dorë kundër, 1 me dorë për, d.m.th. 79 deputetë, që i bie 37 për, 41 kundër dhe 2 abstenime.

Konstatoj se Kuvendi nuk e miratoi rezolutën e propozuar nga Lëvizja Vetëvendosje të harmonizuar me grupet parlamentare.

*E përgatiti:  
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*